The presented results are part of a research of the health needs after hospital treatment among patients aged 65 years and over, discharged during a 45-day period from therapeutic (internal medicine and neurology) and surgical (surgery and orthopaedics) wards of two multi-profile hospitals in northeastern Bulgaria. During the aforementioned period, 416 hospitalized patients left these hospital wards. Of them, 398 were discharged from hospital, 1 was transferred to another hospital, and 17 died in hospital. From 398 ones discharged from hospital - 7 refused to participate in the study. From 391 patients agreed to participate - 9 dead by the 7^{th} day after discharge. From 382 remaining patients, 10 were excluded from the study because of a very distant place of residence. Among the 372 remaining patients, 10 were rehospitalized in the same or in another ward within the same hospital - the information about these patients was provided by the respective hospital wards at every discharge. During data processing, the patients discharged for the second time were consigned to the ward from which they had been discharged for the first time. Thus, the size of the sample at the beginning of the study was 362 patients. Their mean age was 75.07±6.14 years, ranging from a minimal age of 65 and maximal of 98 years. The respondents were visited at their homes in 12 towns and 64 villages on the 7^{th} day (7.41±0.85) and 30^{th} day (33.36±3.92) after discharge. Because of the death of 23 persons between the 7^{th} and 30^{th} day, the size of the sample during the second visit altered to 339 patients. Information about patients' felt needs, expressed needs, and received medical care was obtained via a semi-structured interview. The presented results covered the patients who had survived the 30^{th} day after the discharge. Statistical analysis was made by descriptive statistics, chi-square and correlation analysis (Pearson's correlation coefficient), using of SPSS for Windows, version 12.0.1.

RESULTS AND DISCUSSION

The medical supervision after discharge from hospital depends on the needs felt by the patients, of the examinations recommended in the hospital and by GP, of the demand for medical care (personal visit to a GP or call for home visit), as well as of the possibility to obtain such a care (organization and accessibility of the medical care).

By the 30th day after discharge from hospital, 316 patients (93.2% of the cases) felt needs for GP services (Table 1). The most common frequency of the felt needs for GP was two times. Among the patients of the surgical wards, the needs felt once and twice have an equal share, and they were explained with the necessity to extract surgical catguts or change dressing. The patients of the orthopaedics represent the highest frequency (of more than three times) of felt needs, caused by the necessity not only to change dressing but also for parenteral application of anticoagulants. One quarter of the patients discharged from the wards of internal medicine felt needs for GP more than three times, which was explained by the necessity to control blood pressure.

Table 1.

Felt needs for GP services, within 30 days after discharge from hospital (n=339)

Frequency	Patients discharged from:				total
	Surgery	Orthopaedics	Internal Medicine	Neurology	
never	13 (10.7%)	6 (7.5%)	4 (5.3%)	0 (0.0%)	23 (6.8%)
once	42 (34.4%)	19 (23.8%)	19 (25.3%)	16 (25.8%)	96 (28.3%)
two times	42 (34.4%)	17 (21.3%)	26 (34.7%)	28 (45.2%)	113 (33.3%)
three times	5 (4.1%)	8 (10.0%)	7 (9.3%)	8 (12.9%)	28 (8.3%)
> 3 times	20 (16.4%)	30 (37.5%)	19 (25.3%)	10 (16.1%)	79 (23.3%)
total	122 (100.0%)	80 (100.0%)	75 (100.0%)	62 (100.0%)	339 (100.0%)

No statistically significant differences in felt needs for GP services by sex and age were found ($p>0.05$).

The frequency of the visits to GP was analyzed in order to differentiate the expressed needs concerning the disease having caused the hospital admission and, respectively, other diseases. The respondents' primary ground for the visit was set as the main criterion. The total results show that the disease that caused the hospitalization represents the respondents' primary ground to visit GP (Table 2).

Table 2.

Ambulatory visits to GP within 30 days after discharge from hospital (n=339)

Frequency	Patients discharged from:				total
	Surgery	Orthopaedics	Internal Medicine	Neurology	
Owing to the disease that led to hospitalization					
never	76 (62.3%)	71 (88.8%)	38 (50.7%)	29 (46.8%)	214 (63.1%)
once	42 (34.4%)	6 (7.5%)	17 (22.7%)	21 (33.9%)	86 (25.4%)
two times	4 (3.3%)	2 (2.5%)	14 (18.7%)	11 (17.7%)	31 (9.1%)
three times	0 (0.0%)	0 (0.0%)	4 (5.3%)	1 (1.6%)	5 (1.5%)
> 3 times	0 (0.0%)	1 (1.3%)	2 (2.7%)	0 (0.0%)	3 (0.9%)
total	122(100.0%)	80 (100.0%)	75 (100.0%)	62 (100.0%)	339(100.0%)
Owing to another disease					
never	78 (63.9%)	80 (100.0%)	55 (73.3%)	52 (83.9%)	265 (78.2%)
once	39 (32.0)	0 (0.0%)	18 (24.0%)	10 (16.1%)	67 (19.8%)
two times	5 (4.1%)	0 (0.0%)	1 (1.3%)	0 (0.0%)	6 (1.8%)
three times	0 (0.0%)	0 (0.0%)	1 (1.3%)	0 (0.0%)	1 (0.3%)
> 3 times	0 (0.0%)	0 (0.0%)	0 (0.0%)	0 (0.0%)	0 (0.0%)
total	122 (100.0%)	80 (100.0%)	75 (100.0%)	62 (100.0%)	339 (100.0%)

The disease having caused hospital admission relates to a greater frequency of visits to GP in comparison to visits owing to another disease ($p<0.05$). The single visits owing to another disease were mainly due to the need to control arterial hypertension, as well as to monthly prescription of drugs for chronic

diseases covered by the National Health Insurance Fund. The patients discharged from the therapeutic wards and those discharged from surgery that needed dressing changes account for the bulk of the visits to GP. The patients discharged from the orthopedics feature the smallest number of visits to GP; no disease different from the one which caused the hospitalization has been a leading ground to visit GP.

The medical supervision of the patients with limited mobility was implemented as home visits by GP. These patients expressed their needs for GP service by calls for home visits. The performed home visits are significantly related to the calls ($r=0.685$, $p<0.001$), with the discrepancies being determined by the GPs' refusals for home visits and by the visits initiated by GPs. The greatest number of home visits was performed to the patients discharged from the orthopedics followed by those discharged from the neurology *(Table 3).*

Table 3.

Calls to and home visits by GP within 30 days after discharge from hospital (n=339)

Frequency	Patients discharged from:				total
	Surgery	Orthopaedics	Internal Medicine	Neurology	
Calls for home visits					
never	100 (82.0%)	29 (36.3%)	52 (69.3%)	41 (66.1%)	222 (65.5%)
once	19 (15.6%)	30 (37.5%)	13 (17.3%)	15 (24.2%)	77 (22.7%)
two times	1 (0.8%)	13 (16.3%)	6 (8.0%)	5 (8.1%)	25 (7.4%)
three times	0 (0.0%)	4 (5.0%)	4 (5.3%)	0 (0.0%)	8 (2.4%)
> 3 times	2 (1.6%)	4 (5.0%)	0 (0.0%)	1 (1.6%)	7 (2.1%)
total	122 (100.0%)	80 (100.0%)	75 (100.0%)	62 (100.0%)	339(100.0%)
Home visits					
never	103 (84.4%)	31 (38.8%)	56 (74.7%)	43 (69.4%)	233 (68.7%)
once	16 (13.1%)	24 (30.0%)	10 (13.3%)	12 (19.4%)	62 (18.3%)
two times	3 (2.5%)	13 (16.3%)	4 (5.3%)	6 (9.7%)	26 (7.7%)
three times	0 (0.0%)	3 (3.8%)	3 (4.0%)	0 (0.0%)	6 (1.8%)
> 3 times	0 (0.0%)	9 (11.3%)	2 (2.7%)	1 (1.6%)	12 (3.5%)
total	122 (100.0%)	80 (100.0%)	75 (100.0%)	62 (100.0%)	339 (100.0%)

The intensive contacts between the patients and GPs within the first month after discharge from hospital confirm the paramount importance of primary medical care as a component of the medical monitoring of elderly people. However, the opportunity to receive health benefits varies in the different settlements: patients living in villages have been examined less often by GP than those in towns ($p<0.001$).

A total of 96 respondents (28.3% of the cases) reported difficulties regarding the meeting of their needs for GP services within one month after discharge. The main problems were: transportation difficulties to reach the settlement where the GP practice was (45 patients); GP refusal for home visits (16 patients) explained by GPs with lack of transportation; and other problems (35 patients). The last group of problems stem from rare or missing visits of GPs in the villages (non-performance of the visits required by GP practice regulations). In some villages there are no visits by GP at all. To the question how they act when a GP is not present in the village, all the respondents spontaneously answered that they did hope not to become ill. Those who are incapable of traveling or live in villages without public transportation to the GP practice settlement either do not visit GP, or rely on their relatives from the same or from another settlement to transport them by car. Because of the uncertainty of the last scenario, the emergency aid remains the main source of medical care for the people living in villages.

A total of 98 respondents (28.9%) had felt needs for a specialized outpatient medical care (SOMC) concerning the disease that had caused their hospitalization while 60 (17.7%) – because of another disease ($p<0.05$). The needs for SOMC springing from another disease were determined by the accompanying chronic diseases. It should be taken into consideration that the felt needs owing to the disease that caused the hospitalization are influenced by the recommendations received in the hospital with regard to the monitoring of the course of the disease by a specialist; however, these recommendations are filtered by the individual patients' sensations. The results of the present study show that the patients discharged from the neurology and the orthopedics had the majority of felt needs for SOMC *(Table 4).*

Table 4.

Felt needs for specialized outpatient medical care within 30 days after discharge from hospital (n=339)

Frequency	Patients discharged from:				*total*
	Surgery	Orthopaedics	Internal Medicine	Neurology	
Owing to the disease that led to hospitalization					
never	105 (86.1%)	51 (63.8%)	54 (72.0%)	31 (50.0%)	241 (71.1%)
once	15 (12.3%)	18 (22.5%)	20 (26.7%)	25 (40.3%)	78 (23.0%)
two times	0 (0.0%)	3 (3.8%)	1 (1.3%)	4 (6.5%)	8 (2.4%)
> 2 times	2 (1.6%)	8 (10.0%)	0 (0.0%)	2 (3.2%)	12 (3.5%)
total	122 (100.0%)	80 (100.0%)	75 (100.0%)	62 (100.0%)	339 (100.0%)
Owing to another disease					
never	99 (81.1%)	70 (87.5%)	64 (85.3%)	46 (74.2%)	279 (82.3%)
once	19 (15.6)	8 (10.0%)	8 (10.7%)	10 (16.1%)	45 (13.3%)
two times	3 (2.5%)	2 (2.5%)	3 (4.0%)	6 (9.7%)	14 (4.1%)
> 2 times	1 (0.8%)	0 (0.0%)	0 (0.0%)	0 (0.0%)	1 (0.3%)
total	122 (100.0%)	80 (100.0%)	75 (100.0%)	62 (100.0%)	339 (100.0%)

No statistically significant differences in felt needs for SOMC by sex and age were found ($p>0.05$).

The needs for SOMC were met by ambulatory visits to a specialist or by home visits performed by a specialist. The ambulatory visits among the patients discharged from the neurology represented the greatest share not only because of the disease that had caused the hospital admission but also because of another disease. The home visits by a specialist were occasioned by the disease treated in the hospital, and predominantly to the patients discharged from the orthopaedics and neurology (Table 5 and Table 6).

Table 5.

Ambulatory visits to a specialist in outpatient medical care within 30 days after discharge from hospital (n=339)

Frequency	Patients discharged from:				*total*
	Surgery	Orthopaedics	Internal Medicine	Neurology	
Because of the disease having caused the hospitalization					
never	110 (90.2%)	69 (86.3%)	61 (81.3%)	42 (67.7%)	282 (83.2%)
once	12 (9.8%)	8 (10.0%)	14 (18.7%)	19 (30.6%)	53 (15.6%)
two times	0 (0.0%)	2 (2.5%)	0 (0.0%)	1 (1.6%)	3 (0.9%)
> 2 times	0 (0.0%)	1 (1.3%)	0 (0.0%)	0 (0.0%)	1 (0.3%)
total	122 (100%)	80 (100%)	75 (100%)	62 (100%)	339 (100%)
Because of another disease					
never	102 (83.6%)	74 (92.5%)	70 (93.3%)	49 (79.0%)	295 (87.0%)
once	16 (13.1)	6 (7.5%)	3 (4.0%)	8 (12.9%)	33 (9.7%)
two times	3 (2.5%)	0 (0.0%)	2 (2.7%)	5 (8.1%)	10 (2.9%)
> 2 times	1 (0.8%)	0 (0.0%)	0 (0.0%)	0 (0.0%)	1 (0.3%)
total	122 (100%)	80 (100%)	75 (100%)	62 (100%)	339 (100%)

Table 6.

Home visits by a specialist in outpatient medical care within 30 days after discharge from hospital (n=339)

Frequency	Patients discharged from:				*total*
	Surgery	Orthopaedics	Internal Medicine	Neurology	
never	121 (99.2%)	69 (86.3%)	73 (97.3%)	55 (88.7%)	318 (93.8%)
once	0 (0.0%)	7 (8.8%)	2 (2.7%)	3 (4.8%)	12 (3.5%)
two times	0 (0.0%)	2 (2.5%)	0 (0.0%)	3 (4.8%)	5 (1.5%)
> 2 times	1 (0.8%)	2 (2.5%)	0 (0.0%)	1 (1.6%)	4 (1.2%)
total	122 (100%)	80 (100%)	75 (100%)	62 (100%)	339 (100%)

There are significant differences between the felt needs and the accomplished examinations by a specialist ($p<0.001$). The results demonstrate an insufficient meeting of the needs by SOMC and a poor specialized control not only over the disease treated in the hospital but also over the accompanying diseases.

Examinations by a specialist of the patients living in villages were significantly less than those of patients in towns ($p<0.001$).

Difficulties to meeting the needs for SOMC within one month after discharge from hospital were reported by 68 respondents (20.1%). The main problems were: transportation difficulties to reach the settlement where the specialist was (23 patients); GP refusal to issue referral for a specialist's examination (9 patients) because of the monthly limit, set by the national regulations, to the number of referral forms; delayed issue of referrals (2 patients); high cost of paid examination (8 patients); and other troubles (26 patients). But the issue of referral does not guarantee the performance of a specialized examination. The last group of problems were reported by the respondents who had received referrals: lack of public transportation to another settlement; lack of transportation for patients with wheel-chairs; and specialists' refusal to perform home visits in the villages.

A total of 132 respondents (38.9%) underwent control examinations in the hospital. These were mainly one-time examinations (Table 7). Most control examinations were done to the patients discharged from the wards of surgical profile, with the single ones determined by the necessity to extract the catgut.

Table 7.

Control examination in the hospital within 30 days after discharge (n=339)

Frequency	Patients discharged from:				*total*
	Surgery	Orthopaedics	Internal Medicine	Neurology	
never	64 (52.5%)	48 (60.0%)	56 (74.7%)	39 (62.9%)	207 (61.1%)
once	48 (39.3%)	26 (32.5%)	16 (21.3%)	23 (37.1%)	113 (33.3%)
two times	8 (6.6%)	5 (6.3%)	3 (4.0%)	0 (0.0%)	16 (4.7%)
> 2 times	2 (1.6%)	1 (1.3%)	0 (0.0%)	0 (0.0%)	3 (0.9%)
total	122 (100%)	80 (100%)	75 (100%)	62 (100%)	339 (100%)

Control examinations did not take place for the following reasons: 74 patients felt well; 47 did not know they had the right to control examination in the hospital; and the rest had transportation difficulties. Setting aside the transportation barrier, the issue of the awareness of the right to control examination comes to the forefront. The respondents who did not know that they had the right to control examination had not been verbally informed about it in the hospital. The written information appears in the discharge summary, but 35 respondents had not received such a document even 30 days after their discharge.

CONCLUSIONS

Medical supervision of elderly people after discharge from hospital is performed mainly by the primary medical care. Nevertheless, the concentration of GPs in the towns makes medical monitoring on the elderly in rural areas problematic. Transportation obstacles represent the chief reason for the difficult access to primary medical care of elderly people in the villages. In view of the above, the distribution and organization of GP practices should not be limitation factors for the right to medical care because of age and place of residence.

The specialized medical supervision on elderly people after their hospital treatment is very restricted. The GP refusals to provide the patients with referrals for specialized medical examinations because of the monthly limit to these forms lead to narrowed access to specialized medical care. The specialized outpatient care is especially difficult to access for elderly patients in rural areas because of transportation problems.

The medical follow-up in the hospital is limited by the patients' unawareness of the right to control examination, as well as by transportation problems. The realization of the right to control examination requires first of all the provision of information about this right to the patients while they are still in the hospital.

The demand for medical care is an expression of individual responsibility for health. At advanced age the expression of this responsibility is limited, which necessitates the increase of the public responsibility for the management of the health care for the elderly and ample coordination between all medical services.

REFERENCES

1. National Statistical Institute of Bulgaria. Available from http://www.nsi.bg/Population/Population.htm. [in Bulgarian].
2. National Centre for Health Information. Healthcare Statistical Book 2007. Sofia: NCHI, 2008. [in Bulgarian].
3. National Framework Contract between the National Health Insurance Fund, the Bulgarian Medical Association and the Bulgarian Dental Association for 2006. State gazette No 106, 2005. [in Bulgarian].
4. Health Establishments Act. State gazette No 62, 1999. [in Bulgarian].
5. Regulation №29 about the major requirements to which must comply the structure, activity and the internal order of the hospitals, dispensaries and medical-social care units**.** State gazette No 108, 1999. [in Bulgarian].

РЕЗЮМЕ

ОПИТЪТ НА ЗДРАСТНИТЕ ПАЦИЕНТИ СЛЕД ИЗПИСВАНЕ ОТ БОЛНИЦА В БЪЛГАРИА: ПОТРЕБНОСТ ОТ ПОДОБРЯВАНЕ НА УПРАВЛЕНИЕТО НА МЕДИЦИНСКИТЕ ГРИЖИ

Лора Георгиева[1]

[1]Катедра "Социална медицина и организация на здравеопазването"
Медицински университет, Варна, България

Нарастването на пропорциите на възрастните хора и на техните хоспитализации в България изисква специално внимание към медицинските грижи за тях. Представените резултати са част от проучване на здравните потребности на 339 пациенти на възраст 65 и повече години, изписани от отделения с хирургичен и терапевтичен профил на две многопрофилни болници. Опитът на пациентите в процеса на посрещане на здравните потребности в следхоспитализационния период е изследван чрез полуструктурирано интервю в техните домове на 30-ия ден след изписването им от болницата. Резултатите показват, че първичната медицинска помощ играе ключова роля в грижите за възрастните хора, докато наблюдението от специализираната извънболнична помощ и контролните прегледи в болницата са много ограничени. Основните бариери пред получаването на медицинска помощ са организационни проблеми и транспортни затруднения. Осигуряването на цялостно медицинско наблюдение на възрастните хора след изписване от болницата изисква пълноценна координация между всички медицински услуги.

Ключови думи: Възрастни хора, следхоспитализационен период, медицинско наблюдение, управление на грижите

REZYME

PËRVOJA ME PACIENTËT E SHËNDOSHË PAS LËSHIMIT NGA SPITALI NË BULLGARI: NEVOJA PËR PËRMIRËSIMIN E MENAXHIMIT TË KUJDESIT SHËNDETËSORË

Lora Georgieva[1]

[1]Katedra " Mjekësia Sociale dhe Organizata Shëndetësore"
Universiteti i Mjekësisë, Varna, Bullgari

Rritja e përqindjes së njerëzve të moshuar dhe hospitalizmi i tyre në Bullgari kërkon vëmendje dhe kujdes të veçantë mjekësorë për ata. Rezultatet e prezantuar janë pjesë e një studimi të nevojave shëndetësore te 339 pacientë të moshës 65 vjeç e më tepër, te lëshuar nga dy spitale të përgjithshme nga repartet me profile kirurgjike dhe terapeutike. Përvoja me pacientët në procesin e plotësimit të nevojave shëndetësore gjatë periudhës pashosptalizimit u studiua me intervista gjysëmstrukturore te shtëpitë e tyre në ditën e 30 pas lëshimit nga spitali. Rezultatet tregojnë se kujdesi primar luan një rol kyç në kujdesin e njerëzve të moshuar, ndërsa monitorimi i specializuar ndihmues jashtëspitalor dhe kontrollet mjekësore ne spital janë shumë të kufizuar. Barierat kryesore për marrjen e ndihmës mjekësore janë çështjet organizative dhe transporti i vështirsuar. Sigurimi i mbikqyrjes gjithpërfshirëse mjekësore te njerëzit e moshuar pas lëshimit nga spitali kërkon kordinim të plotë të të gjitha shërbimeve mjekësore.

Fjalë kyç: Njerëz te moshuar, periudha pashospitalizimit, mbikqyrje mjekësore, menaxhimi i kujdesit

PUNIM BURIMOR SHKENCOR / ORIGINAL SCIENTIFIC PAPER
PSIKIATRI

RELACIONET NË MES TË DHUNËS FAMILIJARE DHE SHKOLLORE NDAJ ADOLESHENTËVE DHE KONSUMIMIT TË DROGËS

Kadri Haxhihamza[1], Marija Raleva[1], Florentina Hani[2], Dimitrinka Jordanova Pesevska[3], Rozalinda Isjanovska[4], Izabela Filov[5], Viktor Isjanovski[6], Lidija Sushevska[7], Aktan Ago[8], Blagojçe Gjorqevski[9]

[1]OSHP Klinika e Psikiatrisë, Shkup
[2]SHMK "Dr.IbrahimTemo", Strugë, Maqedoni
[3]Organizatat Shëndetësore Boterore, Byroja Shtetërore në Maqedoni, Shkup, Maqedoni
[4]Instituti i Epidemiologjisë me Biostatistikë dhe Informatikë Mjekësore,
Fakulteti i Mmjekësisë, Shkup, Maqedoni
[5]OSHP Spitali Psikiatrik "Demir Hisar", Demir Hisar, Maqedoni
[6]OSHP Spitali Psikiatrik "Skopje", Shkup, Maqedoni
[7]OSHP Spitali i Qytetit "8 Shtatori", Shkup, Maqedoni
[8]SHMSHGJ"Josip Broz Tito", Shkup, Maqedoni
[9]SHMSHM "Pançe Karagjozov", Shkup, Maqedoni



Kadri Haxhihamza, mjek psikiatër, magjistër
Rr. Resenska 14/2-8, shkup, Maqedoni
Tel: 075 456 917 & 022624043
e-mail: **loli@datedu.com.mk**

REZYME: *Në periudhën Mars-Maj 2010, në shkolla profesionale dhe gjimnaze në Shkup, Gostivar, Strugë, Manastir dhe Shtip u ekzekutua studim i cili ishte nga tipi i "prerjes tërthore"(„Cross section") mbi 664 nxënës, 258 meshkuj dhe 406 femra, nga vitet e katërta të shkollave të mesme, mosha 18-19 vjeç. Grumbullimi i të dhanunave u realizua me ndihmë të pyetësorit mbi eksperiencat të pakëndëshme në fëmijëri (Adverse Childhood Experience). Nga rezultatet shihet se dhuna verbale është më e shprehur se ajo fizike. Po ashtu, shihet se keqtrajtimi në familje është i paraqitur nga femrat në përqindje më të lartë se nga meshkujt. Nga ana tjetër, llojet e keqtrajtimeve nga ana e moshatarve janë më të pranishme te meshkujt se tek femrat. Me analizë statistikore u etabluan asociacione statistikore sinjifikante ndërmjet konsumit të drogës dhe disa kategori të dhunes familiare dhe dhunës nga moshatarët.*

Fjalë kyç: *Dhuna, adoleshentë, droga*

Medicus 2011, Vol. XV (1):

HYRJE

Dhuna te adoleshentët nuk është fenomen i ri e as fenomen që mundet lehtë të shpjegohet.

Dhuna ka ekzistuar kaherë në shoqëri dhe si e tillë është dashur të kanalizohet ndaj dikujt. Ndër caqet më të shpeshta të dhunës kanë qenë ato me më pak fuqi: fëmijët dhe pleqët. Prandaj nuk çuditë fakti se shoqëria gjatë shekujve dhe në civilizime të ndryshme, është përpjekur që t'i mbron këto grupe vulnerabile me norma të ndryshme: morale, etike dhe ligjore.

Dhuna nuk është e lehtë të shpjegohet: nuk mjafton analiza e karakteristikave të dhunuesit, viktimës dhe mjedisit. Në këtë mundet të na ndihmon i ashtuquajturi "model ekologjik" i dhunës i cili e shpjegon ate si interakcion i më tepër faktorëve ("rrathëve"). Faktorët individual, marëdhëniet personale, ato ne komunitet dhe në shoqëri janë katër "rrathë" në të cilat munden të organizohen rreziqet duke ndikuar në sjelljen e individit, duke i ritur (ose zvogëluar) gjasat të personi të bëhet dhunues apo viktimë e dhunës (1).

Dhuna mbi adoleshentët sot është problem i cili i tejkalon kufijtë dhe kështu paraqitet si problem i shteteve të pazhvilluara por edhe te ato të zhvilluara. Për fat të keq, të dhënat mbi këtë dukuri si dhe legjislativa në këtë lami janë të pakëta. Kjo është e përcjellur nga mungesa e metodologjisë hulumtuese të unifikuar, gjë që solli deri te mungesa e punimeve udhërrëfyese në këtë lëmi (2, 3).

Prandaj mundet të thuhet se ekziston diskrepancë ndërmjet numrit të njohur të rasteve të dhunës dhe numrit të vërtetë që ndodhë në teren, i cili është shumë më i madh (4, 5, 6). Shtetet ballkanike, në mes tyre edhe Maqedonia, decenieve të fundit u përballën me ndryshime të shumëta politike, sociale dhe ekonomike. Rinia nga këto shtete u përball me luftëra, çvendosje dhe humbje të anëtarëve të familjes dhe të afërmve tjerë. Këto ngjarje e zmadhojnë shansin që adoleshentët te jenë dëshmitarë por edhe pësues të dhunës.

Dhuna ndikon mbi dhunuesit, viktimat dhe spektatorët e dhunës. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror Staistikor për vitin 2004 27% të meshkujve dhe 16,9% nga të rinjët të moshës 15 vjeçare kanë qenë në rolin e dhunuesit së paku një herë gjatë muajve të fundit ndërsa 24,6% meshkuj dhe 21,5% femra të moshës së njejtë kanë qenë viktima të dhunës së paku një herë gjatë disa muajve të fundit (7).

Është reale, pra, të parashihet se këto përqindje janë shumë më të larta në popullatën e përgjithshme duke e marrë parasysh bindjen e gjërë në popull (dhe në kulturën tradicionale të Ballkanit) se vetëm familja është përgjegjëse për kushtet jetësore dhe mirëqenjen e fëmisë. Në pajtim me këte është edhe bindja se kategoritë si "shpërfillje (neglizhencë)", "keqpërdorim (abuzim)" ose "dhunë" mbi fëminë duhet të mbesin "në familje", "punë private" pa u paraqitur në institucionet përkatëse (6, 7).

E gjitha kjo solli deri te miratimi i deklaratës së OSHB (2005) me të cilën dhuna dhe lëndimet te fëmijët paraqiten si prioritete më të larta të kësaj organizate (8, 9).

Dhuna tek adoleshentët është problem afatgjatë nga aspekti i zhvillimit mendor. Nëse ndryshimet në këtë sferë nuk identifikohen me kohë ato do të keqtrajtohen që do të rezulton me ndryshime ireverzibile në sferën mendore gjatë tërë jetës. Kështu, në shumë kërkime është vërtetuar se abuzimi fizik në fëmijëri është më i shpeshtë, në mënyrë sinjifikante, te subjektet me çrregullim panik. Abuzimi emocional dhe shpërfillja në fëmijëri janë identifikuar në numër sinjifikant më të madh te subjektet të cilët në jetën adulte kanë shprehur çrregullim panik, ankth të gjeneralizuar dhe fobi sociale. Sot është etabluar qëndrimi se abuzimi emocional dhe shpërfillja gjatë fëmijërisë sjellin deri te dëmtimi i zhvillimit të fëmisë, gjë që reflektohet në periudhën adulte.

Sa i përket abuzimit të drogës, ai fatkeqësisht, ka marrë hov ndër adoleshentët. (Keq)përdorimi i narkotikëve mundet të paraqitet si shkak ose si pasojë e dhunës që e rrethon adoleshentin në jetën e tij të përditshme. Narkotikët paraqiten si pasojë e përditshmërisë së zymtë dhe si "derë magjike" për ikje nga dhuna e vazhdueshme në familje dhe nga moshatarët (7).

Por, kriza apstinenciale e të varurit nga droga mundet të shkakton akte të dhunshme për të siguruar dozën ditore të duhur: situata kur droga paraqitet si shkak i dhunës. Sidoqoftë, dhuna dhe droga shpesh herë janë dy faqe të medales së njejtë, medales e cila quhet "krim" (7, 8).

Në suaza botërore ky problem shihet jo vetëm si problem socio-ekonomik dhe kulturor por edhe si problem nga sfera e shëndetit mendor. Ky problem ka rëndësi primare në përpilimin e politikës shëndetësore të çdo shteti, kur janë në pyetje të rinjtë dhe zhvillimi i tyre.

QËLLIMET

Gjatë përpunimit të të dhënave të grubumlluara u shprehën si të dukshme dallimet në disa kategori të hulumtuara. Kjo dukuri i imponoi edhe objektivat për këtë punim:

- Të përcaktohet prania dhe frekuenca e dhunës ndaj adoleshentëve në familje në R. E Maqedonisë;
- Të përcaktohet prania dhe frekuenca e dhunës nga moshatarët ndaj adoleshentëve (në shkollë, në mjedisin ku jeton) dhe
- Të përcaktohen relacionet në mes të dhunes ndaj adoleshentëve (në familje dhe jashtë saj) dhe konsumimit të drogës tek adoleshentët.

MATERIALI DHE METODAT

Studimi është nga tipi i "prerjes tërthore" ("Cross section"). Subjektet në hulumtim ishin grupi i nxënësve të viteve të katërta të shkollave të mesme, mosha 18-19 vjet. Duke e patur parasysh numrin e përgjithshëm të nxënësve në shkollat e mesme në Republikë në vitin shkollor 2008/09, i cili sipas të dhënave të Ministrisë për Arsim (Inspektorati republikan i arsimit) ishte 25.841 nxënës, madhësia e mostrës (konform regullave epidemiologjike për studime të këtilla) duheshte të jetë diçka më tepër se 2% nga grupi i hulumtuar, respektivisht N=586 nxënës (për p=0,05; margina e gabimit=4). Grupi i hulumtuar numëronte 664 nxënës: 258 meshkuj dhe 406 femra.

Studimi e ekzekutua në periudhën Mars-Maj 2010, në shkolla profesionale dhe gjimnaze në Shkup, Gostivar, Strugë, Manastir dhe Shtip. U dorëzuan 700 pyetësorë. Tre nxënës refuzuan plotësimin e pyetësorit

duke e shfrytëzuar kështu mundësinë që i u ishte prezentuar para fillimit të plotësimit të pyetësorit. Pyetësorët e plotësuar ishin të klasifikuar konform kritereve të definuara paraprakisht ashtu që, pas eliminimit të pyetësorëve që nuk ishin në regull dhe u eliminuan nga procesi i mëtejmë, për analizë mbetën 664 pyetësorë.

Grumbullimi i të dhënave u realizua me ndihmë të pyetësorit mbi eksperiencat të pakëndëshme në fëmijëri (*Adverse Childhood Experience*) i cili përbëhet nga 62 pyetje dhe nënpyetje (forma për meshkuj) respektivisht 66 pyetje dhe nënpyetje (forma për femra).

Rezultatet nga pyetësorët përkatës vlerësohen në bazë të metodologjisë të standardizuar, specifike për pyetësorët përkatës.

Plotësimi i pyetësorëve u ekzekutua në shkollë, me ndihmën dhe mbikqyrjen e personit të kualifikuar (psikolog, psikijatër) të cilët ishin familijar me teknikat e këtilla të hulumtimit. Kodimi i pyetësorëve (me të cilin mbrohet identiteti i subjekteve dhe të dhënat e përfituara) u krye me procedurë të caktuar paraprakisht.

Për nxënësit që do të kishin nevojë për bisedë (*debriefing*, shkarkim emocional) ishte e mundsuar ndihma profesionale dhe mundësi e referimit të mëtutjeshëm (nëse do të ishte e vlerësuar se ka nevojë të tillë). Për këto mundësi subjektet ishin të informuar gojarisht (nga anketuesit) dhe me shkrim (si pjesë e pyetësorëve).

Përpunimi statistik i të dhënave u ekzekutua me progamet *Statistica for Windows* dhe SPSS 13,0 duke e shfrytëzuar bazën e të dhanunave të krijuar nergut për kete studim. Për përpunim të mëtutjeshëm u shfrytëzuan metoda statistikore gjegjëse. Rëndësia (signifikanca) statistikore u përcaktua në nivel të $p<0.05$ dhe $p<0.01$.

REZULTATET

Dhuna mbi fëmijët dhe adoleshentët një kohë të gjatë ishte "tabu temë" jo vetëm në trevat tona por edhe më gjërë. Stereotipet si: "Familja din më mirë se çka është mirë për fëminë", "Prindërit kanë çdoherë të drejtë" në kombinim me "Dajaku është prej xhenetit" dhanë hapësirë të gjërë dhunës mbi adoleshentët. Prandaj nuk çudit fakti se rastet e dhunës penalizohen vetëm kur nuk ka rrugëdalje tjetër respektivit nëse shprehen me lëndime të rënda ose me vdekjen e fëmijës/adoleshentit. Megjithate, të gjithë e kanë të qartë se kjo është vetëm "maja e ajsbergut", i cili quhet dhunë. Në anën tjetër, mangësitë në solucionet lijgore në këtë sferë nuk lejojnë qasje serioze në preventivën e këtij problemi.

Rezultatet nga studimi treguan se kjo dukuri është e pranishme edhe në mjedisin e nxënësve tonë të shkollave të mesme.

Tabela 1.

Ekspozimi ndaj dhunës familjare

Lloji i keqtrajtimit	Meshkuj		Femra	
	Shpesh	Asnjëherë (rallë)	Shpesh	Asnjëherë (rallë)
Dhuna psikologjike				
Dikush nga familja ju ka urrejtur	240 (93,02%)	18 (6,98%)	357 (87,93%)	49 (12,07%)
Prindët kane dëshiruar qe të mos jesh lindur fare	252 (97,7%)	6 (2,33%)	362 (89,16%)	44 (10,84%)
Kanosen të të godasin ose të të gjuajnë me diçka	210 (81,4%)	48 (18,6%)	326 (80,29%)	80 (19,71%)
Të kanë sharë, ofenduar ose poshtëruar	207 (80,23%)	51 (19,77%)	215 (52,96%)	191 (47,04%)
Dhuna fizike				
Të kanë shtyrë, shtrënguar ose gjuajtur me diçka	250 (96,9%)	8 (3,1%)	391 (96,3%)	15 (3,7%)
Të kanë rahur duke të lënë shenja ose lëndime	255 (98,84%)	3 (1,16%)	392 (96,55%)	14 (3,45%)
Ke qenë i/e frikësuar nga lëndime fizike	239 (92,63%)	19 (7,37%)	369 (90,89%)	37 (9,11%)
Disiplinimi i fëmijëve me të rahur				
Sa shpesh të kanë rrahur	180 (69,77%)	78 (30,23%)	299 (73,64%)	107 (26,36%)

Tabela 2.

Ekspozimi ndaj dhunës nga moshatarët

Lloji i keqtrajtimit	Meshkuj		Femra	
	Shpesh	Asnjëherë (rallë)	Shpesh	Asnjëherë (rallë)
Dhuna nga moshatarët				
Të kanë sharë, ofenduar ose poshtëruar	**201 (77,9%)**	**57 (22,1%)**	**336 (82,76%)**	**70 (17,24%)**
Të kanë rahur duke të lënë shenja ose lëndime	**255 (98,84%)**	**3 (1,16%)**	**405 (99,75%)**	**1 (0,25%)**

Të kanë shtyrë, shtrënguar ose gjuajtur me diçka (2,46%)	**247 (95,74%)**	**11 (4,26%)**	**396 (97,54%)**	**10**
Ke qenë i/e frikësuar nga lëndime fizike (5,67%)	**246 (95,35%)**	**12 (4,65%)**	**383 (94,33%)**	**23**

Tabela 3.

Përdorimi i drogës nga adoleshentët

Përdorimi i drogës nga adoleshentët	**Meshkuj**		**Femra**	
	Jo	**Po**	**Jo**	**Po**
Përdorimi i drogës				
A ke përdorur ndonjë herë drogë	245(95,0%)	13 (5,0%)	388 (95,6%)	18 (4,4%)
A ke patur ndonjë herë problem me përdorim të drogës	256 (99,2%)	2 (0,8%)	405 (99,75%)	1 (0,25%)
A e konsideron vetëvehten të varur nga droga	258 (100%)	0 (0%)	406(100%)	0 (0%)
Ke përdorur drogë >3 here	251 (97,7%)	6 (2,3%)	401 (98,8%)	5 (1,2%)

DISKUSIONI DHE KONKLUZAT

Nga rezultatet e parashtruara shihet qartë se dhuna ndaj adoleshentëve është e pranishme në familje dhe jashtë saj.

Nga tabelat 1 dhe 2 bie në sy se dhuna verbale është më e shprehur se ajo fizike. Nga këto tabela poashtu shifet se keqtrajtimi në familje është i paraqitur nga femrat në përqindje më të lartë se nga meshkujt. Kjo mundet të shpjegohet me faktin se femrat, fizikisht më të dobëta dhe në suaza tradicionale të nënshtruara ne familje, janë më të ekspozuara dhunës të këtij lloji.

Nga ana tjetër, llojet e keqtrajtimeve nga ana e moshatarëve janë më të pranishme te meshkujt se te femrat. Kjo mundet të shpjegohet me rolin tradicional të meshkujve si "luftëtar". Ky rol në kombinim me moshën e participantëve në hulumtim, mundet të shpjegon rezultatet e fituara. Kjo korespondon me rezultatet e hulumtimeve që janë kryer në vend dhe në shtetet e jashtme (7, 9, 10, 11, 12, 13).

Tabela 3 tregon se përdorimi i drogës është, poashtu i pranishëm te të rinjtë. Ky është problem i kahershëm por në dekadat e fundit morri hov më të madh në mesin e adoleshentëve. Problemi ndërlikohet me dhunën, e cila si dukuri është në lidhje të pashkëputshme me drogën. Dhuna mundet të paraqitet si shkak i përdorimit të drogës, më së shpeshti nga fëmijët që rrjedhin nga familje në të cilat dhuna familjare është e pranishme në jetën e përditshme dhe si e tillë shkakton "ikjen" e adoleshentit nga problemet reale të dhunës shtëpiake në boten ireale të drogës. Përdorimi i drogës si pasojë e dhunës familjare dhe nga moshatarët mundet të paraqitet si formë e modeluar e sjelljes së adoleshentit, të cilën sjellje e kopjon nga mjedisi (14, 15, 16, 17).

Me analizë statistikore u etabluan asociacione statistikore sinjifikante ndërmjet kategorive vijuese te meshkujt:

1. Disiplinimi fizik/dhuna fizike në familje (Përdorimi i drogës >3 herë dhe rahje e fortë me shenja trupore si pasojë) p=0,000.

Te femrat rezultatet në asociacione statistikore sinjifikante ndërmjet kategorive ishin si vijon:

1. Dhuna familjare (Përdorimi i drogës >3 herë dhe Kanosen të të godasin ose të të gjuajnë me diçka) p=0,001723;
2. Dhuna fizike (Përdorimi i drogës >3 herë dhe rahje e fortë me shenja trupore si pasojë) p=0,001723;
3. Dhuna emocionale (Përdorimi i drogës >3 herë dhe sharje, ofendim ose poshtërim) p=0,001723
4. Dhuna psikologjike (Përdorimi i drogës >3 herë dhe Prindët kane dëshiruar qe të mos jesh lindur fare) p=0,001723;
5. Disiplinimi fizik (Përdorimi i drogës >3 herë dhe Sa shpesh të kanë rrahur) p=0,001723.

Në konkluzë mundemi të themi se dhuna familjare dhe nga moshatarët është e pranishme te adoleshentët në vendin tonë. Kjo dukuri negative korespondon me një dukuri tjetër negative: përdorimi i drogës. Vetëvetiu por edhe në kombinim, këto dukuri sjellin dëme afatshkurte dhe afatgjate mbi shëndetin fizik e posaçërisht të atij mendor. Dëmet afatshkurte shihen, në rend të parë, në penalizimin e hershëm e të rinjëve për shkak të dhunës edhe të përdorimit të drogës, akte kriminogjene nga vetë natyra e tyre.

Dëmet afatgjate, mbi shëndetin fizik e posaçërisht atij psikik, janë të shumëllojshme dhe të shumëfishta por ndoshta munden të përmbledhen në një fjali: "Ai që në fëmijëri është i dhunuar, kur të rritet bëhet dhunues".

LITERATURA

1. Krug EG, Dahlberg LL, Mercy JA et al. editors. World report on violence and health, Geneva, WHO, 2002.
2. WHO (1999). The World Health Report: Making a Difference. Geneva: World Health Organization.
3. UNICEF-IRC (2005). Violence against the children in Europe: a preliminary review of research. Florence: UNICEF INNOCENTI IRC.
4. UNICEF-IRC (2003). A league table of child maltreatment deaths in rich nations. Innocenti Report Card, Issue No. 5, UNICEF INNOCENTI IRC.
5. ChildONEurope Secretariat/ Italian Childhood and Adolescence Documentation and Analysis Centre, Documentation, Research and Training Sector (2007). Review on national systems of statistics and registration on child abuse. Florence: Instituto degli Innocenti.
6. UNICEF and "Save the Children" (2004). Child Trafficking in Bosnia and Herzegovina.
7. Тозија Ф, Ѓорѓев Д, Чичевалиева С и др. Извештај за насилство и здравје во Македонија и водич за превенција, Скопје, Министерство за здравство, 2006.
8. Sicher P, Lewis O, Sargent J, Chaffin M, Friedrich WN, Cunningham N, Thomas R, Thomas P, Villani VS. (2000). Developing child abuse prevention, identification, and treatment systems in Eastern Europe. Journal of the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry, 39, 660-667.
9. UN's Secretary General (2006). Study on violence against children, Official Report presented to the 61st UN General Assembly.
10. United Nations (2006). World Report on violence against children. UN Secretary-General's Study on Violence against children.
11. WHO & ISPCAN (2006). Preventing child maltreatment: a guide for taking action and generating evidence. World Health Organization.
12. WHO-Europe (2004). Young People's Health in context: health behavior in school-age children study (HBSC) 2001/2002. World Health Organization.
13. UNICEF (2007). The state of the world's children. UNICEF, United Nations.
14. WHO (1999). Child abuse as a public health issue. World Health Organization.
15. Boney-McCoy S, Finkelhor D. Psychosocial sequelae of violent victimization in a national youth sample. J Consult Clin Psychol. 1995 Oct; 63(5):726-36.
16. Friedrich WN, Einbender AJ, Luecke WJ. Cognitive and behavioral characteristics of physically abused children. J Consult Clin Psychol. 1983 Apr;51(2):313-4.
17. Singer MI, Flannery DJ. The relationship between children's threats of violence and violent behaviors. Arch Pediatr Adolesc Med. 2000 Aug; 154(8):785-90.

SUMMARY

RELATIONSHIP BETWEEN DOMESTIC AND PEER VIOLENCE ON ADOLESCENTS AND USE OF DRUGS

Kadri Haxhihamza[1], Marija Raleva[1], Florentina Hani[2], Dimitrinka Jordanova Pesevska[3], Rozalinda Isjanovska[4], Izabela Filov[5], Viktor Isjanovski[6], Lidija Sushevska[7], Aktan Ago[8], Blagojçe Gjorqevski[9]

[1]PHO Clinic of Psychiatry, Skopje, Macedonia
[2]SSSG "Ibrahim Temo", Struga, Macedeonia
[3]World Health Organization, Country Office Skopje, Macedonia
[4]Institute of Epidemiology with Biostatistics and Medical Informatics, Medical Faculty, University "St.Ciril & Metodij", Skopje, Macedonia
[5]PHO Psychiatic Hospital "Demir Hisar", Demir Hisar, Macedonia
[6]PHO Psychiatric Hospital "Skopje", Skopje, Macedonia
[7]City General Hospital "8[th]September", Skopje, Macedonia
[7]PHO City Hospital "September 8[th]", Skopje, Macedonia
[8]SSSG "Josip Broz Tito", Skopje, Macedonia
[9]SSMS "Pance Karagjozov", Skopje, Macedonia

In the period from March to May 2010, in several vocational schools and gymnasiums in Skopje, Gostivar, Struga, Bitola and Shtip a "Cross section" type of study was performed on 664 students (258 males and 406 females) from the fourth year of high school (age 18-19 years). Data collection was accomplished with the help of the Adverse Childhood Experience questionnaire. The results show that verbal violence is more significant than physical one. It is also shown by the results that domestic abuse is reported in higher percentage by female than by the male adolescents. On the other hand, the kinds of abuse by peers are more frequently present in males than in females. With statistical analysis significant associations were established between drug consumption and certain categories of domestic and peer violence.

Key words: *Violence, teen, drugs*

PUNIM BURIMOR SHKENCOR / ORIGINAL SCIENTIFIC PAPER
BIOKIMI KLINIKE

VLERA DIAGNOSTIKE E PËRCAKTIMIT TË PROTEINËS C-REAKTIVE (CRP) NË LIKUORIN CEREBROSPINAL NË DIAGNOZËN E HERSHME TË MENINGJITIT BAKTERIAL NGA AI VIRAL

Majlinda Kokiçi[1], Ndok Marku[1], Elsa Kone[1], Ela Petrela[1], Vera Ostreni[1], Elona Lamaj[1], Teuta Dedej[1], Dhimitër Kraja[1]

QSU "Nënë Tereza", Fakulteti i Mjekësisë
[1]Laboratori Biokimik-Klinik, Tiranë, Shqipëri



Majlinda Kokiçi, mjeke, pedagoge, Master
QSU "Nënë Tereza", Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri
Komuna e Parisit, prane kopshtit botanik,Tiranë, Shqipëri
Tel: +355692190402
e-mail: majlindakokici@yahoo.com

REZYME: ***Hyrje****. Meningjiti bakterial vazhdon të jetë një problem epidemiologjik kërcënues për jetën veçanërisht në shumicën e vendeve në zhvillim. Duke patur parasysh konsekuencat e tij tepër të rënda, diagnoza e tij e menjëhershme dhe e saktë është bërë një prioritet për shumicën e klinicistëve.* ***Qëllimi i punimit.*** *Përcaktimi dhe krahasimi i vlerave të CRP në likuorin cerebrospinal të pacientëve të dyshuar për meningjit.* ***Materiali dhe metoda****. U morën në studim 133 pacientë të dyshuar klinikisht për meningitis. Pacientet u ndanë në 4 grupe sipas diagnosës përfundimtare. Grupi i parë përbëhet nga 50 pacientë me meningjit bakterial, grupi i dytë nga 36 pacientë me meningjit viral, grupi i tretë nga 13 pacientë me meningjit tuberkular dhe grupi i kontrollit që përbëhet nga 34 pacientë. Pacientëve iu ekzaminua likuori cerebrospinal për numrin e leukociteve, llojin e tyre, proteinën totale, albuminën, glukozën dhe CRP. CRP u mat në autoanalizatorin Olympus AU-400 me imunoturbidometri.* ***Rezultatet.*** *CRP rezultoi e rritur në 44 raste ose 88% të pacientëve me meningjit bakterial, dhe në një pacient ose 7.7% me meningjit tuberkular. CRP nuk ishte e rritur në asnjë pacient me meningjit viral. Vlera mesatare e CRP në meningjitin bakterial është shumë herë më i rritur se në pacientët e grupit 2, 3 dhe grupit të kontrollit me një vlerë sinjifikative p<0.005* ***Përfundim.*** *Përcaktimi i CRP në lëngun cerebrospinal është shumë i rëndësishëm në diagnozën diferenciale të meningjitit. Është një test i shpejtë, me kosto të ulët, i ndjeshëm dhe që përdor sasi të vogla të mostrës. Vlerat e rritura të tij flasin në favor të meningjitit bakterial.*

Key words: *Proteina C reaktive, meningitis, likuori cerebrospinal*

Medicus 2011, Vol. XV (1):

HYRJE

Meningjiti bakterial vazhdon të jetë një problem epidemiologjik kërcënues për jetën veçanërisht në shumicën e vendeve në zhvillim. Duke patur parasysh konsekuencat e tij tepër të rënda, diagnoza e tij e menjëhershme dhe e saktë është bërë një prioritet për shumicën e klinicistëve. Ekzaminimi i likuorit cerebrospinal është çelësi i diagnozës së meningjiteve. Për arsye të kufizimeve të ndryshme të teknikave konvecionale laboratorike të përdorura si proteina totale, numri i leukociteve, lloji i tyre, glukoza ne vlerësuam

dhe krahasuam vlefshmërinë diagnostike të proteinës C reaktive (CRP) në likuorin cerebrospinal (CSF) në diagnozën e meningjitit bakterial, meningjitit viral dhe atij tuberkular. Kjo u bë e mundur falë teknologjisë së re me të cilën punohen likuoret cerebrospinale në QSUT sot.

QËLLIMI

Përcaktimi dhe krahasimi i vlerave të CRP në likuorin cerebrospinal të pacientëve të dyshuar për meningjit.

MATERIALI DHE METODA

U morën në studim 133 pacientë të paraqitur pranë Urgjencës së Shërbimit të Sëmundjeve Infektive në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, me shenjat klinike të dyshuara për meningitis. Brenda 3 orëve të para të mbërritjes së të sëmurëve në urgjencë pacientëve iu mor lëngu cerebrospinal. Kështu u studiuan 133 LCS në kushtet e urgjencës klinike. 90 minuta para marrjes së lëngut cerebrospinal pacientëve iu mor gjak për hemogramë dhe për serum. Kështu u morën në studim 133 gjakra dhe serume. Një vend të rëndësishëm zënë edhe kartelat klinike. Ato përbëjnë 133 kartela ku në këtë numër futet edhe grupi i kontrollit. Punimi është i karakterit kryesisht laboratorik.

Ky punim u krye në bashkëpunim të ngushtë midis Shërbimit Infektiv të Qendres Spitalore Universitare "Nënë Tereza" dhe Shërbimit të Laboratorit Biokimik - Klinik në QSUT. Në studim u përfshinë pacientët e paraqitur pranë urgjencës së Spitalit Infektiv në periudhën Maj 2006 - Maj 2010, ndërsa të gjitha ekzaminimet laboratorike u kryen në Laboratorin Biokimik - Klinik të QSUT. Të gjithë pacientet janë të moshës 18 deri 70 vjeç. Eksperienca modeste në ekzaminimin e lëngut cerebrospinal dhe mundësitë që ofron sot teknologjia laboratorike më detyruan të krijoj një strategji të përpunuar mirë që të përjashtoj sa më shumë të jetë e mundur artefaktet diagnostike laboratorike. Falë bashkëpunimit të ngushtë me klinikën dhe gatishmërisë së stafit të laboratorit u synua dhe u arrit realizimi i punksionit brenda 3 orëve të paraqitjes së pacientit në urgjencë dhe ekzaminimi i lëngut cerebrospinal brenda 30 minutave të marrjes së mostrës. Për të vlerësuar dhe interpretuar saktë paramertat e lëngut cerebrospinal gjaku për hemograme dhe për serum u mor 90 minuta para realizimit të punksionit.

Marrja e lëngut cerebrospinal u realizua nga mjeku infeksionist nëpërmjet punksionit lumbar në L4/L5. Nga mjeku infeksionist u vlerësua presioni në dalje i LCS. Lëngu cerebrospinal u hodh në 3 tuba me nga 2 deri 3 ml secili. U përdorën tuba plastikë, steril, me kapakë dhe me etiketë, dhe të shënuar me numrat 1, 2, 3. Në etiketë u shënuan gjeneralitetet e pacientit dhe numri i tubit që përkon me numrin e porcionit të LCS. Në rastet kur kishte një minimal gjak në tubin me numër 1, ky tub nuk u përdor për asnjë lloj ekzaminimi dhe të gjitha matjet u kryen në 2 ose 3. Në rastet kur LCS në tubin me numër 1 ishte i qartë u përdor metoda standarte e ekzaminimit të LCS d.m.th. tubi 1 u përdor për ekzaminimin biokimik dhe serologjik, tubi 2 për ekzaminimin mikrobiologjik, tubi 3 për numërimin e qelizave dhe llojin e tyre. Në rastet kur u dyshua për meningjit tuberkular një sasi LCS u mbajt në frigorifer për 12-24 orë dhe u shikua për formimin e rrjetes pas 24 orësh. Mostrat u derguan menjëherë në laborator dhe u ekzaminuan për numrin e leukociteve me metodë manuale në kamera Burker, llojin e leukociteve pas ngjyrimit të strishos me Giemsa (1). Pasi u numëruan leukocitet dhe u percaktua lloji i tyre LCS iu nënshtrua ekzaminimit biokimik me këto parametra: glukoza, proteina totale, albumina (1) të cilat janë realizuar edhe me parë në Laboratorin Biokimik-Klinik të QSUT dhe për herë të parë LCS iu mat niveli i CRP. Kjo u bë e mundur falë teknologjisë së re shumë sensitive dhe që përdor sasi të vogla të LCS me të cilën ekzaminohen lëngjet biologjike në Laboratorin Biokimik- Klinik të QSUT që nga viti 2005.

Nga studimi u perjashtuan të gjithë pacientët që kishin moshë më të vogël se18 vjeç, pacientët me dëmtime hepatike, pacientët me dislipidemi, pacientët gra që përdornin kontraceptivë oralë sepse këta faktorë interferojnë vlerat e proteinës C reaktive në LCS (13).

Metoda e matjes së CRP në lëngun cerebrospinal. U përdor testi imunoturbidometrik ku particola (latex) të veshura me antikorpe anti CRP humane reagojnë me CRP në likuor duke formuar komplekse (aglutinina të patretshme) që japin turbullirë e cila matet me fotometër. Kalibrimi u bë me kalibrator Olympus (multikalibrator) dhe kontrolli i kualitetit u bë me ITA control Olympus. Kalkulimi i rezultateve u bë mbi kurbën e kalibrimit në mënyrë automatike nga analizatori Olympus. Lineariteti i testit ishte në intervalin 0.2-480mg/l (aplikimi normal). Sensibiliteti i metodës (aplikimi normal) është 0.1mg/l. Vlerat e CRP mbi 0.1mg/dl u konsideruan të rritura në lëngun cerebrospinal.

Duke iu referuar diagnosës përfundimtare pacientet u ndanë në 4 grupe:

1. Në grupin e parë bëjnë pjesë 50 pacientë me diagnozën përfundimtare meningjit bacterial;
2. Në grupin e dytë bëjnë pjesë 36 pacientë me diagnozën përfundimtare meningjit viral;

3. Në grupin e tretë bëjnë pjesë 13 pacientë me diagnozën përfundimtare meningjit tuberkular
4. Në grupin e katërt bëjnë pjesë 34 pacientë që përbëjnë grupin e kontrollit.

Grupi i kontrollit

Meqenëse marrja e lëngut cerebrospinal për studime në formën e grupit të kontrollit është shumë e vështirë ose e pamundur atëherë gjatë rrugës u bë i qartë një grup pacientësh të cilët u paraqitën në urgjencën e Spitalit Infektiv me shenjat klinike të dyshuara për meningitis por që pas ekzaminimit të lëngut cerebrospinal rezultuan pa ndryshime biokimike dhe klinike në të dhe dolën nga spitali me diagnozën përfundimtare viroze e shoqëruar me meningizëm. Ky grup pacientësh u përdor për tiu referuar gjatë studimit.

Përpunimi statistikor

Për analizën e të dhënave u përdor paketa statistikore SPSS 17.0. Variablet e vazhdueshme u paraqitën në vlerë mesatare dhe devijacion standard (SD). Variablet diskrete u paraqitën në vlerë absolute dhe në përqindje. Për të analizuar diferencat mes variableve sasiore të vazhdueshëm u përdor ANOVA një - rrugëshe. Paraqitja e të dhënave është realizuar përmes tabelave dhe grafikëve. U konsideruan sinjifkante vlerat e $p \leq 0,05$.

REZULTATET


Në grupin e parë, ku përfshihen 50 pacientë me diagnozën përfundimtare meningjit bakterial, në 44 pacientë ose 88% CRP u gjet e rritur. Në 6 pacientë ose 12% CRP ishte normale (tabela 1).

Tabela 1

Tabela e mësiperme paraqet numrin e pacientëve me vlera të rritura dhe normale të proteinës C reaktive në lëngun cerebrospinal për çdo diagnose dhe përqindjet respektive

Vlerat e CRP në likuor	**Meningjit bakterial**	**Meningjit viral**	**Grupi kontrollit**	**Meningjit tuberkular**
CRP ≤ 0,1mg/dl	6	36	34	12
	12,0%	100,0%	100,0%	92,3%
CRP > 0,1mg/dl	44	0	0	1
	88,0%	,0%	,0%	7,7%
Total	50	36	34	13
	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%

Në pacientët me meningjit bakterial vlerat e CRP ishin vlera mesatare 2.51 mg/dl, vlera minimale 0.1 mg/dl,vlera maksimale 21mg/dl, devijacioni standart 3.53 (tabela 2).



Grafiku 1.

Grafiku paraqet shpërndarjen e vlerave mesatare të proteinës C reaktive në lëngun cerebrospinal sipas diagnozës përfundimtare.

Në pacientët me meningjit bakterial vlerat e CRP ishin vlera mesatare 2.51 mg/dl, vlera minimale 0.1 mg/dl,vlera maksimale 21mg/dl, devijacioni standart 3.53 (tabela 2).

Tabela 2

Tabela e mësipërme paraqet për çdo diagnose përfundimtare numrin e rasteve, vlerën mesatare të CRP në likuor, deviacionin standart, vlerën minimale dhe vlerën maksimale.

Diagnoza përfundimtare	Mesatarja	Nr	Deviacioni standart	Minimumi	Maksimumi
Menigjit bakterial	2,5180	50	3,53604	,10	21,00
Meningjit viral	,0056	36	,02323	,00	,10
Grupi i kontrollit	,0000	34	,00000	,00	,00
Meningjit tuberkular	,1000	13	,07071	,00	,30

Në grupin e dytë ku përfshihen 36 pacientë me diagnozën përfundimtare meningjit viral në të gjitha rastet d.m.th në 36 raste ose 100% vlerat e CRP ishin normale. Në pacientët me meningjit viral vlerat e CRP ishin vlera mesatare 0.0056 mg/dl, vlera minimale 0.00 mg/dl, vlera maksimale 0.1 mg/dl, devijacioni standart 0.023 (tabela 2).

Në grupin e tretë ku përfshihen 13 pacientë me diagnozën përfundimtare meningjit tuberkular në 1 rast ose 7.7% CRP u gjet e rritur ndërsa në 12 pacientë ose 92.3% vlerat e CRP ishin normale (tabela 1). Në pacientët me meningjit tuberkular vlerat e CRP ishin vlera mesatare 0.1 mg/dl, vlera minimale 0.00 mg/dl, vlera maksimale 0.3 mg/dl, devijacioni standart 0.070 (tabela 2).

Në grafikun që tregon paraqitjen e vlerave mesatare të CRP u pa që vlera mesatare e CRP në grupin e pacientëve me meningjit bakterial ishte shumë herë më e lartë se vlera e saj në meningjitin viral, tuberkular dhe grupin e kontrollit. Ky ndryshim vlerash shoqërohej me nje diferencë statistikisht të rëndësishme me propabilitet $p<0.007$ midis meningjitit bakterial dhe meningjitit tuberkular, me propabilitet $p<0.001$midis meningjitit bakterial dhe meningjitit viral dhe grupit të kontrollit. Nuk u vu re diferencë statistikisht sinjifikative midis meningjitit viral dhe atij tuberkular. Sensitiviteti i CRP ishte 88% për meningjitin bakterial ndërsa specifiteti 98%.

DISKUTIMI

Meningjiti bakterial vazhdon të jetë një problem epidemiologjik kërcënues për jetën veçanërisht në shumicën e vendeve në zhvillim. Duke patur parasysh konsekuencat e tij tepër të rënda, diagnoza e tij e menjëhershme dhe e saktë është bërë një prioritet për shumicën e klinicistëve. Për arsye të kufizimeve të ndryshme të teknikave konvecionale laboratorike të përdorura, ne vlerësuam dhe krahasuam vlefshmërinë diagnostike të proteinës C reaktive (CRP) në likuorin cerebrospinal (CSF) në diagnozën e meningjitit bakterial, meningjitit viral dhe atij tuberkular.

Proteina C Reaktive (CRP), një pentamer i nënnjësive polipeptidike të pa glikolizuar me një peshë molekulare prej 120 000 dalton, prodhohet kryesisht në melçi. Si një proteinë e fazës akute, pothuajse çdo sëmundje që shkakton inflamacion rezulton në rritjen e CRP në serum apo lëngjet e tjera të trupit ngushtësisht të lidhura me indet e afektuara si psh. LCS, seroza apo lëngu synovial. Në meningjite prishet barriera hemato-cefalike dhe elementët që ndodhen në serum bëhen të matshme në LCS. Kështu ndodh me CRP. Pavarësisht se pak dihet se si CRP funksionon, besohet se aktivizon sistemin e komplementit pa patur nevojë për një kompleks antigjen antitrup (2, 4, 11).

Studimet e fundit tregojnë se CRP mund të sintetizohet edhe në neurone dhe lipopolisaharidi-S mund të nxisë sintezën ekstrahepatike të CRP (13). Vlerat e CRP interferohen nga faktorë të tillë si disfunksioni hepatik, dislipidemia, përdorimi i kontraceptivëve oralë, prandaj ky kontigjent u përjashtua nga studimi (1, 3, 5, 13).

Ne morëm në studim 133 pacientë të dyshuar klinikisht për meningjit dhe të ndarë në 4 grupe sipas diagnozës përfundimtare. Në studimin tonë CRP është e rritur në 44 pacientë me diagnozën përfundimtare

meningjit bakterial ose 88% dhe në një pacient me diagnozën përfundimtare meningjit tuberkular ose 7.7%. CRP nuk është e rritur në asnjë pacient me diagnozën përfundimtare meningjit viral. Ky rezultat është i krahasueshëm me rezultatet e literaturës ku nivelet e rritura te CRP në lëngun cerebrospinal përdoren në diagnozën e shpejtë të meningitit bakterial dhe në diferencimin e tij nga meningjiti viral (Corral,1981, Ambrason,1985, Stearman,1994, 5, 6, 8). Studime të tjera tregojnë përdorimin e proteinës C reaktive si test depistues i meningjitit viral kundrejt atij bakterial veçanërisht tek femijët (Sormunen, 1999). Studimet më të fundit tregojnë jo vetëm vlerat e rritura të proteinës C reaktive në pacientët me meningjit bakterial, por edhe se niveli i saj është sinjifikativisht më i rritur në meningjitin bakterial të shkaktuar nga Gram-negativët kundrejt atyre nga Gram-pozitivët (Rajs, 2002). Në studimin tonë vlera mesatare e CRP në meningjitin bakterial është 2.51 mg/dl, vlera mesatare e CRP në meningjitin tuberkular është 0.1 mg/dl ndërsa vlera mesatare e CRP në meningjitin viral është 0.005 mg/dl. Siç shihet vlera mesatare e CRP është shumë herë më e lartë në meningjitin bakterial dhe me një ndryshim të rëndesishëm sinjifikant me pacientët me meningjit viral dhe me grupin e kontrollit me $p < 0.001$. Në punimin tonë sensitiviteti i matjes së CRP është 88% ndërsa specifiteti 98%. Abraham në një studim të ngjashëm gjeti CRP e rritur me një shkallë sensitiviteti 97% dhe specificiteti 86% në pacientët me meningjit bakterial (14). Corral CJ gjetën që CRP në LCS në diagnozën e meningjitit bakterial kishte sensitivitet 100% dhe specificitet 94% (1, 7, 13, 14). Punimi ynë tregon që matja e CRP në LCS është një parametër shumë i mirë në diagnozën e hershme diferenciale të meningjitit bakterial nga ai viral.

PËRFUNDIM

Percaktimi i CRP në LCS në pacientët e dyshuar klinikisht për meningitis ka vlerë të madhe diagnostike. Percaktimi i CRP është një test i shpejtë (rezultati merret për 10 minuta), me kosto të ulët, i ndjeshëm, specifik dhe që përdor sasi të vogla të likuorit. Vlerat e rritura të pr CRP sugjerojnë meningjitin bakterial. Vlerat normale të CRP flasin kryesisht jashtë diagnozës së meningitis bacterialis. Nëpërmjet këtij punimi që u shtri në një hark kohor prej 4 vjetësh dhe në një numër të konsiderueshëm rastesh ne sugjerojmë futjen e përcaktimit të proteinës C reaktive në protokollin standart të ekzaminimit të likuorit cerebrospinal.

Në fund të këtij punimi gjej rastin të falenderoj gjithë personelin e spitalit infektiv dhe stafin e laboratorit biokimik - klinik pranë QSUT.

LITERATURA

1. Richard A, McPherson ,Matthew R. Pincus, Henry s Clinical Diagnosis AND Management BY Laboratory Methods Twenty/first edition p.426/430.
2. Frances Fischbach A manual of laboratory and diagnostic tests p.291/313.
3. Harald Kluge ,Valentin Wieczorek,Ernst Linke Atlas of CSF Cytology p.25/37.
4. Carl R.Kjeldsberg,MD Joseph A .Knight MD 1993 Laboratory Examination of Amniotic,c erebrospinal, seminal, serous and synovial fluids p 123/145.
5. Ricard A. Komorowski,* Silag G. Farmer, and konstance K. KNOX, Comparison of Cerebrospinal Fluid C-Reactive Protein and Lactate for Diagnosis of Meningitis, Journal of clinical microbiology, Dec. 1986, p. 982-985
6. Nelson N, EEG-Olofsson E, Larsson L, Öhman S. The Diagnostic and Predictive Value of Cerebrospinal Fluid Lactate in Children with Meningitis, Acta Pædiatrica Volume 75, Issue 1, pages 52–57, January 1986
7. Azeem Sheikh. The Diagnostic Value of C-Reactive Protein Estimation in Differentiating Bacterial from Viral Meningitis, J Coll Physicians Surg Pak Oct 2001;11(10):622-4.
8. Pinto VL Jr, Lima MA, Rolla VC, Rebelo MC, Bóia MN. Atypical cerebrospinal fluid profile in tuberculous meningitis. Trop Doct. 2009 Apr;39(2):76-8.
9. Ricard A. Komorowski,* Silag G. Farmer, and konstance K. KNOX, Journal of Clinical Microbilology, Dec. 1986, p. 982-985, Vol. 24, No. 6.
10. Weber MW, Herman J, Jaffar S, et al. Clinical predictors of bacterial meningitis in infants and young children in Gambia. Trop Med Int Health 2002;7(9):722-31.
11. Jadali FMD, Sharifi MM PhD, Jarollahi A PhD, C-Reactive Protein and lactate dehydrogenase in serum and cerebrospinal fluid in rapid and early diagnosis of childhood meningitis. Iran J Child Neurology Aug. 2007.
12. Stephens DS, Farley MM. Pathogenic events during infection of the human nasopharynx with *Neisseria meningitidis* and *Haemophilus influenzae*. *Rev Infect Dis* 1991;13:22–33
13. Anil Kumar T,K Punith,Santosh Revankar Significance of cerebrospinal fluid C reactive protein level in pyogenic and non pyogenic meningitis in adults.JIACM 2010 ,11(2);112-5
14. Col PL Prasad,Brig MNG Nair Childhood bacterial meningitis and usefulness of CRP MJAFI 2005,61.13-15

SUMMARY

DIAGNOSTIC UTILITY OF C REACTIVE PROTEIN (CRP) MEASUREMENT IN CEREBROSPINAL FLUID (CSF) IN THE EARLY DIFFERENTIAL DIAGNOSIS OF BACTERIAL FRON VIRAL ONE

Majlinda Kokiçi[1], Ndok Marku[1], Elsa Kone[1], Ela Petrela[1], Vera Ostreni[1], Elona Lamaj[1], Teuta Dedej[1], Dhimitër Kraja[1]

UHC "Mother Teresa", Tirana, Albania
[1]Biochemy-Clinic Laboratory, Tirana, Albania

Introduction. *Bacterial meningitis is still a life threatening epidemiological problem especially in many developing countries; considering its dire consequences, its prompt and accurate diagnosis has become a priority for many clinicians.* ***Purpose:*** *Determination and comparison of C Reactive Protein values in CSF of patients with meningitis.* ***Material and method****: CSF samples were obtained from 133 patients who clinically were suspected for meningitis. Patients were grouped into four categories according to their final diagnosis. The first group consisted of 50 patients with bacterial meningitis, the second one consisted of 36 patients with viral meningitis, the third group with 13 patients with tubercular meningitis and the control group which consisted of 34 patients. Levels of total protein, albumin, glucose, C Reactive Protein and leukocyte count/form were determined in CSF. CRP was measured in OLYMPUS AU 400 autoanalyser.* ***Results:*** *CRP resulted increased in 44 cases or 88% of patients with bacterial meningitis and in 1 patient or 7.7% with tubercular meningitis. CRP was not elevated in any patients with viral meningitis. The mean value of CRP in bacterial meningitis was much more increased than in patients of group 2, 3 and control group with a significant value of* $p < 0.001$. ***Conclusion:*** *Determination of CRP in cerebrospinal fluid is really important in the differential diagnosis of meningitis. It is a rapid test, with a low cost, sensitive, and needs a small amount of sample. Elevated values of CRP support the diagnosis of bacterial meningitis.*

Key words: *C Reactive Protein, meningitis, cerebrospinal fluid*

PUNIM BURIMOR SHKENCOR / ORIGINAL SCIENTIFIC PAPER
GASTROENTEROLOGJI

SHPESHTËSIA E SIMPTOMAVE DHE E HERNISË HIATALE TE TË SËMURËT ME REFLUKS EZOFAGJIT NË KORELACION ME MOSHËN

Zaim Gashi[1], Aida Polloshka[1], Fitore Komoni[1]

[1]QKUK, Klinika Interne, Reparti i Gastroenterohepatologjisë, Prishtinë, Kosovë



Zaim Gashi, mjek, internist gastroenterolog, mr. sci
QKUK, Klinika Interne,
Reparti i Gastroenterologjisë, Prishtinë, Kosovë
Tel: +377 44 222 626
E-mail: **dr-zgashi@hotmail.com**

REZYME: Qëllimi: Sëmundja e refluksit gastroezofageal (SRGE) është mjaftë e shpeshtë sot në botë. Mosfunksionimi i mirë i barrierës mbrojtëse kundërrefluks bën të mundur paraqitjen e formave të ndryshme të refluks ezofagjitit. Kjo manifestohet me simptome të shumta klinike. **Qëllimi:** Qëllimi i studimit ka qenë që të hulumtohet lidhshmëria në mes të simptomave të sëmundjes së refluksit gastrosezofageal dhe të moshës si dhe ndikimi i pranisë së hernisë hiatale në shfaqjen e formave të ndryshme të refluks ezofagjitit. **Materiali dhe metodat**: Nga të sëmurët janë marrë të dhënat për ankesat/simptomet e sëmundjes së refluksit gastroezofageal të vërtetuar më pas me endoskopi si dhe prania e hernisë hiatale. **Rezultatet**: Nga 186 të sëmurë të hulumtuar, simptomat kryesore të sëmundjes si piroza, dhembja dhe pengesat dispeptike kanë rënë në shpeshtësi duke u shtuar mosha e të sëmurëve, ndërsa simptomat tjera si disfagjia, anemia, anoreksia, humbja e peshës dhe vjellja janë shtuar në shpeshtësi me moshën e shtyer. Shpeshtësia e hernisë hiatale ka qenë më e shtuar në moshën e shtyer (75.3%) krahasuar me moshën e re (22%). **Përfundim**: Simptomat kryesore tipike për SRGE kanë treguar rënie të shpeshtësisë së tyre me shtyrjen e moshës, ndërsa simptomat e tjera janë shtuar në shpeshtësi. Prania e hernisë hiatale ka mundësuar shfaqjen e formave më të rënda të refluks ezofagjitit si dhe ka qenë më e madhe në moshat e shtyera.

Fjalë bosht: Simptomat tipike, refluks ezofagjiti, hernia hiatale

Medicus 2011, Vol. XV (1):

HYRJE

Sëmundja e refluksit gastroezofageal (SRGE) paraqet një gjendje kronike, që zhvillohet si pasojë e refluksit të përmbajtjes së lukthit në ezofag dhe duke shkaktuar shumë simptome, duke kompromituar kualitetin e jetës si dhe duke shkaktuar shumë komplikime (1).

Shpeshtësia e SRGE në SHBA dhe Europën Përendimore është rreth 10-20% (2), ndërsa në Azi më e vogël se 7% (3).

Në relacion me moshën, SRGE vjen duke u shpeshtuar me kalimin e viteve të moshës.

Por, ekzistojnë shumë kundërthënie në lidhje me incidencën dhe prevalencën e simptomeve të SRGE me shtimin e viteve të jetës, shumë studime sygjerojnë që shpeshtësia e ezofagjitit është sinjifikativisht e lartë

në personat e vjetër se sa në personat e rritur dhe të rinj (4, 5, 6, 7, 8, 9). Mosha e vjetër është parë të jetë faktor rreziku sinjifikant në zhvillimin e formave të rënda të SRGE në studimet epidemiologjike dhe klinike (10).

QËLLIMI I PUNIMIT

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte që të bëhet evaluimi i simptomave të SRGE në korelacion me grupmoshat e ndryshme dhe praninë e hernisë hiatale duke i krahasuar të njëjtat.

MATERIALI DHE METODAT

Ky ishte një studim prospektiv, i kontrolluar, i punuar në QKUK, Klinikën Interne, Repartin e Gastroenterohepatologjisë në periudhën Janar – Dhjetor 2010.

Në hulumtim janë kyqur të sëmurë. Në fillim, me rastin e vizitës së parë, të gjithë të sëmurëve iu janë marrë dhe evidentuar prania e simptomave/parametrave si vijon: piroza, regurgitimi, dhimbja, dispepsioni, disfagjia, anoreksia, anemia, humbja e peshës dhe vjellja. Të gjithë të sëmurët e përfshirë në hulumtim janë kategorizuar në grupmoshat si vijon: 20-39, 40-59, 60-79 dhe mbi 80 vjeç.

Të gjithë të sëmurët i janë nënshtruar endoskopisë pasi që edhe pas trajtimit me inhibitorë të pompës protonike simptomet kanë vazhduar edhe më tej dhe për tu përcaktuar klasifikimi i tyre sipas klasifikimit Los Angeles, në njerën nga kategoritë: A, B, C ose D.

Rezultatet e fituara janë paraqitur në tabela dhe grafikone dhe të njëjtat janë krahasuar me ato të autorëve të huaj. Përpunimi statistikor është bërë me të dhënat bazë të statistikës deskriptive ndërsa analiza e tyre është bërë me t-testin e studentit.

REZULTATET


Në studim janë përfshirë gjithsejt 186 të sëmurë, me moshë mestare 57.14 vjeç, prej të cilëve 98 të sëmurë ose 52.68 % ishin meshkuj dhe 88 të sëmurë ose 47.31 % ishin femra.

Shfaqja e simptomave ishte si vijon: piroza 45.75%, dhembja 41.75%, pengesat dispeptike 16.7%, disfagjia 5.07%, anemia 6.35%, anoreksia 10%, humbja në peshë 5.25%, vjellja 16.25%. Ndërsa shpërndarja e tyre sipas grupmoshave ishte si në Tabelën 1 dhe Grafikonin 1.

Tabela 1.

Simptomet	**20-39**	**40-59**	**60-79**	**mbi 80**	**p**
Piroza	80	67	45	27	<0.01
Dhembja	54	47	37	29	<0.01
Dispepsia	20	28	13	6	0.01
Disfagjia	0	1	5.3	14	<0.01
Anorexia	0	2.1	9.1	14.2	<0.01
Anemia	1	3	14	22	<0.01
H. e peshës	1	2	7	11	<0.01
Vjellja	6	8	21	30	<0.01

Grafikoni 1.




Pas ekzaminimeve endoskopike të bëra të sëmurët sipas shfaqjes endoskopike ishin kategorizuar në njerën prej shkallëve të klasifikimit Los Angeles dhe atë: në shkallën A 95 të sëmurë ose 51.07%, në shkallën B 42 të sëmurë ose 22.58%, në shkallën C 26 të sëmurë ose 13.90% dhe në shkallën D 23 të sëmurë ose 12.45%.

Gjatë ekzaminimeve endoskopike sipas grupmoshave u evidentuan këto pjesëmarrje të hernisë hiatale: grupmosha 20-39 vjeç me 41 të sëmurë ose 22%, grupmosha 40-59 me 61 të sëmurë ose 32.8 %, grupmosha 60-79 vjeç me 19 të sëmurë ose 49% dhe grupmosha mbi 80 vjeç me 140 të sëmurë ose 75.3% të paraqitur në tabelën vijuese:

Tabela 2.

Grupmoshat	Numri i të sëmureve	%
20-39	41	22
40-59	61	32.8
60-79	91	49
>80	140	75.3

Graf. 2



Sipas llogaritjes statistikore, paraqitja më e shpeshtë e hernisë hiatale ishte në moshën e shtryer mbi 80 vjeç.

DISKUTIMI

Humbja e baraspeshës në mes të faktorëve agresivë dhe të atyre mbrojtës bën të mundur kthimin e përmbajtjes së lukthit dhe të duodenit në ezofag me konsekuencë të ezofagjitit. Këta të sëmurë kanë çrregullime fiziologjike më të shprehura të tilla si shtypja e ulët në nivel të sfinkterit të poshtëm ezofageal, çrregullim të peristalltikës dhe ekspozim më të shtuar ndaj aciditetit (11). Këta të sëmurë me sëmundje të refluksit gastroezofageal dhe sidomos në komplikimet e mevonshme si Barrett s ezofag, kanë një skor më të ulët të ndjeshmërisë pas perfuzionit acidik, sidomos kur bëhet fjalë për moshat e shtyera (12, 13).

Në moshat e reja, ndjeshmëria e kemoreceptorëve është parë të jetë normale.

Rezultatet tona nga aspekti i moshës mesatare (57.14) dhe pjesëmarrjes së dy gjinive, meshkujt 52.68% dhe femrat 47.31%, janë identike me të dhënat nga literatura bashkëkohore.

Rezultatet e studimit tonë tregojnë për një shpërndarje të njëjtë të të sëmurëve sipas kategorive të klasifikimit sipas Los Angeles.

Efekti i rritjes së moshës në shpeshtësinë e paraqitjes së simptomave të SRGE ka qenë jo e kjartë, dhe pikërisht kjo ka qenë një ndër qëllimet kryesore të hulumtimit tonë.

Nga tabela 1 shihet se piroza, dhembja dhe pengesat dispeptike kanë tendencë të rënies në shpeshtësi të paraqitjes së tyre në lidhje me moshën, dhe atë në mënyrë sinjifikante. Ndërsa simptomet e tjera si disfagjia, anemia, anoreksia, humbja e peshës dhe vjellja kishin tendencë të shtimit të shpeshtësisë së paraqitjes së tyre në krahasim me grupmoshën e re. Edhe studimet e rralla për këtë aspekt (14, 15) tregojnë për shpeshtësi

sinjifikante më të vogël të shfaqjes së simptomave kryesore të SRGE si: piroza ose regurgitimi dhe dhembja abdominale në moshat e vjetra krahasuar me ato më të reja.

Prania e hernisë hiatale çrregullon funksionin e sfinkterit të poshtëm ezofageal dhe me këtë edhe pastrimin e acidit të kthyer në eozfagun distal (16). Në hulumtimin tonë është gjetur se prania e hernise hiatale mbi moshën 80 vjeç ishte e shoqëruar me ezofagjit në 75.3% të rasteve, krahasuar me moshat më të reja. Edhe rezultatet e autorëve të jashtëm (14, 17), nga ky aspekt, janë të ngjashme me rezultatet tona.

PËRFUNDIM

1. Shpeshtësia e simptomeve tipike për SRGE zvogëlohet me shtimin e moshës dhe atë në mënyrë sinjifikante ($p<0.01$).
2. Shpeshtësia e simptomeve të tjera (disfagjia, anemia, anoreksia, humbja e peshës dhe vjellja) rritet me moshën e shtyer $p<0.01$).
3. Shpeshtësia e hernisë hiatale rritet me moshën e shtyer gjë që implikon në format më të rënda të refluks ezofagjitit në këto mosha.

LITERATURA

1. Vakil N, van Zanten SV, Kahrilas P, Dent J, Jones R.The Montreal definition and classification of gastroesophageal reflux disease: a global evidence-based consensus.Am J Gastroenterol 2006;101:1900-20.
2. Dent J, El-Serag HB, Wallander MA, Johansson S.Epidemiology of gastro-oesophageal reflux disease: a systematic review. Gut 2005;54:710-7.
3. Wu JC. Gastroesophageal reflux disease: an Asian perspective. J Gastroenterol Hepatol 2008;23:1785-93.
4. Isolauri J, Laippala P. Prevalence of symptoms suggestive of gastro-oesophageal reflux disease in an adult population. Annu Mediaev 1995;27:67-70.
5. Mohammed I, Cherkas LF, Riley SA, Spector TD, Trudgill NJ. Genetic Influences in gastro-oesophageal reflux disease: a twin study.Gut 2003;52:1085-9.
6. Locke III Gr, Talley NJ, Fett SL, Zinmeister AR, Melon III LJ. Prevalence and clinical spectrum of gastro-oesphageal reflux: a population-based study in Olmsted Country, Minnesota. Gastroenterology 1997;1112:1448-56.
7. Ruigomez A, Garcila Rodriguez LA, Wallander MA, Johannson S, Gaffner H, Dent J, Natural history of gastro-oesophageal reflux disease diagnosed in general practice. Aliment Pharmacol Ther 2004;20:751-60.
8. Kotzan J, Wade W, Yu HH.Assessing NSAID prescription use as a predisposing factor for gastroesphageal refulx disease in a Medicaid population. Pharm Res 2001;18:1367-72.
9. El-Serag H, Sonnernberg A, Associations between different forms of gastro-oesophageal reflux disease. Gut 1997;41:594-9.
10. Collen MJ, Abdulian JD, Chen YK. Gastroesophageal reflux disease in the elderly: more severe disease that requires aggressive therapy. Am J gastoenterol 1995;90:1053-7.
11. Vaezi ME, Richter JE. Role of acid and duodeno-gastro-esophageal reflux in gastroesophageal reflux disease. Gastroenterology 1996;111:1192-1199.
12. Grade A, Pulliam G, Johnson C, Garewal HS, Sampliner RE, Fass R. Reduced chemoreceptor sensitivity in patients with Barrett's esophagus may be related to age and not to the presence of Barrett's epithelium. Am J Gastroenterol 1997;92:2040-2043.
13. Triadafilopoulos G, Sharma PR. Features of symptomatic gastroesophageal reflux disease in elderly patients. Am J Gastroenterol 1997;92:2007-2011.
14. Pilotto K, Franceschi M, Leandro G, Scarelli C, D'Ambrosio LP, Seripa D, et al..Clinical features of reflux esophagitis in older people: a study of 840 consecutive patiens. J Am Geriatr Soc 2006;54;1537-42.
15. Raiha I, Hietanen E, Sourander L, Symptoms of gastro-oesophageal reflux disease in elderly people.Age Ageing 1991;20:365-70.
16. Huang X, Zhu HM, Deng CZ, Porro GB, Sangaletti O, Pace F, Gastroesophageal reflux: the features in elderly patiens. World JGastroenterol 1999;5:421-3.
17. Amano K, Adachi K, Katsube T, Watanabe M, Kinoshita Y, Role of hiatus hernia and gastric mucosal atrophy in the development of reflux esophagitis in the elderly. Gastroenterol Hepatol 2001;16:132-6.

SUMMARY

THE PREVALENCE OF SYMPTOMS AND HIATUS HERNIA IN PATIENTS WITH REFLUX OESOPHAGITIS IN CORRELATION WITH AGE

Zaim Gashi[1], Aida Polloshka[1], Fitore Komoni[1]
[1]UCCK, Clinic for Internal Diseases, Gastrohepatology Ward, Prishtina, Kosova

Introduction and aim*: Gastroesophageal reflux disease (GERD) is very common nowadays. Good breakdown of protective barrier allows antireflux presenting various forms of reflux oesophagitis. This is manifested by numerous clinical symptoms. The purpose of the study was to investigate the connectivity between the symptoms of disease and age and impact of the presence of hiatus hernia in the appearance of various forms of reflux oesofagitis.* ***Material and methods****: From the patients received information on complaints / symptoms of illness certified as reflux oesophagitis subsequently with endoscopy and the presence of hiatus hernia.* ***Results:*** *Of 186 investigated patients, the main symptoms of the disease as pirosis, pain and dyspeptic disturbances have dropped in frequency by adding the age of the patients, while other symptoms dysphagia, anaemia, anorexia, weight loss and vomiting were added toflushing frequency with age. The frequency of hiatus hernia has been added to the age of flushing (75.3%) compared to young age (22%).* ***Conclusion****: The main symptoms typical for SRGE have shown their frequencies decrease with the increses of age, while other symptoms are added to the frequency. The presence of hiatus hernia has enabled the appearance of severe forms of reflux oesofagitis and was greater in the older ages.*

Key words*: Typical symptoms, reflux oesophagitis, hiatus hernia*

PUNIM BURIMOR SHKENCOR / ORIGINAL SCIENTIFIC PAPER
DIABETOLOGJI

IMPACT OF METABOLIC CONTROL IN PREULCERATIVE PHASE OF DIABETIC FOOT

Irfan Ahmeti[1], Milco Bogoev[1], Gordana Pemovska[1], Tatjana Milenkovic[1], Branka Krstevska[1], Arben Taravari[2]
[1]University Clinic of Endocrinology, Diabetes and Metabolic Disorders, Skopje. Macedonia
[2] University Clinic of Neurology, Skopje. Macedonia



Irfan Ahmeti, mjek internist endokrinolog
Str. Xhon Kenedi 25-4-4, Skopje, Macedonia
Tel. +389(0)70 239 607
e-mail: iahmeti@yahoo.com&irfana@endocrinology.org.mk

RESUME: Aim. *To estimate impact of metabolic disturbances in type 2 diabetic patients (T2DM) and risk for ulceration in preulcerative phase of diabetic foot syndrome (DFS).* ***Material and methods****. In this prospective study following parameters are estimated: duration, smoking, BMI, BP, HbA1c, TG, HDL, LDL, fundoscopy and measurements for risk score of DFS. Groups were stratified according measurements : 0–low risk, 1–medium risk, 2-high risk, and 3–very high risk.* ***Results****. From 100 patients, 53% were female and 47% male. Mean duration of T2DM 10, 47 ±4, 77 year. Smokers are registered to have 43%, Results of measurements for risk score stratifications have been in V1: score 0-29 %, 1–3%, 2-18% and 3–18% and in V2 in score 0-17 %, 1–39%, 2-19% and 3–25%. BMI was recorded as follows: normal (18-25 kg/m^2) 14%, overweighed (25-30 kg/m^2) 71% and obese (>30 kg/m^2) 15%. Mean HbA1c in V1 was recorded: 0-7,6%, 1-7,9%, 2-8,5% and 3-8,2% (p<0,005), and in V2: score 0-7.26%, 1-7.46%, 2-7, 54% and 3-7, 54%. Systolic BP divided regarding scores is measured: score 0–136 mmHg, 1–142 mmHg, 2–145 mmHg, 3–142 mmHg. Mean levels of TG were: 0-1,97 mmol/L, 1-2,37 mmol/L, 2-2,3 mmol/L, 3-2,6 mmol/L. Mean levels of HDL: 0–1,06 mmol/L, 1–1,02 mmol/L, 2–0.97 mmol/L, 3–1,00 mmol/L. Mean levels of LDL: 0–3,69 mmol/L, 1–4,27 mmol/L, 2–4,05 mmol/L 3–4,09 mmol/L.* ***Conclusion****: Bad management of T2DM have impact in early appearance of DFS and early progression from low to high score for foot ulceration.*
Key words: *Diabetic foot, metabolic control, preulcerative phase*

Medicus 2011, Vol. XV (1):

INTRODUCTION

Diabetes is a chronic metabolic disease characterized with micro and macro vascular complications. Prevalence is in growth and in global frames is 5-6%. At the moment the number of peoples with diabetes in the world according to IDF - International Diabetes Federation is 285 millions and in the year 2030 is expected to be 438 million (1). Also, with the growth of the prevalence of diabetes and with the prolongation of life, the number of chronic diabetes complications growth. One of the parameters for good glucose regulation, according IDF recommendations is HbA1c<7.0% which delay chronic complications and prevent co-morbidity, invalidity and mortality. Meantime, it's necessary to prevent risk factors such as dyslipidemia, high blood pressure, smoking habits, responsible for atherogenesis of blood vessels which acts independently or as part of multiple risk factors. Unfortunately, it's impossible to stop progression of chronic complications in

diabetes and with the time they are the main problem of treatment of diabetes and are responsible for deterioration of quality of life. Macro vascular complications such as coronary artery disease (CAD), cerebro-vascular disease (CVD) and peripheral artery disease (PAD) are 2-4 times more frequent at the peoples with diabetes. Micro vascular complications, diabetic retinopathy, nephropathy and neuropathy are also 2-4 times more present in diabetic persons.

Diabetic foot syndrome (DFS) is complex heterogenic disorder that affect 15 -20% of people with type 2 diabetes (T2DM) and is responsible for most of amputations in developed countries (2). DFS consist clinic manifestations and or destructions of deep tissues associated with neurological, vascular and microbiologic disabilities characterized with different aetiology and pathologic mechanisms. T2DM patients have 25 times higher risk of lower extremity amputation than general population (3). In global frame, 70 % of all non traumatic amputations are due to diabetes. Distal PNP has been estimated to be present in 50%, PAD affects 40% (4). These two conditions frequently are present together in DFS. Importance of measurements in DFS is to prevent ulcerations and amputations from 80% to 50%. These measurements for practical and clinical use are categorized in three phases: 1- pre ulcerative, 2- ulcerative and 3- post ulcerative phase. In the pre ulcerative phase, the focus is to identify risk factors, to quantify with the risk score, and finally to plan preventive interventions. Evaluation of risk score has the purpose to classify the risk of DF for ulceration. According the ICGDF, the risk score for ulceration is classified in 4 groups: 0-low risk, 1-medium, 2 –high and 3–very high risks, to prevent and delay appropriately progression from one phase to other phase of diabetic foot (4).

AIM

1. To estimate impact of metabolic effect at type 2 diabetic patients in pre ulcerative phase according risk score.
2. To calculate the prevalence of prevalence of DFS in pre ulcerative phase in hospitalized patients.

MATERIAL AND METHODS

This is a prospective, observational study, in which included 100 T2DM patients hospitalized at University Clinic of Endocrinology, Skopje. Inclusion criteria were: type 2 DM after 1 year of diagnosis, between 35-75 year of age, male and female. Exclusion criteria were: neuropathy of non diabetic aetiology, use of drugs for neuropathy, PBI>1, 3, aged persons >75 years. According duration of T2DM, patients were divided in 3 groups: up to 5 year, between 5-10 year and more than 10 year.

At the beginning (visit 1–V1) for each patient is taken history and physical examination, laboratory investigations, (glycaemia with Glucose Analyser 2 - Beckman, and HbA1c ion changing chromatography, Drew), FBC, Lipid profile. Evaluation of measurements in pre ulcerative phase of DF is done at outpatient clinic for diabetic foot and patients are grouped according the risk score for ulceration. According these results it was taken plan of preventive interventions and next visit. Ophthalmologic control is also done for each patient at ophthalmologic outpatient clinic.

Measurements of DFS in pre ulcerative were systematically classified phase according the International Consensus on the Diabetic Foot (ICGDF).

RESULTS

The group of 100 patients with T2DM is of average age 59.45±10 (35-75). According risk score stratification the age is: for score 0–53, 8 year, score 1-59, 5 y, score 2-64,7y, and score 3-63, 3 years. From these results can be seen that there is statistical significance between risk factor age and risk score for ulceration (p=0.04). Distribution of sex was 53% female and 47% male: Kruskal-Wallis test for the factor gender shows that male patients have higher risk score for ulceration than female x^2 =8.232, df=3. p<0,05). Average duration of T2DM was10,47±4,77 years. The risk score in pre ulcerative phase of DF is strongly associated with the duration of diabetes (Kruskal-Wallis test: x^2=8.930, DF = 3, p<0,05).

In this study group, it is not marked statistic significance of risk factor smoking and association with risk score for ulceration, probably because of small number of patients smokers (p=0,595). Expressed manifestation of pathology in male patients is seen in smokers where the group 77.4% of respondents were men and 22.6% women of total 45% smokers.

BMI in the examined group is 27.61 ± 3.22 kg/m2. Results did not show statistical significance of the BMI between score groups at risk for foot ulceration, although in all groups were observed overweight (BMI> 25). BMI is as follows: normal (18 -25 kg/m^2)14%, overweighed (25-30 kg/m^2) 71% and obese (>30 kg/m^2) 15% of patients.

Table 1.

V1 and V2 risk scores in preulcerative phase of DFS compared with age, sex, duration, smoking habits, body mass index and systolic blood pressure

Risk score V1	N	Age y	Sex m	Sex f	Duration y	Smokers	BMI kg/m2	BP mmHg
0-absent/minimal	29	53.8 ±10.2	9	20	8.6±5.3	13	27.9±1.7	136.5±14.8
1-medium	34	59.5±9.3	18	17	10.3±3.8	15	28.6±2.3	142.9±13.9
2- high	19	64.7±10.1	7	11	11.6±5.1	12	27.7±2.3	144.7±14.4
3-very high	18	63.3±12.3	13	5	12.6±4.4	8	26.8±1.9	142.5±12.7
Total	100	59.4±10	47	53	10.5±4.7	48	27.6±2.2	141.3±14.2
P		0.04			0.026	0.595	0.125	0.19
Risk score V2	N	Age y	Sex m	Sex f	Duration y	Smokers	BMI kg/m2	BP mmHg
0-absent/minimal	17	52.5 ±10.2	6	11	7.6±4.4	8	26.3±2.1	132.9±7.2
1-medium	39	58.2±10.1	17	22	9.9±4.5	14	28.5±3.4	135.5±8.7
2- high	19	60.1±8.7	8	11	12.0±4.6	13	27.8±3.4	136.3±7.8
3-very high	25	65.6±11.4	16	9	12.1±4.7	10	26.9±3.1	133.4±7.9
Total	100	59.5±11	47	53	10.5±4.8	45	27.6±3.2	134.7±8.2
P		0.002			0.01	0.165	0.07	0.45

Systolic blood pressure in average is more than 130 mmHg, but did not show statistically significance between risk score groups in V1 (p=0,190) and V2 (p=0,453). Figure 1.

The analysis of the tests values of HbA1c, showed statistically significant difference between groups in scores on the DFS in V1 **(**x^2=8,653, df =3**,** p=0.034). Of the total number of patients with HbA1c <7% there were 18**%,** HbA1c 7-8% were 43% and HbA1c> 8**%** were 49**%** of patients**.** After 12 months, at V2 because of small difference in average HbA1c between groups it's not noted statistical significance between groups and HbA1c score (V2 : x^2 =2,178, df =3, p=0.53).

Table 2.

Mean HbA1c in pre ulcerative phase of DFS Kruskal Wallis

Report						
V1T **HbA1c**	P=0.03			V2 **HbA1c**		P=0,53
V1Score risk	Mean	N	Std. Dev.	Mean	N	Std. Dev.
0-absent/minimal	7.61	29	1.03	7.25	17	.41
1-medium	8.00	34	1.21	7.46	39	.56
2- high	8.42	19	1.32	7.54	19	.70
3-very high	8.18	18	1.39	7.54	25	.58
Total	8.00	**100**	1.23	7.46	**100**	.57

Examination of the lipid profile: In the group of patients at risk for ulceration, the risk score did not show statistical significance in the results of TG, LDL and HDL cholesterol.

TG - Patients in V1 had a higher average than in V2.

Table 3.


Mean TG values in V1 and V2. Kruskal Wallis test: no statistically significant difference in the distribution of frequencies of patients with TG in different score groups

Report						
V1TG	P=0.49			V2 TG		P=0,16
V1Score risk	Mean	N	Std. Dev.	Mean	N	Std. Dev.
0-absent/minimal	1.96	29	.53	1.92	17	.38
1-medium	2.36	34	1.29	2.08	39	.41
2- high	2.30	19	.72	1.98	19	.38
3-very high	2.62	18	2.01	2.23	25	.65
Total	**2.28**	**100**	**1.22**	**2.07**	**100**	**.48**

Value of TG <2, 2 mmol / L is marked in patients with risk score 0 and 1 (47%), while for risk score groups 2 and 3 is 21%. Patients with values of TG>2, 2 mmol / L were deployed in the risk score groups equally (Figure 1).

Figure 1.

Distribution of TG levels in risk score groups of DFS



LDL cholesterol was higher in groups with score 1, 2 and 3 (LDL>4 mmol/L).

Values of HDL cholesterol did not differ by group risk score although a somewhat lower value is noted in group 2 and 3.

However, differences between negative and positive Wilcoxon ranking test shows statistically significance between risk score groups V1 and V2 (for TG p=0.011, For LDL p<0,001 and for HDL p=0.013). Values are decreased in average 0, 2 mmol/L from V1 to V2 for TG, for LDL 0, 5 mmol/L and for HDL are increased 0.03 mmol/L.

In this group of T2DM, diabetic retinopathy was present with 68%-53% non proliferative and 15% proliferative. According the risk score at visit 1 retinopathy is present: in score 0–15% non-proliferativeand 0% proliferative, score 1-18% non-proliferativeand 1% proliferative, score 2-11% non-proliferativeand 6% proliferative, and score 3 -9% non-proliferative and 8% proliferative. After 12 months in V2, diabetic retinopathy was present in 72% of which 51% non-proliferative and 21% proliferative. In scored groups diabetic retinopathy was present: in score 0–6% non-proliferativeand 0% proliferative, score 1-22% non-proliferative and 3% proliferative, score 2-10% non-proliferative and 7% proliferative, and score 3-13% non-proliferative and 11% proliferative.

DISCUSION

Metabolic control of diabetes is associated with the progression of chronic macro-and micro vascular complications**.** The impact of poor glycoregulation, dyslipidaemia**,** hypertension, smoking**,** duration of diabetes**,** is associated with complications of diabetes**.** In our population, diabetic foot syndrome - preulcerative phase was represented by 61.7%. The risk score in V1 is: score 0-29%, score 1-34%, score 2-19%, score 3-18%, while in V2: the risk score is 0-17%, risk 1-39% risk 2-19% and risk 3-25%. The prevalence and incidence of risk score of ulceration in the Mexican Americans in a cohort study amounted to: 0 to 58.6%, 1 - 5.9%, 2-24.7%, 3 - 10.8% (5).

Diabetes is the leading cause of neuropathy in the western world. Data from the U.S shows that 10-70% of patients with diabetes have some form of peripheral neuropathy (6).

Distal sensory polyneuropathy in our investigated group of patients was present 58% in V1 and 68% in V2. As criteria are taken history of disease, testing with monofilament, Vibratory tuning fork.

Periferal artery disease in different studies have different prevalence, and ranges between 22-73%. Prompers et al. (2008) in EURODIALE study, emphasize prevalence of PAD 49% of patients with diabetic foot (7). In our study PAD had 41.7% of patients with T2 DM. From 100 T2DM patients, critical limb ischemia had 8.3%. PAD when measured PBI in V1 is registered in 41% and in V2 in 46%.

The average duration of diabetes in our patients with diabetic foot syndrome is 10.47 years (8.6 years in score 0 and 12.6 years in score 3). This confirms the fact that in higher duration of the diabetes, patients have a higher risk score for foot ulceration. Duration of diabetes in patients investigated for diabetic PNP in the literature ranges from 8.4 to 12.49 years (8).

Among the patients in our study showed almost equal gender representation of men and women with DFS. Distribution by gender is 53% women and 47% males (Kruskal Wallis test x^2=8.232, df = 3. p <0,05). The groups with risk score 3, shows the higher percentage of DFS in men (13%) compared with women (5%). This difference is probably due to the greater number of male smokers in this risk group (77.4% of patients were men and 22.6% women from 45% smokers of total smokers) and also probably due to smaller PBI (<0,9) in the group with the risk score 3, (72% male vs. 28% female in V1 and 64% male and 36% in V2). If we take into account the number of cigarettes smoked per day, it is evident that more than 15 cigarettes / day smoked 90% male and 10% female. Female smokers dominate in the number of up to 10 cigarettes/day (61.9% women and 31.8% men). According the gender distribution, in the literature can be found similar data for diabetic neuropathy, 47, 8% men and 52, 2 % women (9).

BMI showed no statistical significance in pre ulcerative phase risk score groups (p> 0.05), although the study of Pinzur et al. (2008) published in the April edition of Foot and anklet International (FAI), shows that morbidly obese patients are much more likely to develop diabetic foot ulcers than non-obese patients (10).

Systolic BP in average is more than 130 mmHg, but did not show statistically significance at risk score groups in V1 (p=0,190) and V3 (p=0,453). Differences in negative and positive Wilcoxon signed Ranks Test showed that there was statistical significance in risk score groups V1 (140 mmHg) and V2 (134 mmHg) for risk factor systolic BP (p<0,01). In UKPDS 36, Adler et al. conclude that each 10 mmHg decrease in updated mean systolic BP was associated with reduction in risk of 12% for any complication related to diabetes (11). In visit 1 we remarks that HbA1c has statistically significance with the risk score in pre ulcerative phase of DFS. At the visit 1, HbA1c>8% have 49% of patients. After 12 months, at visit 2, it is not marked significance between groups, although in V 2 we remark decrease in HbA1c for 0.54% compared to risk score groups in V1. This suggests that improvements in HbA1c from V1 to V2 do not prevent progression of risk for foot ulceration for period of 12 months.

In our study, values of TG, LDL and HDL cholesterol did not show statistical significance for DFS in pre ulcerative phase for this period of 12 months, although value of TG<2,2 mmol/L is marked in patients with risk score 0 and 1 (47%), while for risk score 2 and 3 is 21%. Patients with values of TG>2, 2 mmol / L are marked in the risk score groups equally. LDL cholesterol is higher in groups 1, 2, and 3, (LDL>4 mmol/L). Values of HDL cholesterol did not differ by risk score groups although somewhat lower values are noted in group 2 and 3.

However, differences between negative and positive Wilcoxon ranking test shows statistically significance between risk score groups in V1 and V2 (for TG p=0.011, For LDL p=0,000 and for HDL p=0.013). Values are decreased approximately 0, 2 mmol / L from V1 to V2, for LDL 0,5 mmol/L and for HDL are increased 0.03 mmol/L.

Association between DFS, risk score for foot ulceration and diabetic retinopathy is statistically significant. Group with risk score 0 and 1 have more non-proliferative retinopathy and group with score 2 and 3 have more proliferative retinopathy (Cross tabulation. Kruskal Wallis test p<0,01). Independent factors associated with retinopathy were duration of diabetes, SBP, $HbA_{1c.}$ The U.K. Prospective Diabetes Study showed a 34% reduction in the progression of retinopathy (12).

CONCLUSION

Bad management of Type 2 diabetes – high HbA1c, high BP, High TG and high LDL, are multifactor for early appearance of DFS and had impact of early progression from low to high score for foot ulceration.

The prevalence of DF in pre ulcerative phase is higher than in other studies probably because of patient groups (in clinic patients), and duration of diabetes more than 10 year, HbA1c>8%, TG>2,2 mmol/L, HDL<1,04 mmol/L , LDL>4 mmol/L have high risk (score 2) or very high risk (score 3) for ulceration.

REFERENCES

1. http://atlas.idf-bxl.org/content/diabetes/

2. The International Consensus on the Diabetic Foot (IWGDF): The diabetic foot: a challenge for professionals and policymakers. Noordwijkerhout, the Netherlands. 2007
3. The International Consensus on the Diabetic Foot. Practical guidelines on the management and prevention of the diabetic foot. Noordwijkerhout, the Netherlands. 2007
4. Piagessi et all. Measurments in diabetic foot. Wounds. 2005;17(9):247-254. 2005 Health Management Publications, Inc.
5. Lavery LA, Armstrong DG, Wunderlich RP, Jeffrey T, Boulton AJM. Diabetic Foot Syndrome. Evaluating the prevalence and incidence of foot pathology in Mexican Americans and non-Hispanic whites from a diabetes disease management cohort. Diabetes Care **May 2003** vol. 26 no. 5 **1435-1438**
6. (www.wrongdiagnosis.com/d/diabetic_neuropathy/prevalence.htm).
7. Prompers L, Schaper N, Apelqvist J, Edmonds M, Jude E, Mauricio D, Uccioli L, Urbancic V, Bakker K, Holstein P, Jirkovska A, Piaggesi A, Ragnarson-Tennvall G, Reike H, Spraul M, Van Acker K, Van Baal J, Van Merode F, Ferreira I, Huijberts M. Prediction of outcome in individuals with diabetic foot ulcers: focus on the differences between individuals with and without peripheral arterial disease. The Eurodiale Study. Diabetologia. 2008 May; 51(5): 747–755.
8. Meijer JWG, van Sonderen E, Blaauwwiekel E, Smit AJ, Groothoff JW, Eisma WH, Links TP. Diabetic neuropathy examination; a hierarchical Scoring system to diagnose distal polineuropathy in diabetes. Diabetes Care 2000;23(6): 750-753
9. Fedele D, Giugliano D. Peripheral diabetic neuropathy: Current recommendations and future prospects for its prevention and management. Drugs. SEP 1997; 54(3): 414-421.
10. Pinzur M, Freeland R, Juknelis D. The association between body mass index
11. Irene MS, Amanda IA, Andrew H, Neil W, David RM, Susan E M, Carole AC, David H, Robert CT, Rury RH on behalf of the UK Prospective Diabetes Study. Association of glycaemia with macrovascular and microvascular complications of type 2 diabetes (UKPDS 35): prospective observational study. BMJ aug 2000; Vol. 321.
12. UK Prospective Diabetes Study (UKPDS) Group: Tight blood pressure control and risk of macrovascular and microvascular complications in type 2 diabetes: UKPDS 38. BMJ 317:703–713, 1998

REZYME

NDIKIMI I KONTROLLIT TË METABOLIZMIT NË FAZËN PREULCERATIVE TE KËMBA DIABETIKE

Irfan Ahmeti[1], Milco Bogoev[1], Gordana Pemovska[1], Tatjana Milenkovic[1], Branka Krstevska[1] , Arben Taravari[2]

[1]Klinika Universitare e Endokrinologjisë, Diabetit dhe Çrregullimeve Metabolike, Shkup, Maqedoni,
[2]Klinika Universitare e Neurologjisë, Shkup, Maqedoni

Qëllimi. *Të vlerësohet efekti i çrregullimeve metabolike te tipi 2 i diabetit (T2DM) dhe rreziku për ulceracion te sindromi i shputës diabetike (DFS) në fazën preulcerative.* ***Materiali dhe metodat:*** *Në këtë studim prospektiv, epidemiologjik janë analizuar: kohëzgjatja, duhani, BMI, tensioni i gjakut, HbA1c, TG, HDL, LDL, fundoskopia dhe matjet për vlerësimin e shkallës së rrezikut për ulceracion te DFS. Grupet janë stratifikuar në: 0–rrezik i ulët, 1–mesatar, 2-i lartë dhe 3–rezik shumë i lartë.* ***Rezultatet:*** *Nga 100 pacientë, 53% kanë qenë femra dhe 47% meshkuj. Kohëzgjatja mesatare ka qenë 10, 47 ±4, 77 vjeç. Konsumues të duhanit kanë qenë 43%. Stratifikimi i shkallës së rrezikut nga ulceracioni te DFS në vizitën 1 (V1) ka qenë: shkalla 0-29 %, 1–35%, 2-18% dhe 3–18%, ndërsa në V2: shkalla 0-17 %, 1–39%, 2-19% dhe 3–25%. Matjet e BMI kanë qenë: normal (18-25 kg/m^2) 14%, mbipeshë (25-30 kg/m^2) 71% dhe obezë (>30 kg/m^2) 15% të pacientëve. Mesatarja e HbA1c në V1 sipas shkallëve ka qenë: 0-7,6%, 1-7,9%, 2-8,5% dhe 3-8,2% (p<0,005), dhe në V2: 0-7.26%, 1-7.46%, 2-7,54% dhe 3-7,54%. Tensioni sistolik i gjakut ka qenë: shkalla 0–136 mmHg, 1–142 mmHg, 2–145 mmHg, dhe 3–142 mmHg. Vlerat mesatare të TG kanë qenë: 0-1,97 mmol/L, 1-2,37 mmol/L, 2-2,3 mmol/L, dhe 3-2,6 mmol/L të HDL: 0–1,06 mmol/L, 1–1,02 mmol/L, 2–0.97 mmol/L, 3–1,00 mmol/L. të LDL: 0–3,69 mmol/L, 1–4,27 mmol/L, 2–4,05 mmol/L 3–4,09 mmol/L.* ***Konkluzion****: Menaxhimi i dobët i T2DM çon në manifestimin e hershëm të DFS dhe ndikon në kalimin e hershëm nga shkalla më e ulët në atë më të lartë të rrezkut për ulcerim.*

Fjalë kyç: *Këmba diabetike, kontrolli metabolik, faza preulcerative*

PUNIM BURIMOR SHKENCOR / ORIGINAL SCIENTIFIC PAPER

NEFROLOGJI

ROLI I PROTEINËS-C-REAKTIVE TE PACIENTËT ME INSUFICIENCË RENALE KRONIKE NË FAZËN PRETERMINALE DHE GJATË TRAJTIMIT ME HEMODIALIZË

Lutfi Zylbeari[1,3], Fatmir Omeri[1], Nexhbedin Karemani[3], Elita Zylbeari[1], Zamira Bexheti[2], Gazmend Zylbeari[2]

[1]Spitali Klinik, Reparti i Sëmundjeve të Brendshme, Tetovë, Maqedoni

[2]Fakulteti Mjekësisë, "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri

[3]Fakulteti i Mjekësisë, USHT, Tetovë, Maqedoni



Lutfi Zylbeari, mjek nefrolog, primarius, dr sci
Rr. JNA 1-9/45, Tetovë
Tel: 044 330 810
e-mail: drluti@yahoo,com & dr-luti@hotmail.com

REZYME: *Një ndër shkaktarët më të shpeshtë të invaliditetit, morbiditetit dhe mortalitetit në shoqerinë bashkëkohore tek pacientët me Insufuciencë Renale Kronike Terminale (IRKT) të trajtuar me Hemodializë (HD) numërohen sëmundjet kardiovaskulare në karahasim me populatën e shëndoshë. Viteve të fundit përveç faktorëve të njohur si: mosha, gjinija, presioni i lartë arterial, diabeti, adipoziteti, predispozicionit gjenetik, sedanteriteti, konzumimi i duhanit, pasiviteti fizikë, stresi psikik, dislipidemia, fibrinogjeni, etj., në etiologjinë e sëmundjeve koronare si faktorë i ri i rrezikut numërohet edhe niveli i lartë i Proteinës-C-Reaktive (PCR). Në rastet kur çrregullimet e PCR shoqërohen edhe me çrregullime të lipideve, pasojat ndaj sistemit kardiova-skular janë më të shprehura dhe më evidente e cila na motivoi që në punimin tonë të bëjmë edhe përcaktimin e profilit të lipideve .*

Fjalë kyç: *Proteina-C-Reaktive, sëmundjet koronare, ateroskleroza, profili i lipideve (ChT,TG,HDL-ch, LDL-ch).*

Medicus 2011, Vol. XV (1):

HYRJE

Pacientët me dobësim të funkcionit të veshkëve që në fazat fillestare janë kandidat potencial të sëmundjeve koronare. Studime të shumta kanë verifikuar se komplikimet kardiovaskulare te pacientët me insuficiencë renale kronike terminale (pa marrë parasyshe fazat) janë me etiologji multifaktoriale. Mortaliteti te pacientët me IRKT të trajtuar me hemodializë përsëritëse nga sëmundjet koronare është tejet më i shpeshtë dhe me prevalencë më të lartë krahasuar me pacientët e populatës së shëndoshë. Është i njohur fakti se pacientët me IRKT prezentojnë pasqyrë klinike të aterosklerozës së hereshme me komplikime serioze kardiovaskulare, cerebrovaskulare dhe dëmtime arteriale periferike shumë më të shpeshta, në numër shumë më të madh te pacienteve dhe në moshe më te re në krahasim me popullatën e shëndoshë (1, 2). Proteina-C-Reaktive (PCR) fiziologjikisht tajohet nga mëlçia e zeze dhe gjate çdo proqesi inflamator kemi rritje të tepërt të përqendrimeve të saja në plazmë. Vlerat refernte të PCR janë=0-5mg/L/

Dislipidemia uremike si dhe ndryshimet e përqëndrueshmërisë së PCR te pacientët me dobësim të veshkëve paraqitet që në fazat fillestare të dobësimit të tyre, prandaj ekzaminimi dhe etiopatogjeneza e abnormaliteteve të tyre në rastin konkret të nivelit te PCR dhe korelacioni i saj me nivelet e lipideve dukshëm mund të kontriboje në prevencën e sëmundjeve kardiovaskulare, cerebrovaskulare dhe aterosklerozës së hershme te pacientët me IRKT të mjekuar me hemodijalizë përsëritëse. Nivelet e larta te PCR tregojnë për një prezencë permanente të inflamacionit dhe sherbenë si përcaktues i fuqishëm i mortalitetit te pacientët uremik të trajtuar me hemodializë pëerseritëse (3, 4).

Viteve të fundit është verifikuar se ateroskleroza perziston që në fazat fillestare të dobësimit të veshkëve, para fillimit të trajtimit me hemodializë (HD) kronike dhe ajo numrohet si faktorë themelor i fillimit të proçeseve aterogjene te pacientët me IKRT. Përcaktimi i profilit të përqëndrueshmerisë së disa nga faktorëve favorizues të aterosklerozës (biomarkerëve të inflamacionit- PCR, profilit të lipideve) dhe në veçanti abnormalitetet e tyre te pacientët me IRKT në fazat fillestare të sëmundjes, si dhe ndriçimi i mekanizmave etiopatogjenetik dukshëm mundë të ndihmojnë në propozimin e masave preventive (dietetike, masat mjekuese) me çka do të zvoglohet dhe redukohet dukshëm paraqitja e shpeshtë e dëmtimeve aterosklerotike dhe do te zvogëlohet incidenca e aterosklerozës te pacientët me IKRT të randomizuar sipas gjinisë dhe moshës.

Supozohet se ndryshimet suptile, kvalitative të regjistruara në morfologjinë (madhësinë) e partiklave (grimcave) të lipoproteinave të pacientët me IRKT, jashtëzakonishtë e rrisin ndikimin aterogjen të tyre (afinitet i rritur) me fiksim (ngjitje) në subentotelin arterial të *LDL të oksiduar-LDlox, LDL i vogël) dhe grimcave minore të HDL* me dëmtime të shpeshta aterosklerotike ndaj sistemit kardiovaskular dhe cerbrovaskular me pasoja vdekjepruese në qendrat për mjekim me hemodializë (14). Më së shpeshti paraqiten sëmundjet ishemike të zemrës, infarkti akut i miokardit, sëmundja vaskulare periferike dhe insulti cerebrovaskular.

Pre □₁-HDL është subfrakcion minor i cili vepron si akceptor inicijal i kolesterolit të lirë i emanuar nga qelizat dhe transportit te tyre drejt mëlçisë. Nën ndikimin e Lecitin-Kolesterol-Acetil-Transferazës (LCAT), *□₁- HDL kalon në-□HDL-ch-migrues. LCAT në plazmën normale* ndikon në pjekurinë e kolesterolit-HDL, *duke e shëndrruar HDL të vobegët me lipide në HDL sferik të pasur me yndyrëra. Te pacientët uremikëaktiviteti i LCAT* është *i zvogëluar për □30% dhe konvertimi optimal i lartëpërshkruar* është *i kompromituar dhe redukuar* (25, 26, 27). Ekzaminimet klinike eksperimentale (inkubacioni i plazmës së pacientëve uremik me inhibitor të LCAT ose pa inhibitor të LCAT) e verifikojn qëndrimin e lartëpërmendur dhe vërtetojnë se ateroskleroza e herëshme me pasoja ndaj sistemit kardiovaskular është e varur direkt nga katabolizmit i çrregulluar i □1-HDL kolesterolit dhe biomarkerve inflamator PCR dhe kumulimit të tepërt të toksineve të ndryshme, inflamacioneve të shpeshta dhe imunitetit të dobësuar (5, 6). Inflamacionet kronike si tregues i përqëndrimeve të larta të citokineve proinflamatore: Interleukin-6, Interleukin-1ß dhe PCR janë dukuri të rëndomta dhe permanente te pacientët me IKRT që në fazat fillestare të sëmundjes (7).

Përqëndrimet e larta të PCR janë ngushtë të lidhura me paraqitjen e ateromatozës së arterieve koronare (infarktit te miokardit) dhe dukshëm asocojnë me mortalitetin e lartë te pacientët me IKRT pa marr parasysh fazën e dëmtimeve renale (preterminale apo terminale të trajtuar me hemodializë). Janë fakte të dokumentuara se përqëndrimet e larta të PCR dhe Interleukinës-6 për 25% më tepër e rrisin vdekshmërinë e pacientëve me IRKT nga sëmundjet koronare krahasuar me popullatën e shëndoshë (28, 29, 30). Përqëndrimet e larta të PCR dhe Interleukinës-6 janë në korrelacion të kundërt me funkcionimin normal të veshkëve dhe dukshëm ndikojnë në rritjen e mortalitetit nga sëmundjet aterosklerotike te pacientët me dobësim të veshkëve.

Torzewski me bp. kanë verifikuar shtresim (ngjitje) të biomarkuesit inflamator - PCR në muret e arterieve koronare bashk me grimcat e ashtuquajtura *"grimca të mbetura-foamm cells"*. Shkencetari me bp. (17, 15) me rezultatet e tyre sugjerojnë se PCR nuk është vetëm parashikues ndaj inflamacionit por është direkt i ivolvuar në lezionet ateroskleotike duke aktivizuar komplementet e involvuara në qelizat e mbetura lipoproteinemike.

Ne fazat akute të dobësimit te veshkëve Amyloidi-A Proteinemik në serum (AAPS-një apoprotein multifunkcional) është i involvuar në transportin dhe metabolizmin e kolesterolit si dhe në modifikimin e një numri të madh të faktorëve të inflamacionit si traumave të ndryshme, infeksioneve dhe stresit dhe paraqet edhe një faktorë plotësues dhe ndihmës për parqitjen e shpeshtë të proqeseve aterogjenetike te pacientët me dobësim kronik te veshkëve (18). Gjate fazës fillestare akute biosinteza hepatale e AAPS është e rregulluar nga citokinet proinflamatore dhe përqëndrueshmëria e sajë mund të arrije të rritet deri ne 1000 njësi, mirëpo në fazat e më vonëshme të fazës akute përqëndrueshmëria e AAPS fillon të zvogëlohet nga shkaku i prodhimit të tepërt të receptorit antagonistë (IL-1Ra) i cytokinës interleukin-1a. Këto fakte janë rezultat i një paralajmërimi sinjalizues mbi rolin dhe ndikim e citokinëve ndaj proçeseve inflamatore dhe ndikimin e tyre

ndaj atreogjenezës së arterive koronare, prandaj aplikimi dhe përdorimi i preparateve hipolipemik nuk janë në gjendje të japin rezultatet e pritura mbi korigjimin e dislipidemisë.

QËLLIMI I PUNIMIT

Ekzaminimi i përqëndrimit të PCR njërit nga biomarkerëet e shumtë inflamatorëe dhe rolin e sajë në paraqitjen e sëmundjeve kardiovaskulare, cerebrovaskulare dhe aterosklerozën e hershme te pacietët me insuficiencë renale kronike preterminale dhe pacientët me insuficiencë renale kronike terminale të trajtuar me hemodijalizë perseritëse.

MATERIALI DHE METODAT

Materijali ekzaminues u shfrytëtzua gjaku i marrur nga vena e 120 pacientëve prej të cilëve 70 pacientë ishin të trajtuar me hemodializë përsëritëse në Repartin e Nefrologjisë me Hemodializë pranë Spitalit Klinik të Tetovës, 50 pacientë ishin me sëmundje kronike renale - preterminale dhe grupi kontrolues prej 120 individëve të shendoshë, i marrur në orën 08 të mëngjezit, në temperaturë të dhomës prej 19-24^{0}C, në pozitë të shtrirë. Gjaku për analizë merrej çdo herë para seansave të hemodijalizës (HD) pas një gjendje urie prej 12-orësh me pesë matje konsekutive. Rezultatet e fituara prezentojnë vlera mesatare të fitura prej pesë matjeve në kushte identike. Gjaku i marrë për ekzaminim (3 ccm serum) me disa pika heparin për analizë është dërguar në Institutin e Biokimisë Klinike pranë Qendrës Klinike Universitare të Fakultetit të Mjeksisë në Shkup. Gjatë ekzaminimit të vlerave te PCR u ekzminua dhe analizua edhe profili i lipideve. Mosha mesatare e pacientëve me IRK-preterminale dhe grupës së pacientëve të trajtuar me hemodializë përsëritëse është identike =57.05□8.60 vjeçare ndërsa grupi kontrollues përbëhej prej=120 individëve të shëndoshë të moshës mesatare prej=59.5□8.40 vjeçare. Frekuenca e hemodializës ishte tre herë në javë nga katër orë e gjysëm, me membranë polysulfonike kapilare biokompatibile (F6 HPS dhe 5HPS, Fressenius & Hemomed) me sipërfaqe□1-1.3m^2, e sterilizuar me shtypje të lartë të avullit. Rezultatet e fituara u përpunuan në programin standard statistikor Windows (Statistics for Windows softfare) verzioni 6.0 A).

Vlerat referente te parametrave të analizuar janë të paraqitura në tabelën 1.

Tabela 1.

Profili i Lipideve	Vlerat referente	Autoret
LT	4-10g/l	Zollner & Kirsch [21]
TG	0,68-1,70 mmol/l	G. Buccola& H. David [22]
ChT	3,1-5,2 mmol/l	CC. Allain et al [23]
LDL-Ch	<3,4mmol/l,zgolemen rizik: > 4,1 mmol/1	Friedewalde&Fredrickson[24]
HDL-Ch	>1,6mmol/1,zgolemen rizik: < 0,9 mmol/1	G. Warnick et al [25]
PCR	0-5 mg/L	Imunoturbidimetrike

REZULTATET

Rezultatet e fituara nga pacientet dhe grupit kontrolues per PCR dhe profilit te lipideve (ChT,TG,HDL-ch,LDL-ch), jane te evidentuara ne tabelen 2.

Tabela 2.

Profili i Lipideve	**PACIENTËET ME IRK PRETERMINALE**	**PACIENTËT ME IRKT TË TRAJTUAR ME HEMODIALIZË**	Grupi kontrollues	***p***
TG mmol/l	3.10±0.40	3.80± 0.70	1.15±0.40	<0.0001
ChT mmol/l	5.60±0.70	6.20 ± 1.30	4.80± 1.30	<0.0001
LDL-Ch mmol/l	4.10±0.30	4.50±0.40	2.80±0.60	<0.0001

HDL-Ch mmol/l	1.02±0.60	0.80 ±0.40	1.50 ±0.60	<0.0001
PCR mg/L	**18.90±7.40 mg/L**	**13.8±*4.20 mg/L***	**3.90 1.80 mg/L**	<0.0001

Nga vetë tabela vërehet një dallim sinjifikant me p=0.0001 nga të gjitha vlerat e fituara të profilit të lipideve ndërmjet pacientëve me IRKT preterminale, pacientë e trajtuar me hemodializë përsëritëse krahasuar me grupin kontrollues. Përqëndrimet e PCR te grupi i pacientëve me IKRT u prezantuan me vlera prej=18.90±7.40 mg/L, te pacientët e trajtuar me hemodializë u ekzaminuan përqëndrime të PCR prej=13.8±4.20 mg/L, ndrësa te grupi kontrollues i shëndoshë u ekzaminuan koncentracione të PCR prej=3.90 1.80 mg/L dhe dallimi që u paraqit ndërmjet tre grupeve (të pacientëve me IRK preterminale, pacientëve të trajtuar me hemodializë përsëritëse dhe grupit kontrollues të shëndoshë) ishte me nje statistikë sinjifikante për p<0.0001. Fakte të dokumentuara edhe ne shumë studime mbi rolin dhe dallimin ndërmjet përqëndrimeve të PCR te pacientët me IRKT dhe popullatës së shëndoshë që janë në përputhshmëri edhe me rezultatet e punimit tonë.

DISKUTIMI

Te pacientët me insuficiencë renale kronike preterminale dhe terminale të trajtuar me hemodializë kronike persëritëse proçesi i nflamacionit i përshpejton lezionet renale me çrregullime ndaj homeostazës së kolesterolit në nivel qelizor me rritje te përqendrueshmerisë së tij në gjak dhe intensifikim te proçeseve aterogjene ndaj arterieve koronare me rritje të mortalitetit te kjo grup pacientesh. Janë fakte te verifikuara mbi efektet stimulative te citokineve ndaj sintezës së kolesterolit me stimulacion të lartë ndaj sintezës së HMG-Co-A-reduktazës me çka dukshëm zvogëlohet katabolizmi hepatal i kolesterolit. Në mesin e disa biomarkerëve inflamator mbi vlersimin e shkalles së inflamacionit, ndjeshmerisë së lartë të PCR viteve të fundit ka tërhjekur vemendje të madhe ndërmjet eksperteve të nefrologjisë për rolin dhe efektin e saj ndaj sëmundjeve koronare (12, 13). Vlerat e PCR në praktikën e pergjithshme duhet perdorur si një kriter klinik për parashikimin e rrezikut global ndaj sëmundjeve koronare (8, 9, 15). Sa PCR është ngushte e lidhur me sëmundjet vaskulare nga shume ekspert kohëve të fundit eshte sugjeruar se ky protein nuk është vetem një shënues i rëndomtë por edhe ndërmjetësues i fuqishëm i proçeseve aterogjenetike.

Te pacientët me insuficiencë renale kronike preterminale dhe terminale të trajtuar me hemodializë kronike përseritëse aktiviteti i Lipazës-Tregliceride-Hepatale (LTGH) është i zvogëluar për= 33-45% ndërsa aktiviteti i Lipopoprotein Lipazes (LPL) sistemike është i zvogëluar përshkak të (grumbullimit) kumulimit të toksineve ose citokineve (Interleukin-1, Interleukin-6, Interleukin- 1α, Interleukin-1) dhe përqendrimit të lartë të PCR dhe numrohet si shkaktare i çrregullimeve patologjike të lipideve te pacientët uremik (koncentracionet e HDL-ch dhe Apolipoproteines A-I janë të zvogëluara, ndërsa koncentracionet e tregliceride, LDL-ch, P-C-R ,Il-1, Il-6, Interleukin-1ß dhe Interleukin-1α jane te rritura) dhe janë të përcjellura me rritje të lartë të prevalencës së sëmundjeve aterosklerotike kardiovaskulare, cerebrovaskulare dhe arterieve periferike. Te pacientët me insuficiencë renale kronike preterminale dhe terminale të trajtuar me hemodializë kronike perseritëse përqendrueshmeritë e larta te kolesterolit të oksiduar (LDLox), IDL dhe VLDL e rrisin dhe shpejtojnë sekrecionin e citokineve inflamatore si Interleikun-6 (IL-6), *PDGF (Plateled-Derived-Growth-Factor-faktori i rritjes),TGFβ (Transforming-Growth-Factor-Beta), TNF-α dhe Proteines-C-Reaktive (PCR)* (10).

Studimet e fundit mbi PCR të vërtetuara in vitro në qelizat endoteliale, monocitet,makrofaget dhe qelizat e muskujve të bute kanë dokumentuar mbi rolin e drejperdrejtë të PCR mbi aterogjenezën ndaj sëmundjeve vaskulare. Te pacientët me IRKT si dhe pacientët uremik të trajtuar me hemodializë nivelet e CRP llogariten si parashikues të aterosklerozës koronare dhe një ndër faktorët me ndikim me të larte të mortalitetit te kjo popullatë,mirëpo studimet me bashkëkohore dhe krahasuese mbi efektin dhe rolin e Interleukine-6 (It-6) kan vërtetuar se ky lloj citokini mund të jetë dhe është si parashikues më i sigurt për shkallën e zhvillimt të aterosklerozës arterieve koronare, cerebrale dhe të arterieve periferike te pacientë të trajtuar me hemodializë dhe pacientë me IRKT në fazen preterminale (19). Prandaj janë të nevojshme studime krahasuese me kohëzgjatje më të madhe dhe numër më të madh të pacientëve për të vlersuar se cili prej biomarkeërve inflamatorë është parashikues më i rëndsëishëm për zhvillimin e proçeseve aterosklerotike te kjo grupë pacientësh dhe pasojave të saja ndaj sëmundjeve koronare dhe mortalitetit të lartë. Pacientët me IRKT në fazen preterminale dhe ato të trajtuar me hemodializë përseritëse dhe sëmundje themelore të sheqerit janë kandidat më të shpeshtë të sëmundjeve koronare dhe insulteve cerbral si pasojë e hipeglikemisë e shoqëruar edhe me vlera të larta te tregliceride (Hipertergliceridemi) dhe PCR ne krahasim me pacientët uremik por me sëmundje themelore të ndryshme të veshkëve.

Gjatë proçeseve të inflamacionit makrofagët janë përgjegjëse për largim shumë të shpejtë të eritrociteve nga gjaku, shkurtim të jetës së tyre me ulje të koncentracioneve të hemoglobinës dhe eritrociëtve duke e ndihmua anemin renale prezente te pacientë uremik. Te pacientët me IRKT në fazen preterminale apo pacientët e trajtuar me hemodializë, gjatë fazës së inflamacionit (në vlera të CRP>9mg/l koncentracionet e hekurit dhe transferinit jan tejet të ulta si pasojë e apsorpcionit të zvogëluar të hekurit nga lukthi, prandaj atëhere sasi me te vogla te transferines sekretohen në v. fellea dhe sasi me të vogla perzistojne në zorrë dhe si rezultat i ketijë proçesi sasi më të vogla të hekurit dorëzohen në mukozën receptoreve qelizore (28). Në mënyre teorike munges funkcionale e hekurit te pacientë uremik mund të paraqitet në dy mënyra: 1. kur doza të larta të rHuEpo-së e stimulojnë eritropoezen aq tepër sa që tejkalohet mundësia e kapacitetit maksimal që të prodhojë sasira të duhura të hekurit dhe 2. kur perquarja e hekurit nga qelizat retikuloendoteliale deri në hepatocite është e bllokuar(16,29). Prevalenca e inflamacionit te pacientë me IRKT si në fazën preterminale apo atë terminale të mjekuar me hemodializë është shume e lartë edhe nga vlerate e larta te PCR, Il-6 poashtu edhe e ndihmuar edhe nga infeksionet e ndryshme bakteriale, virusale, nga traumat e shpeshta, infekcioneve të fistule arteriovenoze apo katetrave femoral që perdoren si ndërhyrje për kryerjen e seansave të hemodializës. Nivelet e larta të PCR te pacientë me IRKT në fazën preterminale si dhe ate terminale të mjekuar me hemodializë mund të jenë një ndër shkaktarët kryesor për parqaqitjen e infarktit të miokardit-hipotetikisht mund të konkludohet se ndezjet kronike mund të jenë shumë të rëndësishme për paraqitjen e aterosklerozës së aterieve koronare. Pacientet me insuficiencë renale kronike në fazën preterminale prezantuar vlera me të larta të PCR dhe Interleukinë-6 dhe rrezik më të lartë nga sëmundjet koronare, cerebrovaskulare dhe mortalitet, krahasuar me vlerat e fituara nga pacientet e ekzaminuar me IRKT por të trajtuar me hemodializë perseritëse.

Në përfundim mund të konkludojmë se te pacientë me IRKT të mjekuar me hemodializë transporti rezerv i kolesterolit është tejët i dëmtuar dhe redukuar. Te pacientë me IRKT të mjekuar me hemodializë përsëritëse kolesreroli LDL i oksiduar(LDLox), IDL dhe VLDL e shpejtojnë sekretimin e citokinave inflamatore si interleukina-6(IL-6), PDGF (Plateled-Derived-Growth-Factor), TGFβ (Transfo-rming-Growth-Factor-Beta), TNF-α dhe CRP efekte plotësuse dhe ndihmëse për zhvillimin e proçeseve aterogjene dhe sëmundjeve kardiovaskulare te kjo grupe pacientësh.

Tek pacientë me insuficience renale kronike dhe te pacientët e trajtuar me hemodializë, *inflamacioni permanent* (18, 20) e shpejton lezionin renal yndyror i ndërmjetesuar me ndryshime dhe çregullime të homeostazës së kolesterolit në nivel qelizor. Oksidimi i grimcës së LDL kolesterolit me të drejtë ndodh ne pjesën e brendshme të mureve të arterieve, dhe jo në plazmë ku normalish ka shumë antioksidues.

Tek pacientët me IKRT si dhe të mjekuar me hemodializë (HD), koncentracionet e tregliceridеve në serum, Lp(a), Apo-B, fibrinogjeni, feritini PCR si dhe PTH riten në menyrë sinjifikante në krahasim me grupin kontrollues të individeve të shëndoshë.

Ateroskleroza e hershme korrelon pozitivisht me PCR si dhe konce-ntracionet e ulta te albuminave. Koncetracionet e CRP dhe Interleukin-6, tregliceridеve dhe LDL-ch ne mënyrë sinjifikante më të rritura janë te pacientët e mjekuar me hemodializë peritoneale ambulatorike (CAPD) në krahasim me pacientët e mjekuar me hemodializë normale bikarbonate. CIMT (Carotid–Intima–Media-Thickness) dhe pllakat ateromatoze pozitivisht korespondojnë me vlera te larta të PCR, kurse negativisht korespondojnë me nivelin e albuminave në serum (8, 9, 17). Lezionet e lartëpermendura jane verifikuar me ndihmën e metodave jo invazive si B-mode ultrasonografisë me rezulucion të larte të përdorura per gjetjen dhe ndjekjen e progreseve dhe ndryshimeve aterosklerotoke tek CIMT (18, 20).

Komplikimet kardiovaskulare janë njëri ndër faktorët me të shpeshtë të vdekshmerisë te pacientët me IRKT të mjekuar me hemodializë. Përqindja e përgjithshme e vdekshmerisë nga semundjet kardiovaskulare ndërmjet pacientëve të mjekuar me hemodialzë bikarbonate dhe peritoneale ambulatorike (CAPD) tregon për një dallim sinjifikant. Disa studime të mëdhaja evropiane kanë vërtetuar se patologjitë e semundjeve kardiovaskulare janë përgjegjëse për vdekjen e 27%-56% të pacientëve me CAPD dhe 25%-38% të pacientëve mjekuar me HD, kurse në SHBA vdekshmeria si pasojë e mjekimit me hemodializë arrinë edhe deri në 45%. Një numer i madh autoresh mendojne se *IRKT eshtë semundje inflamatore*, për arsye se në gjakun e këtyre pacienteve janë gjetur koncentracione të rritura të mediatorëve inflamator të cilët pozitivisht korespondojnë me paraqitjen e aterosklerozës së hershme tek pacientët e mjekuar me hemodializë (HD) përseritës ose te cilët gjatë seansave të hemodializës kanë përdorur materile bioinkopatibile.

Tek pacientët me insuficiencë renale kronike preterminale dhe terminale të trajtuar me hemodializë përseritëse vlerat e larta të PCR korespodojnë me vlera të ulta të hemoglobinës dhe rezistueshmerisë ndaj eritropoetinës këto janë momente që edhe më tepër e favorizojnë proçesin inflamatorë te keto pacientë (16, 29). Medijatorë tjerë gjatë inflamacionit kronik që janë në korrelacion tejet të lartë pozitiv ndaj rezistencës së terapisë me rHuEpo te pacientët uremikë janë albumina dhe fibrinogjeni, prandaj te pacientët uremik me vlera të PCR>2omg.l dozimi i eritropoetinës për arritje të vlerave të duhura të hemoglobinës duhet të rritet për

4o-70%. Përqendrueshmëria e hemoglobinës gjate një inflamacioni të fortë kronik te pacientë me IRKT të trajtuar me hemodializë mundë të zvoglohen në nivel kritik atëherë edhe efektet e rHuEpo-së janë tejet të zvogëluara atëherë preferohet dhenje e transfuzioneve të gjakut dhe eritrociteve të dekantuara (6). Gjatë niveleve të larta të PCR (>1omg/l) dhe prezences se inflamacioneve te shpeshta si gjate një bakteriemie, perziston zvogëlim i përqendrimeve të hekurit, prandaj aplikimi dhe përdorimi i preparateve te hekurit është kontraverze nga shkaku se aplikimi i tijë gjatë një bakteriemije e rritë numrin dhe efektet e tyre të demshme ndaj organizmit.

Përcaktimi i koncentracioneve të PCR në popullatën e shëndoshë detyrimisht percaktimi i tyre edhe te pacientët me IRKT në fazën preterminale dhe termianle të trajtuar me hemodializë përsëritese është me rëndësi të madhe sepse përqendrimete e larta të saja (PCR>10mg/l shërbejnë si parashikues të rrezikut nga sëmundjet kardiovaskulare dhe cerebrovaskulare.Te pacientët me IRKT të mjekuar me hemodializë përseritëse sëmundjet kardiovaskulare paraqiten në formë epidemike (infarkti i zemërs, angina pektorale, iskemia e zemrës, insulti cerebrovaskular) dhe janë pesë herë më të shpeshta krahasuar me personat me gjini dhe moshë të njejtë nga popullata e përgjithshme e cila vuan nga hipertensioni arterial por nuk janë me insuficiencë renale kronike terminale (20) . Vdekshmëria është për pesë herë më e madhe te pacientët me IRKT se sa tek presonat nga e njejta familje me hiperholesterolemi tip-lIa.

Faktorët e paraqitjes së semundjeve kardiovaskulare te pacientët me IRK preterminale dhe terminale janë të shumllojshëm dhe ne esencë ato ndahen në dy grupe: faktore të perbashkët dhe faktorë specifik.

Faktorët e përbashkët të sëmundjeve kardiovaskulare tek pacientët e mjekuar me hemodializë krahasuar me popullatën e përgjithshme janë: mosha, gjinia, hipertensioni, diabetes, konzumimi i duhanit, hiperlepidemia, sedanteriteti, asupoziteti dhe çrregullimet e lipoapoproteineve ndërsa si *faktorë specifik numerohen*: hiperparatiroidizimi sekundar, anemia, hiperhomocisteinemia, hiperfibrinnemia, stresi oksidativ, malnutricioni, MIA sindromi, faktorët trombogjen dhe inflamacione kronikë me rritje të vlerave të PCR dhe ndikimi i demshëm i citokinëve (Il-6). Vdekshmëria e lartë te pacientët me IRKT të mjekuar me hemodialize përsëritese, më shpesh ndodh pë shkak kardiomiopative iskemike e shoqëruar me hipertenzion. *Kardiomiopatia iskemike* është e lidhur ngushte me: moshën e shtyrë, gjininë mashkullore, hipertensioni arterial, diabetes mellitus, konzumimin e tepërt të duhanit, aneminë, stressi oksidativ, dislipidemia dhe hiperhomocisteinemia.

Kardiomiopatija uremike është ngushtë e lidhur dhe në korrelacion të larët pozitiv me veprimin e toksinëve uremikë, mediatorët inflamator-CRP, Il-6, hiperparatiroidizimin sekundar, dhe *MIA sindromin (Malnutritio-Inflamatio-Atherosclersis)* (30).

Malnutricioni tek pacientët uremik çdo here është i percjellur me *hipoalbuminemi të lartë përshkak të sintezës së zvogluar të albunmines, ndërsa prodhimi i PCR, fibrinogjenit dhe SAA-Serum-Amyloid-A,është e zmadhuar proporcionalisht me shkallën e aterogjenezës.*

Është verifikuar se te pacientët me uremi, infrakti i miokardit është për 10 herë më i shpeshtë se sa tek pacientët me ndonjë tjetër sëmundje primare. Studimet statistikore të publikuara në SHBA vitin 1997 mbi paraqitjen e mortalitetit tek pacientët me IKRT te mjekur me hemodializë treguan se 53% e vdekshmërisë shkaktohet nga sëmundjet kardiovaskulare, 16% për shkak të infeksioneve, 4% nga karcinomet dhe 27% nga shkaqe tjera, tek pacientët gjer në moshën 64 vjeçare.

Efekti aterogjen i dislipidemisë te pacientët me IRKT të mjekuar me hemodilaizë përsëriëtse është edhe më tepër i potencuar nga rritja e koncentracionit të kolesterolit të oksiduar-LDLox. Në gjenezën e vdekshmërisë kardiake te pacientët me IRKT mjekuar me hemodilaizë perseritese numrohet edhe ndikimi negativ i mekanizmave vazokonstriktor si koncetrimi plazmatik i rritur i endithelin-1 (ET-1) dhe noradrenalines të cilët numerrohen si një ndër vazokonstriktorët më të fuqishëm. Sinteza e oksidit të azotit (NO) i cili numerohet si vazodilantantorë më i fuqishëm dhe më efektiv në kushtet e uremisë, është e bllokuar për shkak te akumulimit të tepërt kompetitiv të NO-sintetazës nga Dimenthyl-L-argenines asimetrike (DMAA). Inflamacionet kronike luajn rol te rendesishem në zhvillimin e insuficience renale kronike. Polimorfizmi i lartë i gjeneve te PCR asocojne dukshëm në koncentracionet e PCR ne serum. Eshte e panjohur ende asocimi i polimorfizmit te PCR ne progresin e IRKT ose modifikimin e efketeve te terapise antihiperetenzive ne progresin e IRKT (11).

Roli i faktorëve të infeksionit tek pacientët me IKRT të mjekuar me hemodialize përsëritese si: Klebsiella pneumoniae,Helicobacter pylori dhe citomegaloviruset e sforcojnë aterogjenitetin inflamatore.

PERFUNDIMI

Në përfundim mund të konkludojme se pavaresishte nga stadi i sëmundjes renale kronike (preterminale apo pacientet uremik te trajtuar me hemodializë perseritese) të dy grupet prezantuan me vlera te

rritura te PCR dhe te të gjithë ishin prezente dhe dominonin simptomet e sëmundjeve kardiovaskulare-infarktit të miokardit, anginës pektorale, ishemise së zemrës). *Edhe te pacientët tonë me IRKT u konstatuan vlera të larta e PCR krahasuar me vlerat e fituara nga grupi kontrolues* që janë në përputhshmeri edhe me rezultatet e fituara nga studimet me bashkekohore te punuara mbi rolin e PCR si faktore te ri te rezikut te arterieve koronare nga ateroskleroza.

LITERATURA

1. Carmine Z. Franceska M. Giovanni T. Novel cardiovascular risk factors in End-stage-Renale Disease. *J.Am Soc Nephrol 15; S:77-80,2004.*
2. Shlipak MG, Fried LF , Manolio TA et al. Cardiovascular mortality risk in chronic kidney disease: comparasion of traditional and novel risc factors.*JAMA,2005; (14):1737-1745.*
3. Toneli M. Wiebe N, House A, Fok M et al. Chronic kidney diseasse and mortality risc: a systematic review. *J Am Soc Nephrol 2006; 17(7):2034-2047.*
4. Gerard M. London , Sylvain J. Bruno P.Fabien M. Hassan A. Inflammation, arteriosclerosis and cardiovascular therapy in haemodialysis patients. *Kidn Int.Vol.63(2003); f.s88-93.*
5. Wanner- How to treat inflammation. *Articles of CME course.2006.*
6. Locatelli F, Andrulli S, Memoli B, Maffei C. Nutritional-inflamation status and resistance to Erythropoetin therapy in haemodialysis patienets. *NDT, Vol.21: 991-2006.*
7. Zoccali C: Infalmation and atherosclerosis in End-stage-Renal disease. *Blood Purif 21:29-36,2003 (Cross Ref) Medline}.*
8. Stenvinkel P, Wanner C.Malatino L, Tripepi G. Inflamation and outcome in End-stage-Renal failure:Does female gender constitute a survival advantage? *Kidney Int 62: 1791-1798,2002 (Cross Ref) Medline}.*
9. Division of Renal Medicine and Baxter Novum, Department of clinical Science Karolinska University Hospital, Karolinska Institutet, Stockholm Sweden. *C-Reactive Protein in End-Stage-renal Disease:Are There Reasons to Measure it ? Article Vol. 23, No.1, 2005*
10. Zylbeari L. Profili i Dislipidemisë dhe Aberacionet e Apoproteineve te pacientët e Mjekuar me Hemodializë Perseritëse. *Disertacioni i Doktoraturës. Shkup,2009.*
11. Adriana M. Hung, Dana C. Crawford . et al. CRP Polymorphism and Progression of Chronic Kidney Disease in USA . *Clin J Am Soc of Nephrol 5: 24-33, 2010.*
12. Zoccali C.*Biomarkers in chronic kidney disease :utility and issues towards better understanding.Curr Opin Nephrol Hypertens 2005;14: 1-6.*
13. Mallamaci F, Tripepi S, Cutrupi S, et al. Prognostic value of combined use biomarkers of inflammation, endothelial dysfunction, and myocardiopathy in patients with ESRD. *Kidney Int 2005; 67:2330-2337.*
14. Schffrin El, Lipman Ml, Man JFE. Chronic Kidney Disease. Effect on Cardiovascular system. *Circulation 2007;116: 85-97*
15. Valocikova I, Kristofova B, Valocik G. Cardiac Biomarkers and chronic renal disease. *Tropical Review Bratisl Lek Listy 2008; (8): 341-344.*
16. Peter Barany. Inflamation, serum C-reaktive protein,and erythropoietin resistance. *Nephrol. Dial. Transpl.2001; 16(2):224-227.*
17. Torzewski J et al. C-reaktive protein frequently colcaliizes with the terminal complement complex in the intima of early atherosclerotic lesions of human coronary arteries. *Arterioscl Thromb Vasc Biol; 1998;18:1386-1393.*
18. Ross R. Atherosclerosis –an inflammatory disease. N Engl J Med 1999;340:115-126.
19. Vincenzo P, Umberto M, Daniele T, Paolo Rindi et al: Interleukin-6 is a stronger predictor of total and cardiovascular mortality than C-reactive protein in haemodialysis patients.*Nephrol Dial Transpl ,2004;19:1154-1160.*
20. Vasan RS, Sullivan LM et al.Infammatory markers and risk of heart failure in elderly subjects without prior myocardial infarctions:the Framingham Heart Study.*Circulation 2003 ;107:1486-1491.*
21. Zölner N. Kirchs, K.Z. Ges, Exp.Med., 1962; 135; 545.
22. Bucola G, David H, Quantitative determination of serum triglycerides by use of enzymes. *Clin. Chem,* 19, 476-482 (1973).
23. Allain CC, Poon LS, Chan CS, Richmond W. Enzymatic determination of total serum cholesterol, *6th Edition Clin. Chem,* 20,470-475(1974).
24. Friedewald Wt, Levy RJ, Fredrickson DS, Estimation of concentration of low density lipoprotein cholesterol without the use of the preparative ultracentrifuge, *Clin. Chem.* 18, 499-502 (1972).
25. Wamick G, Benderson J, Allbers J, Quantitation of high density lipoprotein subclasses after separation by dextran sulfate and Mg+ precipitation [Abstract], *Clin. Chem.* 28, 1574-1561 (1982).
26. Agarwal SK. et al. Prevalence of Chronic Renal Failure in adults in Delhi, India. *Nephrol Dial Transplant 2005; (20) :1638-42.*

27. Miida T, et al. LCAT-dependent conversion of pre □ l-HDL into □-migrating HDL is severely delayed in haemodialysis patients. *J Am Soc Nephrol.2003;14:732-8.*
28. Agarwal SK. et al. Prevalence of Chronic Renal Failure in adults in Delhi, India. *Nephrol Dial Transplant 2005; (20) :1638-42*
29. Neiss G. Effect of iron treatment on circulating cytokine levels in ESRD patients receiving recombinant human erythropoetin. *Kidney Int 2003;(64) :572-8.*
30. Rao P, Reddy GC and Kanagasabapathy AS. Malnutition-Inflammation-Atherosclerosis Syndrome in Chronic Kidney Disease. *Indian Journal of Clinical Biochemistry, 2008 (23) 209-217.*

SUMMARY

THE ROLE OF REACTIV-C-PROTEIN TO THE PATIENTS WITH TERMINALE CHRONIC RENAL DISEASE DURING TRETMAN WITH HAEMODIALYSIS

Lutfi Zylbeari[1,3], Fatmir Omeri[1], Nexhbedin Karemani[3], Elita Zylbeari[1], Zamira Bexheti[2], Gazmend Zylbeari[2]

[1]Hospital Clinik, Department of Internal Diseases, Tetovo, Macedonia
[2]Medical Faculty "Nënë Tereza", Tirana,Albania
[3]Faculty of Medical Sciences,SUT, Tetovo, Macedonia

One of the often risk factor for exepcional hight invalidity, morbidity and mortality in modern society to the pacients with terminal chronic renal insuficience (ESRD), with haemodialysis counted coronary artery disease (CAD), comparing with healthy population. In the recent years by the all known factors (heredity, age, sex, high blood pressure, smoking, diabetes, over wiight, reducted activity, psyho-stress, dyslipidemi, fibrinogen, in etiology of coronary artery disease as a new risk factor in recent years can by placed hight nivel of C Reactive-Proteine (CRP). In case of disorder of CRP when they are accompa-tpanied with disorders of lipid profile are more evidents at coronary artery diseas so we conclude that, the goal of our study was determination of conetration of high nivel of CRP and lipid profile at patients with CAD.

Key words: Coronary Artery Disease, CRP, atherosclerosis, Lipid profile (TCh,TL,TG,HDL-cholesterol, LDL-cholesterol)

PUNIM BURIMOR SHKENCOR / ORIGINAL SCIENTIFIC PAPER
PSIKIATRI

RELACIONI I DHUNËS DHE PËRDORIMIT TË ALKOOLIT TE ADOLESHENTËT

Kadri Haxhihamza[1], Marija Raleva[1], Florentina Hani[2], Dimitrinka Jordanova Pesevska[3], Rozalinda Isjanovska[4], Izabela Filov[5], Viktor Isjanovski[6], Lidija Sushevska[7], Aktan Ago[8], Blagojçe Gjorqevski[9]

[1]OSHP Klinika e Psikiatrisë, Shkup, Maqedoni
[2]SHMK "Dr.IbrahimTemo", Strugë, Maqedoni
[3]Organizatat Shëndetësore Boterore, Byroja Shtetërore në Maqedoni, Shkup, Maqedoni
[4]Instituti i Epidemiologjisë me Biostatistikë dhe Informatikë Mjekësore, Fakulteti i mjekësisë, Shkup, Maqedoni
[5]OSHP Spitali Psikiatrik "Demir Hisar", Demir Hisar, Maqedoni
[6]OSHP Spitali Psikiatrik "Skopje", Shkup, Maqedoni
[7]OSHP Spitali i Qytetit "8 Shtatori", Shkup, Maqedoni
[8]SHMSHGJ"Josip Broz Tito", Shkup, Maqedoni
[9]SHMSHM "Pançe Karagjozov", Shkup, Maqedoni



Kadri Haxhihamza, mjek psikiatër, magjistër
Rr. Resenska 14/2-8, shkup, Maqedoni
Tel: 075 456 917 & 022624043
e-mail: **loli@datedu.com.mk**

REZYME: *Në gjashtë shkolla profesionale dhe dy gjimnaze në qytetet: Shkup, Gostivar, Strugë, Manastir dhe Shtip, në periudhën Mars-Maj 2010, u ekzekutua studim i cili ishte nga tipi i "prerjes tërthore" („Cross section") me 664 nxënës (258 meshkuj dhe 406 femra) nga vitet e katërta të shkollave të mesme (mosha 18-19 vjet). Grumbullimi i të dhënave u realizua me ndihmë të Pyetësorit mbi eksperiencat të pakëndëshme në fëmijëri (Adverse Childhood Experience). Nga rezultatet shihet se dhuna verbale është më e shprehur se ajo fizike. Po ashtu shihet se keqtrajtimi në familje është i paraqitur nga femrat në përqindje më të lartë se nga meshkujt. Nga ana tjetër, llojet e keqtrajtimeve nga ana e moshatarëve janë më të pranishme te meshkujt se te femrat. Me analizë statistikore u etabluan asociacione statistikore sinjifikante ndërmjet konsumit të alkoolit dhe disa kategori të dhunes familijare dhe dhunës nga moshatarët.*

Fjalë kyç: *Dhuna, adoleshentë, alkooli*

Medicus 2011, Vol. XV (1):

HYRJE

Dhuna mbi adoleshentët sot është problem i cili i tejkalon kufijtë shtetërorë dhe kështu paraqitet si problem i shteteve të pazhvilluara por edhe te atyre të zhvilluara. Për fat të keq, të dhënat mbi këtë dukuri si dhe legjislativa në këtë lami janë të pakëta. Kjo është e përcjellur nga mungesa e metodologjisë hulumtuese të unifikuar, gjë që solli deri te mungesa e punimeve udhërrëfyese në këtë lëmi (1, 2, 3).

Dhuna ndikon mbi dhunuesit, viktimat dhe mbi ato qe e vëzhgojnë dhunën. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror Statistikor për vitin 2004, 27% të meshkujve dhe 16,9% nga të rinjët të moshës 15 vjeçare kanë qenë në rolin e dhunuesit së paku një herë gjatë muajve të fundit, ndërsa 24,6% meshkuj dhe 21,5% femra të moshës së njejtë kanë qenë viktima të dhunës sëpaku një herë gjatë disa muajve të fundit (4).

Është reale, pra, të parashihet se këto përqindje janë shumë më të larta në popullatën e përgjithshme duke e marrë parasysh bindjen e gjërë në popull (dhe në kulturën tradicionale të Ballkanit) se vetëm familja është përgjegjëse për kushtet jetësore dhe mirëqenjen e fëmijës. Në pajtim me këte është edhe bindja se kategoritë si "shpërfillje (neglizhencë)", "keqpërdorim (abuzim)" ose "dhunë" mbi fëmijën duhet të mbesin "në familje", "punë private" pa u paraqitur në institucionet përkatëse (5, 6).

E gjitha kjo solli deri te miratimi i deklaratës së OSHB (2005) me të cilën dhuna dhe lëndimet te fëmijët paraqiten si prioritete më të larta të kësaj organizate (6).

Dhuna tek adoleshentët është problem afatgjatë nga aspekti i zhvillimit mendor. Nëse ndryshimet në këtë sferë nuk identifikohen me kohë ato do të keqtrajtohen që do të rezulton me ndryshime ireverzibile në sferën mendore gjatë tërë jetës. Kështu, në shumë kërkime është vërtetuar se abuzimi fizik në fëmijëri është më e shpeshtë, në mënyrë sinjifikante, te subjektet me çregullim panik. Abuzimi emocional dhe shpërfillja në fëmijëri janë identifikuar në numër sinjifikant më të madh te subjektet të cilët në jetën adulte kanë shprehur çrregullim panik, ankth të gjeneralizuar dhe fobi sociale. Sot është etabluar qëndrimi se abuzimi emocional dhe shpërfillja gjatë fëmijërisë sjellin deri te dëmtimi i zhvillimit të fëmijës, gjë që reflektohet në periudhën adulte (9, 10, 11, 12, 13).

Konzumimi i alkoolit shpesh herë asocohet me dhunën: si shkak apo si pasojë e saj. Çmimi i ulët i alkoolit, prezenca e tij gati se në çdo hap në shitje të lirë si dhe konteksti kulturor i cili, në disa pjesë të shtetit tone jo vetëm që tolerohet por edhe shihet si mjet i socializimit te të rinjët, mundëson përdorimin e gjërë të alkoolit. Personi i dehur shpesh dhe shpejtë transformohet në dhunues dhe në këtë mënyrë alkooli bëhet shkaktar i dhunës. Pirja e alkoolit shpesh ka "traditë" familijare dhe ky lloj i sjelljes adoptohet (kopjohet)" nga babai te biri" (14, 15, 16, 17, 18, 19).

Me të njejtin model kopjohen edhe modelet e dhunës familjare ashtu që në këtë mënyrë mjegullohet lidhja shkak-pasojë ndërmjet alkoolit dhe dhunës.

Në suaza botërore këto probleme shihen jo vetëm si probleme socio-ekonomike dhe kulturore por edhe si probleme nga sfera e shëndetit mendor. Këto probleme kanë rëndësi primare në përpilimin e politikës shëndetësore të çdo shteti, kur janë në pyetje të rijtë dhe zhvillimi i tyre (14, 20).

QËLLIMI

Gjatë përpunimit të të dhënave të grubulluara u shprehën të dukshme dallimet në disa kategori të hulumtuara. Kjo dukuri i imponoi edhe objektivat për këtë punim:

- Të përcaktohet prania dhe frekuenca e dhunës ndaj adoleshentëve në familje në RM
- Të përcaktohet prania dhe frekuenca e dhunës ndaj adoleshentëve jashtë familjes (në shkollë, në mjedisin ku jeton)
- Të përcaktohen relacionet në mes të dhunes ndaj adoleshentëve (në familje dhe jashtë saj) dhe konsumimit të alkoolit tek adoleshentët.

MATERIALI DHE METODAT

Studimi është nga tipi i "prerjes tërthore" („Cross section"). Subjektët në hulumtim ishin grupi i nxënësve të viteve të katërta të shkollave të mesme (mosha 18-19 vjet). Grupi i hulumtuar numëronte 664 nxënës: 258 meshkuj dhe 406 femra.

Studimi u ekzekutua në periudhën Mars-Maj 2010, në gjashtë shkolla profesionale dhe dy gjimnaze në Shkup, Gostivar, Strugë, Manastir dhe Shtip. U dorëzuan 700 pyetësorë. Tre nxënës refuzuan plotësimin e pyetësorit duke e shfrytëzuar kështu mundësinë që i u ishte prezentuar para fillimit të plotësimit të pyetësorit. Pyetësorët e plotësuar ishin të klasifikuar konform kritereve të definuara paraprakisht ashtu që, pas eliminimit të pyetësorëve që nuk ishin në përputhje me kriteret, për analizë mbetën 664 pyetësorë.

Grumbullimi i të dhënave u realizua me ndihmë të pyetësorit mbi eksperiencat të pakëndëshme në fëmijëri (*Adverse Childhood Experience*) i cili përbëhet nga 62 pyetje dhe nënpyetje (forma për meshkuj) respektivisht 66 pyetje dhe nënpyetje (forma për femra).

Rezultatet nga pyetësorët përkatës vlerësohen në bazë të metodologjisë të standardizuar, specifike për pyetësorët përkatës.

Plotësimi i pyetësorëve u ekzekutua në shkollë, me ndihmën dhe mbikqyrjen e personit të kualifikuar (psikolog, psikijatër) të cilët ishin familjar me teknikat e këtilla të hulumtimit. Kodimi i pyetësorëve (me të cilin mbrohet identiteti i subjekteve dhe të dhënave të përfituara) u krye me procedurë të caktuar paraprakisht.

Për nxënësit që do të kishin nevojë për bisedë (*debriefing*, shkarkim emocional) ishte e mundësuar ndihmë profesionale dhe mundësi e referimit të mëtutjeshëm (nëse do të ishte e vlerësuar se ka nevojë të tillë) në organizata shëndetësore përkatëse. Për këto mundësi subjektet ishin të informuar gojarisht (nga anketuesit) dhe me shkrim (si pjesë e pyetësorëve).

Përpunimi statistik i të dhënave u ekzekutua me progamet Statistica for Windows dhe SPSS 13,0 duke e shfrytëzuar bazën e të dhënave të krijuar nergut për kete studim. Për përpunim të mëtutjeshëm u shfrytëzuan metoda statistikore gjegjëse. Rëndësia (sinjifikanca) statistikore u përcaktua në nivel të $p<0.05$ dhe $p<0.01$.

REZULTATET

Dhuna mbi adoleshentët një kohë të gjatë ishte e pranishme (por e paparaqitur në instancat kompetetnte) jo vetëm në trevat tona por edhe më gjërë. Prandaj, nuk çuditë fakti se rastet e dhunës penalizohen vetëm kur nuk ka rugëdalje tjetër: nëse shprehen lëndime të rënda ose vdekje e fëmijës/adoleshentit. Megjithate, të gjithë e kanë të qartë se kjo është vetëm "maja e ajsbergut" i cili quhet dhunë.

Nga ana tjetër, përdorimi i alkoolit, edhe pse në esencë dhe për përdorim në kohë më të gjatë, shihet si dukuri negative, në kultura të ndryshme ka trajtim të ndryshëm, qoftë edhe brenda një shteti. Kështu, në pjesën lindore të shtetit tonë adoleshentët në numër më të madh kanë paraqitur konsum të pijeve alkoolike në krahasim me moshatarët e tyre nga pjesa perëndimore e republikës. Mosha e fillimit të konsumit të alkoolit si dhe sasitë e konsumuara ishin "në favor" të adoleshentëve nga pjesa lindore e shtetit.

Me një fjalë, pikëvështrimet e ndryshme kulturologjike mbi këto dukuri negative dhe mangësitë në solucionet ligjore në këtë sferë nuk lejojnë qasje serioze në preventivën e këtij problemi.
Rezultatet nga studimi të këtyre dukurive negative janë të paraqitur në tabelat që vijojnë.

Tabela 1

Ekspozimi ndaj dhunës familijare

Lloji i keqtrajtimit	Meshkuj		Femra	
	Asnjëherë (rallë)	Shpesh	Asnjëherë (rallë)	Shpesh
Dhuna psikologjike				
Dikush nga familja ju ka urrejtur	**240 (93,02%)**	**18 (6,98%)**	**357 (87,93%)**	**49 (12,07%)**
Prindët kane dëshiruar qe të mos jesh lindur fare	**252 (97,7%)**	**6 (2,33%)**	**362 (89,16%)**	**44 (10,84%)**
Kanosen të të godasin ose të të gjuajnë me diçka	**210 (81,4%)**	**48 (18,6%)**	**326 (80,29%)**	**80 (19,71%)**
Të kanë sharë, ofenduar ose poshtëruar	**207 (80,23%)**	**51 (19,77%)**	**215 (52,96%)**	**191 (47,04%)**
Dhuna fizike				
Të kanë shtyrë, shtrënguar ose gjuajtur me diçka	**250 (96,9%)**	**8 (3,1%)**	**391 (96,3%)**	**15 (3,7%)**
Të kanë rahur duke të lënë shenja ose lëndime	**255 (98,84%)**	**3 (1,16%)**	**392 (96,55%)**	**14 (3,45%)**
Ke qenë i/e frikësuar nga lëndime fizike	**239 (92,63%)**	**19 (7,37%)**	**369 (90,89%)**	**37 (9,11%)**
Disiplinimi i fëmijëve me të rahur				
Sa shpesh të kanë rrahur	**180 (69,77%)**	**78 (30,23%)**	**299 (73,64%)**	**107 (26,36%)**

Tabela 2.

Ekspozimi ndaj dhunës nga moshatarët

Lloji i keqtrajtimit	Meshkuj		Femra	
	Asnjëherë (rallë)	Shpesh	Asnjëherë (rallë)	Shpesh
Dhuna nga moshatarët				
Të kanë sharë, ofenduar ose poshtëruar	**201 (77,9%)**	**57 (22,1%)**	**336 (82,76%)**	**70 (17,24%)**

Të kanë rahur duke të lënë shenja ose lëndime (0,25%)	**255 (98,84%)**	**3 (1,16%)**	**405 (99,75%)**	**1**
Të kanë shtyrë, shtrënguar ose gjuajtur me diçka (2,46%)	**247 (95,74%)**	**11 (4,26%)**	**396 (97,54%)**	**10**
Ke qenë i/e frikësuar nga lëndime fizike (5,67%)	**246 (95,35%)**	**12 (4,65%)**	**383 (94,33%)**	**23**

Tabela 3

Përdorimi i alkoolit nga adoleshentët

Përdorimi i alkoolit nga adoleshentët	**Meshkuj**		**Femra**	
	Jo	**Po**	**Jo**	**Po**
Përdorimi i alkoolit				
Ke pirë alkool 30 ditët e fundit	201 (77,9%)	112 (43,4%)	200 (49,3%)	206(50,7%)
Ke patur problem ndonjëherë me përdorimin e alkoolit	255 (98,84%)	3 (1,16%)	405 (99,75%)	1(0,257%)
Numri i pijeve 30 ditët e fundit				
Më tepër se dy pije 30 ditët e fundit	247 (95,74%)	11 (4,26%)	396 (97,54%)	195(48, 2%)
Më tepër se gjashtë pije në një rast	246 (95,35%)	12 (4,65%)	383 (94,33%)	340 (48, 2%)

DISKUTIMI

Nga rezultatet e parashtruara shihet qartë se dhuna ndaj adoleshentëve është e pranishme në familje dhe jashtë saj.

Nga tabelat 1 dhe 2 bie në sy se dhuna verbale është më e shprehur se ajo fizike. Nga këto tabela, po ashtu, shihet se keqtrajtimi në familje është i paraqitur nga femrat në përqindje më të lartë se nga meshkujt. Kjo mundet të shpjegohet me faktin se femrat, fizikisht më të dobëta dhe në suaza tradicionale të nënshtruara ne familje, janë më të ekspozuara dhunës të këtij lloji.

Nga ana tjetër, llojet e keqtrajtimeve nga ana e moshatarëve janë më të pranishme te meshkujt se te femrat. Kjo mundet të shpjegohet me rolin tradicional të meshkujve si "luftëtar". Ky rol në kombinim me moshën e participantëve në hulumtim (kur kërkohet rugëdalje e dhunshme nga problemet që paraqiten ndërmjet moshatarëve), mundet të shpjegon rezultatet e fituara. Kjo korespondon me rezultatet e hulumtimeve që janë kryer në vend dhe jasht tij (7, 8, 9, 10, 11, 12, 13).

Tabela 3 tregon se përdorimi i alkoolit është, i pranishëm te të rinjtë në përqindje brengosëse. Ky është problem i kahershëm por ne dekadat e fundit morri hov më të madh në mesin e adoleshentëve për shkak se alkooli është një ndër supstancat psikoaktive që më së lehti një adoleshent mundet t'i gjenë, bile edhe në shitore, në shitje të lirë. Edhepse kohëve të fundit qasja e adoleshentëve ndaj alkoolit me ligj bëhet më restriktive, çdoherë mbetet mundësia e "anashkalimit" të rregullave ligjore me rezultat përfundimtar: tej konsumim të pijeve alkoolike.

Problemi i konsumit të paligjëshëm të alkoolit nga adoleshentët ndërlikohet me dhunën, e cila si dukuri është në lidhje të pashkëputshme me alkoolin. Alkooli është kahmoti i njohur si "inkurajues" i adoleshentëve që të kryejnë vepra të ndryshme kriminogjene, më së shpeshti akte dhune (7, 14).

Konsumi i alkoolit mundet të paraqitet si pasojë e dhunës, më së shpeshti nga fëmijët që rrjedhin nga familje në të cilat dhuna familjare është e pranishme dhe si e tillë shkakton "modelimin" e sjelljes së adoleshentit, të cilën sjellje e kopjon nga mjedisi, më së shpeshti nga babai alkoolik (14, 15, 16, 17).

Me analizë statistikore u etabluan asociacione statistikore sinjifikante ndërmjet kategorive vijuese te meshkujt:

2. Disiplinimi fizik/dhuna fizike ne familje (Alkool >6 pije në një rast dhe rahje e fortë me shenja trupore si pasojë) p=0,000;
3. Dhuna familijare (Alkool > 6 pije në një rast dhe Kanosen të të godasin ose të të gjuajnë me diçka) p=0,01168;
4. Probleme me përdorim të alkoolit p=0,013364;
5. Dhuna emocionale (Alkool >6 pije në një rast dhe sharje, ofendim ose poshtërim) p=0,000356;
6. Dhuna psikologjike (Alkool >6 pije në një rast dhe Prindët kane dëshiruar qe të mos jesh lindur fare) p=0,000188.
7.

Te femrat rezultatet në asocijacione statistikore signifikante ndërmjet kategorive ishin si vijon:

1. Dhuna familjare (Alkool >6 pije në një rast dhe Kanosen të të godasin ose të të gjuajnë me diçka) p=0,003646;
2. Dhuna fizike (Alkool >6 pije në një rast dhe rahje e fortë me shenja trupore si pasojë) p=0,003646;
3. Dhuna emocionale (Alkool >6 pije në një rast dhe sharje, ofendim ose poshtërim) p=0,001723;
4. Disiplinimi fizik (Alkool > 6 pije në një rast dhe Sa shpesh të kanë rrahur) p=0,003646.

PËRFUNDIM

Në konkluzë mundemi të themi se dhuna familjare dhe nga moshatarët është e pranishme te adoleshentët në vendin tonë. Kjo dukuri negative korespondon me një dukuri tjetër negative: përdorimi i alkoolit. Vetëvetiu por edhe në kombinim, këto dukuri sjellin dëme afatshkurte dhe afatgjate mbi shëndetin fizik e posaçërisht të atij mendor. Dëmet afatshkurte shiHen, në rend të parë, në penalizimin e hershëm e të rinjëve: vjedhje, përleshje fizike dhe si pasoje e kësaj: burgosje, recidivizëm kriminogjen dhe, shpesh herë, vetëvrasje ose vrasje (3, 4).

Dëmet afatgjate, mbi shëndetin fizik e posaçërisht atij psikik, janë të shumëllojshme dhe të shumëfishta, të njohura qysh nga kohërat më të lashta. Prandaj, për shembull, të gjitha librat e shenjtë të religjioneve më të mëdha e ndalojnë pirjen e alkoolit. Pyetjes "Pse të mos pijmë alkool?" ato u përgjigjen: "Krijuesi i dha mendjen (urtësinë, rezonin) njeriut që ta dallon nga kafshët. Kur njeriu dehet, ai e humb mendjen dhe zbret në nivelin e kafshës. Kjo i ofendon njerëzit tjerë por më së tepërmi e ofendon Krijuesin".

Duke e marrur këte parasyshë, mundemi të themi se dhuna dhe alkooli janë kundër ligjeve njerëzore por edhe kundër ligjeve hyjnore.

LITERATURA

1. Krug EG, Dahlberg LL, Mercy JA et al. editors. World report on violence and health, Geneva, WHO, 2002.
2. WHO (1999). The World Health Report: Making a Difference. Geneva: World Health Organization.
3. UNICEF-IRC (2005). Violence against the children in Europe: a preliminary review of research. Florence: UNICEF INNOCENTI IRC.
4. Тозија Ф, Ѓорѓев Д, Чичевалиева С и др. уредници. Извештај за насилство и здравје во Македонија и водич за превенција, Скопје, Министерство за здравство, 2006.
5. Sicher P, Lewis O, Sargent J, Chaffin M, Friedrich WN, Cunningham N, Thomas R, Thomas P, & Villani VS. (2000). Developing child abuse prevention, identification, and treatment systems in Eastern Europe. Journal of the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry, 39, 660-667.
6. WHO/Regional Committee for Europe (2005). European strategy for child and adolescent health and development. 55th Session, Provisional agenda, Bucharest, Romania.
7. UN's Secretary General (2006). Study on violence against children, Official Report presented to the 61st UN General Assembly.
8. United Nations (2006). World Report on violence against children. UN Secretary-General's Study on Violence against children.
9. WHO & ISPCAN (2006). Preventing child maltreatment: a guide for taking action and generating evidence. World Health Organization.
10. WHO-Europe (2004). Young People's Health in context: health behavior in school-age children study (HBSC) 2001/2002. World Health Organization.
11. WHO-Europe (2005). Children's health and environment: developing action plans. World Health Organization.
12. UNICEF (2007). The state of the world's children. UNICEF, United Nations.
13. Боневски Д. Поврзаноста на раната психолошка трауматизација со анксиозните растројства (докторска дисертација), 2008
14. WHO (1999). Child abuse as a public health issue. World Health Organization.
15. Boney-McCoy S, Finkelhor D. Is youth victimization related to trauma symptoms and depression after controlling for prior symptoms and family relationships? A longitudinal, prospective study. J Consult Clin Psychol. 1996 Dec;64(6):1406-16.
16. Kolko DJ, Herschell AD, Costello AH, Kolko RP. Child welfare recommendations to improve mental health services for children who have experienced abuse and neglect: a national perspective. Adm Policy Ment Health. 2009 Jan;36(1):50-62.
17. Friedrich WN, Einbender AJ, Luecke WJ. Cognitive and behavioral characteristics of physically abused children. J Consult Clin Psychol. 1983 Apr;51(2):313-4.
18. Martinez P, Richters JE. The NIMH community violence project: II. Children's distress symptoms associated with violence exposure. Psychiatry. 1993 Feb; 56(1):22-35.

7. Софија Станоева Стојановска, Здравствен дом, Делчев

PUNIM BURIMOR SHKENCOR / ORIGINAL SCIENTIFIC PAPER
ANESTEZIOLOGJI REANIMACION

BLLOK I PLEKSIT BRAKIAL ME RRUGËN SUBKORAKOIDALE: INFLUENCA E LOKALIZIMIT TË NJË PËRGJIGJE MOTORIKE DISTALE TË TIPIT MEDIAN APO RADIAL NË SUKSESIN E ANESTEZISË

Tefik Zhurda[1], Mustafa Bajraktari[2], Gjergji Caushi[2], Dritan Muzha[1], Mihal Kerci[1]

[1]Shërbimi i Anestezisë, Qendra Kombëtare e Traumës, SUQU, Tiranë, Shqipëri
[2]Shërbimi Universitar i Ortopedisë dhe Traumatologjisë, QSUT "Nene Tereza", Tiranë, Shqipëri



Tefik Zhurda, mjek anestezist reanimator
Rr. "Gjergj Legisi" Nd.17, H.3 Ap.9 Nj.B.11 Kodi post.1026
Tel. ++355 4413254 / Mob.++355672069412
e-mail: **zhurdatefik@ymail.com**

REZYME: *Studime të shumta kanë raportuar se bllokimi i pleksit brakial (BPB) nëpërmjet rrugës subkorakoidale siguron një përqindje të lartë suksesi nëse lënda anestetike (LA) injektohet pas lokalizimit me neurostimulator te një përgjigje motorike distale.* ***Qëllimi:*** *Qëllimi i studimit tonë ishte të krahasonte influencën e injektimit të LA në prezencë të një përgjigje motorike radiale apo mediane në suksesin e anestezisë.* ***Metoda dhe pacientët****: Në studimin tonë janë përfshire 246 pacientë të intervenuar nën bllok subkorakoidal për (BSC) intervente ortopedike-traumatologjike nën 1\3 e poshtme të krahut për një periudhë mars 2007- mars 2010. Blloku u realizua sipas metodës Wilson. Në bazë të lokalizimit të një përgjigjeje motorike distale të tipit radial apo median pacientët u randomizuan në dy grupe: Grupi A -Radial n= 124 dhe Grupi B- Median n=122. Në të dy grupet LA ishte një miksture me volum 40 ml - Lidokainë 2% 20 ml + Bupivakainë 0.5% - 20ml, dhe u injektua në prezencën e një përgjigje motorike minimale me intensitet stimulimi ≤ 0.3 mA. Vlerësimi i bllokut sensor dhe motor ne te katër nervat (median, ulnar, radial, muskulokutan) u krye 5-10-15-20 min pas injektimit te LA.* ***Rezultatet****: Në Grupin Radial në 122 (98.3%) pacientë blloku sensor dhe motor në të katër nervat ishte i efektiv, në 2-raste u kërkua sedatim dhe infiltrim te LA ne linjën e incizionit. Në Grupin Median në 114 (93.4%) raste blloku sensor dhe motor ishte efektiv, në 8-raste u kërkua sedatim dhe infiltrim me LA. Në të gjitha rastet interventet u kryen nën bllok subkorakoidal.*
Konkluzionet*: Injektimi i LA mbi një përgjigje motorike distale të tipit radial siguron një përqindje të lartë suksesi të bllokut infrakorakoidal, në krahasim me injektimin e saj mbi një përgjigje të tipit median.*

Fjalë kyç*: Pleksi brakial, bllok subkorakoidal, përgjigje motorike distal*

Medicus 2011, Vol. XV (1):

HYRJE

Bllokimi i Pleksit Brakial (PB) nëpërmjet rrugëve supraklavikulare dhe nenklavikulare tashmë janë të përdorura në mënyre rutinë, pasi sigurojnë anestezi kirurgjikale cilësore në intervente mbi anësinë e sipërme (1, 2, 4). Për arsye te arkitekturës anatomike te PB ne brendësi të një këllëfi tubular faciokonjuktival që shtrihet nga kolona cervikale drejt aksiles bënë të mundur bllokimin e tij në rrugë të shumta (3, 4, 18). Zgjedhja e një rruge për bllokimin e tij varet nga regjioni që do të intervenohet, eksperienca e anestezistit si dhe komplikacione të mundshme që prezantonte secila rrugë e bllokimit të tij (1).

Bllokimi i PB nëpërmjet rrugës nënklavikulare e sidomos ajo subkorakoidale (BSC) është bërë objektiv i shumë publikimeve të viteve të fundit (2, 3, 4, 6, 7, 8). Kjo rruge e bllokimit të PB paraqet një interes të veçantë, sepse realizohet në një regjion ku strukturat nervore janë të grupuara mirë, duke bërë të mundur realizimin e tij me metodën e neurostimulimit me një punksion te vetëm. Ai premton bllokimin e të pesë nervave përgjegjës për inervimin e 1/3 së poshtme të krahut dhe për realizimin e tij nuk kërkon lëvizjen e anësisë, gjë që është e rëndësishme në traumatologji, në dallim me rrugën aksilare që kërkon lëvizjen e anësisë, e cila është e vështirë për arsye të dhimbjes (6, 7, 8).

Që prej përshkrimit të rruges subklavikulare për herë të parë nga Bazy et al në vitin 1918 janë modifikuar shumë herë rrugët e bllokimit të PB në këtë regjon: rruga subclavikulare vertikale, rruga subkorakoidene me modifikimet e saj, laterale apo në afersi të procesit coracoidal (2, 3, 4, 6). Të gjitha këto modifikime janë kryer për të evituar komplikacione te njohura te saj si pneumotoraksi, punksioni vaskular si dhe për të rritur efikasitetin anestetik. Në përvojën tonë klinike gjatë së cilës kemi aplikuar të gjitha rrugët e mundshme të bllokimit të PB për kirurgjinë e anësive të sipërme, rruga nënklavikulare SC është më e aplikueshmja sidomos ajo e përshkruar nga Wilson, me repert kutan 2 cm medialisht dhe 2 cm kaudalisht procesit coracoidal (6).

Shumë studime kanë raportuar se kjo rrugë siguron një përqindje të lartë suksesi nëse LA injektohet pas lokalizimit me neurostimulator të një përgjigje motorike distale krahasuar me atë proksimale duke raportuar një sukses anestezie që varion nga 44-99% (9, 12, 13, 14, 15, 17).

QËLLIMI I PUNIMIT

Qëllimi i studimit tonë ishte të krahasonte influencën në suksesin anestetik të BSC, nëse LA injektohet në prezencë të një përgjigje motorike të tipit radial, stimulim i kordës posteriore, apo të tipit median, stimulim i kordës mediale.

METODA DHE PACIENTËT

Pas informimit dhe marrjes të një konsensusi të plotë për aplikimin e BSC, janë përfshire në studim 246 pacientë të moshës nga 16-82 vjeç, 86- femra dhe 160- meshkuj, ASA I/II/III, të programuar për tu nënshtruar interventeve ortopedike-traumatologjike mbi anësitë e sipërme. Studimi është kryer në periudhën mars 2007 - mars 2010 në Shërbimin e Anestezisë në QKT të Spitalit Ushtarak Qendror Universitar. Pacientët janë intervenuar në dy shërbime: Shërbimin e Ortopedisë dhe Traumatologjisë në SUQU dhe Shërbimin Universitar të Ortopedisë dhe Traumatologjisë se QSUT "Nene Tereza". Realizimi i BSC është realizuar nga dy anestezistë me përvojë në anestezinë lokoregjonale periferike duke pasur në dispozicion mjete të nevojshme për kryerjen e saj me metodën e neurostimulimit. Janë përfshire në studim pacientë që plotësonin këto kritere:

*Kriteret e përfshirjes së pacientëve në studim***:**

- Konsensusi i qartë i pacientëve për tekniken e propozuar.
- Intervente në 1/3 e poshtme të krahut, bërryl, parakrah dhe dorë.
- Intervente ne të cilët, koha e nevojshme për kryerjen e tyre nuk parashikohej më e gjatë se 90 minuta.
- Intervente që parashikoheshin të kryheshin vetëm në dekupitus dorsal.

*Kriteret e mospërfshirjes në studim***:**

- Hipersensibilitet apo reaksione alergjike nga anestetikët lokale.
- Çrregullime të hemostazës.

- Infeksione në regjionin e pikës së punksionit.
- Paciente me sëmundje mendore apo të pakooperushëm për realizimin blloqeve nervore.

Të gjithë pacienteve që plotësonin këto kritere, në konsultën preanestetike, dhe në vizitë preanestetike në prezencën dhe të mjekut operator, ju shpjeguan në mënyrë të detajuar mënyra e realizimit të bllokut: materialet dhe procedurën e metodës së neurostimulimit, se punksioni mund të ishte rralle herë i dhimbshëm, se vetëm anësia që do të intervenohej do të ishte e pa ndjeshme, se gjatë interventit ata do të ishin zgjuar, për mundësinë e sedatimit dhe infiltrimit me lëndë anestetike lokale nëse nevojitej gjatë interventit, apo nëse dëshironin një përgjumje të lehtë, për mundësinë e vogël të dështimit dhe mundësinë e rralle të kalimit në Anestezi Gjenerale si dhe komplikacioneve tepër të rralla të bllokut SC.

Të gjithë blloqet, në mungese të një ambienti preanestetik, janë realizuar në Bllokun Operator pas vendosjes së një rruge venoze dhe monitorizimi standard, presion arterial sistolik joivaziv, trase EKG, puls oksimeter Sp02.

Materialet e nevojshme:

Për realizimin e bllokut subkorakoidal është përdorur:

- Neurostimulator të tipit Stimulpleks.
- Age të neurostimulimit të izoluara me majë të shkurtër G24 me gjatësi 50 mm.
- Laps demografik.
- Vizore e milimetruar.
- Elektroda EKG.
- Dy shiringa 20 ml me Lidokaine Hidrokloride 2% 20 ml + Bupivakaine Hidrokloride 0.5%- 20ml.



Fig.1: Reperti kutan dhe pika e punksionit sipas Wilson

Pas pozicionimit të pacientit në dekubitus dorsal, me anësi në gjatësinë e trupit, apo në rast të pa mundur në pozicion mbi trupin e pacientit, është përcaktuar dhe vizuar reperti kutan, procesi korakoidal lehtësisht i identifikueshëm, 2 cm medialisht dhe 2 cm kaudalisht atij është konsideruar si pikë punksioni.

Pas një asepsie kirurgjikale me age të neurostimulimit G24-50 mm, pasi penetrohet lëkura, ndizet neurostimulatori me intensitet 1 mA, me frekuence stimulimi 1 Hz dhe kohëzgjatje të neurostimulimit 0.1 ms, me drejtim të ages perpendikular me lëkuren, ne drejtim postanterior, në kërkim të lokalizimit të një përgjigje korrekte distale: fleksion te gishtave apo te dorës (pergjigje të tipit median - stimulim i kordës mediale) ose ekstension të gishtave dhe të dorës (përgjigje të tipit radial - stimulimi i kordës posteriore). Kemi vërejtur se përgjigjja e parë në pjesën më të madhe të rasteve ka qënë fleksion i parakrahut mbi krahun (përgjigje të tipit muskulokutan- stimulimi i kordës laterale) të cilën e kemi konsideruar jokorrekte, drejtimi i ages është devijuar kaudalisht, posteriorisht ose lateralisht dhe asnjëherë medialisht (shmangien e një pneumotoraksi) në kërkim të përgjigjeve të mësipërme. Pas gjetjes së përgjigjes korrekte ulëm intensitetin e stimulimit dhe pasi u bindëm për prezencën e saj nën ≤ 0.3 mA, prag nën të cilin ajo zhduket, u injektua volumi i LA në mënyre të fraksionuar duke aspiruar herë pas here, për të kontrolluar mundësinë e një refluksi gjaku me qëllim evitimin e injektimit intravenoz aksidental. Në të gjitha rastet u infiltrua 2-3 ml Lidokaine në gjatësi 2-4 cm në regjionin medio-inferior të aksiles me qëllim bllokimin e sigurt të nervave median kutan të krahut dhe parakrahut jo rrallë herë të pa bllokuar me këtë rruge. Në bazë të lokalizimit të një përgjigjeje motorike distale të tipit radial apo median pacientët u ndanë në dy grupe:

- **Grupi A** n= 124, ku u lokalizua një përgjigje e tipit radial.
- **Grupi B** n=122, ku u lokalizua një përgjigje e tipit median.

Në të dy grupet lënda anestetike ishte një miksturë me volum 40 ml (Lidokaine Hidrokloride 2% 20 ml + Bupivakaine Hidrokloride 0.5%- 20ml).

Për të dy grupet u shënuan dhe u analizuan të dhënat si: mosha, seksi, statusi fizik sipas ASA, regjionet e intervenuara, koha e realizimit të bllokut, koha e instalimit të plotë të bllokut sensor dhe

motor, cilësia e anestezisë kirurgjikale, komplikacionet të lidhura me tekniken, kohëzgjatja e bllokut sensor.

Vlerësimi i kohës së kryerjes së bllokut: është konsideruar koha nga momenti i asepsisë së regjionit të punksionit, lokalizimit të përgjigjes motorike deri në injektimin e LA.

Vlerësimi i bllokut sensor: është vlerësuar 5-10 - 15-20 min nga momenti i injektimit të LA, me metodën shpim-prekje, me një age G-20, duke testuar lëkuren në regjionet përkatëse të inervuara nga nervat:

- N. median: sipërfaqja palmare e gishtit të madh dhe pjesës palmare të metakarpeve.
- N. radial: sipërfaqja dorsale e dorës dhe artikulacionit radiokarpal.
- N. ulnar: sipërfaqja palmare e gishtave IV-V.
- N. muskulokutan: sipërfaqja dorsale e parakrahut .

Shkalla e vlerësimit te bllokut sensor: vlerësimi është bërë sipas shkalles se ndjeshmërisë.

- Ndjeshmëri e ruajtur = 2
- Humbje parciale e ndjeshmërisë = 1 (analgjezi)
- Humbje totale e ndjeshmërisë = 0 (anestezi kirurgjikale)

Vlerësimi i Bllokut motor: është vlerësuar 20-40 min nga momenti injektimit të LA si pamundësi e kryerjes së manovrave te tilla si:

- N. median: flexion të pjesës distale intrafalingale të gishtave.
- N. radial: ekstension të kyçit të dorës.
- N. ulnar: abduksion të gishtave IV-V.
- N. muskulokutan; fleksion i parakrahut mbi krahun.

Shkalla e vlerësimit:

- Ruajtja e plote e motorikës =2
- Humbje parciale e motorikës (parezë) = 1
- Humbje totale e motorikës (paralizi) = 0

*Kohëzgjatje e bllokut sensor: Ë*shtë konsideruar koha nga momenti i realizimit të bllokut deri në momentin që pacienti ka referuar se ka dhimbje dhe ka kërkuar nevojën për aplikim të një analgjeziku.

Komplikacione të lidhura me teknikën: janë konsideruar dhe vlerësuar gjatë realizimit të bllokut dhe 24 orët e para postoperatore ngjarje si: punksion të vazave te gjakut, pneumotoraks, parestezi apo deficite motore dhe sensore.

Kriteri kryesor i studimit ishte vlerësimi i bllokut sensitiv, pra suksesi i anestezisë duke e konsideruar atë:

- Të plotë apo optimal, kur interventi është kryer nën anestezinë e përfituar nga blloku.
- Jo të plotë, kur është nevojitur sedatim apo infiltrim me AL për përfundimin e interventit.
- Të dështuar, kur për përfundimin e interventit, është nevojitur kalimi në Anestezi Gjenerale.

Kriter sekondar i studimit ishin koha e instalimit të plotë të bllokut sensor dhe motor, kohëzgjatja e bllokut sensor dhe komplikacione të lidhura me metodën.

Të dhënat demografike, statusi fizik, koha e instalimit dhe kohëzgjatjes së bllokut sensor janë shprehur me vlerën mesatare të devijimit standard ± SD, ndersa regjionet e intervenuara, suksesi i anestezisë dhe nevoja për infiltrim te AL, janë në përqindje. Të dhënat variabël janë analizuar me testin t-Studentit. Vlera e $p \leq 0.05$ është konsideruar statistikisht sinjifikative.

REZULTATET

Karakteristikat demografike të pacienteve, të përfshire në studimin tonë janë të paraqitura në Tabelën 1. Në Grupin A (n= 124), 78 (62.9%) ishin meshkuj dhe 46 (37.1%) femra ndërsa në Grupin B (n=122), 82 (67.2%) meshkuj dhe 40 (32.8%) ishin femra.

Siç duket dhe në tabelë në të dy grupet e pacienteve nuk vërehen ndryshime të dukshme për sa i përket të dhënave demografike dhe statusit fizik.

Tabela 1.

Karakteristikat Demografike

	Grupi A	Grupi B
Seksi F / M (n)	46/78	40/82
Mosha	16-84	17-78
(vjeç)	(41 ± 3.2)	(40 ± 4.1)
ASA I/II/III	76/44/4	78/41/3

Për sa i përket regjioneve të intervenuara ato janë paraqitur në Tabelën 2 të shprehura në përqindje ku përfshihen intervente kirurgjikale për: fraktura, heqje materiale sinteze, riparim tendinëve, bursite, amputacione.

Tabela 2.

Regjionet e intervenuara

Regjionet e Intervenuara	**Grupi A**	**Grupi B**
1/3 e poshtme e krahut	20(16.1%)	21(17.2%)
Bërryl	22(17.7%)	27(22.1%)
Parakrah	26(20.9%)	24(19.7%)
Dorë	56 (45.1%)	50 (41 %)

Koha e realizimit të bllokut në të dy grupet sipas lokalizimit të rastësishëm të tipit të përgjigjes motorike ishte e përafërt, në Grupin A 3.6 ± 0.2 min krahasuar me 3.8±1.2 min në grupin B ($p \geq 0.21$).

Tabela 3.

Koha e instalimit dhe kohëzgjatja e analgjezisë

	Grupi A	**Grupi B**	**p =**
Koha realizimit min	3-6 (3.6±0.2)	3-7 (3.8±1.2)	$p \geq 0.21$
Instalim i Bllokut Sensor (min)	6- 16 (9.2± 2.2)	9-18 (11 ± 4.1)	$p \leq 0.067$
Instalim i Bllokut Motor (min)	16-26 (21 ± 2.3)	16-30 (22 ± 0.2)	$p \geq 0.39$
Kohëzgjatja Analgjezisë (ore)	10-12 (11 ±1.5)	10-12 (11 ±1.1).	$p \geq 0.37$

Për sa i përket kohës së instalimit të plotë të bllokut sensor të paraqitura në Tabelën 3, në Grupin A ajo ishte 9.2 ± 2.2 min krahasuar me 11 ± 4.1 min ne Grupin B (p≥0.26). Koha e instalimit të plotë të bllokut motor në grupin A ishte 21 ± 2.3 krahasuar me 22 ± 0.2 ne Grupin B (p≥0.39). Pra, nuk vërehen ndryshime të dukshme për sa i përket kohës së instalimit të bllokut sensor dhe atij motor.

Anestezia kirurgjikale ishte e plotë në 122 (98.38%) raste në grupin A, ndërsa në grupin B ajo ishte e plotë në 114 (93.4%) raste (p≤ 0.05). Në 2 (1.62%) raste në grupin A ajo ishte jo komplete dhe u kërkua sedatim apo infiltrim në linjën e incizionit, ndërsa në Grupin B në 8 (6.6%) raste u kërkua sedatim apo infiltrim në linjën e incizionit (p≤ 0.05). Në të dy grupet interventi u përfundua nën bllok SC pa nevojën e kalimit në anestezi të përgjithshme.

Kohëzgjatja e bllokut sensor në të dy grupet ishte e përafërt nga 10-12 ore, në Grupin A (11 ±1.5) ndërsa në Grupin B (11 ±1.1) (p ≥0.37).

Tabela 4.

Suksesi i Anestezisë

	Grupi A	**Grupi B**	**p =**
Anestezi kirurgjikale plotë	122 (98.38%)	115 (93.4%)	p≤ 0.05
Anestezi Kirurgjikale jokomplete	2(1.62%)	8(6.6%)	p≤ 0.05
Dështim	-	-	

Për sa i përket komplikacioneve , gjatë punksionit u vërejt punksion i vazave në Grupin A 12.9% krahasuar me 11.4 % të rasteve në Grupin B (p ≥0.28). Në Grupin B në 1-rast u vërejtën shenja të toksicitetit sistemik, 30 min pas realizimit të bllokut e shoqëruar me bradikardi ekstreme, rast i cili u trajtua me sukses. Në të dy grupet nuk u vërejt asnjë rast pneumotoraksi.

Tabela 5.

Komplikacionet të lidhura me teknikën

	Grupi A	**Grupi B**	**p=**
Punksion Vaskular	16(12.9%)	14(11.4%)	p ≥0.28
Pneumotoraks	-	-	
Toksicitet sistemik		1(0.8%)	-
Deficit mot. sensor	-	-	

Në 24-orëshin e parë postoperator pacientët e të dy grupeve nuk prezantuan deficite motore apo sensore të lidhura me teknikën.

DISKUTIMI

Rezultatet e studimit tonë klinik venë në dukje se bllokimi i pleksit brakial nëpërmjet rrugës nënklavikulare subkorakoidale realizuar me një punksion të vetëm me metodën e neurostimulimit, siguron një përqindje të lartë suksesi të anestezisë kirurgjikale, nëse LA injektohet pas lokalizimit të një përgjigje motorike distale. Suksesi i anestezisë ishte më i larte në rastet e stimulimit të kordës nervore posteriore në krahasim me stimulimin e kordës mediale.

Ne mendojmë se njohja e anatomisë së PB në këtë nivel është një ndër faktorët më të rëndësishëm që mund të shpjegojë suksesin e lartë anestetik të kësaj rruge të bllokimit të PB, si dhe incidente minimale komplikacionesh të parëndësishme të saj.

PB në regjionin subklavikular është i përbërë nga tre kordat nervore emri i të cilave korrespondon me pozicionimin e tyre në raport me arterien aksilare (1, 6, 20). Korda laterale pozicionohet lateralisht arteries nga e cila del n. muskulokutan dhe radiksi lateral i n.median, nga korda mediale që pozicionohet medialisht arteries aksilare, midis saj dhe venës aksilare, qe jep degët për formimin e n. ulnar dhe radiksin median për formimin e nervit median si dhe nervat kutan medial të krahut dhe parakrahut. Fashikulli posterior pozicionohet posteriorisht dhe kaudalisht arteries dhe prej tij dalin n.axilar dhe n. radial (fig.2).




Fig.2 Anatomia e kordave të PB në regjionin subklavikular

Në këtë regjion vetë arteria aksilare dhe fashikujt nervorë janë të mbështjellë nga një këllëf tubular aponeurotik pranë njeri-tjetrit, afërsi kjo e pa parashikuar në mënyre të saktë (8, 15, 20). Injektimi i LA mbi kordën nervore posteriore, për pozicionin e saj anatomik në qendër të tufës vaskulonervore, është faktor që lejon difuzimin uniform të LA në drejtim të dy kordave të tjera nervore e pa dyshim shpjegon, pse efektiviteti anestetik është më i lartë dhe instalimi i bllokut sensor më i shpejtë (6, 14, 17, 18, 21).

BPB nëpërmjet rrugës subkorakoidale sipas Wilson, është një rruge për realizimin e së cilës, repertet kutane janë lehtësisht të identifikueshme dhe ajo qe është dhe më e rëndësishme larg domës pleurale duke evituar mundësinë e një pneumotoraksi, komplikacion ky i njohur për rrugët e tjera nënklavikulare sidomos ajo vertikale. Me një punksion të vetëm lejon anestezimin e plotë të anësisë, pa nevojën e mobilizimit të saj, e rëndësishme kjo për pacientet e traumatizuar për të cilët mobilizimi i anësisë është tepër i dhimbshëm dhe i pa mundur (6, 16, 22).

Historikisht janë përshkruar shumë rrugë të bllokimit të pleksit brakial në regjionin subklavikular, të cilat paraqesin vështirësi në identifikimin e reperteve kutane që shoqëroheshin me komplikacione, sidomos për incidencën e lartë të pneumotoraksit dhe një përqindje të suksesit të anestezisë që varionte nga 40-99%, në varësi të lokalizimit me metodën e neurostimulimit, të një përgjigje motorike distale apo proksimale (13, 14, 15, 18, 19). Studime të shumta klinike dhe eksperimentale kanë sjelle argumente se ndërmjet këtyre strukturave vazonervore ekzistojnë jo rrallëherë septe kolagjenike të cilat bëhen shkak për pengimin e difuzimit të LA në mënyre uniforme, duke shpjeguar kështu dhe incidencën e dështimit të bllokut dhe pse i realizuar sipas rekomandimeve standarte (19, 20, 23). Ato kanë treguar se shpërndarja e AL si dhe suksesi i anestezisë nëpërmjet kësaj rruge ka variuar në varësi të përgjigjes së marrë nëpërmjet neurostimulatorit. Në studimin Borgett et al (2001) që ka analizuar suksesin anestetik të bllokut SC në varësi të lokalizimit të një përgjigje motorike distale, ekstension apo fleksion të dorës ka raportuar një përqindje suksesi të anestezisë kirurgjikale 97% të rasteve ndërsa ka raportuar një përqindje suksesi të anestezisë 44% të rasteve kur ka lokalizuar një përgjigje motorike proksimale , kontraksione te m. biceps apo m. triceps. Miniville et al 2007 dhe Rodrigues et al 2004, në dy studime të tyre që kanë pasur si objektiv suksesin e anestezisë nëse stimulonin kordën posteriore apo mediale, kanë raportuar një përqindje të suksesit më të lartë se 96% të rasteve (9, 22). Në përvojën tonë klinike disa vjeçare, kur kemi aplikuar bllokun subklavikular vertikal apo subkorakoidal, në rastet që nuk i kemi venë rendësi lokalizimit të kordave dhe kemi injektuar LA sipas përgjigjes motorike distale apo proksimale, kemi vërejtur një kohe të gjatë instalimi si dhe përqindje të ulet suksesi të anestezisë kirurgjikale. Në këtë studim prospektiv që kishte si objektiv injektimin e LA vetëm nën një përgjigje motorike distale, u vërejt një përqindje suksesi të anestezisë të përafërt me rezultatet e autoreve që kanë pasur të njëjtin objektiv në studimet e tyre. Në pacientët ku LA u injektua mbi një përgjigje distale të tipit radial (stimulim i kordës posteriore) u vërejt një sukses anestezie më i lartë 98.3% të rasteve krahasuar me 93.4% të rasteve kur LA u injektua mbi një përgjigje motorike mediane (stimulim i kordës mediale) ($p \leq 0.05$). Gjithashtu u vërejt se instalimi i bllokut sensor ishte më i shpejtë në Grupin A- 9.2 min krahasuar me 11,4 min në Grupin B, megjithëse pa ndryshime sinjifikative ($p \leq 0.067$). Ndërsa kohëzgjatja e

analgjezisë ishte thuajse e përafërt 11 ±1.5 krahasuar me 11±1.1 ore (p ≥0.37). Dhe disa studime imazherike, ekografike dhe ato nën rezonancë manjetike kanë konkluduar se injektimi i LA pranë kordës posteriore lehtëson dhe lejon shpërndarjen uniforme në formë tubulare në dy kordat e tjera, gjë që bën të mundur anestezimin e tre kordave të pleksit brakial e shoqëruar me kohë të shkurtër instalimi dhe përqindje absolutisht të lartë suksesi të anestezisë (11, 22, 23, 24). Wilson në studimin e tij, në të cilin ka vlerësuar nëpërmjet rezonancës manjetike, se thellësia e PB nga lëkura sipas repertit kutan të përshkruar nga ai, për bllokun SC ishte 4.2 cm dhe ai ishte pozicionuar në faqen posteriore të arteries aksilare (6). Gjithashtu është vërejtur se n. muskulokutan mund të lërë këllëfin aponeurotik që në nënivelin e buzës së poshtme të klavikulës, më lart se ky repert dhe injektimi i LA nën një përgjigje proksimale shpjegon në mënyrë të qartë dështimin e anestezisë nën ketë përgjigje (12. 15, 18). Në përvojën tonë aktuale është kjo arsyeja që kemi shmangur injektimin e LA sa herë që e hasim atë dhe gjithmonë tentojmë të lokalizojmë një përgjigje distale .

Kriteret e përkufizimit të efikasitetit të anestezisë lokoregjionale janë të ndryshme në studime të ndryshme (9, 11, 13). Është e qartë se kriteret e ndryshme të përkufizimit të suksesit të anestezisë është faktor variabël, kur ne kërkojmë të krahasojmë rezultatet e studimeve. Më i shpeshti është intensiteti i bllokut sensitiv që përcakton efikasitetin e teknikes pa marrë në konsideratë intensitetin e bllokut motor (13). Ne kemi marrë si kriter kryesor të vlerësimit intensitetin e bllokut sensitiv kutan për të katër nervat median, radial, ulnar dhe muskulokutan. Ndërsa për nervat median kutan të krahut dhe parakrahut kemi infiltruar 2-3 ml lëndë anestetike në regjionin medioinferior të aksilës. Arsye kjo që rruga subkorakoidale njihet për incidencë të ulet të bllokimit të këtyre nervave, e rëndësishme kjo për tolerancën e zhgutit në regjionin e krahut (1, 2, 14). Ne nuk kemi observuar asnjë komplikacion të rendë gjatë aplikimit të kësaj rruge. Në literature dhe pse nuk raportohet ndonjë incidencë e saktë e komplikacioneve të rrugëve nenklavikulare, në disa studime, janë raportuar raste sporadike të pneumotoraksit, difuzimit cefalik te LA, të shoqëruar me sindromën Horner apo disfunksion respirator (2, 8, 10, 14, 15, 18, 25).

Në kërkim të një përgjigje distale risku për një punksion të vazave (arterie-venë) është gjithmonë i mundshëm dhe autorët aplikues të kësaj rruge gjejnë një incidence të saj që varion nga 2-12% të rasteve në varësi të rrugës së aplikuar si dhe pozicionit të krahut ((3, 4, 5, 7, 8, 9). Ne gjetëm një incidencë të punksionit të vazave 12.9% të rasteve në grupin A, ndërsa në grupin B ajo ishte 11.4% (p ≥0.28). Incidencë kjo më e lartë se rezultatet e publikuara, shpjeguar me tendencën tonë, gjithmonë për të arritur një përgjigje distale, duke e riorientuar agen e punksionit deri sa ta lokalizonim atë. Siç e përmendem dhe më lart prania e elementeve vaskulonervore, shumë pranë njeri-tjetrit në ketë regjion, kërkon injektimin e LA në mënyre të fraksionuar dhe e shoqëruar me aspiracione të përsëritura për të shmangur injektimin intravenoz aksidental si dhe respektimin e dozave maksimale të anestetikeve lokale pasi njihet si zone me absorbim të shpejtë tyre. Në studimin tonë, ne vërejtëm tek një pacient i moshuar, 30 min pas aplikimit të bllokut SC shenja të toksicitetit sistemik neurologjik dhe kardiak, të cilat u trajtuan me sukses me injektimin e barbiturikeve, oksigjenimin joivaziv si dhe injektimin e Sol. Intralipid 20%, 1 ml/kg sipas protokolleve tashmë të standardizuara të trajtimit të intoksikimit sistemik nga LA gjatë aplikimit të anestezisë lokoregjionale periferike të publikuara nga Shoqata e Anestezistëve Britanike dhe Irlandës (26, 27).

KONKLUZION

Bllokimi i pleksit brakial nëpërmjet rrugës subkorakoidale realizuar sipas Wilson është një nga rrugët subklavikulare me repert kutan me të lehtë për tu identifikuar dhe pa komplikacione të lidhura me tekniken. Nga rezultatet e studimit tonë konkludojmë se, injektimi i Lëndës Anestetike mbi një përgjigje motorike distale të tipit radial siguron një instalim të shpejtë të bllokut sensor dhe përqindje më të lartë suksesi, në krahasim me injektimin e saj mbi një përgjigje të tipit median. Ne rekomandojmë që, gjatë aplikimit të kësaj rruge të bllokimit të pleksit brakial, të jetë prioritare kërkimi i stimulimit të kordës posteriore.

REFERENCAT

1. Neal JM, Gerancher JC, Hebl JR, Ilfeld BM, McCartney CJ, Franco CD, et al. Upper extremity regional anesthesia: Essentials of our current understanding, 2008. Reg. Anesth Pain Med. 2009;34:134–70.
2. Raj PP, Montgomery SJ, Nettles D, Jenkins MT. Infraclavicular brachial plexus block--a new approach *Anesth. Analg.* 1973; 52: 897-904.
3. Sims JK. A modification of landmarks for infraclavicular approach to brachial plexus block *Anesth. Analg.* 1977 ; 56 : 554-555.
4. Whiffler K. Coracoid block--a safe and easy technique *Br. J. Anaesth.* 1981; 53: 845-848.
5. Kilka HG, Geiger P, Mehlrkens HH. Infraclavicular vertical brachial plexus blockade. A new method for anesthesia of the upper extremity. An anatomical and clinicalstudy *Anaesthesist* 1995; 44: 339-344.
6. Wilson JL, Brown DL, Wong GY, Ehman RL, Cahill DR. Infraclavicular brachial plexus block: parasagittal anatomy important to the coracoid technique *Anesth. Analg.* 1998; 87: 870-873.
7. Borgeat A, Ekatodramis G, Dumont C. An evaluation of the infraclavicular block via a modified approach of the Raj technique *Anesth. Analg.* 2001; 93: 436-441.
8. Kapral S, Jandrasits O, Schabernig C, Likar R, Reddy B, Mayer N, et al. Lateral infraclavicular plexus block vs. axillary block for hand and forearm surgery *Acta Anaesthesiol. Scand.* 1999; 43 : 1047-1052.
9. Rodriguez J, Barcena M, Taboada-Muniz M, Lagunilla J, Alvarez J. A comparison of single versus multiple injections on the extent of anesthesia with coracoid infraclavicular brachial plexus block *Anesth. Analg.* 2004; 99: 1225-1230.
10. Ilfeld BM. Single- versus multiple-stimulation infraclavicular blocks *Reg. Anesth. Pain Med.* 2003; 28: 149-150.
11. Jandard C, Gentili ME, Girard F, Ecoffey C, Heck M, Laxenaire MC, et al. Infraclavicular block with lateral approach and nerve stimulation: extent of anesthesia and adverse effects *Reg. Anesth. Pain Med.* 2002; 27: 37-42.
12. Les blocs périphériques des membres chez l'adulte. Recommandations pour la pratique clinique. la Collection de la Sfar Paris: Elsevier (2004). 14-17.
13. Minville V, N'Guyen L, Chassery C, Zetlaoui P, Pourrut JC, Gris C, et al. A modified coracoid approach to infraclavicular brachial plexus blocks using a double-stimulation technique in 300 patients *Anesth. Analg.* 2005; 100: 263-265.
14. Desroches J. The infraclavicular brachial plexus block by the coracoid approach is clinically effective: an observational study of 150 patients *Can. J. Anaesth.* 2003; 50: 253-257.
15. Salazar CH, Espinosa W. Infraclavicular brachial plexus block: variation in approach and results in 360 cases*Reg. Anesth. Pain Med.* 1999; 24: 411-416.
16. Rodriguez J, Barcena M, Lagunilla J, Alvarez J. Increased success rate with infraclavicular brachial plexus block using a dual-injection technique *J. Clin. Anesth.* 2004; 16: 251-256.
17. Rodríguez J, Taboada M, Oliveira J, Ulloa B, Bárcena M, Alvarez J.Single stimulation of the posterior cord is superior to dual nerve stimulation in a coracoid block.Acta Anaesthesiol Scand. 2010 Feb; 54(2): 241-5.
18. Bloc S, Garnier T, Komly B, Leclerc P, Mercadal L, Morel B, Dhonneur G. Single-stimulation, low-volume infraclavicular plexus block: influence of the evoked distal motor response on success rate.
19. Klaastad O, Lilleås FG, Røtnes JS, Breivik H, Fosse E. Magnetic resonance imaging demonstrates lack of precision in needle placement by the infraclavicular brachial plexus block described by Raj et al. Anesth Analg. 1999; 88: 593–8.
20. Ootaki C, Hayashi H, Amano M. Ultrasound-guided infraclavicular brachial plexus block: An altlernative technique to anatomical landmark-guided approaches. Reg Anesth Pain Med. 2000; 25: 600–4.
21. Lecamwasam H, Mayfield J, Rosow L, Chang Y, Carter C, Rosow C. Stimulation of the posterior cord predicts successful infraclavicular block. Anesth Analg. 2006;102:1564–8.
22. Minville V, Fourcade O, Bourdet B, Doherty M, Chassery C, Pourrut JC, et al. The optimal motor response for infraclavicular brachial plexus block. Anesth Analg. 2007 ;104: 448–51.
23. Morimoto M, Popovic J, Kim JT, Kiamzon H, Rosenberg AD. Case series: Septa can influence local anesthetic spread during infraclavicular brachial plexus blocks. Can J Anaesth. 2007; 54: 1006–10.
24. Rodriguez J, Barcena M, Alvarez J. Restricted infraclavicular distribution of the local anesthetic solution after infraclavicular brachial plexus block *Reg. Anesth. Pain Med.* 2003; 28: 33-36.
25. Rodriguez J, Barcena M, Rodriguez V, Aneiros F, Alvarez J. Infraclavicular brachial plexus block effects on respiratory function and extent of the block *Reg. Anesth. Pain Med.* 1998; 23: 564-568.

26. Crews JC, Gerancher JC, Weller RS. Pneumothorax after coracoid infraclavicular brachial plexus block. Anesth Analg. 2007; 105: 275–7.
27. Association of Anesthesists of Great Britain and Ireland home page.
28. Zhurda T, Muzha D, Caushi GJ, Bajaktari M, Kerci M. Efficacité de l'administration précoce d'une solution lipidique pour traiter la toxicité systémique induite par la bupivacaïne après un bloc plexique sous-coracoïdien *Ann Fr Anesth Reanim* 2010; 29: 592-593

SUMMARY

THE BRACHIAL PLEXUS BLOCK BY THE CORACOID APPROACH: THE INFLUENCE OF THE LOCALIZATION TO THE DISTAL MOTOR REPONS MEDIAN OR RADIAL TYPER ON THE SUCCESS OF ANESTHESIA

Tefik Zhurda[1], Mustafa Bajraktari[2], Gjergji Caushi[2], Dritan Muzha[1],Mihal Kerci[1]

[1]Anesthesiology & Intensive Care, CMUH, Tirana, aLBANIA
[2]Universitary Service of Orthopaidic & Traumatology UHC "Mother Teresa", Tirana, Albania

Background and Objectives*: Many studies have reported that brachial plexus block through an infracoracoidal approach achieves a high success rate if anesthetic drug is injected with neurostimulator after localization of a distal motor response. The goal of our study is to compare the influence of anesthetic success of the IC block if the drug is injected with the presence of a motor radial or mediane response.* ***Material and Method****: In our study we included 246 patient who had orthopaedic or trauma surgery (period march 2007 –march 2010) under infracoracoidal block. The surgery was performed on the distal 1/3 of the arm. The block was done with a single stimulation. Patients were randomized according to the localization of the distal motor response radial or mediane. In the radial group there were 124 patients and in the mediane group there were 122 patients. In both groups the anesthetic drug was a mixture of 40 ml volume - Lidocaine 2% 20 ml + Bupivacaine 0.5% - 20 ml. The drug was injected in the presence of minimal motor response with stimulation intensity ≤0.3 mA. The evaluation of the sensor and motor block in 4 nerves (median, ulnar, radial, muskulocutan) was done in 5-10-15-20 min after the injection of the anesthetic drug.* ***Results****: In the radial group in 122 (98.3%) patients the sensor and motor block in four nerves was effective. In 2 cases we did complementary. In the mediane group in 114 (93.4%) cases the motor and sensor block was effective, in 8 cases we did complementary. All surgeries were performed under IC block without any complication.* ***Conclusion****: Injection of anesthetic drug under distal motor response of radial type gives a higher success rate of the IC block compared with the mediane type.*

Key words: *Brachial plexus, subcoracoidal block, distal motor response*

PUNIM BURIMOR SHKENCOR / ORIGINAL SCIENTIFIC PAPER
OFTALMOLOGJI

COMPARATIVE STUDY OF PTERYGIUM EXCISION WITH CONJUNCTIVAL AUTOGRAFT TRANSPLANTATION WITH GRAFT FROM THE SUPERIOR OR INFERIOR TEMPORAL BULBAR CONJUNCTIVA

Vesna Celeva Markovska[1], Emilija Dastevksa Goseva[1]

[1]University Eye Clinic, Skopje, Macedonia



Vesna Celeva Markovska, MD, ophthalmologist
Primarius, Mr.sci.
Bul. "Kuzman Josifovski - Pitu" 19/5/33, Skopje, Macedonia
Tel: 03147-152 & 070 363-281
e-mail: **vesna_c@yahoo.com**

RESUME: Aim*: To evaluate the success rates of surgical techniques of pterygium excision with conjunctival autograft transplantation for primary pterygium. The two techniques that were evaluated are as follows: (1) Pterygium excision with conjunctival autograft transplantation with graft from the superior temporal bulbar conjunctivae (STBC) and (2) Pterygium excision with conjunctival autograft transplantation with graft from the inferior temporal bulbar conjunctivae (ITBC).* ***Material and methods****: 120 cases with primary pterygium were evaluated. Outcomes were evaluated in terms of recurrence of pterygium onto the cornea. The patients were divided into 2 groups: (1) 60 eyes were operated with conjunctival autograft transplantation with graft from the superior temporal bulbar conjunctivae (30 cases of pterygium's length over the cornea less than 3mm and 30 cases of pterygium's length over the cornea more or equal to 3mm). (2) 60 eyes were operated with conjunctival autograft transplantation with graft from the inferior temporal bulbar conjunctivae (30 cases of pterygium's length over the cornea less than 3mm and 30 cases of pterygium's length over the cornea more or equal to 3mm).* ***Results****: Mean follow up time after the surgery was 12 months (2 to 24 months). 4 out of 60 (6,67%) pterygium cases recur after the conjunctival autograft transplantation with graft from the STB conjunctiva, and 3 out of 60 (5%) pterygium cases recur after the conjunctival autograft transplantation with graft from ITB conjunctiva. Only one surgeon performed all 120 surgeries.* ***Conclusion****: The excision of pterygium using the conjunctival autograft transplantation (both from superior and inferior bulbar conjunctiva) is highly efficient in terms of low recurrence rates. From the two techniques used in this comparative study with similar recurrence rates, the conjunctival autograft transplantation with graft from the inferior bulbar conjunctiva is preferred only because we keep intact the superior bulbar conjunctiva for eventual future surgical intervention.*

Key words*: Pterygium, recurrence, primary, conjunctival autograft transplantation*

Medicus 2011, Vol. XV (1):

INTRODUCTION

Pterygium is an active, invasive, inflammatory process, a key feature of which is focal limbal failure (1). It is proposed that the initial biologic event in pterygium pathogenesis is an alteration of limbal stem cells due to chronic ultraviolet light exposure (2).

In the Caucasian population the prevalence of pterygium is between 1-7,7%, a number that is directly proportional to the geographic location of the country (2). In other words, the countries which are closer to the Equator have higher percentage of pterygium prevalence, and vice versa.

The etiology of pterygium still intrigues the scientists as a puzzle that is yet to be solved. Davanger and Evenson were the first to postulate that a limbus serves as a generative organ for corneal epithelial cells (3). The source of corneal epithelial cellular migration and proliferation comes from the peripheral cornea. This has been extended to clinical application of conjunctival transplantation.

Macedonia, a country notable with a high number of sunny days, is also distinctive with a high prevalence of pterygium especially in the capable working middle aged people, those with a permanent damage of visual acuity and with a cosmetic insufficiency (4). For all of the above reasons, as well as the lack of a known effective prophylaxis, the pterygium still is a challenge to be examined and solved.

AIM

To evaluate the success rates of surgical techniques of pterygium excision with conjunctival autograft transplantation for primary pterygium. The two techniques that were evaluated are as follows:

1. Pterygium excision with conjunctival autograft transplantation with graft from the superior temporal bulbar conjunctivae (STBC) and
2. Pterygium excision with conjunctival autograft transplantation with graft from the inferior temporal bulbar conjunctivae (ITBC).

MATERIAL AND METHOD

120 cases with primary pterygium were evaluated. Outcomes were evaluated in terms of recurrence of pterygium onto the cornea. The patients were divided into 2 groups:

1. 60 eyes were operated with conjunctival autograft transplantation with graft from the superior temporal bulbar conjunctivae (30 cases of pterygium's length over the cornea less than 3mm and 30 cases of pterygium's length over the cornea more or equal to 3mm).
2. 60 eyes were operated with conjunctival autograft transplantation with graft from the inferior temporal bulbar conjunctivae (30 cases of pterygium's length over the cornea less than 3mm and 30 cases of pterygium's length over the cornea more or equal to 3mm).

The surgical technique of pterygium excision with conjunctival autograft transplantation is performed using topical and subconjunctival anesthesia (sometimes adrenaline is used as well). A rigid lid speculum facilitates maximal exposure. A disposable scarifier Grishaber 681 is used to superficially excise the corneal portion of the pterygium, while the reminder is excised with Wescott scissors following a careful identification and dissection of the extra-ocular muscles. The size of exposed bare sclera is measured with calipers, then the eye is turned up or down to expose the inferior or superior bulbar conjunctiva in order to measure the area of corresponding size and mark the same with metilen blue. These marks are included within the margins of the thinly dissected graft tissue in order to facilitate its unequivocal reorientation. The free graft is transferred to its anatomically equivalent position in the recipient bed and secured with approximately eight interrupted suture of 8-0 vicryl. Postoperatively, topical corticosteroid and antibiotic ointment are administered locally for approximately 4 - 6 weeks.

RESULTS

Mean follow up time after the surgery was 12 months (2 to 24 months). 4 out of 60 (6,67%) pterygium cases recur after the conjunctival autograft transplantation with graft from the STB conjunctiva, and 3 out of 60 (5%) pterygium cases recur after the conjunctival autograft transplantation with graft from ITB conjunctiva. Only one surgeon performed all 120 surgeries.

The group of 60 cases with pterygium operated by excision with conjunctival autograft transplantation from the STB conjunctiva, showed a recurrence rate of 6,67% (4 out of 60 cases) and all of the recurring cases occurred in the subgroup of cases whose pterygium's length over the cornea was 3mm or more. Also, in the other group of 60 cases with pterygium operated by excision with conjunctival autograft transplantation from the ITB conjunctiva, showed a recurrence rate of 5% (3 out of 60 cases) and all of the recurring cases occurred in the subgroup of cases whose pterygium's length over the cornea was 3mm or more.


Tab. 1.

Recurrence after pterygium excision with conjunctival transplantation with graft from STB and ITB conjunctiva

STBC			**ITBC**		
	<3mm	>=3mm		<3mm	>=3mm
no recurrence	30	26	no recurrence	30	27
recurrence	0	4	recurrence	0	3


Graphic 1.

Recurrence after pterygium excision with conjunctival transplantation with graft from STB conjunctiva




Graphic 2.

Recurrence after pterygium excision with conjunctival transplantation with graft from ITB conjunctiva



Graphic 3.

Comparison between the different excision methods of pterygium excision with conjunctival transplantation with graft from STB and ITB conjunctiva



DISCUSSION

This study demonstrates a low recurrence rate of pterygium after excision with conjunctival autografting in a country with a high occurrence of pterygium and high levels of ultra-violet light (4).

Recurrence rates reported for pterygium excision with conjunctival autografting are generally low (3-16%) (Tab.2). Variations in the results from a given technique may be caused by a number of factors: variation within techniques, the age and geographical location of the population studied, the length of the follow up time, the interpretation of the definition of recurrence and the experience of the surgeon undergoing the pterygium excision and conjunctival auto grafting (5, 6, 7).

Tab.2.

Published rates of pterygium recurrence after excision and conjunctival auto grafting

Author	Location	Numbers	Recurrence
Dowlut	Canada	15	8% (1)
Kenyon	Boston	57	5% (3)
Lewallen	St Kitts	19	16% (3)
Singh	Los Angeles	13	8% (1)
Mrzygold	Poland	41	3% (1)
Koch	Essen	13	8% (1)
Simona	Geneva	14	15% (3)

Conjunctival auto grafting is a relatively slow procedure, often taking at least 45min to perform. However, it is still recommended for primary pterygium excision, and for advanced and recurrent pterygium.

From the two techniques used in this comparative study with similar recurrence rates, the conjunctival autograft transplantation with graft from the inferior bulbar conjunctiva is preferred only because we keep intact the superior bulbar conjunctiva for eventual future surgical intervention.

CONCLUSION

The excision of pterygium using the conjunctival autograft transplantation (both from superior and inferior bulbar conjunctiva) is highly efficient in terms of low recurrence rates. Therefore, it is a recommended technique for pterygium excision in cases with primary, advanced and recurrent pterygium.

REFERENCES

1. Coroneo MT, Di Girolano N, Wakefield D. *The pathogenesis of pterigia*, Curr.Opin.Ophthalmol 1999Aug; 10(4); 282-8.
2. Kwok LS, Coroneo MT. *A model for pterygium formation*, Cornea 1994 May; 13(3):219-24.
3. Davenger M, Evensen A. *Role of the pericorneal papillary structure in renewal of corneal epithelium*, Nature 1991; 229:560-1.
4. Markovska Celeva V. *Comparative evaluation of surgical methods of pterygium excision*, Master thesis, University "Ss.Cyril and Methodius", Skopje, Macedonia, p.56.
5. Kenyon KR, Wagoner MD, Hettinger ME. *Conjunctival autograft transplantation for advanced pterygium and recurrent pterygium*, Ophthalmology 1994 Nov; 92(11):1461-70.
6. Dowlut MS, Laflamme MY, *Recurrent pterigia: frequency and treatment by conjunctival autograft*. Can. J Ophthalmol. 16(3):119-20.
7. Starck T, Kenyon K, Serrano F. *Conjunctival autograft for primary and recurrent pterygia: surgical technique and problem management*, Cornea 1991 May, 10(3):196-202.

РЕЗИМЕ

КОМПАРАТИВНА СТУДИЈА НА ЕКЦИЗИЈА НА ПТЕРИГИУМ СО КОНЈУНКТИВАЛНА АВТОТРАНСПЛАНТАЦИЈА СО ГРАФТ ОД ГОРНА ИЛИ ДОЛНА ТЕМПОРАЛНА БУЛБАРНА КОНЈУНКТИВА

Весна Челева Марковска[1], Емилија Даштевска Ѓошева[1]

[1]Клиника за очни болести, Скопје, Македонија

***Цел**: Да се процени степенот на успешност на хируршките техники на екцизија на птеригиум со конјунктивална автотрансплантација за примарен птеригиум. Следниве две техники беа разгледувани: (1) Екцизија на птеригиум со конјунктивална автотрансплантација со графт од горната темпорална булбарна конјунктива (ГТБК) и (2) Екцизија на птеригиум со конјунктивална автотрансплантација со графт од долната темпорална булбарна конјунктива (ДТБК). **Материјал и метод:** 120 случаи со примарен птеригиум беа испитани. Резултатите беа разгледувани според повторното појавување на птеригиумот на роговицата. Пациентите беа поделени во 2 групи: (1) 60 очи беа оперирани со конјунктивална автотрансплантација со графт од горната темпорална булбарна конјунктива (30 случаи со птеригиум помал од 3мм и 30 случаи со птеригиум поголем или еднаков на 3мм). (2) 60 очи беа оперирани со конјунктивална автотрансплантација со графт од долната темпорална булбарна конјунктива (30 случаи со птеригиум помал од 3мм и 30 случаи со птеригиум поголем или еднаков на 3мм). **Резултати:** Средното време на постоперативното следење на пациентите беше 12 месеци (2 до 24 месеци). Кај 4 од 60 (6,67%) пациенти птеригиумот повторно се појави по конјунктивалната автотрансплантација со графт од горната темпорална булбарна конјунктива, и кај 3 од 60 (5%) пациенти птеригиумот повторно се појави по конјунктивалната автотрансплантација со графт од долната темпорална булбарна конјунктива. Само еден хирург ги изведе сите 120 операции. **Заклучок:** Екцизијата на птеригиумот со конјунктивална автотрансплантација со графт (од горна или долна булбарна конјунктива) е многу успешна хируршка метода со ниска стапка на повторно појавување на птеригиумот кај пациентите. Од двете хируршки техники со слични стапки на повторно појавување на птеригиумот кои беа разгледани во оваа компаративна студија, се дава предност на конјунктивалната автотрансплантација со графт од долната булбарна конјунктива бидејќи горната булбарна конјунктива е зачувана за идните можни хируршки интервенции на пациентот.*

***Клучни зборови**: птеригиум, надворешно перде, повторно појавување на птеригиум, примарен птеригиум, конјунктивална автотрансплантација*

PUNIM BURIMOR SHKENCOR / ORIGINAL SCIENTIFIC PAPER
HEMATOLOGJI

LABORATORY EVALUATION OF ANEMIA OF CHRONIC DISEASE (ACD), OUR EXPERIENCE

Alma Barbullushi[1], Etleva Refatllari[1], Anila Godo,[2] Irena Korita[1], Nevila Heta[1], Anila Beqja[1],Anila Simonaska[3], Palmira Daja[1], Anyla Bulo[1]

University Hospital Center "Mother Theresa", Tirana, Albania
[1]Laboratory Department
[2]Department of Pediatry
[3]"Intermedica" Laboratory



Alma Rucaj-Barbullushi
Master ne fushen e mjeksise laboratorike
Departamenti i Laboratoreve
Qendra Spitalore Universitare "Nene Tereza" Tirane
e-mail: **dael_dr@yahoo.com**

RESUME: ***Objectives****: Anemia of chronic disease (ACD) is a cytokinemediated anemia, most frequent anemia among hospitalized patients and characterized by hypoferremia with adequate reticuloendotelial iron stores, normal to elevated ferritin concentrations and it is a frequent complication of chronic inflammatory conditions.* ***Methods****: In our study were included 118 patients, 72 males and 46 females. Anemia was defined as hemoglobin below 12 g/dl in females and 13 g/dl in males. Anemic patients were further evaluated for the type of anemia with iron profile, peripheral blood smear, retikulocit count, prohepcidin and citokins (IL6, TNFα) levels. The laboratory measurements were performed in ABX, Olympus AU 640, and Immulite 1000. DRG ELISA kits were used for sTfR and prohepcidine determinations. Independent Sample Test, Anova test, Chi-Square Tests was used for statistical analysis.*
Results: *Anemia was observed in 57.6% anemic patients, 31.4% have ACD, 14.4.% IDA, 9.3% ACD+IDA, 2.5% talassemia minor and. Sideremia, ferritinemia, Tf, Tfs are significantly lower in IDA vs ACD vs IDA+ACD vs no anemic patients, (p=0,000, p=0,000, p=0.024,p=0.000), sTfR, sTfR/log ferritin, sTfR-F index is significantly higher in IDA vs IDA + ACD vs ACD vs no anemic patients, p=0,000. Hepcidin, IL6, TNFα are significantly higher in ACD vs IDA + ACD vsIDA vs no anemic patients(p=0,000, p=0.000, p=0.012).* ***Conclusions:*** *ACD is the most frequent anemia among hospitalized patients. Panel iron (especially ferritina) together with hepcidin and cytokins are the best indicator to find ACD. sTfR,sTfR/logferritin and TfR-F index are good indicators to distinguishes from IDA especially in mixed type ACD+IDA.*

Key words*: Anemia, sTfR,sTfR/logferritin, Hepcidin, Cytokines*

Medicus 2011, Vol. XV (1):

INTRODUCTION

Background: *The different studies in literature regarding the reliability of urine collected by bag technique show contradictory data. The study evaluates the reliability of sterile bag collection in a group of children who had their first episode of urinary tract infection 1 to 30 months of age.* ***Study design:*** *The research findings derived from multi-centre prospective randomised study. 407 patients performed 2 consecutive urinalysis and urine cultures. Urinalysis and urine culture follow-up were performed every month to the first 6 months; and then every other month. The urine was collected by sterile bag collection in all children.* ***Results:*** *First urine culture showed 385 E.Coli, only one urine culture changed from E.Coli to Proteus Mirabilis in the second urine culture. Were performed 2398 routine urinalysis and urine cultures, only one contamination was contracted; 79 patients (23%) had a positive urine culture during the follow-up, 53 (15,6%) of them were girls. 27 (1,1%) febrile urinary tract infection were excluded. 2252 (95%) urine cultures were negative; 34 (1,4%) contaminations; 57 (2,4%) asymptomatic bacteriuria; 28 (1,2%) lower urinary tract infection. E.Coli was most frequent micro-organism; it was found in 56 (50%) of all cases and in 77% of upper urinary tract infection.* ***Conclusions:*** *A small number of contaminations was contracted in our large study, so we believe that sterile bag collection is reliable.*

Key words: *Sterile bag urine, urine culture follow-up, febrile urinary tract infection*

PUNIM BURIMOR SHKENCOR / ORIGINAL SCIENTIFIC PAPER
GJINEKOLOGJI

EFIKASITETI DHE TOLERUESHMËRIA E ANTIINFLAMATORËVE JOSTEROIDË NË TRAJTIMIN E DISMENORESË PRIMARE

Diana Shahini[1]

[1]Departamenti i Obstetrikë Gjinekologjisë, Spitali Rajonal Durrës, Shqipëri



Diana Shahini, Mjeke Obsteter-Gjinekologe, Master
Lagja 4, Rr. Egnatia, Pall. Glemar, Durres, Shqipëri
Tel: +355 692160049 & +355 522 22366
e-mail: **dianashahini@yahoo.com**

REZYME: ***Qellimi*** *i ketij studimi eshte te krahasoje antiinflamatoret josteroide (AIJS) qe perdoren per trajtimin e dismenorese primare me* ***1****. placebon* ***2.*** *analgjeziket e tjere joopiod dhe* ***3.*** *me njeri tjetrin per te vleresuar efikasitetin dhe tolerueshmerine e tyre.* ***Kriteret perfshirese: 1.*** *gra ne moshen riprodhuese,* ***2.*** *gra me dismenore primare.* ***Kriteret perjashtuese: 1****. gra me dismenore nga patologji te njohura organike* ***2****. gra me cikle te crregullta menstruale. Ky studim eshte bere ne periudhen tetor - dhjetor 2004. Trajtimi vazhdoi per 3 cikle te njepasnjeshme. 120 paciente te perfshire ne kete studim u ndane ne 4 grupe:* ***1.*** *grupi i trajtuar me 400mg ibuprofen,* ***2****. grupi i trajtuar me 500mg naproxen* ***3****. grupi i trajtuar me paracetamol 150 mg dhe* ***4****. grupi i trajtuar me placebo. Çdo pacient u vleresua para dhe pas trajtimit per 3 muaj rresht.* ***Rezultatet****: Studimi i 4 grupeve te trajtimit rezultoi ne reduktim te dukshem te intesitetit te dhimbjes ne pacientet e trajtuar me AIJS dhe zhdukjen e simptomave autonomike si te vjella, te perziera. Keshtu para trajtimit 30% e pacienteve te trajtuar me ibuprofen kishin dhimbje te moderuara dhe 70% kishin dhimbje acute. Pas trajtimit dhimbja u zhduk ne 43.3% te pacienteve ne muajin e pare te trajtimit, ne 65.5% ne muajin e dyte dhe ne 80% ne muajin e trete te trajtimit. Vlera te peraferta te intesitetit te dhimbjes rezultuan dhe ne pacientet e trajtuar me naproxen, por ka ndryshime te rendesishme statistikore ne reduktimin e dhimbjes (p<0.05) krahasuar me paracetamolin dhe placebon.* ***Konkluzion:*** *AIJS kane efikasitet te larte dhe tolerushmeri ne trajtimin e dismenorese primare.*

Fjalë kyç: *Dismenore, simptoma autonomike, cikel menstrual infrekuent*

Medicus 2011, Vol. XV (1):

HYRJE

Dismenorea eshte nje nga problemet me te zakonshme gjinekologjike ne grate e moshave te reja.Termi dysmenorrhea rrjedh nga fjala greke dys-e dhimbshme, meno-mujore, rrhea-fluks, d.m.th. fluks menstrual i dhimbshem. Dismenorea prek 40-70% te grave qe menstruojne dhe 10% e ketyre

grave me dhimbje te forta behen te paafta per pune ne 1-3 dite te ciklit menstrual. Raportohet qe eshte 18 milion numuri i grave qe perjetojne menstruacione te dhimbshme ne US. Kjo situate ka nje impakt te rendesishem ne shendetin personal por gjithashtu dhe nje impakt global ekonomik. Vetem ne US vleresohet qe humbjet vjetore jane 600 milion ore pune dhe 2 bilion US dollar (DAWOOD).

Dismenorea klasifikohet ne dy kategori: Dismenorea primare ose esenciale dhe Dismenorea sekondare ose organike.

Dismenorea primare: Karakterizohet si dhimbje menstruale pa patologji organike. Ne pergjithesi fillon 1-2 vjet pas menarkave, me shfaqjen e cikleve ovulatore. Dhimbja mund te paraprije pak ore fluksin menstrual, te intesifikohet ne 24 oret e para e pastaj zvoglohet e zhduket brenda 72 oresh (10). Kjo dhimbje shoqerohet me nauze, te vjella. Kjo raportohet ne 92% ne adoleshence dhe incidenca bie me rritjen e moshes dhe paritetit. Prevalenca dhe severiteti i dismenorese primare ne grate qe kane lindur eshte ne menyre sinjifikative me i ulet se ne nuliparet.

Dismenorea sekondare eshte dhimbje qe shkaktohet nga faktore organike dhe shfaqet disa vite pas menarkave (11). Vihet re me shpesh ne grate e moshes 30-40 vjec. Ka shume faktore ne patogjenezen e dismenoreve sekondare si endometrioza, PID, kistet ovariale funksionale, adenomiozat, fibromat, etj.

Etiologjia e dismenoresë primare: Eshte identifikuar mbiprodhimi i prostaglandinave uterine (PG) si faktor thelbesor qe kontribuon ne krampe te dhimbshme. Gjate renies endometriale qelizat e disintegruara clirojne PGF2a, nderkohe qe mensturacioni fillon. Grate me dismenore primare paraqesin nivel me te larte te PGE2 dhe PGF2a ne plazem, ne endometrium ose ne gjakun menstrual sesa grate jodismenoreike (12). Pg sjellin modifikim te perqendrimit intracellular te AMP-ciklik (adenozinmonofosfatit ciklik) e te GMP-ciklike (guanozinmonofosfatit ciklik). Ne qelizat endometriale ato lehtesojne daljen e Ca+ + nga membrana qelizore, funksion ky i kundert me ate te progesteronit. Rritja e PG qe shoqeron renien e progesteronit karakterizohet nga rritja e kontraktilitetit uterin duke shkaktuar kontraksione disritmike me presion me te larte se presioni arterial sistemik, vazokonstriksion, zvogelim te fluksit hematik dhe per pasoje ishemi, acidoze lokale dhe lirimin e enzimave lizosomike. Keshtu stimulohen nocireceptoret (receptoret e dhimbjes, qe konsiderohen kryesisht kimioreceptore). Kjo gje realizohet nepermjet aktivizimit te AMP-ciklike. Nocireceptoret jane fije nervore amielinike qe origjinojne nje impuls nervor sa here qe stimulohen nga stimuj te tipit mekanik, termik ose kimik (25). Keto fibra nervore qe kalojne ne medulen spinale projektohen ne kompleksin ventro-bazal te talamusit e prej ketu ne korteks.
Dihet qe PG jane produkt i shtegut te ciklooxigjenazave (22). COX1 eshte enzima konstitucionale qe ndodhet ne te gjitha indet, pervec eritrociteve dhe pergjigjet per sintezen e prostaglandinave ne kuadrin e rolit fiziologjik te tyre lidhur me homeostazen fiziologjike. COX1 mbron integritetin e mukozes gastrike dhe luan rol integral, vazoaktiv ne sistemin renal dhe vaskular. COX2 shfaqet kur indet demtohen dhe eshte enzima primare qe mediaton inflamacionin. COX2 ka 60% homogjenitet me COX1. Te dyja kane te njejtin afinitet te konvertojne acidin arakidonik ne prostaglandina.

C'jane antiinflamatoret josteroide(AIJS)?

Jane medikamente qe inhibojne sintezen e prostaglandinave dhe lidhjen e tyre me receptoret specifike. Ato perdoren per trajtimin e situatave akute dhe kronike, ku dhimbja dhe inflamacioni jane presente. Potenca e AIJS gjendet ne mekanizmin central dhe periferik te frenimit te dhimbjes. **Mekanizmi i veprimit të AIJS:** Shumica e tyre veprojne si inhibitore jo selektive te COX-1 dhe COX-2 enzimave. Mekanizmi i veprimit u nxor ne drite nga John Vane i cili me vone morri çmimin Nobel per kete zbulim. COX-1 gjendet dhe ne stomak ku ketu prostaglandinat luajne rol mbrojtes duke ruajtur mukozen e stomakut nga erozioni i acidit klorhidrik te prodhuar prej tij. Kur COX-1 inhibitoret ulin nivelin e prostaglandinave ne stomak atehere efektet e tyre humbin, rritet aciditeti gastrik me gjithe pasojat e tij. Per te minimizuar efektet e padeshiruara te tyre perdoret doza me e ulet efektive dhe periudha kohore me e vogel e domosdoshme. AIJS klasifikohen duke u bazuar ne strukturen e tyre kimike. Ato ndahen ne disa grupe: 1. salicilatet, 2. derivatet e a.arylalkanoik, 3. profenet 4. a.fenamic, 5. Oxicamet, 6. coxibet. Perfaqesuesi i grupit te profeneve **Ibuprofeni** perdoret gjeresisht ne komunitet si agjent analgjezik me teper sesa antiinflamator. Ka incidencen me te ulur te efekteve anesore gastro-intestinale ne krahasim me NSAID-s e tjere joselektive. Efektet anesore me te zakonshme jane: ulcera gastro-intestinale, nauze, dyspepsia, retensioni i kripes dhe i ujit (6).

Acetaminofeni (**paracetamoli**) eshte nje analgjezik jo opioid i cili duke zoteruar aksionin inhibues te ciklooxigjenazes ndonjehere grupohet bashke me AIJS. Ai ka efekt te dobet inhibues te COX1 e COX2, gje qe e ben ate te mos jete antiiflamator. Simmons ne 2002 ka zbuluar relacionin e acetominofenit me izoenzimen e re COX3. Ai inhibon COX3 ne spinen dorsale e ne SNQ. Inhibimi i COX3 perfaqeson nje mekanizem central primar nepermjet te cilit paracetamoli ul intesitetin e dhimbjes. Nga studimet e bera ka rezultuar qe paracetamoli lehteson vetem dhimbjet e lehta viscerale. Ky inhibim selektiv i COX3 ne tru e ne spinen dorsale shpjegon efektin e paracetamolit ne uljen e temperatures e ne lehtesimin e dhimbjes pa patur efekte te padeshiruara gastrike (8).

QELLIMI

Qëllimi i ketij studimi eshte te krahasoje AIJS qe perdoren per trajtimin e dismenoreve primare 1. me placebon. 2. me analgjeziket e tjere jo opioide. 3. me njeri tjetrin per te vleresuar efikasitetin dhe tolerueshmerine e tyre.

Objektivat: Te percaktoje efikasitetin e AIJS ne trajtimin e dismenoreve primare. Ne duam te testojme keto hipoteza: **1**. Trajtimi me AIJS eshte me efektiv se placebo ne dismenorete primare. **2.** AIJS individual kane te njejtin efikasitet ne trajtimin e dismenoreve. **3**. Trajtimi me AIJS eshte me efektiv se analgjeziket e tjere jo opioide ne dismenore primare. **Objektivat specifike**: Te tregohet efikasiteti dhe tolerueshmeria e Ibuprofen 400mg tab ne krahasim me Nnaprxen 500mg tab, Paracetamol 500mg tab dhe placebo ne fund te çdo muaji per: **1**. vleresimin e lehtesimit te dhimbjes **2**. efektet anesore te preparatit **3**. kerkesa per medikamente shtese **4**. vleresimin e statusit funksional te pacientit **5.** mungesat ne pune a ne shkolle.

MATERIALI DHE METODA

Ne studim u perfshine 120 paciente, mosha 14-30 vjec. **Kriteret përfshirëse**: **1**. gra ne moshen riprodhuese **2**. gra me dismenore primare. Per diagnozen e dismenorese primare u bazuam ne anamnezen e pacienteve, me histori tipike te spasmave te herepashershme te perqendruara ne arean supra pubike, dhimbje qe iradiohet ne shpine e ne kembe si dhe simptoma sistemike me nauze, cefale, diare, te vjella. Te gjitha pacienteve iu aplikua examinim echografik, kulture cervikale, analize gjaku, eritrosedimenti, analize urine si dhe ekzaminim fizik. Qellimi i ekzaminimit eshte qe te perjashtohen shkaqet organike te dismenorese. **Kriteret përjashtuese**: **1**. Paciente me dismenore sekondare me patollogji te identifikuar. **2**. gra me cikle menstruale jofrekuente. U perjashtuan gjithashtu nga studimi pacientet me asem bronkiale, me ulcer aktive, me alergji nga AIJS si dhe ato te trajtuar me antikoagulante.

Studimi u krye ne nje periudhe kohore tre mujore, tetor-dhjetor 2004. Trajtimi u dha per tre cikle konsekutive me qellim qe te dalloje me mire efektivitetin e AIJS ne krahasim me placebon. Eshte nje studim i randomizuar, double-blind, aktiv, i kontrolluar. Randomizimi u krye ne menyre sekuenciale me blloqe me nga 10 paciente deri ne plotesimin e 120 pacienteve te cilet u ndane ne 4 grupe: 1. grupi i trajtuar me ibuprofen 400mg cdo 6 ore 2. grupi itrajtuar me naproxen sodium 500 mg tab cdo 12 ore 3. grupi i trajtuar me paracetamol 500mg cdo 6 ore 4. grupi i trajtuar me placebo.

Pacienteve iu dhane dozat fillestare te preparateve sipas grupeve dhe secili pacient u vleresua para se te perdorte mjekimin dhe mbas cdo cikli menstrual per 3 muaj rresht.

Vleresimi i dhimbjes: Edhe pse dhimbja eshte nje sensacion subjektiv, per te percaktuar intesitetin e saj perdoren metoda konkrete praktike. Keshtu intesiteti i dhimbjes u vleresua nepermjet V.A.S (visual analogue scale) qe jane shkalle kategorike te vleresimit te intesitetit te dhimbjes me vlera nga 0 (pa dhimbje), 1 pike (dhimbje e lehte), 2 pike (e moderuar), 3 pike (e forte) dhe 4 pike (dhimbje te padurushme). Keshtu nepermjet nje ditari pacientja referon intesitetin e dhimbjes, shpejtesine e veprimit te preparatit, kerkesen per dozen shtese, efektet anesore te medikamenteve etj. **Efektet anesore** vleresohen si te dhena dikotomike si paciente qe kane ose jo efekte anesore nga terapia e perdorur. **Kerkesat per mediamente shtese** vleresohen si raport i grave qe kane nevoje per medikamente shtese per lehtesimin e dhimbjes menstruale ose jo. **Statusi funksional** vleresohet si raport i pacienteve qe kane ose jo kufizim te aktivitetit ditor para dhe pas trajtimit. **Mungesat ne pune a ne shkolle** percaktohet si raport i pacienteve qe kane bere mungesa dhe atyre qe nuk kane bere para dhe pas trajtimit.

Per analizen e te dhenave u perdoren programet EXCEL, SPSS, 9. 0.

REZULTATET

Popullata e marre ne studim perfshin moshen nga 14-30vjec**.** Grupi i trajtuar me **Ibuprofen:** mosha mesatare 17(SD ± 2.9), **Naproxen**18.2 (SD ± 4.1)**, Paracetamol**: 17.1 (SD ± 2.4) dhe **Placebo:** 17.9 (SD ± 3.3)**.** Nuk u vune re diferenca te theksuara ne moshe midis grupeve te marra ne studim. Mosha mesatare e menarkave te pacienteve te marra ne studim eshte 12.5 (SD ±1.3) vite. Zgjatja mesatare e periudhes se menstruacioneve eshte 6.6 (SD ± 1.4) dite.


Tabela 1.

Vleresimi i dhimbjes para trajtimit me medikamente

Nr	**Preparati**	**Vlers.dhimbjes para trajt.**	
		e moderuar	***e forte***
1	ibuprofen	9 (30%)	21 (70%)
2	naproxen	8 (26.6%)	22 (73.4%)
3	paracetamol	11 (36.6%)	19 (63.4%)
4	placebo	10(33.3%)	20 (66.7%0

Grafikoni 1.

Vlersimi i dhimbjes para trajtimit



Siç shihet jane marre ne konsiderate pacientet me dhimbje te moderuar dhe te forte, ndersa ato me dhimbje te lehte jane perjashtuar nga studimi.

Tabela 2.

Vleresimi i dhimbjes pas nje muaji trajtimi

Nr	Preparati					
		mungon	dh.lehte	dh.moder.	dh. Forte	sinjifikanca
1	ibuprofen	13(43.3%)	6(20%)	10(36.7%)		reference
2	naproxen	11(36.6%)	7(23.3%)	12(40%)		P=0.079(NS)
3	paracetamol	4(13.3%)	8(26.6%)	18(60%)		P=0.034(S)
4	placebo	5(16.7%)	4(13.3%)	21(70%)		P=0.013(S)

Ne grupin e trajtuar me ibuprofen raportohet nje pacient i humbur ne follow-up. Pas muajit te pare te trajtimit asnje nga pacientet nuk paraqet dhimbje te forte. Ne grupin e trajtuar me ibuprofen dhe naproxen ne rreth 40% te pacienteve dhimbja mungon. Verehen ndryshime te rendesishme statistikore ne lehtesimin e dhimbjes midis ibuprofenit, placebos dhe paracetamolit ($p<0.05$). Nuk shihet diference e rendesishme midis ibuprofenit dhe naproxenit.

Grafikoni 2.

Vlersimi i dhimbjes ne fund te muajit te pare




Tabela 3.

Vleresimi i dhimbjes pas 2 muaji trajtimi

Nr	Preparati					
		mungon	dh.lehte	dh.moder.	dh. Forte	sinjifikanca
1	ibuprofen	19(65.5%)	6(20.7%)	4(13.8%)		reference
2	naproxen	17(56.7%)	7(23.3%)	6(20%)		P=0.063(NS)
3	paracetamol	5(20.7%)	10(33.3%)	15(50%)		P=0.041(S)
4	placebo	3(20%)	4(13.3%)	13(43.3%)	9(30%)	P=0.009(S)

Ne grupin e trajtuar me placebo nje paciente shkeputet nga studimi ne muajin e dyte e trete per aresye personale. Ne muajin e dyte te trajtimit shihet qe shtohet % e pacienteve ne te cilat dhimbja mungon ne grupin e trajtuar me AIJS dhe ne 30% te pacienteve te trajtuar me placebo rishfaqet dhimbja e forte. Ky fakt demostrohet dhe ne grafiket perkates.

Grafikoni 3.

Vlersimi i dhimbjes pas muajit te dyte




Tabela 4.

Vleresimi i dhimbjes pas 3 muaji trajtimi

Nr	Preparati					
		mungon	dh.lehte	dh.moder.	dh. Forte	Sinjifikanca
1	ibuprofen	24(80%)	4(13.7%)	1(3.45%)		reference
2	naproxen	23(76.6%)	5(17.24%)	2(6.67%)		P=0.085(NS)
3	paracetamol	2(10%)	5(16.67%)	18(60%)	5(16.67%)	P=0.027(S)
4	placebo	1(3.33%)	3(16.6%)	6(20%)	19(70%)	P=0.012(S)

Nga te dhenat e mesiperme verejme se rritet akoma me shume % e pacienteve ne te cilat dhimbja mungon ne grupin e trajtuar me ibuprofen dhe naproxen, nderkohe qe ne grupin e trajtuar me paracetamol rishfaqet numri i pacienteve me dhimbje te forte. Ndersa ne grupin e trajtuar me placebo % e pacienteve me dhimbje te forte arrin ne vlerat e perftuara para trajtimit. Keshtu konfirmohet efektiviteti superior i ibuprofenit dhe naproxenit ne krahasim me placebon, ndersa paracetamoli rezulton pak me efektiv se placebo per reduktimin e dhimjeve menstruale.

Grafikoni 4.

Vlersimi i dhimbjes ne fund te muajit te trete




Tabela 5.

Mungesat ne pune dhe ne shkolle

nr	Preparati	Mungesat ne pune		
		para trajt.	pas trajt.	
1	ibuprofen	5 paciente	0	reference
2	naproxen	3 paciente	0	p>0.05
3	paracetamol	4 paciente	4 paciente	p<0.05
4	placebo	4paciente	4 paciente	p<0.05

Nga 5 paciente qe kishin mungesa ne pune para trajtimit me ibuprofen asnje rast nuk u raportua pas trajtimit. Verehet nje ndryshim i rendesishem statistikor (p<0.05) ne krahasim me paracetamolin dhe me placebon ku numri i pacienteve qe abstinonin aktivitetet sociale mbeti i njejte para dhe pas trajtimit.

Grafikoni 5.

Mungesat ne pune para dhe pas mjekimit




Tabela 6.

Vleresimi i statusit funksional te pacienteve

nr	Preparati					
		Statusi para trajtimit		Statusi pas trajtimit		
		jo kufizim	kufizim	jo kufizim	kufizim	
1	ibuprofen	23pac	7pac	29pac	0	reference
2	naproxen	27pac	3pac	30pac	0	P=0.086(NS)
3	paracetamol	25pac	5pac	24pac	6pac	P=0.031(S)
4	placebo	26 pac	4pac	25pac	4pac	P=0.02(S)

Ndersa para trajtimit 24% e pacienteve te grupit te ibuprofenit paraqesin kufizim te aktivitetit ditor pas trajtimit 100% e pacienteve nuk kane kufizim te statusit te tyre funksional. Gjithashtu pas trajtimit me naproksen 100% e pacienteve gezojne status funksional te plote, nderkohe qe ne grupin e trajtuar me paracetamol e placebo statusi funksional mbetet pothuajse i njejte para dhe pas trajtimit. Grafikoni 6.

Paraqitja e statusit funksional te pacienteve
para dhe pas trajtimi me medikamente




Tabela 7.

Numri i pacienteve qe iu nevojiten preparate shtese per lehtesimin e dhimbjes

Nr	Preparati	Preparatet shtese
1	ibuprofen	0
2	naproxen	1pacient(aulin) p=0.12(NS)

3	paracetamol	10paciente(aulin,eudorlin) p=0.041(S)
4	placebo	15paciente(analgine,auline)p=0.014(S)

U vu re se asnje nga pacientet e trajtuara me ibuprofen nuk paten nevoje per preparate shtese dhe vetem një paciente e trajtuar me naproxen kishte nevoje per medikament shtese per lehtesimin e dhimbjes menstruale. Ndersa nje numer i madh i pacienteve te trajtuara me paracetamol dhe placebo kishin nevoje per preparate shtese.

Grafikoni 7.

Medikamente shtese te perdorura nga subjekte e marra ne studim




Tabela 8.


Numri i pacienteve me efekte anesore

Preparati	Efektet anesore
ibuprofen	1 pacient me pyrosis ne dozen 2.0gr
naproxen	1pacient me hypomenore+1 me nauze
paracetamol	jo fenomene anesore
placebo	1pacient me cefale+1me diare

Nuk u vu re ndryshim i rendesishem statistikor (p>0.05) midis efekteve anesore te preparateve.


Grafikoni 8.

Efektet ansore te medikamenteve



Grafikoni 9.

Paraqitja grafike e % se pacienteve qe paraqesin lehtesim te dhimbjeve sipas muajve



DISKUTIM

Perdorimi i nje droge qe inhibon sintezen e prostaglandinave duhet te jete nje zgjedhje llogjike,derisa shumica e simptomave shpjegohet nga rritja e nivelit te tyre gjate diteve te para te menstruacionit. Per shkak te efikasitetit dhe tolerueshmerise se mire ibuprofeni eshte nje nga preparatet gjeresisht te perdorura te antiinflamatoreve josteroide. Ne studimin e bere verehet nje reduktim i dukshem i intesitetit te dhimbjes ne pacientet e trajtuar me AIJS si dhe zhdukje e simptomave autonomike si nauze te vjella, diare. Keshtu ndersa para trajtimit ne grupin e trajtuar me ibuprofen 30% te pacienteve paraqesin dhimbje te moderuar dhe 70% dhimbje te forte, ne muajin e pare dhimbja mungon ne 43.3% te pacienteve, ne muajin e dyte mungon ne 65.5% te pacienteve e ne muajin e trete ne 80% te pacienteve. Vlera te peraferta te intesitetit te dhimbjes rezultojne edhe per pacientet e trajtuar me naproxen. Edhe pse naproxeni ka ½ jete plazmatike me te gjate se brufeni nuk jane gjetur ndryshime te rendesishme statistikore mes tyre ne reduktimin e dhimbjes. Ndersa vihen re ndryshime te rendesishme satistikore ne reduktimin e dhimbjes ($p<0.05$) ne krahasim me paracetamolin dhe placebon. Keshtu acetominofeni eshte me pak efektiv se AIJS per trajtimin e dismenoreve por ka me pak potencial te demshem ne traktin gastro-intesinal (gje qe lidhet me mekanizmin e tij te frenimin te COX-3 dhe veprim te dobet mbi COX-1). Ne kete studim verehet qe numri i pacienteve me reduktim te dhimbjes vjen duke u ulur ne cdo muaj ne pacientet e trajtuar me antiinflamatore josteroide. Per te shpjeguar keto rezultate duhet marre ne konsiderate influenca psikologjike ne dhimbje. Ne sistemin neurologjik integrohen influencat psikologjike e sociale, individuale te bazuara ne subjektivitetin e dhimbjes. Ky fakt shpjegon dhe reduktimin e dhimbjes ne muajin e pare ne rreth 30% te pacienteve te trajtuar me placebo. Studimet e shumta kane treguar qe njohurite e pacienteve per manaxhimin e dhimbjes jane ne nje relacion invers me intesitetin e saj (22). Ne kete studim edhe pse i tipit double-blind pacientet ishin participante aktive, gje qe pjeserisht mund te shpjegoje reduktim e dhimbjes ndersa studimi progesonte.

Efikasiteti i ibuprofenit dhe naproxenit ne trajtimin e pacienteve me dismenore reflektohet pozitivisht dhe ne aktivitetin ditor te pacienteve. Abstenizmi nga puna ose aktiviteti studentor reduktohet ne menyre sinjifikative gjate kursit te studimit duke konfirmuar keshtu rezultatet e studimeve te meparshme (23). Nje fakt tjeter pozitiv qe konfirmon efikasitetin e AIJS ne krahasim me placebon eshte dhe permiresimi i statusit funksional te pacientit. Ndersa para trajtimit 24% te pacienteve ne grupin e trajtuar me NSAID-s paraqesin kufizim te statusit funksional, pas trajtimit 100% e pacienteve nuk jane te kufizuar ne aktivitet e tyre ditore. Efikasiteti i AIJS shfaqet dhe ne nevojat e pacienteve te perfshire ne studim per preparate shtese. Keshtu ne grupin e trajtuar me ibuprofen asnje nga pacientet nuk ka nevoje per marjen e preparateve shtese per lehtesimin e dhimbjes, ndersa ne grupin e trajtuar me paracetamol e placebo pothuajse ½ se pacienteve iu nevojiten preparate shtese analgjezike.

Tolerueshmëria e preparatit. Ne studimin e bere verehet nje tolerushmeri e dukshme e preparateve antiinflamatoreve jo steroide. Ne grupin e trajtuar me ibuprofen vetem nje pacient paraqet pyrosis dhe kjo ne dozen 2.0 gr te preparatit (vlen te theksohet qe shumica e pacienteve te trajtuara shfaqen permiresim qe ne tableten e trete te preparatit pra ne dozen 1.2gr). 28 pacientet e tjere nuk paraqiten asnje efekt anesor. Ne grupin e trajtuar me naproxen nje paciente paraqet hipomenore dhe nje me cefale. Keshtu u vune re ndryshime jo te e rendesishme statistikore ($p>0.05$) ne efektet anesore krahasuar me paracetamolin dhe placebon.

Ky fakt eshte ne perputhje me metaanalizen e studimeve klinike qe raportojne qe incidenca e efekteve anesore ne trajtimin me ibuprofen eshte e ngjashme me ate te placebos. Kjo frekuence shihet te jete me e ulet se ajo e raportuar ne trajtimin me AIJS te tjere ne studimet krahasuse. Me shume se 90% e pacienteve nuk kishin nevoje per me shume se 3 dite mjekim dhe doza e perdorur ishte rreth 1.2gr. Incidenca e ulceres peptike nuk u vu re ne asnje pacient.

Nga studimet e bera nga autore te ndryshem qe krahasojne rrezikun e ulceres peptike hemoragjike ne perdorimin e NSAID-s ka rezultuar qe ibuprofeni ka OR me te ulet ne krahasim me indometacinen, diklofenacun, piroxicamin qe te shkaktoje ulcer hemoragjike (1).

Nje studim i Dawood & CO_2 qe krahason efikasitetin e ibuprofenit, naproksenit, acetominofenit e placebos ku u trajtuan 443 paciente rezultoi se naprokseni siguronte nje lehtesim me te madh te dhimbjeve te barkut ne krahasim me acetominofenin e placebon brenda 30 min nga administrimi ($p<0.01$,$p<0.05$ respektivisht) dhe kishte efekt te njejte me ibuprofenin. Nuk u raportuan

efekte anesore serioze. Sipas Cryer B Feldman (5) është evidentuar qe ulcera e shoqeruar me dhimbje ose hemoragji shfaqet vetem ne 1-3% te pacienteve qe perdorin antiinflamatore josteroide per 3-6 muaj radhe e ne 2-4 % ne ato qe perdorin per 1 vit. Pacientet qe nuk kane faktore risku per ulcer, nuk kane te dhena per ulcer te shkaktuar nga NSAID-s. Gjithsesi ky efekt anesor mund te parandalohet nga kombinimi me antagonistet e H-2. Studime te koheve te fundit kane treguar rolin e oksidit nitric (NO) ne mbrojtje te mukozes gastrike, efekt ky i ngjashem me prostaglandinat. Ai sintetizohet nga L-arginina nga nje calcium-dependent NO-sintetaze. NO dhe drogat qe permbajne NO kane treguar qe reduktojne demtimin e mukozes gastrike (15). Shoqerimi i ibuprofenit me arginine, ibuprofen-arginina rrit absorbimin e ibuprofenit duke rezultuar ne nje perqendrim me te shpejte e me te larte ne plazem ne krahasim me ibuprofenin vetem (16). AIJS qe permbajne NO jane ne studim e siper.

KONKLUZION

Rezultatet e ketij studimi treguan se AIJS (ibuprofen 400mg dhe naproxen 500mg) kane:

1. Efikasitet me te larte per trajtimin e dismenoreve ne krahasim me analgjeziket jo opioide (paracetamolin);

2.Efikasitet superior ne krahasim me placebo;

3.Efikasitet te njejte me njeri tjetrin dhe

4.Ne dozen dhe ne peridhen minimale te perdorur ato kane tolerueshmeri te mire dhe mbeten linja e pare e terapise per trajtimin e dismenoreve primare

BIBLIOGRAFI

1. Marchini M,Tozzi L,Bakshi R,et al.Comparative efficacy of diclofenac and ibuprofen in patients with dysmenorrhoea.Int J Clin Pharmacol Ther 2000 .
2. Dawood MY:Ibuprofen and dysmenorrhoea.Am J Med.Jul 13,2001. Nonsteroidal anti-inflammatory drugs and changing attitudes toward dysmenorrhoea;Am J Med May 20 1999.
3. Zhang WY,Li WAN PO:Efficacy of minor analgesics in primary dysmenorrhoea:a systematic review.British journal of Obstetric and Gyneacology,1998 Jul.
4. Stephen E.Daniels,Do of SCIREX.Clinical Research Center in San Marco Texas.Journal Obstetric and Gyneacology,Texas 2003.
5. Cryer B Feldman:Effects of NSAID-s on gastro-intestinal prostaglandins.Arch Intern Med 1999.
6. RossiS(Ed) (2004).Australian Medicines Handbook 2004.
7. Castell JV,Gomez MJ,Miranda MA,Morera IM(1999).Photolytic degradation of ibuprofen
8. Chandrasekharan NV,Dai H,Roos KL,Evanson NK,Tomsik J,Elton TS,Simmons DL.COX-3,a cyclooxygenase-1 variant inhibited by acetaminophen and other analgesic-antipyretic drugs.Proc Natl Acad Sci USA 2002.
9. Green GA.Understanding NSAID-s;from aspirin to COX-2.Clin Cornerstone 2002.
10. .Marjoribanks J,Proctor ML,Farquar C.Nonsteroidal antiinflamatory drugs for primary dysmenorrhea(the Cochcrane database of sistematic reviews) 2003,issue 4.
11. Andrew S.COCO,M.D.Primary dysmenorrheal-august 1999-american academy of family Physicians.
12. Eden JA:Dysmenorrhoea and premenstrual syndrome.In:NF Hacker,JG Moore.Philadelphia;WB Saunders 1998.
13. Barbieri RL,Propst AM;physical examination finding in women with endometriosis.J Gynecol Tech 1999.
14. Morrison BW,Daniels SE,Kotey ,et al:rofecoxib,a specific cyclooxygenaze-2 inhibitor.Obstet gynecol 1999.
15. Martin CaleroMJ,JimenezMD,Alcaron de la LastraC,et al.Protective effect of L-arginine against ibuprofen induced gastric injury rats.Pharm sci 1997.
16. Ceppi MontiG,GazzanigaA,Gianisello V,et al.Activity and pharmacokinetics of a new oral form of soluble ibuprofen.Arrzneimittelforschung 1999.
17. Sandrini G ,Franchini S,Lanfranchini S,et al.Effectivenes of ibuprofen-arginina in the treatment of acute migraine attacks.Int j Clin Pharmacol res 1998.
18. Wallace JL.Nonsteroidal antiinflamatory drug derivatives with markedly reduced ulcerogenic properties.Gastroenterelogji 1999.
19. Henry D,Lim LLy,Garcia LA,et al.Variability in risk of gastrointestinal complications with individual antiinflammatory drugs,result of a collaborative meta analysis.BMJ 2000.

20. Taha AS,Dahills,Morran C.Neutrophils,helicobacter pylory and NSAID-s Ulcers.Gastroenterology 1999.
21. Black P,Max MB,Desjardins P,et al.A randomized,double blind,placebo controlled comparison of analgesic efficacy,onset of action and tolerability of ibuprofen-arginate and ibuprofen in pain. Clin Ther 2002.
22. De Wit R,Van Dam F,Zandbelt L,et al.A pain education program for cancer patients:follow up results from a randomized controlled trial.Pain 1997.
23. Jamieson DJ,Steege JF.The prevalence of dysmenorrhoea,dyspareunia,pelvic pain and irritable bowel syndrome in primary care practice.Obstet Gynecol 1999.
24. Camil Castelo-Branc;Gemma Casals;Javier Haya;Maria Jesus Cancelo;Jose Manasank. Efficacy and safety of ibuprofen arginine in the treatment of primary dysmenorrhoea.Clin Drug Invest 2004
25. Busacca M;Marconi D;Venturini P;Zullo F;Zupi E:Dolore pelvico.Endometriosi.Universita di Milano 2002.
26. Harel Z,Riggs S,Vas R;The use of the leukotriene receptor antagonist montelukast(singulair) in the management of primary dysmenorrhea.Pediatric Adolescent Gynecology 2004 Jun.

SUMMARY

EFFICACY AND TOLERABILITY OF NONSTEROID ANTIINFLAMATORY- DRUGS IN THE TREATMENT OF PRIMARY DISMENORRHEA

Diana Shahini[1]
[1]Department of Obstetric Gyneacology,1Regional Hospital of Durres, Albania

Aim *of this study is: To compare NSAID-s drugs that are used for the treatment of primary dismenorhea with:* ***1****. placebo,* ***2****. the other non opioid analgesic* ***3****. each others, to evaluate their efficacy and tolerability.* ***Methods****: In this study are included 120 patients of age 14-30 year.* ***Included criterions****:* ***1****.women in reproductive age,* ***2****. women with primary dismenorhea .****Excluded criterions****:* ***1****. women with secondary dismenorhea of known pathology.* ***2****. women with infrequent cycle. This study is done in the period October-December 2004. The treatment continued for three consecutive cycle. 120 patients included in this study were divided in 4 group:* ***1****. group treated with 400mg ibuprofen,* ***2****. group treated with naproxen 500mg,* ***3****. group treated with paracetamol 150 mg.* ***4****. group treated with placebo. Every patient was evaluated before and after treatment for three consecutive month. The age of the patients was 14-30 year.* ***Results****: The study of 4 groups of treatment (ibuprofen, naproxen, paracetamol, placebo) results an evident reductions of intensity of pain in the patients treated with NSAID-s and dysapparance of autonomic symptoms such as nousea, vomiting. So before treatment 30% of the patients treated with ibuprofen had moderated pain and 70% had acute pain. After treatment pain missed in 43.3% in first month, 65.5% in second month and 80% in third month. Approximated value of pain intensity results in the patients treated with naproxen, but there is important statistical change in reduction of pain ($p<0.05$) compared with paracetamol and placebo****. Conclusion:*** *NSAID-s have high efficacy and tolerability in treatment of primary dismenorhea.*

Key words: *Dismenorhea, autonomic symptoms, infrequent cycle*

PUNIM BURIMOR SHKENCOR / ORIGINAL SCIENTIFIC PAPER
TRANSFUZIOLOGJI

SHPËRNDARJA E GRUPEVE TË GJAKUT ABO/RHD NË PACIENTËT ME KANCER TË TRAKTIT GASTROINTESTINAL

Vjollca Duro[1], Shpëtim Qyra[2], Andi Koraqi[3], Pëllumb Pipero[4]

[1]Drejtoria e Planifikimit Spitalor, Ministria e Shendetesise,Tiranë, Shqipëri
[2]Istituti i Shëndetit Publik, Tiranë, Shqipëri
[3]Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Laboratoreve, Tiranë, Shqipëri
[4]Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Shëndetësore, Ministria e Shëndetësisë, Tiranë, Shqipëri



Vjollca Durro, PhD MD
Rr. Bulevardi "Bajram Curri", No. 1, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 68 40 32328
e-mail: vdurro@moh.gov.al & dvjollca@yahoo.com

REZYME: Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të investigojmë shoqërimin e grupeve të gjakut ABO me sëmundjet malinje të traktit gastrointestinal. **Materiali dhe metoda:** Shpërndarja e grupeve të gjakut ABO/RhD është analizuar në 236 pacientë me sëmundje malinje të traktit gastrointestinal. Pacientët janë diagnostikuar dhe trajtuar. **Rezultatet.** Rezultate e marra në këtë studim tregojnë që: (a) kanceri i stomakut është më i shpeshtë te meshkujt se femrat; (b) kancerit i stomakut është më shpeshtë se kanceri i kolonit; (c) grupi i gjakut A është në përqindje më të lartë në pacientë me kancer të stomakt, ndërsa grupi O në pacientet me kancer të kolonit. **Konkluzion:** Pacientë me grup gjaku A janë më rrizikuar për kancer të traktit gastrointestinal dhe sidomos kancer të stomakut.

Fjalë kyç: Grupi i gjakut ABO, faktori Rh, trakti gastrointestinal

Medicus 2011, Vol. XV (1):

HYRJE

Qe në vitet 1953 Arid dhe Bentall zbuluan se kanceri i stomakut hasej me shpesh ne pacientet me grup gjaku A (1). Edhe në studimet e mëvonshme është vene re mundesia e lidhjes së disa sëmundjeve me grupet ABO të gjakut. Kështu është vënë re një frekuencë më e lartë e disa lloj karcinomave në individët me grup gjaku A dhe B krahasuar me ata me grup O (2, 3, 4).

Izoaantigjenët e grupeve të gjakut ABO janë në vetevete glukoproteina dhe glikoproteina të ndryshme, specifiteti antigenik i të cilëve përcaktohet nga ndryshimet qe pësojnë përbëresit e tyre në zinxhirët e karboidrateve (5, 6, 7). Këto determinatë gjenden në sipërfaqe të eritrociteve, qelizat endoteliale, në shume qeliza epiteliale normale dhe kryejnë funksione të ndryshme në fiziologjinë e qelizës si: luajnë rol në përcaktimin e integritetit struktural të membranës, adezionit qelizor dhe transferimin e informacionit midis qelizave. Shumica e kancereve te njeriu e kanë origjinën nga qelizat epiteliale kështu që ndryshimet në antigenët e grupeve të gjakut luajnë një rol të rëndësishëm

në shfaqjen e tumoreve humane (8, 9, 10). Ne disa tumore alterimet e antigeneve të sistemit ABO/Lewis është shoqëruar me transformime malinje. Shfaqja e sistemit të antigenëvë ABH ndryshon në mënyrë drastike gjatë zhvillimit normal të qelizave dhe gjatë diferencimit neoplazik të qelizave (10, 11).

QËLLIMI

Qëllimi i këtij studimi është lidhja midis kancereve të traktit gastrointestinal dhe sistemit ABO/RhD të grupeve të gjakut në popullsinë e shqipërisë. Të dhënat tona në këtë studim i kemi krahasuar me të dhënat e autorëve të ndryshëm për të parë mundësinë e influencës së faktorëve të ndryshëm si etnik, gjeografik apo gjenetik ne keto shoqërime. Për të investiguar lidhjen e kancerit me grupin e ABO të gjakut ne ndërmorrëm një studim retrospektiv të shoqërimit të sëmundjeve malinje të traktit gastrointestinal me grupet ABO/RhD të gjakut. Këta pacientë janë diagnostikuar dhe trajtuar në Shërbimin e Kirurgjisë së Përgjithsme në QSU " Nënë Tereza" në Tiranë.

MATERIALI DHE METODA

Popullsia e marrë në studim

Në këtë studim janë përfshirë 236 pacientë me sëmundje malinje të traktit gastrointestinal të diagnostikuar dhe trajtuar në Klinikën e Kirurgjisë së Përgjithshme në Spitalin Universitar "Nënë Tereza" në Tiranë.

Frekuenca e grupeve të gjakut te pacientëve është krahasur me frekuencën e grupeve të gjakut në popullatë të shëndoshë ku si popullatë e shëndoshë janë zgjedhur 826 dhurues gjaku.

Mbledhja e të dhënave

Për mbledhjen e të dhënave u shfrytëzuan kartelat personale të pacientëve të arkivuar në statistikën e QSUT-së dhe të dhuruesve të gjakut të arkivuar në bankën e gjakut.

Për përcaktimin e grupit të gjakut është përdorur gjaku venoz. Gjaku është mbledhur në tuba pa antikoagulant, në sasinë 10ml. Mostrat janë testuar në bankën e gjakut pranë QSU " *Nënë Tereza* ".

Për kryerjen e grupit të gjakut është përdorur metoda standarte në tuba në mënyrën direkte dhe indirekte. Mënyra direkte konsiston në identifikim e antigjeneve eritrocitare kur njohim antitrupat respektive. Mënyra indirekte konsiston në përcaktimin e antitrupave në serum kur njihen antigjenet eritrocitare.

Reagentet e përdorur për përcaktimin e grupeve të gjakut (anti-A, anti-B, anti-AB, RhD1 dhe RhD2) dhe eritrocitet standarte.

REZULTATET

Totali i pacientëve të diagnostikuar dhe trajtuar për sëmundje malinje të traktit gastrointestinal të përfshirë në këtë studim është 236 paciente. Prej tyre 126 (53.4%) janë me kancer të stomakut dhe 110 (46.4%) pacientë janë me kancer të kolonit.

Në tabelën 1 paraqiten shpërndarja e pacientëve dhe popullatës të shëndoshë sipas gjinisë. Midis pacientëve 138 (58.5%) janë meshkuj dhe 98 (41.5%) femra. Ndersa në popullatën e shëndoshë vëmë re se 460 (55.7%) janë meshkuj dhe 366 (44.3%) femra.

Tabela 1.

Shpërndarj e pacienteve dhe popullatës së shëndoshë sipas gjinisë

Gjinia	Meshkuj		Femra		Totali	
	No	%	No	%	No	%
Nr. i rasteve me ca stomaku	70	55.5	56	44.5	126	53.4
Nr i rasteve me ca koloni	68	61.8	42	38.2	100	46.4
Nr total i pacienteve	138	58.5	98	41.5	236	
Popullate e shendoshe	460	55.7	366	44.3	826	

Në tabelën 2 paraqiten pacintët me sëmundje malinje te traktit gastrointestinale dhe popullata e shëndoshë të ndarë sipas grup-moshave, ku 15 (6.4%) i përkasin grup-moshës 18-30 vjeç, 138 (58.5%) grup-moshës 30-50 vjeç dhe 93 (35.1%) grup-moshës mbi 50 vjeç.

Tabela2

Shpërndarja e pacientëve dhe popullatës së shëndoshë sipas grup-moshës

Gjinia	18-30 vjeç No (%)	30-50 vjeç No (%)	Mbi 50 vjeç No (%)	Total
Nr. i rasteve me ca stomaku	9 (7)	77 (61.2)	40(31.7)	126
Nr i rasteve me ca koloni	6(5.5)	61 (55.5)	43(39)	110
Nr total i pacienteve	15 (6.4)	138(58.5)	83 (35.1)	236
Popullate e shendoshe	124(15)	569(69)	133(16)	826

Tabela 3.

Shpërndarja e grupeve të gjakut ABO në pacientë dhe popullaten e shëndoshë

Paciente	Grupet e gjakut					
	O (%)	A(%)	B(%)	AB(%)	RhDneg(%)	RhDpoz(%)
Ca stomaku	33(26.2)	56(44.4)	31(24.6)	6(4.8)	16 (12.7)	110 (87.3)
Ca koloni	47(42.7)	42(38.2)	12(10.9)	9(8.2)	17 (15.5)	93 (84.5)
Totali i pacientëve	80(33.89)	98(41.5)	43(18.2)	15(6.35)	33 (13.9)	203 (86.1)
Popullsi e shëndoshë	311(37.3)	262(31.3)	174(20.8)	89(10.6)	45(5.4)	781(94.6)

Tabela 4.

Shpërndarja e grupeve të gjakut ABO/RhD në pacientë dhe popullaten e shëndoshë sipas gjinisë

Grupi i gjakut	Ca stomaku		Ca koloni		Popullatë e shëndoshë	
	Meshkuj (%)	Femra(%)	Meshkuj(%)	Femra(%)	Meshkuj(%)	Femra(%)
O	18(14.4)	12(9.5)	30(27.3)	18(16.4)	172(20.8)	139(16.8)
A	34(26.9)	25(19.8)	26(23.6)	16(14.5)	145(17.55)	117(14.16)
B	18(14.3)	13(10.3)	7(6.5)	5(4.5)	97(11.7)	77(9.32)
AB	0	6(4.8)	4(3.6)	4(3.6)	46(5.56)	33(3.99)
Total	70(55.5)	56(45.5)	67(60.9)	43(39.1)	460	366

Në tabelën 4 tregohet shpërndarja e grupeve të gjakut ABO/RhD në pacientë dhe popullaten e shëndoshë sipas gjinisë.

DISKUTIMI DHE PËRFUNDIMI

Grupi ABO i gjakut eshte nje tipar i qëndrueshëm te njeriut dhe ndryshon ne varësi të kushteve social ekonomike, veçorive gjeografike dhe grupeve etnike. Në zonën Euroaziatike frekuenca e grupit A rritet nga lindja në perëndim, ndërsa frekuenca e grupit B ka trend të kundërt. Kështu në vendet e Azisë Lindore si Japonia, Kina e India frekuenca e grupi B është rreth 40%, ndërsa grupi A është i pranishëm në 20-30% të popullsisë. Në të kundërt në Europë frekuenca e grupit A është më e lartë rreth 40% ndërsa grupi B varion nga 10-20% me nje frekuencë më të lartë në Rusi 23%, dhe më të ulët në vëndet skandinave rreth 10%. Grupi i gjakut O ka një frekuencë rreth 40% me ndryshime të vogla (1). Të dhënat e studimit tonë tregojnë se në popullsinë e shqipërisë përqindja

më e madhe e popullsisë është grup gjaku O (37.3%) pasuar nga grupi i gjakut A me 31.3%, ndërsa përqindjen më të vogël e përbëjnë individet me grup gjaku AB (10.6%).

Në këtë studim ne kemi investiguar shpeshtësinë e grupeve të gjakut në pacientët me kancer të traktit gastrointestinal krahasuar me popullatën e shëndoshë. Të dënat tona tregojnë se frekuenca e kancereve të traktit gastrointestinal është më e lartë tek meshkujt (58.5%) se femrat. Ndërsa grup mosha më e prekur nga sëmundjet malinje të traktit gastrointestinal është grup mosha 30-50 vjeç.

Duke krahasur të dhënat e rezultateve tona me statistikat globale për kanceret e traktit gastrointestinal, vëmë re se rezultatet tona janë të ngjashme me ato përsa i përket shpërndarjes së tyre sipas gjinisë, me një përqindje më të lartë tek meshkujt. Ndërsa përsa i përket shpërndarjes së kancerit të traktit gastrointestinal sipas grup moshës vëmë re se në popullsinë tonë frekuenca është më ë lartë në grup moshën 30-50, ndërsa statistikat globale tregojnë për një rritje të shpejtë të frekuencës së tij pas moshës 50 vjeç (12, 13).

Midis pacientëve me sëmundje malinje të traktit gastrointestinal vëmë re se kanceri i stomakut ka një frekuencë më të lartë me 53.4% (Tabela 1). Frekuenca e kancerit të stomakut në vëndet kufitare si Itali, Greqi, Maqedoni, Mali Zi, është më e ulët se e kancerit të kolonit (14) , ndërsa në Bosnje Hercegovinë kanceri i stomakut është në një përqindje më të lartë se kanceri i kolonit (15).

Studimet për shoqërimin e llojeve të ndryshme te kancereve me grupet ABO të gjakut kanë treguar një rritje relative të riskut për disa kategori sëmundjesh. Kështu është vënë re një frekuencë e lartë e grupit të gjakut A në tumoret e kokës, gjëndrave të pështymës, kolonit, uterusit, veshkave, pankreasit, vezikën urinare (16, 17, 18, 19, 20) dhe frekuencë më e lartë e grupit O në kanceret e lëkurës dhe melanomat (18).

Shpërndarja e grupeve të gjakut ABO/RhD në pacientët e përfshirë në këtë studim nuk është e njëjtë me shpërndarjen e tyre në popullatën e shëndoshë. Në studimin tonë vëmë re se në pacientët me kancer të traktit gastrointestinal individët me grup gjaku A janë në një përqindje më të lartë, ndërsa në popullatën e shëndoshë përqindjen më të lartë e përbëjnë individët me grup gjaku O (Tabela 3).

Sipas vëndit të lokalizimit të kancerit, në pacientët me kancer të stomakut përqindjen më të madhe e përbëjnë individët me grup gjaku A (44.4%), ndërsa në pacientët me kancer të kolonit përqindjen më të madhe e zënë individët me grup gjaku O (42.7%). Pra të dhënat tona në këtë studim tregojnë së shpërndarja e grupeve të gjakut në pacientë me kancer të kolonit është e njëtë më shpërndarjen e tyre në popullatën e shëndoshë.

Shpërndarja e grupeve të gjakut ABO sipas gjinisë në pacientët e përfshirë në këtë studim është sinjifikativisht e ndryshme nga shëprndarja e tyre në popullatën e shëndoshë. Të dhënat tona në këtë studim tregojnë se grupi i gjakut A ka një përqindje më të lartë në të dyja gjinitë, në pacientët me kancer të stomakut, grupi i gjakut O është në përqindje më të lartë për të dyja gjinitë në pacientët me kancer të kolonit. Ndërsa në popullatën e shëndoshë përqindjen më të lartë si te meshkujt ashtu dhe te femrat e zë grupi i gjakut O (Tabela 4).

Pra në popullsinë e shqipërisë vëmë re se individët me grup gjaku A kanë një propabilitet më të lartë për tu sëmurë me sëmundje malinjë të traktit gastrointestinal. Sipas vëndit të lokalizimit të kancerit individët me grup gjaku A kanë një risk më të lartë për kancer të stomakut, ndërsa ata me grup gjaku O për kancer të kolonit. Të ndarë sipas gjinisë, meshkujt janë më të riskuar për tu sëmurë me kacer të traktit gastrointestinal se femrat.

Në popullsinë e marrë në studim vëmë re se individët RhD pozitivë janë në përqinje më të lartë si tek pacientët ashtu dhe në popullatën e shëndoshë. Ne Bosnje Hercegovinë përqindja e kancereve të traktit gastro intestinal është më e lartë në individët RhD pozitive (80.3%).

Me gjithë studimet e shumta të kryera në këtë fushë mbetet ende e paqartë lidhja e grupeve të gjakut ABO/RhD me disa sëmundje të veçanta dhe sidomos tumoret. Shumë të dhëna tregojnë se shfaqja e disa antigenëve të grupeve të gjakut në disa tumore është e lidhur me shfaqjen e metastazave dhe prognozën e tyre (21, 22). Gjenet e grupeve ABO(H) janë të vendosur në kromozonin 9q34.2 në të cilin ndodhin zakonisht ndryshime gjenetike në disa kancere. Kështu që shfaqja e antigenëvë të grupeve të gjakut mund të influencohet nga ndyshimet gjenetike të tumoreve (23, 24).

Përvec faktorëve gjenetik në etiopatogenezën e kancerit gastrointestinal ndikojnë edhe faktorë të tjerë të ambientit si pirja e duhanit, dieta, konsumimi i alkoolit, sëmundjet infektive të shkatuara nga Helicobacter pylori, etj. Kështu që grupi i gjakut duhet të merret në konsideratë bashk me faktorët e tjerë të riskut për të përcaktuar riskun individual të pacientit dhe korrelacionin e grupit të gjakut me tipet e kancerit. Për studimet e ardhshmen është e rëndësishme që të investigohet roli i gjenotipit

dhe/ose fenotipit si sitemi ABO/RHD në një grup më të gjërë pacientësh e lidhur kjo edhe me faktorët e tjerë të riskut të sipër përmëndur.

Si përfundim mund të themi se sitemi ABO/RhD i grupeve të gjakut mund të përbëjë një faktor risku për shfaqjen e tumoreve malinje të traktit gastrointestinal në popullsinë e marrë në studim.

REFERENCAT

1. Bhasin MK, Chahal SMS. (1996): ALaboratory Manual for Human Blood Analysis. Kamla-Raj Enterprises, Delhi.
2. Annese V, Minervini M, Gabbrielli A, Gambassi G, Manna R. (1990). ABO blood groups and cancer of the pancreas. Int. J. Pancreatol. 2(6), 81-88.
3. Pandey M, Gautam A, Shukla VK. (1995). ABO and Rh blood groups in patients ëith choleithiasis and gall bladder. Brit. Med. J. 310, 1639-1700.
4. Guleria K, Singh HP, Kaur H, Sambzal V. (2005). ABO blood groups in gastrointestinal tract and breast carcinoma patients. Anthropologist **7**(3), 189-192.
5. Dabelsteen E. Cell surface carbohydrates as prognostic markers in human carcinomas. J Pathol 1996; 179:358-69.
6. Hakomori S. Tumor-associated carbonhydrate antigens. Ann Rev Immunol 1984; 2:103-26.
7. Okada Y, Arima T, Togawa K, Nagashima H, Jinno K, Moriëaki S, Kunitomo T, Thurin J, Koprowski W. (1987). Neoexpression of ABH and Lewis blood group antigens in human hepatocellular carcinomas. J. Natl. Cancer. Inst. 78(1), 19-28.
8. Ichikawa D, Handa K, Hakomori S. (1998). Histo-blood group A/B antigen deletion/reduction vs. continuous expression in human tumor cells as correlated ëith their malignancy. Int. J. Cancer. 76(2), 284-289.
9. Nakagoe T, Fukushima K, Nanashima A, Sawai T, Tsuji T, Jibiki MA, Yamaguchi H, Yasutake T, Ayabe H, Matuo T, Tagawëa Y. (2001). Comparison of the expression of ABH/Lewis-related antigens in polypoid and non-polypoid growth types of colorectal carcinoma. J. Gastroenterol. Hepatol. 16(2), 176-183
10. Coon JS, Weinstein RS. Blood group-related antigens as markers of malignant potential and heterogeneity in human carcinomas. Hum Pathol 1986; 17:1089-106.
11. Ashly DJB. (1990). Tumors of the gastrointestinal tract. In: Evans's Histological Appearances of Tumors (Fourth Edition). Churchill Livingstone, Edinburgh – London-Melbourne – New York.
12. Parkin DM, Bray F, Ferlay J, Pisani P. (2002). Global Cancer Statistics. Calif. Cancer J. 55, 74-108.
13. GLOBOCAN 2008 (IARC) Section of Cancer Information (14/9/2010). www.globalcan.iarc,fr
14. Jovanović-Ćupić S, Stamenković G, Blagojević J, Vanis N, Stanojević B, Berberović Lj. ABO histo-blood groups and Rh systems in relation to malignant tumors of the digestive tract in bosnia and herzegovina. Arch. Biol. Sci., Belgrade, 60 (4), 593-599, 2008
15. Kamlesh Guleria, Hardeep Pal Singh, Harpreet Kaur and Vasudha Sambyal ABO Blood Groups in Gastrointestinal Tract (GIT) and Breast Carcinoma Patients. Anthropologist, 7(3): 189-192 (2005)
16. Henderson J, Seagrott V, Goldacre M. Ovarion cancer and ABO blood groups. J. Epidemiol. Comm. Hlth.,47: 287-289 (1993).
17. Karakousis CP, Evlogimenos E. Sun O.: Blood groups and malignant melanoma. J. Surg. Oncol., 33: 24-26(1986).
18. Pyd M, Rzeënicki I, Suwayach U. ABO blood groups in patients with laryngeal and hypopharyngeal cancer. Otolaryngol Pol 1995; 49:396-8.
19. Jia DX. Bone tumor and ABO blood type. Zhonghua Zhong Liu Za Zhia 1991; 13:220-2.
20. Umit Tursen, E Naci Tiftik, Sakir Unal, Ozgur Gunduz, Tamer Irfan Kaya, Handan Camdeviren, Guliz Ikizoglu. Relationship betëeen ABO blood groups and skin cancers Dermatology Online Journal 11 (3): 44 ,2005
21. Pack SD, Karkera JD, Zhuang Z, Pak ED, Balan KV,Hwu P, Park WS, Pham T, Ault DO, Glaser M, Liotta L, Detera Wadleigh SD, Wadleigh RG: Molecular cytogenetic ingerprinting of esophageal squamous cell carcinoma by comparative genomic hybridization reveals a consistent pattern of chromosomal alterations. Genes Chrom. Cancer, 25: 160-168 (1999)
22. Hu N, Roth MJ, Polymeropolous M, Tang ZZ, Emmert Buck MR, Wang QH, Goldstein AM, Feng SS, Dawsey SM, Ding T, Zhang ZP, Han XY, Ried T, Giffen C, Taylor PR. Identification of novel regions of allelic loss from a genomewide scan of esophageal squamous cell carcinoma in a high risk Chinese population. Genes Chrom. Cancer, 27**:** 217-218 (2000).

23. Simoneau M, La Rue H, Aboulkassim TO, Meyer F, Moore L, Fradet Y. Chromosome 9 deletions and recurrence of superficial bladder cancer: identification of four regions of prognostic interest. Oncogene, 19:6317-6323 (2000).
24. Zitzelslsberger H, Engert D, Walch A, Kulka U, Aubele M, Hofler H, Bauchinger M, Werner M: Chromosomal changes during development and progression of prostrate adenocarcinoma. Br. J. Cancer, 84**:** 202-208 (2001).

SUMMARY

DISTRIBUTION OF ABO/ RHD BLOOD GROUP IN GASTROINTESTINAL CARCINOMA PATIENTS

Vjollca Duro[1], Shpëtim Qyra[2], Andi Koraqi[3], Pëllumb Pipero[4]

[1]Hospital Planification Directory, Ministry of Health, Tirana, Albania,
[2]Public Health Institute, Tirana, Albania
Of the 62 cases who had abnormalities on head CT images only 47 cases had evident structural abnormalities; 32% of those cases (15/47) underwent surgical intervention respectively 5% of all bacterial meningitis cases (15/277).

DISCUSSION

Neuroimaging studies are typically used to identify and monitor complications of meningitis, such as hydrocephalus, subdural effusion, empyema, and infarction and to exclude parenchymal abscess and ventriculitis. Identifying cerebral complications early is important, as some complications, such as symptomatic hydrocephalus, subdural empyema, and cerebral abscess, require prompt neurosurgical intervention. In this study 109 cases (39%) underwent a head CT scan out of 277 children treated for bacterial meningitis during a six year study period. Children that didn't have any indications for CT scaning were all cured (158 cases) without any evident clinical neurologic complications. Ten children died (5 neonates) without performing a head CT scan although there were strong indications for performing a CT scan; 8 died within the first 24 hours after admission. Children that underwent a head CT scan, in 60 cases developed neurologic complications and there were 5 death cases all of them diagnosed by CT scan for hydrocephalus.

In this study the most common neurologic complications following bacterial meningitis in children were subdural collections (14%) and hydrocephalus (3%). The highest incidence of neurologic complications occurred in 2002 (33%), although this year also saw the lowest mortality rate (2%). The frequent occurrence of neurologic complications in recent years is owing to the high survival rate in bacterial meningitis and due to the availability of neuroimaging.

In this study subdural effusion was the most common complication of bacterial meningitis in infants (27%) and there were only 6 cases of subdural effusion in older children (4%). Major indications for performing a head CT scan were: prolonged fever, focal neurologic deficit, seizures, worsening of consciousness level and worsening of clinical presentation following meningitis. Due to its availability, its ability to detect early neurologic complications of bacterial meningitis in children, the compjuted tomography should be the first imaging procedure done during an attempt at diagnosis for neurologic complications (23, 24). Magnetic resonance imaging (MRI) should be performed as a second test and for follow up (10, 19, 20). During the years of our study MRI was not available in our country while ultrasonography is the first choice for infants. Imaging studies performed in patients with acute meningitis may provide normal findings. The results of an imaging study do not exclude or prove the presence of acute meningitis.

Out of the 109 children who underwent a head CT scan, one in three children was diagnosed with subdural effusion. Based on previous publications, subdural effusion is usually found in 40-60% of infants with bacterial meningitis with *Haemophyllus influenzae* as the most common causative pathogen (4, 8, 9, 18, 23). The other subdural collections complicating bacterial meningitis were rare in children; subdural empyema occurred in two cases caused by *Staphylococcus aureus,* and subdural hematoma occurred in one case caused by *H.Influenzae.* Clinical differentiation between the two is important for management and outcome.

Based on a review of the literature, *H. Influenzae* was found to be the most common pathogen to cause subdural effusion, although some reports describe subdural effusion cases occurring after the use of the anti-*H.Influenzae* vaccine to be most often caused by *N.meningitidis* (18,18). In Kosovo, without the implementation of vaccination against the three major pathogens of bacterial meningitis in children (*meningococcus, H. influenzae and pneumococcus), N.meningitidis* is the leading cause of bacterial meningitis in children and the cases complicated with subdural effusion.

From 47 cases diagnosed by neuroimaging for structural neurologic complications following bacterial meningitis, surgical treatment was required in 15 cases (32%). A poorer prognosis and outcome had cases with obstructive hydrocephalus. No major operative and postoperative complications occurred. Compjuted Tomography provides an accurate means of diagnosing neurologic complications of BM and together with clinical presentation and laboratory analysis helps on neurosurgical treatment and duration of conservative treatment of complicated BM cases in children. Surgical treatment is required in all cases in which a significant mass effect is apparent on imaging and by clinical presentation.

CONCLUSION

Although many studies point out that CT scanning has limited therapeutic applications in children with complicated bacterial meningitis (22, 23) we concluded that CT scanning has it's clinical relevance for diagnosing cases with evident structural abnormalities where an urgent neurosurgical intervention is required. In this study 32% of those cases underwent surgical intervention with good outcome in all of them.

Acknowledgments

We thank the personnel of Clinic of Infectious Diseases of Prishtina for their work and support during this study and we thank the personel of Radiology Institute who performed computed tomography scanning in children. *We thank our neurosurgeon dr Talat Gjinolli who performed neurosurgical interventions.*

Competing Interests

The authors declare that they have no competing interests.

Authors's Contributions

Sadie Namani participated in the design of the study, data collecting, comparing the results with other publications, perfomed the statistical analysis and drafted manuscript. The coauthors participated in additional correction and design.

REFERENCES

1. American Academy of Pediatrics. Diagnostic imaging of child abuse. Pediatrics. 2 000; 105:1345–8.
2. Aronin SI, Peduzzi P, Quagliarello VJ. Community-aquired bacterial meningitis; risk stratification for adverse clinical outcome and effect of antibiotic timing. Ann Inter Med. 1998; 129 (11):862-869.
3. Durand ML, Calderwood SB, Weber DJ, et al. Acute bacterial meningitis in adults. A review of 493 episodes. N Eng J Med. 1993; 328(1):21-28.
4. Grimwood K, Anderson P, Anderson V, Tan L, Nolan T. Twelve year outcomes following bacterial meningitis: further evidence for persisting effects. Arch Dis Child. 2 000; 83:111-116.
5. Jaspan T, Griffiths PD, McConachie NS, Punt JAG. Neuroimaging for non-accidental head injury in childhood: a proposed protocol. Clin Radiol. 2003; 58:44–53.
6. Kaplan SL, Catlin IF, Weaver T, Feigin RD. Onset of hearing loss in children with bacterial meningitis. Pediatr. 1984; 73:575-578.
7. Kaplan SL, Woods CR. Neurologic complications of bacterial meningitis in children. Curr Clin Top Infect Dis. 1992; 12:37-55.
8. Koomen I, Grobbee DE, Jennekens-Schinkel A, Roord JJ, van Vurth AM. Parental perception of educational, behavioural and general health problems in school-age survivors of bacterial meningitis. Acta Paediatr. 2003; 92:177-185.
9. Liu CC, Chen JS, Lin CH, Chen YJ, Huang CC. Bacterial meningitis in infants and children in southern Taiwan: emphasis on Haemophilus influenzae type B infection. J Formos Med Assoc. 1993; 92(10):884-888.
10. Margaret HD, Smith MD, Richard E, Dormont MD, George W, Prather MD Subdural effusions complicating bacterial meningitis. Pediatr. 1951; 7; 34-43.
11. McIntyre PB, MacIntyre CR, Gilmour R, Wang H. A population based study of the impact of corticosteroid therapy and delayed diagnosis on the outcome of childhood pneumococcal meningitis. Arch Dis Child. 2005; 90:391–396.
12. Meli DN, Christen S, Leib SL, Tauber MG. Current concepts in the pathogenesis of meningitis caused by Streptococcus pneumoniae. Curr Opin Infect Dis. 2002; 15:253-257.

13. Nathan BR, Scheld WM. New advances in the pathogenesis and pathophysiology of bacterial meningitis. Curr Infect Dis Rep. 2 000; 2:332-336.
14. Østergaard C, Konradsen HB, Samuelsson S. Clinical presentation and prognostic factors of Streptococcus pneumoniae meningitis according to the focus of infection. BMC Infect Dis. 2005; 5: 93.
15. Pfister HW, Feiden W, Einhaupl KM. Spectrum of complications during bacterial meningitis in adults. Results of a prospective clinical study. Arch Neurol. 1993; 50: 575–581.
16. Quagliarello VJ, Scheld WM. Treatment of bacterial meningitis. N Engl J Med. 1997; 336:708-716.
17. Sato Y, Yuh WT, Smith WL, Alexander RC, Kao SC, Ellerbroek CJ. Head injury in child abuse: evaluation with MR imaging. Radiology. 1989; 173:653–7.
18. Scheld WM, Koedel U, Nathan B, Pfister HW. Pathophysiology of bacterial meningitis: mechanism(s) of neuronal injury. J Infect Dis. 2002; 186(Suppl. 2):S225-S233.
19. Schuchat A, Robinson K, Wenger JD, et al. Bacterial meningitis in the United States in 1995. Active Surveillance Team. New Engl J Med. 1997; 337: 970–976.
20. Snedeker JD, Kaplan SL, Dodge PR, Holmes SJ, Feigin RD. Subdural Effusion and Its Relationship With Neurologic Sequelae of Bacterial Meningitis in Infancy: A Prospective Study. Pediatr. 1990; 86, 163-170.
21. van de Beek D, de Gans J, Spanjaard L, Weisfeldt M , Reitsma JB , Vermeulen M. Clinical features and prognostic factors in adults with bacterial meningitis. N Engl J Med. 2004; 351:1849–1859.
22. Vinchon M, Joriot S, Jissendi-Tchofo P, Dhellemmes P. Postmeningitis subdural fluid collection in infants: changing pattern and indications for surgery. J Neurosurg. 2006; 104(6 Suppl):383-387.
23. Daoud AS, Omari H, al-Sheyyab M, Abuekteish F. Indications and benefits of computed tomography in childhood bacterial meningitis. J Trop Pediatr. 1998; 44(3):167-9.
24. Cabral DA, Flodmark O, Farrell K, Speert DP. Prospective study of computed tomography in acute bacterial meningitis. J Pediatr 1987; 201-5

REZYME

RËNDËSIA KLINIKE E TOMOGRAFISË SË KOMPJUTERIZUAR TE MENINGJITI BAKTEROR TE FËMIJËT

Sadie Namani[1]**,** Kreshnike Dedushi[2]**,** Remzie Koci[3], Murat Mehmeti[4], Valbon Krasniqi[5]

[1]Klinika Infektive, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Prishtinë, Kosovë

[2]Insituti i Radiologjisë, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Prishtinë, Kosovë

[3] Klinika Pediatrike, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Prishtinë, Kosovë

[4]Klinika Infektive, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Prishtinë, Kosovë

[5]Klinika Infektive, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Prishtinë, Kosovë

Ndërlikimet neurologjike të meningjitit bakteror mund të shfaqen në çdo kohë gjatë ecurisë së meningjitit dhe disa prej tyre mund të jenë jetëkëcnuese ku indikohet intervenimi ugjent neurokirurgjik. ***Qëllimi*** *i këtij studimi ishte të analizohet rëndësia klinike e tomografisë së kompjuterizuar te meningjiti bakteror te fëmijët.* ***Metodologjia****: Janë analizuar 277 fëmijë të mjekuar nga meningjiti bakteror në Klinikën Infektive në Prishtinë. Autorët kanë analizuar rastet tek të cilat është bërë tomografia e kompjuterizuar e kokës dhe kanë analizuar rëndësinë e saj klinike për mjekimin e fëmijëve me meningjit bakteror.* ***Rezultatet****: Në periudhën kohore 6 vjeçare, te 109 fëmijë është bërë tomografia e kompjuterizuar e kokës për shkak të dyshimit në ndërlikime neurologjike të meningjitit bakteror. Ndryshime patologjike janë gjetur te 62/109 fëmijë (57%); 15/62 të rasteve kanë pasur ndryshime minore ndërsa 47/62 fëmijë kanë pasur ndryshime evidente strukturale. Ndërlikimet neurologjike akute më të shpeshta ishin 38 raste të koleksioneve subdurale dhe 7 raste të ventrikulomegalisë. Te 15/47 rasteve (32%) është indikuar intervenimi urgjent neurokirurgjik; 6/35 rasteve me effusion subdural, 2 raste me empyemë subdurale, 1 rast me hematomë subdurale, 5 raste me hidrocefali dhe një rast me absces spinal.* ***Përfundimi:*** *Tomografia e kompjuterizuar e kokës ka rëndësi klinike për diagnostifikim të rasteve me ndryshime evidente strukturale te të cilat indikohet intervenimi urgjent neurokirurgjik. Në këtë studim intervenimi kirurgjik urgjent është bërë në 32% të rasteve me ecuri të favorshme tek të gjitha rastet.*


Fjalë kyç*: Meningjiti bakteror, efusioni subdural, ndërlikimet neurologjike, ecuria e sëmundjes, tomografia e kompjuterizuar*

PUNIM PROFESIONAL / PROFESIONAL PAPER
GJINEKOLOGJI OBSTRETIKË

IDENTIFIKIMI I FAKTORËVE TË RISKUT PËR LINDJEN PREMATURE, STUDIM RAST KONTROLL NË MATERNITETIN E VLORËS.

Brunilda Mersini[1], Elizana Petrela[2], Migena Gega[3]

[1]Spitali Vlorë, Shqipëri
[2]ISHP, Vlorë, Shqipëri
[3]Fakulteti i Infermierisë, Vlorë, Shqipëri



Brunilda Mersini, mjeke gjinekologe obstetere
Rr. Hajro Çakëri, Vila 50, Vlorë, Shqipëri
Tel: +355682055360
e-mail: **brunmer@yahoo.com**

REZYME: Hyrje: *Lindja premature eshte nje problem i madh klinik i shoqeruar me mortalitet dhe semundshmeri perinatale të lartë.* ***Qellimi i studimit*** *eshte te identifikoj faktoret e riskut qe shoqerojne lindjen premature* ***Metoda:*** *Nje studim rast kontroll u realizua nga Ttetori 2007 deri Tetor 2010 ne maternitetin e vlores* ***Rezultatet:*** *Nje numer prej 200 rastesh te lindjes premature dhe nje numer kontrolli prej 200 lindjesh ne term u perfshin ne studim. Analiza statistikor u bazua ne analizen e regresionit logistik. Disa faktore risku qe shoqeruan linde premature u identifikuan si dieta e varfer (OR = 4.33), puna e rende (OR = 1.70), mbajtja e kafsheve shtepiake (OR = 5.06), infeksionet e traktit urinar (OR = 2.85), stresi (OR = 2.16), inkompetenca cervikale, (OR = 4.74), shtatezania binjake (OR = 7.51), apendesiti (OR = 3.76) dhe aborti (OR = 6.36).* ***Konklusione:*** *Faktoret percaktues te lindjes premature ne Vlore jane niveli i ulet socioekonomik dhe faktoret qe shoqerojne ate si puna e rende dhe puna e fshatit si dhe infeksionet e traktit urinar, anamneze obstetrikale te ngarkuar.*

Fjalë kyç: *Lindja premature, faktorët e riskut*
Medicus 2011, Vol. XV (1):

HYRJE

Lindja premature eshte nje nga faktoret percaktues te semundshmerise dhe vdekshmerise neonatale si dhe te çregullimeve te femijerise dhe mbetet nje nga problemet serioze te obstetrikes.

Lindja premature eshte percaktuar si nje lindje ne me pak se 37 jave shtatezanie dhe eshte klasifikuar ne tre kategori.

E lehte	32–36 javë	me frekuence 85%,
Shume premature	28–31 jave	me frekuence 10%
Ekstrem me pak se	28 jave	me frekuence 5%

Pavaresisht perpjekjeve preventive incidenca e lindjes premature mbetet konstante rreth 5–10% te lindjeve ne shumicen e vendeve.

Ne 75% te lindjes premature nuk eshte stabilizuar asnje shkak bindes por disa faktore etiologjik jane identifikuar si risk per prematuritetin.

Faktoret e riskut jo obstetrikale perfshijne nivelin e ulet socioekonomik, kequshqyerja e nenes, nivelin e ulet arsimor, mosha e nenes me pak se 20 vjeç dhe me e madhe se 35 vjeç , puna e rende fizike, pirja e duhanit, udhetimet e gjata dhe traumat abdominale.

Faktoret e riskut obstetrikale qe shoqerojne lindjen premature perfshijne barren binjake, inkompetencen cervikale, intervale te shkurtra ndermjet lindjeve, abortet, plasja e parakohshme e membranave dhe lindje premature te meparshme.

Nje numer kushtesh te tjera mjekesore shoqerojne lindjen premature si diabeti mellitus, infeksionet urinare si dhe stresi psikologjik.

QËLLIM

Qellimi i studimit eshte te identifikoj faktoret e riskut në menyre që të reduktohet risku i lindjes premature ne Vlore .

METODA

Studimi u realizua ne maternitetin e vlores me nje popullesi perreth 150000 banorë nga tetori i 2007-tes deri ne tetor 2010 –tes dhe rastet u zgjodhen nga poliklinika si dhe nga ambulancat e fshatrave dhe klinika mjekesore Jasmin.

Nje studim rast kontroll u perdor . Rastet u perzgjodhen te grate me shtatëzani të gjallë me moshe gravidance (29–<37 javë) me lindje normale ose seksio cesare. Kontrollet u percaktuan si gra shtatezane që u kontrolluan dhe linden ne maternitetin e vlores me nje moshe barre (≥37 jave pavaresisht se lindja ishte vaginale ose seksio cesarea.

Ne pergjithesi u perzgjodhen 230 raste por vetem 200 ishin dakort per perfshirjen ne studim.

Secili rast u perzgjodh si kontroll dhe intervistat u bene sipas nje pyetësori specifik.

Ne shtesë të anamnezës gratë u pyetën dhe për faktorët e riskut.

Situata ekonomike u vleresua me te ardhura mujore nga asistenca, nga kushtet e banimit prania e ujit dhe elektricitetit. Nje status i pergjithshem ekonomik u u vleresua me 1 pike, 2 pike dhe 3 pike.

Nje informacion u mblodh dhe u perpunua dhe mbi ushqyerjen si per konsumimin e mishit njëherë në javë, apo më pak, rregullisht apo shpesh dy herë në javë si dhe shumë.informacion. per shtatëzanitë e kaluara.

Diagnoza e inkompetences cervikale u mor nga rastet klinike e përkufizuar si dilatacion i cerviksit 2 cm ose me shume ne tremestrin e pare nga ekografia transvaginale.

Pacientja u pyet rreth diagnozës dhe trajtimit te situatave gjate shtatëzanisë, diabetit, infeksioneve te traktit urinar, dhe infeksioneve te traktit genital. Më në fund dhe shqetesimet emocionale që ndodhin gjatë barrës u vlerësuan me pyetsor rreth ankthit dhe frikes.

Frike e rende u quajten lajmet e keqija nga humbja e familjareve.

Stresi u vleresua me gjashtë pyetje referuar ngjarjeve stresuese si nervozmimi, tension muskular çregullime te gjumit, irritim dhe veshtiresi te perqendrimit, lodhje e shpejte. Prezenca e ankthit u stabilizua kur piket ishin pozitive per më shumë se ≥50% dhe (OR) dhe CI) janë 95%.

Dhe vlera e p është >0.05 jo sinjifikantive dhe u përdor regresioni logjistik.

Të gjitha variablet u përfshin në analizën fillestare, variablet me lidhje më të ngushtë u matën të parat te ndjekura nga të gjitha variablet sinjifikantive.

.

REZULTATE

Një numër i përgjithshëm të 200 rasteve dhe të 200 kontrolleve u përfshin në studim.

Tabela 1 tregon shpërndarjen e moshës të popullsisë në studim.

Një shoqërim i riskut të lartë u pa ndërmjët lindjes premature dhe shtatzanive në moshë të re të barabarte me 19 vjeç, më një OR =4.9.

Table 1.

Shperndarja e popullesise ne studim sipas moshes

.

Grupmosha (vite)	rastet (nr)	kontrolli (nr.)	OR 95%	CI	vlera p
<19	41	**10**	4.90	2.38–10.09	<0.001
20–29	90	102	1.00	-	-
30–34	37	48	0.72	0.45–1.17	NS
35–39	18	30	0.56	0.30–1.04	NS
≥40	14	10	1.43	0.62–3.30	NS
gjithsej	200	200	-	-	

Tabela 2

I referohet historisë të nivelit socio ekonomik të popullësisë në studim**.**

Ne pergjithesi te gjithe subjektet ishin te papunesuara dhe ishin shtepiake.

Nje shoqerim risku sinjifikativ ishte present ndermjet lindjes premature dhe konsumimit te mishit okazional (OR = 3.26).

Punes se rende me dore (OR = 2.80), nivelit te ulet socioekonomik (OR = 2.60).

Tabela 2.

Variablet	rastet (nr.)	kontrollet (nr)	OR	95% CI	Vlera P
1. Frekuenca e konsumimit te mishit					
rastesor	121	64	3.62	2.16–4.92	<0.001
mesme-larte	79	136			
2. puna e dores					
E rende	140	91	2.80	1.86–4.23	<0.001
e zakonshme	60	109			
3. niveli socio ekonomik					
I ulet	165	129	2.60	1.63–4.15	<0.001
Mesme-larte	35	71			
4. punesimi					
shtepiake	198	196	2.02	0.37–11.16	N.S
punetore	2	4			
5. niveli I edukimit					

Variablet	rastet (nr.)	kontrollet (nr)	OR	95% CI	Vlera P
tetevjecar	128	80	2.67	1.78–4.00	<0.001
mesme	65	103	0.45	0.30–0.68	<0.001
larte	7	17	1.00	-	-

Lidhja ndermjet lindjes premature dhe faktoreve te tjere te riskut jane permbledhur ne tabelen 3.

Tabela 3.

.

Variablet	rastet (nr.)	kontrolli (nr.)	OR	95% CI	P value
Pariteti					
0–2	112	111	1.00	-	-
3	23	24	0.95	0.52–1.75	NS
4	22	24	0.91	0.49–1.68	NS
5+	43	41	1.06	0.65–1.72	NS
Te gjitha kategorite	200	200	-	-	-
Variable e riskut ne shtatezanine prezente					
Inkompetence cervikale	47	18	3.11	1.73–5.58	<0.001
Shtatezani multiple	19	3	6.89	2.00–23.69	<0.001
Hemoragji aksidentale	9	4	2.31	0.70–7.64	NS
Infeks trakti genital	48	45	1.09	0.69–1.74	NS
Histori obstetrikale					
L.premat.meparsh.	30	1	35.12	4.74–260.32	<0.001
abortet	3	1	3.03	0.31–29.38	NS
PPROM	14	10	1.43	0.62–3.30	NS
Semundje mjekesore					
diabet	2	1	2.01	0.18–22.35	NS
Infeks. traktit urinar	82	40	2.78	1.78–4.35	<0.001

Variablet	rastet (nr.)	kontrolli (nr.)	OR	95% CI	P value
Shqetesime emocionale					
Frike e rende	67	63	1.10	0.72–1.67	NS
ankth	87	60	1.80	1.19–2.72	<0. 01
Vizita antenatale te lidhura me komplikacionet e shtatezanise					
0	25	30	1.00	-	-
1–3	65	95	0.53	0.35–0.80	<0.001
≥4	110	75	2.04	1.37–3.04	<0.001
duhanpirja					
duhanpires	4	5	0.80	0.21–3.02	NS
Udhetime te gjata dhe trauma abdominale					
Udhetim te gjate	61	65	0.91	0.60–1.39	NS
Trauma abdominale	45	14	3.86	2.04–7.30	<0.001

Ndermjet variableve te riskut te barrave te perseritura dhe anamnezes se kaluar tregohet nje risk sinjifikativ ndermjet lindjes premature dhe inkompetences cervikale (OR = 3.11), shtatzanise multiple (OR =6.89), lindjes së meparshme (OR 35.12), dhe traumes direkte abdominale (OR = 3.86).

Tabela 3 tregon nje shoqerim pozitiv te riskut te lindjes premature dhe infeksioneve urinare (OR = 2.78), ankthit (OR = 1.80), vizitave antenatale dhe komplikacioneve te shtatezanise (OR =2.04).

Perfundimisht nje model regresioni logjistik per riperseritjen e lindjes premature eshte paraqitur në tabelen 4.

Tabela 4.

variablet	OR	Vlera p	95% CI	
			I ulet	I larte
ankthi	2.16	<0.001	1.28	3.64
kequshqyerja	4.33	<0.001	2.60	7.22
Puna e dores	1.70	<0.05	1.02	2.84
Infeks traktit urinar	2.85	<0.001	1.63	4.98

variablet	OR	Vlera p	95% CI	
			I ulet	I larte
Trauma abdominale	3.76	<0.001	1.77	7.98
Abortet	6.36	<0.001	2.77	14.63
Inkompetence cervikale	4.74	<0.001	2.29	9.79
Barre multiple	7.51	<0.01	1.89	29.87

Pergjithesisht te gjithe faktoret e riskut u pane se kishin nje lidhje sinjifikative ne kete analize, perveç moshes, nivelit socioekonomik , edukimit dhe lindjes se meparshme premature .

DISKUTIMI

Një studim rast kontroll u realizua ku shkalla e pergjigjjes për rastet ishte 93% dhe per kontrollet 100%. Rastet të cilat refuzuan te merrnin pjesë në studim cilesuan lodhjen si arsye.

Lindja premature eshte nje problemet me te zakonshme obstetrikale dhe te porsalindurit preterm jane më të ekspozuar per vdekjen se sa bebet e lindura ne term.

Megjithate te gjitha bebet qe mbijetojne ekspozohen përpara nje risku të madh per demtimet neurologjike te mevonshme. Ne analizen bere e bere shikohet nje risk sinjifikant qe shoqeron lindjen premature në grate me moshe te re. Mosha behet e rëndësishme ne anlizen e regresionit kur kontrollohen variablet e tjera.

Nuk ka shoqerim sinjifikativ ndermjet linde premature dhe paritetit.

Frekuenca e konsumimit të mishit eshtë një indikator i gjendjes se ushqyrjes së gruas dhe në studim u pa se konsumimi i rralle ose okazional i mishit është i lidhur sinjifikativisht me lindjen premature.

Mishi eshte konsideruar si burim esencial i hekurit dhe anemia nga deficenca e hekurit eshte pare si nje risk faktor për lindjen premature. Ne Vlore kjo anemi eshte nje situate e shpeshtë dhe mund të jëtë e lidhur direkt me konsumimin e mishit.

Niveli i ulet socioekonomik dhe i ulet arsimor u gjeten si faktore te lidhur ngushte me lindjen premature.

Ne menyrë të ngjashme u pa nje lidhje me lindjen premature dhe punes se rende me dore.

Te gjitha keto situata jane te lidhura me nivelin e ulet socioekonomik. Kjo mund te shpjegoj pse disa faktore behen te rendesishem per analizen statistikore te regresionit logistik. Rezultate te ngjashme jane raportuar ne disa studime.

Studime te tjera kane raportuar se limitimi i punes se rende dhe shmangja e lodhjes se madhe ndihmon per reduktimin e lindjes premature.

Studimi nxorri ne dukje shoqerimin e inkompetences cervikale, shtatezanise multiple dhe lindjes premature si nje faktore risku. Hemoragjia aksidentale eshte raportuar si faktor risku dyshues.

Ne studimin aktual nje OR prej 2.31 u pa si nje faktor por jo sinjifikantiv dhe kjo mund te jete e lidhur me numrin e vogel te rasteve .

Infeksionet urinare u pane si nje faktor risku sinjifikativ per lindjen premature.

Nuk u gjet shoqerim midis lindjes premature dhe infeksioneve te traktit genital. Studime te tjera nuk jane konkluzive, megjithese ka pat studime negative ka patur dhe studime te tjera te cilat raportojnë infeksionet nga trikomoniaza, mycoplazma si shoqerues me lindjen premature.

Deshtimi per te gjetur kete lidhje mund te jete ne lidhje me qellimin e studimit, incidenca e ketyre infeksioneve u percaktua nga historia klinike sepse nuk pati rezultate direkte klinike laboratorike. Eshte e mundshme qe grate mund te jene konfuze ne raportimin e infeksioneve urinare dhe infeksione genitale. Studimi investigoj dhe shoqerimin e mundshem te lindjes premature me histori te tjera mjekesore.

Vetem dy raste diabeti mellitus u gjeten ndermjet rasteve dhe kontrolleve.

Studime te tjera kane raportuar rezultate kontroversiale per nje shoqerim ndermjet pirjes se duhanit dhe lindjes premature.

Ne kete studim pati numer te vogel fumatoresh te cilet nuk perbejne dot nje konkluzion.

Trauma direkt ne abdomen u raportua ne 45 raste dhe ne 14 rast kontrolli dhe shoqerimi ishte sinjifikant.

Ne studim u pa se rastet paten numer me te madh vizitash antenatale sesa kontrollet kryesisht per komplikacionet.

Vizitat antenatale nuk mbulohen nga struktura mjekesore ne shume zona te fshatrave dhe vizitat antenatale mund te behen vetem ne shtatezanite me risk te larte. Rezultatet e ketij studimi raportuan se gratë e diagnostikuar me probleme te cilesuara si faktore risku per lindjen premature kane patur numer me te madh vizitash antenatale sesa te tjerat.

Stresi, ankthi dhe shqetesime te tjera psikologjike jane suspektuar si faktor risku per lindjen premature. Eshte e zakonshme qe komuniteti i Vlores te kete ankth e frike sigurie shpeshere sidomos pas luftes civile te 1997.

Studimi konfirmoi nje shoqerim sinjifikativ ndermjet ankthit dhe lindjes premature. Eshte provuar se stresi dhe ankthi rritin hormonin kortikotrop dhe mund te rezultoj ne rritjen e kontraktilitetit uterin. Stresi gjithashtu rrit prodhimin e citokinave te cilet mund te rezultojnë ne lindje premature ose rritin ndjeshmërine per infeksionin dhe lindje premature të përsëritur.

Shumë nga faktoret e riskut janë të lidhur me njëri tetri ose me faktor te tjerë, por shumica e ketyre faktorëve u analizuan nga analiza e regresionit logistik.

KONKLUZIONE

Ne Vlore grate jane grup vulnerable sepse numri me i madh jane me nivel te ulet arsimor dhe te papunesuara dhe ne keto kushte ato ballafaqohen me kequshqyerjen, standart te ulet niveli socioekonomik, infeksionin, ekspozimin ndaj stresit dhe ankthit.

Te gjithe keta faktor risku te cilet jane gjetur te lidhur me lindjen premature jane te modifikueshëm. Ata duhet të merren ne konsidertaë ne planifikimin e nje programi prevenues per te ulur lindjen premature dhe pasojat per semundshmerine dhe vdekshmerine ne rajonin e vlores

REFERENCE

1. Bibby E, Steëart A. The epidemiology of preterm birth. *Neuro Endocrinol Lett.* 2004;**25**:43–47.[PubMed]
2. Zeitlin J, Bucourt M, Rivera L, Topuz B, Papiernik E. Preterm birth and maternal country of birth in a French district ëith a multiethnic population. *BJOG.* 2004;**111**:849–855. [PubMed]
3. Savitz DA, Kaufman JS, Dole N, Siega-Riz AM, Thorp JM, Jr, Kaczor DT. Poverty, education, race and pregnancy outcome. *Ethn Dis.* 2004;**14**:322–329. [PubMed]
4. Sadoon I, Hassan M. Incidence and risk factors of prematurely in Basrah, Iraq. *JABMS* .2001; **3**:100–103.
5. Muggah E, Way D, Muirhead M, Baskerville B. Preterm delivery among Inuit women in the Baffin region of the Canadian Arctic. *Int J Circumpolar Health.* 2004;**63**:242–247. [PubMed]
6. Cisse CT, Mbaye M, Faye Dieme ME, Traore AL, Moreau JC. Previous induced abortions and the risk of very preterm delivery: results of the EPIPAGE study. *BJOG.* 2005;**112**:430–437. [PubMed]
7. Jacobsson B, Ladfors L, Milsom I. Advanced maternal age and adverse prenatal outcome. *Obstet Gynecol.* 2004; **104**: 727–733. [PubMed]
8. Krymko H, Bashiri A, Smolin A, Sheiner E, Bar-David J, Shoham-Vardi I, Vardi H, Mazor M. Risk factors for recurrent preterm delivery. *Eur J Obstet Gynecol Reprod Biol.* 2004; **113**: 160–163. doi: 10.1016/j.ejogrb.2003.08.006. [PubMed] [Cross Ref]
9. Ezechi OC, Makinde ON, Kalu BE, Nnatu SN. Risk factors for preterm delivery in South Western Nigeria. *J Obstet Gynaecol.* 2003;**23**:387–391. doi: 10. 1080/ 0144361031000119556. [PubMed] [Cross Ref]
10. Pollack H, Lantz PM, Frohna JG. Maternal smoking and adverse birth outcomes among singletons and tëins. *Am J Public Health.* 2000;**90**:395–400. [PMC free article] [PubMed]

11. Moutquin JM. Socio-economic and psychological factors in the management and prevention of preterm labor. *BJOG.* 2003;**110**:56–60. [PubMed]
12. El-Kady D, Gilbert WM, Anderson J, Danielsen B, Towner D, Smith LH. Trauma during pregnancy, an analysis of maternal and fetal outcomes in a large population. *Am J Obstet Gynecol.* 2004;**190**:1661–1668. doi: 10.1016/j.ajog.2004.02.051. [PubMed] [Cross Ref]
13. Kurdi AM, Mesleh RA, Al-Hakeem MM, Khashoggi TY, Khalifa HM. Multiple pregnancy and preterm birth. *Saudi Med J.* 2004;**25**:632–637. [PubMed]
14. Althuisius SM, Dekker GA. Controversies regarding cervical incompetence, short cervix and the need for cerclage. *Clin Perinatol.* 2004;**31**:695–720. doi: 10. 1016/j. clp. 2004. 06.009. [PubMed] [Cross Ref]
15. Nguyen N, Savitz DA, Thorp JM. Risk factors for preterm birth in Vietnam. *Int J Gynaecol Obstet.* 2004; **86**:70–78. doi: 10.1016/j.ijgo.2004.04.003. [PubMed] [Cross Ref]
16. Wright SP, Mitchell EA, Thompson JM, Clements MS, Ford RP, Steëart AW. Risk factors for preterm birth: a New Zealand study. *N Z Med J.* 1998; **111**:14–6. [PubMed]
17. Brown D., Jr Clinical variability of bacterial vaginosis and trichomoniasis. *J Reprod Med.* 2004; **49**:781–786. [PubMed]
18. American Psychiatric Association *Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders.* 4. Washington DC; 2000. p. 211. Text revision, (DSM-IV-TR)
19. da Silva AA, Simoes VM, Barbieri MA, Bettiol H, Lamy-Filho F, Coimbra LC, Alves MT. You

SUMMARY

IDENTIFICATION OF RISK FAKTORS IN PREMATURE DELIVERY, CASE STUDY CONTROLE IN MATERNITY OF VLORA

Brunilda Mersini[1], Elizana Petrela[2], Migena Gega[3]

[1]Hospital in Vlora, Vlora, Albania
[2]IPS, Vlora, Albania
[3]Nursing Faculty, Vlora, Albania

Background: *Preterm birth (PTB)is a major clinical problem associated with perinatal mortality and morbidity. The aim of the present study is to identify risk factors associated with PTB in maternity of Vlora.* ***Methods:*** *A case-control study was conducted in from 1st October 2007, to 28th October 2010.in hospital of vlora.* ***Results:*** *A total of 200 cases of PTB and 200 controls of full-term births were screened and enrolled in the study. Forward logistic regression analysis was used in the analysis. Several significant risk associations between PTB and the following risk factors were identified: poor diet (OR=4.33), heavy manual work (OR=1.70), urinary tract infection (OR=2.85), anxiety (OR=2.16), cervical incompetence (OR=4.74), multiple pregnancies (OR= 7.51), direct trauma to abdomen (OR=3.76) and abortion (OR=6.36).* ***Conclusion:*** *The main determinants of PTB in Vlora were low socio-economic status and factors associated with it, such as heavy manual work in addition to urinary tract infections and poor obstetric history.*

Key words: *Premature delivery, risk factors*

PUNIM PROFESIONAL / PROFESIONAL PAPER
PEDIATRI

TË DHËNA EPIDEMIOLOGJIKE PËR INTOKSIKACIONET NË FËMIJË

Ilirjana Bakalli[1], Elmira Kola[1], Robert Lluka[1], Ermela Gjyzeli[1], Aurel Vula[1], Sashenka Sallabanda[1]

QSUT "Nene Tereza"
[1]Terapia Intensive Pediatrike
Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri



Ilirjana Bakalli, mjeke pediatre
Rr. Grigor Gjirokastriti, Nd. 14, H.4, Ap. 11. Tirane
Tel: +355672055359
e-mail: **ilirjanabakalli@yahoo.com**

Përmbledhje: *Në këtë punim do të sillen rezultatet e një studimi 10 vjeçar mbi intoksikacionet në fëmijë. Në këtë studim janë përfshirë 253 fëmijë të shtruar në Shërbimin e Terapisë Intensive Pediatrike (TIP), QSUT "Nënë Tereza", Tiranë, për periudhën 2001 – 2010. Është vlerësuar frekuenca, mosha, tipi i agjentit toksik, mënyra e marrjes së helmit dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur. U vërejtë që mosha më e prekur ishte nën 5 vjeç. Intoksikacionet medikamentoze zinin vendin kryesor me 54.1% të rasteve ndjekur nga intoksikacionet nga fosfororganikët dhe pesticidet (21.7% e rasteve). Marrja e helmit në 86.2% të rasteve ka qënë aksidentale.*

Fjalët çelës: *Helmim, fëmijë*

Medicus 2011, Vol. XV (1):

HYRJE

Intoksikacionet në fëmijë përbëjnë një problem të rëndësishëm për shëndetsinë në mbarë botën si për shkallën e morbiditetit ashtu dhe për rriskun e mortalitetit (5). Ato përfaqësojnë një nga urgjencat më të zakonshme të moshave pediatrike duke përbërë një numër të konsiderueshëm të shtrimeve në terapinë intensive. Sipas një raporti të CDCP (Center of Disease Control and Prevention), ≈ 1 milion fëmijë nën 5 vjeç intoksikohen nga substanca të ndryshme çdo vit dhe më shumë se 35 fëmijë nën 4 vjeç vdesin çdo vit si pasojë e intoksikacionit akut (Medline). Fëmijët kanë një risk relativisht të lartë për ekspozimin ndaj helmeve sepse ritmit të shpejtë të metabolizmit që ato paraqesin i shtohet natyra e tyre kurioze, si dhe dëshira për të futur çdo gjë në gojë (1). Helmimet aksidentale përbëjnë një problem të zakonshëm për fëmijët me një moshë mesatare 2,5vjeç dhe natyrisht faktorë kryesorë përgjegjës për këtë mbeten: së pari një mbikqyrje jooptimale nga ana e prindërve dhe së dyti: mbajtja e produkteve me potencial të lartë toksik në shtëpi (7). Nga ana tjetër, pijet alkoolike përbëjnë drogat me të cilat abuzohet nga një pjesë e fëmijëve. Ndërkohë mbidoza e qëllimshme ndodh zakonisht tek adoleshentët.

QËLLIMI I PUNIMIT

Nëpërmjet studimit tonë ne duam të paraqesim disa të dhëna epidemiologjike të pacientëve me intoksikacion akut nga shkaqe të ndryshme, të shtruar në TIP gjatë një periudhe 10 vjeçare (2001-2010), e nevojshme kjo për çdo vend për të nënvizuar problemet që takohen si dhe marrjen e masave që duhen marrë lidhur me këto probleme.

MATERIALI DHE METODA

Studimi është retrospektiv, rast-kontroll. Janë marrë në studim 253 fëmijë të shtruar në TIP për intoksikacion gjatë një periudhe 10 vjeçare (2001-2010). Është vlerësuar frekuenca vjetore e intoksikacioneve, mosha, tipi i agjentit toksik (lloji i helmit), shpërndarja sipas gjinisë, mënyra e marrjes së helmit (aksidentale apo e qëllimshme), rrethanat ku ka ndodhur, rruga e intoksikimit. Fëmijët janë ndarë në tre grupe: 0-5 vjeç; 6-12 vjeç; mbi 12 vjeç dhe çdo grup janë analizuar variablat e mësipërme

REZULTATET

Gjatë periudhës në studim (2001-2010), 253 fëmijë me intoksikacion akut janë shtruar në Shërbimin e Terapisë Intensive Pediatrike, me një paraqitje mesatare prej 26 rastesh në vit ose 5% të të gjithë shtrimeve.

Në raport me moshën, 177 raste (70% e rasteve) janë 0-5 vjeç, 64 raste (25.3% e rasteve) janë të moshës 6 -12 vjeç dhe 12 raste (4.7% e rasteve) janë >12 vjeç. Mosha mesatare është 4.9 vjeç. Përsa i përket raportit meshkuj/femra, është parë që meshkujt zënë 58.1% të rasteve kundrejt 41.9% të femrave, raport ky afërsisht 1,4/1. Kështu kemi një predominim të meshkujve që është më evident nën 12 vjeç, sepse pas kësaj moshe kemi një raport 1/1.

Duke vlerësuar rrugën e ekspozimit ndaj helmit:

- Ingjestionin e gjetëm në 249 raste (98,4%)
- Rruga dermale dhe oftalmike 2 raste (0.7%)
- Rruga inhalatore në 2 raste (0,7%)

Intoksikacionet medikamentoze përbëjnë shkakun kryesor të intoksikacioneve, pasuar nga produktet helmuese të shtëpisë (ushqime të helmuara, kërpudha, pije alokolike). Medikamentet zënë vendin e parë me 137 raste (54.1%), ndjekur nga pesticidet me 55 raste (21.7%), alkooli me 32 raste (12.6%), hidrokarburet 12 raste (4.7%) dhe më rrallë substancat kaustike (acide + baza) me 8 raste (3.1%), kërpudha 7 raste (2.8%) apo gazet tosike 2 raste (0.7%).

Për secilin grup moshë është specifikuar agjenti toksik siç vihet re qartë në tabelën 1, për të vlerësuar se cili ishte agjenti më i shpeshtë në secilën grupmoshë.

Duke qënë se medikamentet përbënin grupin më të madh të intoksikacioneve u analizua lloji i tyre dhe u pa se intoksikacionet nga antidepresantët zënë pjesën më të madhe me 33 raste. Medikamente të tjera shkaktare të intoksikacionit ishin: benzodiazepinat + antiepileptikët e tjerë 29 raste, pseudoephedrina 17 raste, paracetamoli 15 raste, metoclopropamid 7 raste, etj.

Tabela 1.

Struktura e intoksikacioneve sipas moshës

Agjenti toksik	0-5 vjeç	6-12 vjeç	>12 vjeç
Medikamente	105 raste	20 raste	12 raste
Pesticide	27 raste	24 raste	4 raste
Alkool	7 raste	17 raste	8 raste
Lëndë kaustike	7 raste	1 raste	-
Hidrokarburet	8 raste	4 raste	-
Kërpudha	2 raste	4 raste	1 rast
Gazet toksike	1 rast	1 rast	-

Në 86.2% të intoksikacioneve (218 raste) marrja e helmit ka qënë aksidentale, në 7.1% të rasteve (18 raste) abuzive, në 4.7% (12 raste) suicidale dhe 2% (5 raste) jatrogene. Intoksikacionet

suicidale i kemi takuar vetëm tek vajzat e moshës >12 vjeç, prej të cilave 4 raste kanë qënë me përfundim fatal.

Vdekshmëria u pa në 11 raste (4.3% e të gjithë intoksikacioneve) me shkaktarë 5 raste Fostoksinë, 3 raste nga kërpudhat, 2 raste medikamentoze (1 rast nga paracetamoli dhe një rast nga Daonili) dhe një nga substancat kimike.

Tabela 2.

Mortaliteti sipas mënyrës së intoksikacionit

		0-5 vjeç	6-12 vjeç	> 12 vjeç
Aksidentale	Meshkuj	2 rast	1 rast	1 rast
	Femra	2 raste	2 raste	1 rast
Suicidale	Meshkuj			
	Femra			4 raste
Totale		11 raste		

Ndërsa në tabelën 3 paraqitet paraqitet mortaliteti në vite, i shprehur në përqindje, ku duket qartë se mortaliteti është reduktuar <10% dhe keto tre vitet e fundit pa mortalitet.

Tabela 3.

Mortaliteti në vite

2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
9.5%	5%	6.9%	4.5%	10%	0%	0%	0 %	8%	0 %

DISKUTIMI

Intoksikacionet përfaqësojnë një nga urgjencat më të zakonshme të moshave pediatrike duke përbërë një numër të konsiderueshëm të shtrimeve në reanimacion. Në studimin tonë vihet re se përbëjnë 5% të shtrimeve, ndërkohë që në studime të ndryshme gjejmë një numër më të vogël (0,9%) (7).

Pjesa më e madhe e intoksikacioneve ka ndodhur <5 vjeç (70,1% e rasteve). Shifra të ngjashme (>50% e intoksikacioneve) raportohen dhe nga Shoqata Amerikane e Toksikologjisë (TESS- Toxic Exposure Surveillance System) (1, 4). Natyrisht kjo reflekton plotësisht natyrën kurioze si dhe dëshirën e fëmijës për të futur çdo gjë në gojë (1) dhe justifikon dhe faktin që ingjestioni është rruga kryesore e ekspozimit ndaj helmit gjë të cilën ne e gjejmë në 98% të rasteve, statistikë kjo që është konsistente dhe me studime të tjera të TESS (ku ingjestioni takohet në 75.4% të rasteve, rruga dermale dhe oftalmike 13.9% dhe inhalacioni në 6.1%) (1, 4).

Dhe në punimin tonë, siç përshkruhet dhe nga literature (3, 4, 7, 8) ***medikamentet*** janë agjenti kryesor toksik. Në studimin tonë 54.1% të rasteve, në literaturë 40% (4). Në grupin e medikamenteve ***antidepresivët*** janë në krye të klasifikimit, sepse natyrës kurioze të fëmijëve në keto raste i shtohet dhe një vëmendje jo e kënaqshme nga ana e prindërve të tyre që mjekohen me këto medikamente. E veçantë në studimin tonë, me një frekuencë për tu marrë në konsideratë është intoksikacioni nga ***pseudoephedrina*** (6.7%) e takuar <1 vjeç, natyrisht jo e përshkruar nga mjeku, por e përdorur nga familjarët, pa ditur efektet sistemike që ky medikament mund të japë në bebet e vogla.

Për tu theksuar është që kemi një rritje të intoksikacionit nga ***acetaminopheni*** (5.9% në studimin tone) kjo për arsye: të ekzistencës në farmaci me shumë emra farmaceutikë (tachipirinë, daleron, algotropyl, calpol, tylenol etj.), përshkrimit nga ana e mjekëve jo me emrin gjenerik si dhe mungesës së informacionit të nevojshëm nga familjarët (ata mendojnë që po japin ilaçe të ndryshme për të stabilizuar temperaturën e fëmijës së tyre).

Pas intoksikacioneve medikamentoze, vend të rëndësishëm zënë intoksikacionet nga ***fosfororganikët dhe pesticidet*** (21.7% e rasteve). Të tërheq vëmendjen një **<u>tregtim jo korrekt</u>** nga ana e farmacive bujqësore të këtyre substancave dhe nga ana tjetër mbajtja e këtyre produkteve kaq toksike në vende *jo të sigurta* nga familjarët. Të dhë na të ngjashme raportohen dhe nga Greqia ku detergjentët, produktet e petroliumit dhe pesticidet përbëjnë 10% të të gjithë intoksikacioneve, me një pik të detergjentëve vitit të dytë të jetës, produktet e petroliumit gjtë vitit të tretë, ndërsa pesticidet mbeten konstante gjatë gjithë fëmijërisë (19).

Në rast se në grupin e parë të fëmijëve <5 vjeç mbizotërojnë intoksikacionet medikamentoze, në grupet e tjera roli i medikamenteve zbehet për ti lënë vendin alkoolit, agjentëve abuzivë apo pesticideve të ndryshme, që në një pjesë të rasteve janë për qëllim suicidi.

Intoksikacionet në pjesën më të madhe kanë qënë aksidentale (86.2%) dhe vetëm një përqindje e vogël (4.7%) janë suicidale. Bie në sy që nëqoftëse në shpërndarjen e intoksikacioneve sipas seksit, ka një predominim të meshkujve në raport me femrat: 1,4/1 (predominim që e gjejmë dhe në studimet e tjera (2, 7, 8). Interesante është që intoksikacionet *suicidale* predominojnë vajzat e moshës > 12 vjeç dhe në të gjitha rastet
(12 raste) kemi patur prezent një konflikt në familje apo një situatë delikate, që e kanë çuar vajzën në një labilitet emocional dhe suicid. Fatkeqësisht 4 prej këtyre rasteve kanë patur përfundim fatal, sepse doza e helmit ka qënë letale. Predominimi i vajzave në intoksikacionet suicidale raportohet dhe nga studime të tjera (2, 4, 8) dhe vetëm në një studim (9) është vënë re predominim i meshkujve.

Nëse nuk mund të flasim me saktësi për incidencën e intoksikacioneve, sepse fëmijët që kanë marrë substanca me toksicitet të ulët, mbahen në observacion, pa patur nevojë të shtrohen, mund të flasim me saktësi për mortalitetin, që natyrisht nuk është i papërfillshëm (4.3%), por ajo që është e rëndësishme dhe që shihet qartë nga tabela 3 është se kemi një reduktim të vazhdueshëm të tij në vite, <10% dhe mortalitet 0 ne periudhën 2006-2008. Kjo mundet si rezultat i një njohjeje më të mire të intoksikacioneve, përmirësimit të kujdesit prespitalor dhe spitalor, gjithsesi nuk mund të themi me saktësi arsyet e rënies së mortalitetit.

Agjentët më të shpeshtë që kanë çuar në një përfundim letal kanë qënë:

- Phostoxin – aluminium phosphide (pesticide). Në përqëndrime 50ppm (parts per million), phosphine është menjëherë e rrezikshme për jetën. Në përqëndrime afërsisht 2000ppm, phosphine jep vdekje brenda disa minutave (16). Një studim tjetër në Marok tregoi që doza të phostoxin prej 3.3+/-1.8 g, kanë një mesatare të mortalitetit afërsisht 61% (20).

- Si dhe kërpudhat velenoze Amanita e Gallerina, ku prognoza mbetet mjaft serioze (shifrat e mortalitetit nga kërpudhat helmuese arrijnë në 5-10% (1), pasi vetëm marrja e 20-30g kërpudhave Amanita Phalloides është letale (15). Intoksikacionet nga kërpudhat tek këta fëmijë kanë ndodhur nga ngrënia e kërpudhave të mbledhura në pyll nga vetë familjarët dhe jo nga kërpudhat e tregtuara, të cilat natyrisht janë plotësisht të kontrolluara.

Pesticidet kanë një mortalitet sinjifikant dhe në Greqi (19% e suicideve), Turqi (21% e vdekjeve nga intoksikacionet) dhe Bullgaria (24% e të gjithë vdekjeve nga intoksikacionet) (17). Intoksikacionet nga kërpudhat përbëjnë një problem substancial në Greqi me shumë raste, ndryshe nga Shqipëria, por mortaliteti atje është i ulët 1% (18).

KONKLUZION

Pediatrit duhet të marrin në konsideratë mundësinë e helmimit, veçanërisht në fëmijët e moshës nën 6 vjeç dhe mbi 12 vjeç.

Faktorët kryesorë përgjegjës për intoksikacionet aksidentale mbeten mbikqyrja jooptimale nga ana e prindërve dhe prezenca e produkteve me toksicitet të lartë në shtëpi.

Prezenca e një numri të konsiderueshëm fëmijësh të intoksikuar, kërkon zhvillimin e një programi edukativ për parandalimin këtyre intoksikacioneve si dhe bën të domosdoshme zhvillimin e një Qëndre Shërbimi dhe Informimi Toksikologjie për mbështetjen e këtyre pacientëve, për një informacion sa më të mire prë popullatën, me qëllim trajtimin e tyre në kohë dhe sa më efikas.

LITERATURA

1. Abdollahi M, Jalali N, Sabzevari O, Hoseini R, Ghanea T. A retrospctive study of poisoning in Tehran.J. Toxicol Clin Toxicol. 1997;35: 387-393.
2. Behrman, Kliegman, Jusan. Nelson. Textbook of Pediatrics. 2003; 17th ed: 2355-2378.
3. Benjamin D. Mushrom poisoning in infants and children: Clin Toxicol. 1992; 30: 13.
4. Aronow R, Garretson LK, Grensher J, Krassner LS, McIntire MS, Othersen Jr, et al. Handbook of Common Poisonings in children. 1983; 2nd ed:22-138.
5. Litovitz TL, Klein-Schwartz W, Dyer KS, Shanan M, Powers M.1997.Annual Report of the American Association of Poison Control Centers Toxic Exposure Surveillance System.Am.J.Emerg Med. 2001; 19: 337-395.
6. Jarac Zewsha W, Kotwica M. Acute poisoning with drugs. Przeglzek 1997;54: 737-740.
7. James LP, Wells E, Beard RH, Farrar HC. Predictors of outcome after acetaminophen poisoning in children and adolescents. J Pediatr 2002; 140: 522-526.
8. James LP Kearns GL: Cyclic antidepressant toxicity in children and adolescents. J Clin Pharmacol. 1995; 35: 343-350.
9. Kent R.Olson: Poisoning & drug overdose. 2006; 5th ed: 39-276.
10. Lifshitz M, Shahah E, Safer S: Carbamate and organophosphate poisoning in young children. Peditr Emerg Care 1999; 15: 102-103.
11. Matityahu Lifshitz MD, Vladimir Gavrilov Md. Acute Poisoning in children., 2000; 2: 504-506.
12. Milev V, Mikkov D. Attempted suicide by poisoning in the Sofia region. J.Psychiatry 1992;160:560-562.
13. Petridou E, Polychronopoulou A, Komi N, Karpathios T, Koussouri M.Unintentional childhood poisoning in Athens:J Toxicol Clin Toxicol. 1997;35: 669-675.
14. Shanon M: Ingestion of toxic substances in children. N Engl J Med 2000;342: 186-191.
15. Aluminium Phosphine (Phostoxin) UnionSafe. (http://unionsafe.net.au/ hazards/ 11098227166696.html) 2005.
16. Woolf AD.Poisoning in children and adolescents.Pediatr Rev 1993;14: 411-422.
17. Tzafeta SG, Karampelas NA, Papadimitriou E, Ske-parni F.Toxicological aspects of sudden and violent deaths in Southwestern Greece: a three-year review (2001-2003) review of Clinical Pharmacology and Pharmacokinetics, International edition. 2004; 18:184-185.
18. Mila M, Tsamadou A, Sofidiotou V, Papathanassiou V, Valti E, Neon P. The incidence and outcome of mushroom Poisoning in Greece in Autumn 2002. Clinical toxicology. 2004;42:536.
19. Petridou E, Polychrionopoulou A, Kouri N, Karpathios Th, Koussouri M, Messaritakis Y, et al: Unintentional Childhood Poisoning in Athens: A Mirror of Consumerism? Clinical Toxicology, 1997; 35: 669 – 675.
20. Hajouji Idrissi M, Oualili L, Abidi K, Abouqal R, Kerkeb O, Zeggwagh A. Ann Fr Anesth Reanim. Severity factors of aluminium phosphide poisoning (Phostoxin).2006; 25:382-385.

SUMMARY

EPIDEMIOLOGICAL DATA OF POISONING IN CHILDREN

Ilirjana Bakalli[1], Elmira Kola[1], Robert Lluka[1], Ermela Gjyzeli[1], Aurel Vula[1],
Sashenka Sallabanda[1]
UHC "Mother Theresa"
[1]Paediatric Intensive Care Unit, Tirana, Albania

We report the results of a ten years retrospective study for poisoning in children. In this study are included 253 children with poisoning exposures, admitted at PICU, UHC "Mother Theresa", Tirana, for the period 2001-2010. It has been evaluated the frequency, the age, the type of exposure, route of exposure and the circumstances of poisoning. The peak age of poisoning was under 5 years old. 54.1% of cases were related to medicaments poisoning, pursued par the pesticides 21.7% of cases. Poisoning in 86.2% has been accidental.

Key words: *Poisoning, children*

PUNIM PROFESIONAL / PROFESIONAL PAPER
KIRURGJI TORAKALE

TRAJTIMI KIRURGJIKAL TEK TË SËMURËT ME KANCER TË MUSHKËRIVE

Rezart Oketa[1], Silvana Bala[2], Milda Nanushi[2], Jolanda Nikolla[1]

[1]Spitali Universitar i Sëmundjeve të Mushkërive "Shefqet Ndroqi", Tiranë, Shqipëri
[2]Departamenti i Sëmundjeve të Brëndëshme, Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri



Rezart Oketa, mjek kirurg torakal
Rr. Elbasanit, Pall Enri, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355694070607
e-mail: **oketarezart@gmail.com**

REZYME: *Rezeksioni kirurgjikal mbetet trajtimi i vetëm kurativ për pjesën më të madhe të pacientëve me Ca bronkopulmonar me qeliza jo të vogla (NSCLC), por dhe në rastet ku modalitetet e trajtimit, të bazuara në kimioterapinë neoadjuvante ose adjuvante, vlerësohen me benifice për pacientët, dhe ofrojnë nje avantazh të lehtë në mbijetesë, pjesa thelbësore e mjekimit i perket kirurgjisë. Trajtimi kirurgjikal i NSCLC bëhet i suksesshëm kur funksionon një ekip i specializuar kirurgjikal , i cili punon me metodika bashkëkohore, në një spital të paisur me mjetet moderne bashkëkohore dhe kur ky ekip, bën zgjedhje adekuate të tipit të rezeksionit dhe disekim të plotë dhe sistematik të limfonodulave.* ***Qëllimi:*** *Qëllimi i këtij studimi është përcaktimi i tipit të rezeksionit pulmonar në trajtimin e të sëmurëve me kancer të mushkërive.* ***Materiali dhe metoda****: Është marrë në studim një grup prej 151 të sëmurësh me kancer të mushkërive, të trajtuar kirurgjikalisht gjatë viteve 2000-2003 në Spitalin Universitar të Sëmundjeve të Mushkërive. Analiza statistikore është kryer me paketën statistikor SPSS for Windows, version 15.0.* ***Rezultatet:*** *Te dhënat e këtij studimi konsiderohen shumë te vlefshme për faktin se, kanceri bronkopulmonar është një problem madhor sot në botë.* ***Përfundim:*** *Zgjidhja e tij kirurgjikale mbetet rruga kryesore dhe radikale për të pasur një komoditet jetësor dhe jetëgjatsi.*

Fjalë kyç: *Kancer bronkopulmonar, intervent kirurgjikal, funksion respirator, Tipi Histologjik.*

Medicus 2011, Vol. XV (1):

HYRJE

Rezeksioni kirurgjikal mbetet trajtimi i vetëm kurativ për pjesën më të madhe të pacientëve me Ca bronkopulmonar me qeliza jo të vogla (NSCLC), por dhe në rastet ku modalitetet e trajtimit, të bazuara në kimioterapine neoadjuvante ose adjuvante, vlerësohen me benifice për pacientët dhe ofrojnë një avantazh të lehtë në mbijetesë, pjesa thelbësore e mjekimit i përket

kirurgjisë (1). Rrallë herë trajtimi kirurgjikal është një opsion trajtimi i përshtatshem për kancerin pulmonar me qeliza të vogla. Trajtimi kirurgjikal i NSCLC bëhet i suksesshëm kur funksionon një ekip i specializuar kirurgjikal, i cili punon me metodika bashkëkohore, në një spital të paisur me mjetet moderne bashkëkohore dhe kur ky ekip, bën zgjedhje adekuate të tipit të rezeksionit dhe disekim të plotë dhe sistematik të limfonodulave.

QËLLIMI I STUDIMIT

Përcaktimi i tipit të rezeksionit pulmonar në trajtimin e të sëmurëve me kancer të mushkërive.

MATERIALI DHE METODA

Studimi u realizua në Spitalin Universitar të Sëmundjeve të Mushkërive, në Repartin e Kirurgjisë Torakale. Studim është i tipit retrospektiv dhe përfshin 151 të sëmurë me kancer pulmonar të shtruar gjatë viteve 2000-2003 në këtë spital.

Ekzaminimi bronkoskopik si dhe biopsia bronkiale e bërë tek këto, fillimisht ndanë pacientët në dy grupe: Pacientë me Ca bronkopulmonar me qeliza të vogla dhe në pacientë me Ca bronkopulmonar me qeliza jo të vogla. Ky bëri hapin e parë të zgjedhjes së metodikës trajtuese. Përsa i përket ekzaminimeve të tjera si, provë funksionale respiratore, vlerësimi i statusit kardiologjik, vlerësimi biokimik i te gjithë sistemeve të tjera dhe skanerit pulmonar, këto janë vlerësuar si tepër te rëndesishme në vlerësimin e statusit klinik të pacientit.

Analiza statistikore e studimit u kryer me paketën statistikor SPSS for Windows, version 15.0.

REZULTATET

Në pasqyrat dhe grafikët e mëposhtëm janë paraqitur disa nga të dhënat kryesore të përgjithshme të grupit të pacientëve të marrë në studim, Tipet e interventeve kirurgjikale të zgjedhura në lidhje me moshën e pacientit, struktura e llojit të interventit në lidhje me tipin histologjik, me lokalizimin e patologjisë malinje, si dhe zgjedhja e ndërhyrjes kirurgjikale në vartësi të vlerësimit preoperator të pacientit.

Pasqyra 1 jep përmbledhtazi disa karakteristika bazë të pacienteve me Ca pulmoni të trajtuar kirurgjikalisht.

Pasqyra 1 – Karakteristika bazë te subjekteve me kancer te mushkërive të trajtuar kirurgjikalisht	
Meshkuj	138 (91.4%)
Mosha (vite)	56.6±9.9 (19 - 83)
Cigare/ditën	22±13.7
Vite fumacion	26±14.7
Paketa/vite	34±25.8
FVC % teorikut	94.8±12.4
FEV_1 % teorikut	85.2±16.5
PaO2 mmHg	85.5±11.5
PaCO2 mmHg	39.3±5.3
SaO2	95.5±3.6

Pasqyra 2.

Pacientët sipas moshës dhe llojit të interventit

Interventi	Nr.pacientëve	Mosha mesatare	Deviacioni standard	Variacioni
Segmentektomi	14	61.7	7.4	42-68
Lobektomi	98	56.5	10.5	19-83
Bilobektomi	14	55.3	8.1	38-66
Pulmonektomi	25	55.8	9.6	22-68

Në studimin tonë, sic shihet nga tabela 2, ka predominuar interventi kirurgjikal i tipit të lobektomise, i pasuar nga pulmonektomia , segmentektomia dhe bilobektomia. Nuk vihet re ndonjë lidhje sinjifikante midis moshës dhe zgjedhjes së tipit të ndërhyrjes kirurgjikale.

Pasqyra 3 . Pacientët sipas grupmoshës dhe llojit të interventit


Interventi		GRUPMOSHA							Total
		15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65-74	mbi 74	
segment	Nr.			1	2	6	5		14
	%			7,1%	14,3%	42,9%	35,7%		100,0%
lob	Nr.	1	1	12	27	33	21	3	98
	%	1,0%	1,0%	12,2%	27,6%	33,7%	21,4%	3,1%	100,0%
bilob	Nr.			2	3	7	2		14
	%			14,3%	21,4%	50,0%	14,3%		100,0%
pulmon	Nr.	1		1	7	12	4		25
	%	4,0%		4,0%	28,0%	48,0%	16,0%		100,0%
Total	Nr.	2	1	16	39	58	32	3	151

Pearson Chi-Square Asymp. Sig. (2-sided) ,921


Pasqyra 3 dhe grafiket e mëposhtëm japin të dhëna për zgjedhjen e tipit të interventit sipas grupmoshës, ku në grupin e pacientëve me moshë mesatare ka predominuar segmentektomi dhe tek pacientët me moshë më të re ka predominuar bilob- dhe pulmonektomia.

Grafiku 1.


Të sëmurët sipas moshës në rastet me segmentektomi




Grafiku 2.
Të sëmurët sipas moshës në rastet me lobektomi



Grafiku 3.
Të sëmurët sipas moshës në rastet me bilobektomi



Grafiku 4.
Të sëmurët sipas moshës në rastet me pulmonektomi



.

Pasqyra 4.


Pacientët sipas grupmoshës dhe anës së ndërhyrjes kirurgjikale

Ndërhyrja Kirurgjikale			GRUPMOSHA							Total
			15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65-74	mbi 74	
	E djathtë	Nr.	1		11	25	36	23	3	99
		%	1,0%		11,1%	25,3%	36,4%	23,2%	3,0%	100,0%
	E majtë	Nr.	1	1	5	14	22	9		52
		%	1,9%	1,9%	9,6%	26,9%	42,3%	17,3%		100,0%
Total		Nr.	2	1	16	39	58	32	3	151
		%	1,3%	,7%	10,6%	25,8%	38,4%	21,2%	2,0%	100,0%


Pearson Chi-Square Asymp. Sig. (2-sided) ,585

Siç shihet dhe nga pasqyra 4, janë studiuar dhe numri i kryerjes së interventeve i lidhur me anën e ndërhyrjes , ku numri më i madh i interventeve, i përket torakotomisë së djathtë.

Grafiku 5. Struktura e llojit te interventit (%) në lidhje me tipin histologjik




Pearson Chi-Square Asymp. Sig. (2-sided) ,374



Pearson Chi-Square Asymp. Sig. (2-sided) ,503

Në grafikët 5, 6 vihet re se, nuk kanë rezultuar ndryshime domethënëse në lidhje me llojin e interventit dhe tipin histologjik të kancerit pulmonar, por në rastet me kancer me qeliza të vogla është kryer vetem lobektomi, pulmonektomia më shpesh në format e tjera të karcinomës dhe në tipin skuamoz. Gjithashtu, megjithëse nga ana statistikore jo domethënëse, në të gjithë tipet histologjike, lezioni ka qënë më shpesh djathtas.



Pearson Chi-Square Asymp. Sig. (2-sided) ,011

Ne grafikun 7 evidentohet lloji i interventit, në lidhje me lokalizimin e Ca bronkopulmonar, dhe rezulton se ka diferenca statistikore domethënëse, ku pulmonektomia është kryer me tepër në anën e majtë, po ashtu dhe lobektomia; ndërsa bilobektomia djathtas, si dhe segmentektomia, por me diferenca të vogla.

Pasqyra 5. Pacientët sipas stadit preoperator dhe ndërhyrjes kirurgjikale

Ndërhyrja Kirurgjikale		Stadi pre-operator							Total
		1a	1b	2a	2b	3a	3b	4	
segment	Nr.		6	3	3			2	14
	%		42,9%	21,4%	21,4%			14,3%	100,0%
lob	Nr.	3	20	6	35	31	1	2	98
	%	3,1%	20,4%	6,1%	35,7%	31,6%	1,0%	2,0%	100,0%
bilob	Nr.	1	2		7	4			14
	%	7,1%	14,3%		50,0%	28,6%			100,0%
pulmon	Nr.		1	1	5	17	1		25
	%		4,0%	4,0%	20,0%	68,0%	4,0%		100,0%
Total	Nr.	4	29	10	50	52	2	4	151
	%	2,6%	19,2%	6,6%	33,1%	34,4%	1,3%	2,6%	100,0%

Pearson Chi-Square Asymp. Sig. (2-sided) ,001

Nga pasqyra 5 evindentohet se sa më i avancuar te jete stadi preoperator, aq dhe më radikale bëhet dhe ndërhyrja kirurgjikale. Për stadin e 3a , pulmonektomia ka qënë më e volitshmja, ndërsa për stadin e 1b ka predominuar segmentektomia.

Ka rezultuar ndërlidhje sinjifikative statistikore ndërmjet llojit të interventit dhe sistemit TNM (tumor, nodul, metastaze). Lidhja është më e fuqishme për T dhe M, meqë këto janë më lehtësisht të vlerësueshme klinikisht, ndërsa N në disa raste paraqet vështirësi. Dhe në lidhje me stadin e sëmundjes vërehet ndërlidhje statistikore sinjifikante, kjo më e fuqishme me stadizimin preoperator.

Pasqyra 6. Të semurët sipas vlerave të FVC preoperatore dhe llojit të interventit

FVC		Interventi				Total
		segment	lob	bilob	pulmon	
> 80%	Nr	10	87	10	25	132
	%	7,6%	65,9%	7,6%	18,9%	100,0%
80-70%	Nr	4	6	4		14
	%	28,6%	42,9%	28,6%		100,0%
70-50%	Nr		5			5
	%		100,0%			100,0%
Total	Nr	14	98	14	25	151
	%	9,3%	64,9%	9,3%	16,6%	100,0%

Pearson Chi-Square Asymp. Sig. (2-sided),005

Pasqyra 7. Të sëmurët sipas vlerave të FVC postperatore dhe llojit të interventit

FVC		Interventi				Total
		segment	lob	bilob	pulmon	
> 80%	Nr	6	65	6		77
	%	7,8%	84,4%	7,8%		100,0%
80-70%	Nr	2	15	2	7	26
	%	7,7%	57,7%	7,7%	26,9%	100,0%
70-50%	Nr	6	18	5	17	46
	%	13,0%	39,1%	10,9%	37,0%	100,0%
< 50%	Nr			1		1
	%			100,0%		100,0%
Total	Nr	14	98	14	24	150
	%	9,3%	65,3%	9,3%	16,0%	100,0%

Pearson Chi-Square Asymp. Sig. (2-sided),000

Pasqyra 8. Të sëmurët sipas vlerave të FEV1 preoperatore dhe llojit të interventit

FEV1		Interventi				Total
		segment	lob	bilob	pulmon	
> 80%	Nr				2	2
	%				100,0%	100,0%
50-80%	Nr	9	63	7	21	100
	%	9,0%	63,0%	7,0%	21,0%	100,0%
30-50%	Nr	5	35	7	2	49
	%	10.2%	71.4%	14.3%	4,1%	100,0%
Total	Nr	14	98	14	25	151
	%	9,3%	64,9%	9,3%	16,6%	100,0%

Pearson Chi-Square Asymp. Sig. (2-sided),02

Pasqyra 6, 7, 8 jep të dhëna për radikalitetin e ndërhyrjes, lidhur me funksionin respirator. Pas studimit të paternës respiratore, shihet se ndërhyrjet janë radikale, bilob ose pulmonektomi në ato pacientë, ku rezerva repiratore është e konsiderueshme.

DISKUTIMI

Studimi i kryer gjatë viteve 2000-2003 në Spitalin Universitar të Sëmundjeve të Mushkerive ka si qellim të tij, të evidentoj llojin e interventit kirurgjikal të zgjedhur sipas tipit histologjik te rezultuar. I gjithe ky studim retrospektiv, pas nje analize te hollesishme shkencore dhe statistikore, percaktoi qarte radikalitetin e nderhyrjes, i lidhur ky me tipin histologjik, stadit te Ca bronkopulmonar sipas TNM (tumor, nodul, metastaze), moshes se pacientit si dhe funksionit respirator te tij.

Ne rastet e marra ne studim, ne 14 (9.3%) paciente eshte kryer segmentektomi dhe ne 98 (64.9%) paciente lobektomi, bilobektomi ne 14 (9.3%) paciente dhe pulmonektomi ne 25 (16.5%) paciente. Nuk rezulton ndonje nderlidhje domethenese ndermjet grupmoshes dhe llojit te interventit te aplikuar, por sic shihet nga pasqyra nr.3 dhe grafike1, 2, 3, 4 mesatarja e moshes eshte me e madhe ne segmentektomi dhe me e re per bilob- dhe pulmonektomi.

Me shpesh nderhyrjet kirurgjikale ne total jane te djathta, ne 99 paciente ose 65.6% te tyre.

Sipas nje punimi (2) nga 8063 paciente me kancer bronkial, 23% ju nenshtruan torakotomise, ku ne 5.5% nuk u shoqerua me procedure tjeter kirurgjikale (rezeksion). Mosha mesatare e pacienteve te operuar eshte 64 vjec nga ku 89% e pacienteve jane meshkuj. Pacientet me pneumonektomi jane me te rinjte (64 vjeç), ata me bilobektomi (67 vjec, $p<0.01$) ose lobektomi (66 vjec, $p<0.01$). Nga pacientet me pulmonektomi, 24% jane ne moshe ≥70 vjec, krahasuar me 29% te atyre me lobektomi dhe 35% te atyre me bilobektomi (3). Sipas nje punimi tjeter mosha mesatare e pacienteve ishte 59.7+2.4 vjeç; 7.6% ju nenshtruan rezeksioneve sublobare, 36.4% iu nenshtruan lobektomise dhe 12,1% pulmonektomise. Limfodiseksioni mediastinal ka qene nje faze e detyrueshme ne te gjitha rastet e trajtimit kirurgjikal (4). Nga interventet me te rrezikshme persa i perket morbiditetit dhe mortalitetit eshte pulmonektomia (5). Nje numer i autoreve mendojne, qe indikacioni per kete tip interventi te behet me kujdes ekstrem ne paciente ne moshe te vjeter (3), duke qene se eshte operacion me frekuencen me te larte te morbiditetit (6), por ka dhe studime qe kane bere krahasimin e ketij tipi interventi, me te tjeret, dhe nuk kane rezultuar ndryshime sinjifikante, kjo dhe kur eshte bere per paciente te moshes mbi 75 vjeç (5).

Interventi me i zakonshem per karcinomen e mushkerive eshte lobektomia (ose pulmonektomia). Gjithsesi, per paciente me funksion pulmonar te kufizar, operacionet e zgjeruara perbejne nje vdekshmeri te larte. Shpikja e VATS ka sjelle mundesine per te operuar me pak, me nje prerje minimale, me nje potencial per te ulur morbiditetin. Ne kanceret periferik (T1 N0) mund te arrihet e njejta mbijetese afatgjate, nderkohe qe parenkima pulmonare e rezekuar eshte e paket. Ne lidhje me kete eshte kryer nje studim nga "Lung Cancer Study Group" (7). Ne grupin e rezeksioneve te limituara kerkesa per ndihme mjekesore u trefishua dhe numri i vdekjeve u rrit me 30% e krahasuar me grupin e atyre me lobektomi. Arsyet e forta per kete mund te jene qelizat kanceroze ne limfonodulet lobare ose ne limfonodulet intrapulmonare, te cilat mund te mos hiqen me operacione te kufizuara. Sugjerimet statistikore jane qe lobebtomia vazhdon te jete proceduara e zgjedhur. Rezeksione me te kufizuara permbajne me shume risk, reduktojne mbijetesen dhe duhet te behen vetem ne raste te veçanta.

Gjate operacioneve te kancerit te mushkerive ka shume rendesi vemendja ndaj pastrimit te limfonodulave. Por ka opinione te ndryshme mbi aplikimin e disekimit te plote mediastinal (8, 9). Ne nje studim nga "Estern Oncology Group" u arrit ne perfundimin qe pacientet ne stadin II dhe stadin IIIA te cilet ju nenshtruan ekstirpimit te plote mediastinal paten nje permiresim te mesatares se mbijeteses, ndaj atyre pacienteve qe ju nenshtruan vetem ekstirpimit te limfonodulave te zgjedhura gjate observimit (57.5 ndaj 29.2 muaj) (10).

Ne pacientet me rezerva te mjaftueshme pulmonare, (bi)lobektomia preferohet me shume se pulmonektomia. Operacione minimale si pershembull wedge dhe segmentektomi kryhen ne paciente me rezerva pulmonare te vogla (3).

Pas konfirmimit te mundesise anatomike për rezeksion te lezineve kanceroze, pacienti duhet t'i nenshtrohet nje vleresimi te gjithaneshem, per te percaktuar aftësine e organizmit, për të përballuar opeacionin dhe mungesën e pjesës së rezekuar pulmonare (11).

Ne te semuret e marre ne studim rezultojnë, se ne percaktimin e llojit te interventit eshte konsideruar gjendja funksionale respiratore pulmonare, ndermjet te cileve, rezulton lidhje statistikore domethenese. Nga te gjithe keta tregues, FEV_1 mendohet te jete me i mire ne vleresimin fillestar, si ne lidhje me nderlikimet operatore ashtu dhe ne marrjen e vendimit per nderhyrje (11).

Vlerat post operatore te FVC rezultojnë te zvogëluara, si pasoje e rezeksionit te parenkimes pulmonare, por sidoqoftë, vetem ne nje rast jane nen vleren 50% te teorikut.
Nuk u vune re, ndryshime domethenese ne dite qendrimin ne lidhje me llojin e intervetit.
Mireqenja shendetesore e pacienteve te operuar, ne peridhen post operatore varet dhe nga lloji dhe shtrirja e rezeksionit (4).

PËRFUNDIM

1. Tipi me i shpeshte i interventit eshte lobektomia. Nuk ka rezultur ndonje nderlidhje domethenese ndermjet te grupmoshes dhe llojit te interventit te aplikuar, por mesatarja e moshes eshte me e madhe ne segmentektomi dhe me e re per bilob- dhe pulmonektomi.
2. Pulmonektomia eshte kryer me teper ne anen e majte, po ashtu dhe lobektomia; ndersa bilobektomia djathtas, si dhe segmentektomia.
3. Ka nderlidhje sinjifikative statistikore ndermjet llojit te interventit dhe TNM. Lidhja eshte me e fuqishme per T dhe M, me qe keto jane me lehtesisht te vleresueshme klinikisht, ndersa N ne disa raste paraqet veshtiresi.
4. Stadizimi postoperator ka rezultuar me i avancuar, gje qe flet per aplikimin e metodave dhe mjeteve me invasive per te arritur nje vleresim sa me real.
5. Mbijetesa postoperatore ka rezultuar ne shifra me te ulta se e literatures, e lidhur kjo me stade te avancuara te semundjes .

LITERATURA

1. The International Adjuvant Lung Cancer Trial Collaborative Group. Cisplatine-based adjuvant chemotherapy in patients with completely resected non-small cell lung cancer. N Engl J Med 2004;350:351-60.
2. Hoover R. Pathogenesis and therapy of lung cancer. Marcel Dekker, New York, 1978.
3. Van Meerbeeck JP, Damhuis RAM, Vos de Wael ML. High postoperative risk after pneumonectomy in elderly patients with right-sided lung cancer. Eur Respir J 2002; 19:141-145.
4. Aminodov S, Ryabova E,Kuligina M. Changein the Quality of Life of Patients with Non-Small Cell Carcinoma of Lung in I-II Stages after Surgical Treament. Regional Oncologic Dispensary, Ivanovo, Russia.
5. Freixinet J L, Julià-Serdà G, Rodríguez P M, Santana N B, Rodríguez de Castro F, Fiuza M D, López-Encuentra A. Hospital volume: operative morbidity, mortality and survival in thoracotomy for lung cancer. Eur J Cardiothorac Surg 2006;29:20-25.
6. Birkmeyer JD, Siewers AE, Finlayson EVA, Stukel TA, Lucas FL, Batista I, Welch HG, Wennberg DE. Hospital volume and surgical mortality in the United States. N Engl J Med 2002;346:1128-1137.
7. Ginsberg RJ, Rubinstein LV, for the Lung Cancer Study Group. Randomized Trial of lobectomy versus limited resection for T1 N0 non-small cell lung cancer. Ann Thorac Surg 1995;60:615-23.
8. Naruke T. "Mediastinal lymph node dissection" in Shields TW (ed.). General Thoracic Surgery, Malvern, PA: Williams and Wilkins, 1994, pp 469-480.
9. Shields TW. The "incomplete" resection. Ann Thorac Surg 1989;47(4):487-8.
10. Keller SM, Adak S, Wagner H, Johnson DH. Mediastinal lymph node dissection improves survival in patients with stages II and IIIA non-small cell lung cancer. Eastern Cooperative Oncology Group. Ann Thorac Surg 2000 Aug;70(2):358-65.
11. Datta D, Lahiri B. Preoperative Evaluation of Patients Undergoing Lung Resection Surgery Chest. 2003;123:2096-2103.

SUMMARY

SURGICALLY TREATMENT IN PATIENTS WITH PULMONARY CANCER

Rezart Oketa[1], Silvana Bala[2], Milda Nanushi[2], Jolanda Nikolla[1]

[1]University hospital of pulmonary disease "Shefqet Ndroqi" Tirana, Albania.
[1]Fakulty of Medicine, Department of interne medicine, Tirana, Albania.

The surgery resection remains the only curative treatment for most patients with bronchopulmonary cancer non-small cell (NSCLC), but even in cases where the treatment modalities, based on neoadjuvant or adjuvant chemotherapy, are evaluated with benefice for patients and offer a slight advantage in their survival, essential part of treatment belongs to surgery. NSCLC surgical treatment is successful when does exist a specialized surgical team, which works with contemporary methods, in a hospital equipped with modern tools and when the team makes an adequate choice of the type of resection and a comprehensive and systematic dissection of lymph nodes. The aim of this study is: "The determination of pulmonary resection type in treating patients with lung cancer". Material and methods: The survey was taken in a group of 151 sick with lung cancer, surgically treated, during 2000-2003 in the University Hospital of Lung Disease. Statistical analysis was performed with SPSS statistical package for Windows, version 15.0.

Key words: *Cancer bronchopulmonary, surgery intervent, respiratori function**,** Type Histology*

PUNIM PROFESIONAL / PROFESIONAL PAPER
KIRURGJI TORAKALE

TRAJTIMI I MEDIASTINITIT NEKROTIZANT ZBRITËS

Fadil Gradica[1], Dhimitraq Argjiri[2], Fahri Kokiqi[1], Agron Menzelxhiu[1], Zef Perduka[3], Ilir Skenduli[1], Alma Cami[1], Alban Hatibi[1], Epaminonda Fype[1]

[1]Shërbimi Kirurgjisë Torakale dhe Anestezi-Reanimacion,ë Spitali Universitar i Sëmundjeve të Mushkrive, Tiranë, Shqipëri
[2]Sherbimi i Pneumologjise ,Spitali Universitar i Sëmundjeve të Mushkrive, Tiranë, Shqipëri
[3]Shërbimi Pneumologjisë, Rreshen, Shqipëri



Fadil Gradica, mjek, kirurg torakal
Rr.”Komuna e Parisit” Pall.”Erlad” Ap.1.Shk.1 Tiranë. Shqipëri
Tel: ++355(0)682130841
e mail: **fadilgradica@yahoo.com**

REZYME: Permbajtja: Mediastiniti nekrotizant zbritës (DNM) prezanton një formë shumë të rëndë të infeksionit mediastinal i cili kërkon diagnozë dhe trajtim të shpejtë, për të reduktuar mortalitetin e lartë, lidhur me këtë sëmundje. Trajtimi kirurgjikal apo ndonjë formë optimale e drenazhit mediastinal mbetet e diskutueshme. **Qëllimi:** Eksperienca jonë në trajtimin e 12 pacientëve me DNM trajtuar me drenazh te hërshëm dhe intervent të madh kirurgjikal mediastinal. **Materiali dhe metoda:**. Për periudhën 7 vjeçare ne kemi trajtuar 12 pacient në institucionin tonë me mediastinit nekrotizant zbritës (DNM). Simptomat e pacientëve në shtrim kanë qëne: pireksia (n=12), odynofagia (n=9), edema e qafës (n=12), disfagia (n=10), takipnea (n=10), takikardia (n=7), hypotension (n=3), rigiditet të qafës dhe mandibulës si dhe trizmus në (n=2) pacient. Sipas gjinisë kane rezultuar 11 pacient meshkuj dhe 1 paciente femër. Mosha mesatare 40±13,6 vjeç qe varion nga 19 deri në 67 vjeç. Infeksioni primar orofaringeal ishte në 8 pacient dhe absces dental në 4 pacient. Trajtimi kirurgjikal ka konsistuar në te gjithë pacientët, te cilët janë trajtuar me drenazh cervikal bilateral, kjo shoqëuar me drenazh torakal unilateral në 5 pacient dhe bilateral ne 7 pacient. Dy pacient janë trajtuar nëpërmjet procedures kirurgjikale të sternotomisë mediane totale . Po ashtu dy pacient janë trajtuar me anë të torakotomisë së djathtë, ndersa me anë të torakotomisë së majtë një pacient. Në një pacient është realizuar torakotomi anterolaterale bilaterale me sternotomi transversale sipas Clamshell. Procedura kirurgjikale perfshinte: pastrimin radikal kirurgjikal të indeve të devitalizuara në mediastin me ekscizionin komplet të indeve nekrotike, dekortikimin pleural dhe drenazhin pleuro-mediastinal të përshtatshëm për lavazhin e pleuromediastinal. Me drenazh mediastinal transcervikal (collar incizion) është trajtuar një pacient. **Rezultatet**: Rezultate te favoreshme patem në nëntë (9) pacient, shtatë (7) prej të cilë ve janë trajtuar me disa drenazhe cervikale dhe drenazh mediastinal transcervikal dhe transpleural. Një pacient trajtuar me torakotomi bilaterale (clamshell torakotomi) dhe drenazh mediastinal. Tre (3) pacient kanë bërë vdekje nga mediastiniti, një pacient në ditën e 37 pas drenazheve cervikale dhe mediastinale kurse nje tjetër pacient vjen në gjëndje tepër te rende dhe ben vdekje te menjëherëshme nga shoku septik pak ore pas fillimit të sëmundjes sapo arrin në spital. Pacienti i tretë, u diagnostikua shumë shpejt pasi vjen nga

klinika e ORL në gjendje tepër të rëndë, rreth 10 orë pasi kishte filluar sëmundja dhe vdes disa orë pas interventit kirurgjikal të sternotomisë, absces nekeoektomisë dhe drenazhit adekuat pleuromediastinal. Shkaku i vdekjes në të tre rastet është gjendja e rëndë e shokut septik nga mediastiniti nekotizant zbritës. Disa pacientë nuk u trajtuan me torakotomi por vetëm me drenazh cervikal, kjo për shkak se absesi ishte i kufizuar vetëm në mediastinin anterior dhe të sipërm. **Konkluzion**: Trajtimi me drenazh mediastinal transcervikal është i justifikuar në pacientët në të cilët sëmundja është shumë e kufizuar në mediastinin e sipërm anterior. Gjithashtu sepsisi mediastinal mund te kërkoje drenazh të ri nëpermjet torakotomisë e cila duhet të bëhet menjëherë. Mediastiniti i gjëre nuk mund të trajtohet në mënyrë adekuate pa drenazhin mediastinal duke përfshirë dhe torakotominë. Trajtimi kirurgjikal agresiv ka ulur vdekshmërinë në 25% në 12 pacientët tanë pasi kjo sëmundje ka vdekeshmëri të lartë .

Fjalë kyç: Mediastinit zbritës, nekrotizant, torakotomi, sternotomi

Medicus 2011, Vol. XV (1):

HYRJE

Shumica e infeksioneve mediastinale akute janë rezultat i perforacionit të ezofagut për-rshkruar për herë të parë në vitin 1724 nga Boerhaave's ose i infeksioneve që pasojnë procedurat kardiake transtorakale. Gjithashtu mediastiniti akut mund të jëtë rezultat i abscesit orofaringeal "angina Ludwig", nga një infeksion i rëndë cervikal që përhapet gjatë planeve fasciale cervikale deri në mediastin. Kjo është kryesisht forma më virulente dhe është pë- rshkruar si DNM. Kriteret për diagnozë të DNM janë vendosur nga Estera dhe kolege (1). Vonesa në diagnozë dhe drenazhi i vonuar ose jo i përshtatshëm i mediastinit, janë shkaqet kryesore për vdekeshmërinë e lartë të kësaj së mundje me rezikshmeri te larte per jetën . Kjo së mundje kërkon diagnozë dhe trajtim adekuat te menjëherëshëm. Trajtimi kirurgjikal mbetet i diskutueshem, kryesisht për formën e drenazhit mediastinal optimal qe varion nga drenazhi i vetëm cervikal deri në bërjen rutinë të torakotomisë. Ne raportojmë eksperiencën tonë në trajtimin e 12 pacientëve me drenazh të hershëm dhe të madh kirurgjikal mediastinal, e cila ka pë rmiresuar rezultatet e vdekeshmërisë të cilat janë shumë të larta (rreth 30%-40%) sipas literatures (1, 2). Përdorimi rutinë i trajtimit agresiv kirurgjikal ka bërë që rezultatet e vdekeshmërisë të jenë relativisht të ulta rreth 25% (3).

QËLLIMI I PUNIMIT

Punimi ynë ka për qëllim të pasqyrojë eksperiencën tonë në trajtimin e 12 pacientëve me mediastinit nekrotizant zbritës (DNM), trajtuar me drenazh të hershëm dhe intervent të madh kirurgjikal mediastinal.

MATERIALI DHE METODA

Për një periudhë rreth 7-vjeçare ne kemi trajtuar 12 pacient me DNM, në Shërbimin e Kirurgjisë Torakale te SUSM Tiranë. Të gjithë rastet janë vlerësuar në bazë të kritereve të Estera. Këto kritere përfshijnë : 1) manifestimi klinik nga infeksioni i rëndë orofaringeal; 2) demonstrimi karakteristik i mediastinitit në rontgenografi; 3) dokumentimi i mediastinitit nekrotizant në operacion ose post mortem; 4) vendosja e lidhjeve midis infeksionit orofaringeal dhe zhvillimit të procesit mediastinitit nekrotizant. Në çdo rast ne kemi vënë re lidhje të qartë mes tyre. Sipas gjinisë rezultojne 11 pacient meshkuj dhe 1 paciente femër. Mosha mesatare 40±13,6 vjeç që varion nga 19 deri në 67 vjeç. Infeksioni primar orofaringeal ishte në tetë pacient dhe abscess dental në katër pacient. Të gjithë pacientët janë trajtuar fillimisht me antibiotikoterapi. Me sëmundje shoqëruese kanë qënë pesë pacient, nga te cilet tre pacient ishin përdorues të alkolit dhe të duhanit, një paciente me diabet mellitus dhe sëmundje pulmonare obstruktive, kurse një pacient me anemi të rëndë. Vonesa në diagnozën e sëmundjes dhe hospitalizimit në Kirurgji Torakale varion nga 2-7 ditë (mesatarisht 3 ditë). CT- skaner preoperator është realizuar në të gjithë pacientët për të vlerësuar

terapinë si dhe ndjekjen e mëtejshme, ndërsa CT-sckaner post operator nuk është arritur të bëhet në të gjithë pacientet. Shënjat e infeksionit mediastinal që demonstrohen me anë të CT skanerit përfshijnë : 1) infiltrimin me bula gazose të indeve të buta mediastinale (Fig 1); 2) koleksion likidi të pa kapsuluar mediastinal (Fig 1) dhe 3) abscesin mediastinal (Fig 2, 3). Në çdo rast kirurgjia ka konsistuar ne një ose disa drenazhe cervikale. Me drenazhe pleurale uni ose bilaterale jane trajtuar 11 pacient. Drenazhi mediastinal transcervikal është përdorur në një pacient. Incizioni cervikal zakonisht bëhet anteriorisht muskulit sternokleidomastoideus ose një incizion collar bilateral. Hapsirat cervikale të përfshira hapen, pastrohen nga zonat nekrotike dhe të dëmtuara si dhe drenohen. Plagët cervikale janë lënë të hapura. Kurse procedura torakale përfshinë kirurgjinë radikale, debridmimin kirurgjikal të mediastinit me ekscizion komplet të indeve nekrotike, dekortikimin, drenazhin pleural dhe në disa raste drenazhin e perikardit. Vendosje e drenave torakal bëhet në mënyrë të tillë që të shërbejnë në mënyrë sa më adekuate për lavazhe të vazhdueshme pleuromediastinale. Drenazhi i hapur i mediastinit është realizuar me drena plastik polietileni ose propiletileni me numër (28F-40F) me vrima të mëdha që kanë lejuar lavazhin pleuromediastinal. Zgjatja e drenazhit dhe lavazhit pleural ka qënë në vartësi të ecurisë klinikëm, të aspektit normal të CT skanerit dhe rezultateve bakteriologjike të kulturës së aspiruar nga dreni mediastinopleural.




Fig.1




Fig.2a




Fig.2b

Fig 1. CT- scan duket mediastinit anterior me koleksion likidi të pa kapsuluar dhe gas
Fig 2 (a,b). CT scan vihet re abscess paratrakeal djathtë mediastin posterior i cili përhapet poshtë në karinë dhe dy hapsirat pleurale lidhur dhe me emfizemën e mediastinit të sipërm anterior




Fig.3a

Fig.3b

Fig.3 (a,b). demonstron abscesin mediastinal anterior dhe pleural bilateral i cila kërkon intervent kirurgjikal



Fig.4a



Fig.4b




Fig.5a




Fig.5b




Fig.5c



Fig.5d

Fig.4 (a,b). Edemë e qafës dhe skuqje e lekurës se qafës dhe pjesës se sipërme torakale. Drenazh submandibular dhe cervikal

Fig.5(a,b). Torakotomi dekster incizioni Cllamshell

Fig.(5c,d). Sternotomi dhe torakotomi dekster shoqëruar me drenazhe pleuromediastinale

REZULTATET

Në të gjithë rastet është observuar klinikisht infeksioni cervikal (edemë difuze e dhi mbshme e qafës, emfizema e qafës ose prezenca nën lëkuren e ajrit) si dhe prezenca e insuficiencës respiratore, me rritje të simptomave të infeksionit të cilat kanë sugjeruar për mediastinit. Koha midis ndodhjes së simptomave torakale dhe drenazhit mediastinal varion nga 1-5 ditë, mesatarisht 2 ditë . Radiografia torakale tregonte zgjerim të hijes mediastinale në 9 pacient, pneumomediastin në 7 pacient, likid pleural në 11 pacient. Në çdo rast CT skaneri ka konfirmuar diagnozën e DNM, prezencën e abscesit cervikal ose celulitit cervikal me emfizemë e lidhur kjo me mediastinitin difuz, ose me koleksionin mediastinal; respekrivisht: empyeme pleurale në 11 pacient, pneumomediastinit 7 pacient, perikardit 5 pacient. Mediastiniti difuz është gjetur si infiltrim i indeve të buta >25 HU ose obliterimi i planeve normale të indeve dhjamore (Fig. 1). Abscesi mediastinal pë rmban një koleksion të qartë të likidit me ose pa hydronivele (<20 HU) (Fig. 2, 3). Lloj i torakotomisë dhe i anës së ndërhyrjes torakotomike është bërë në bazë të kompartmentit mediastinal të përfshirë dhe prezencës së likidit pleural të evidentuar ne Skanerin torakal. Gjetjet operatore dhe procedurat kirurgjikale të përdorura janë paraqitur në Tabelën 1. Zgjatja e drenazhi mediastinal varion nga 8-37 ditë (mesatarisht 20 ditë).

Rezultatet bakteriologjike të materialit të marrë nga qafa, pleura, mediastini, perikardi dhe gjaku u vleresuan në të gjitha rastet. Infeksioni ka rezultuar polimikrobik me kulturë mikste aerobe dhe kulturë aneorobe. Në shumicën e rasteve është izoluar stafilokoku (7 pacient), Streptokoku aerob (11 pacient), *Pseudomonas aeruginosa* (6 pacient), *Bacteroïdes* (4 pacient) dhe *Fusobacterium* (3 pacient).

Rezultate të favoreshme kishim në 9 pacient nga të cilët u trajtuan me drenazh pleuromediastinal nëpërmjet minitorakotomisë kater pacient, dy pacient me torakotomi të hapur, një pacient me Clamshell torakotomi, ne dy pacientë sternotomisë. Një pacient ka bërë ekzitus letalis një orë pas intubimit nga shoku septic. Rast i dytë bën exitus letalis 36 orë pas interventit kirgjikal nga shoku septik. Rasti i tretë bën ekzitus letalis në ditën e 37-të pasi u trajtua me anë të drenazheve të shumta cervikale bilaterale në koperim dhe me kirurgët maksillofacial dhe minitorakotomive bilateral. Një pacient është rioperuar për shkak të prezencës së koleksionit postoperator në ditën e tretë postoperatore në kavitetin pleural sinistër i cili nuk kontrolloheshe nga drenazhet e më pareshme. Është bërë torakotomi sinistër, debritmo i kavitetit pleural dekortikim et lavazh pleural sinistër et drenazh pleuromediastinal adekuat. CT- skaneri post operator në nente pacientet nuk kishim mbeturina të mëdha të mediastinitit dhe bëhet dalje nga spitali.

Tabela 1.

Për rmbledhja e 12 pacientë ve me DNM

Rastet	Mosha në vite	Origjina	Shtrirja infeksionit	Ndë rhyrja kirurgjikale	Rezultati
1	47	Absces peritonsillare	Abces cervikal bilateral Mediastinit anterior Perikardit purulentEmpyemë pleurale bilaterale	Cervikotomi bilateral Drenazh pleuraomediastinal bilateral (refuzon intervention kirurgjikal).	Ekzitus letalis ditë n e 37 nga perikarditi dhe shoku septik dhe insuficiencë multiorganore
2	57	Absces peritonsillare	Absces cervikal	Cervikotomi bilateral	Shëruar

			bilateral. Mediastinit anterior	Mediastnotomi anterior.	
3	39	Absces peritonsillare	Absces cervikal bilateral.Absces mediastinal posterior Empiem pleurale dekster	Cervikotomi bilateral.Mediastinotomi posteriore Torakotomi e djathtë	Shëruar
4	43	Absces dentar	Absces cervikal i djathte Mediastinit anterior	Cervikotomi dekster Mediastinotomi anterior dekster	Shëruar
5	21	Absces peritonsillar	Absces cervikal bilateral Mediastinit anterior Empieme pleurale bilateral Anemi e rëndë ,gjendje shoku septik.	Cervikotomi bilateral Drenazh pleuromediastinal bilateral. Hemotransfuzion	Shëruar
6	40	Absces peritonsillare	Absces cervikal bilateral Mediastinit anterior Perikardit purulent Empiemë pleurale bilateral Shok septik (anuri)	Cervikotomi bilateral Drenazh pleural bilateral Sternotomi mediana totale Drenazh pleura mediastinal bilateral. Drenazh mediastinocervikal Drenazh perikardik	Exitus letalis 36 orë pas interventit lirurgjikal (shok septik)
7	35	Abces dentare	Abces cervikal bilateral Mediastinit posterior Perikardit purulent Empiemë pleurale bilateral Shok septik	Cervikotomi bilateral Drenazh pleural bilateral Respiracion mekanik	Ekzitus letalis 1 orë pas intubimit.
8	19	Absces dentar	Celulitis cervikal bilateral Empiemë pleurale	Cervikotomi bilateral Drenazh pleural sinistë r	Shëruar

			sinistë r		
9	35	Abscë s peritonsillar	Abscess cervikal bilateral.Mediastinit anterior dhe posterior.Perikardit purulent Empiemë pleurale bilateral.	Cervikotomi bilateral Sternotomi totale.Drenazh pleuromediastinal bilateral. Drenazh perikardik Reintervent Torakotomi sinistë r ri drenazh pleuromediastinal dite e 3- pos interventit parë .	Shëruar Trajtuar spitali ushtarak kirurgji torakale.
10	35	Absces peritonsillare	Absces cervikal bilateral Abscess mediastinal posteror bilateral Perikardit purulent Empiemë pleurale bilaterale	Cervikotomi bilateral.Drenazh pleuromediastinal bilateral Intervent kirurgjikal torakotomi bilateral et sternotomi transfversale anterior Tip Clamschell re drenazh cerviko mediastinal.Drenazh perikardik.Drenazh pleuromediastinal bilateral.	Shëruar
11	48	Abscess dentar	Abscess cervical bilateral Mediastinit posterior Empiemë pleurale dekster	Cervikotomi bilateral Torakotomi posterolaterale dekster Drenazh pleuromediastinal dekster	shëruar
12	67	Absces dentar	Absces cervical bilateral Mediastinit anterior Empiemë pleurale dekster	Cervikotomi bilateral dekster Mediastinotomi anteriore Drenazh pleuromediastinal dekster	Shëruar.

DISKUTIMI

Shumica e gjendjeve të rënda dhe probabilisht dhe e shumë vdekjeve nga mediastiniti vjen si rezultat i nekrozave të ndryshme difuze që ndodhin si rezultat i komplikacioneve nga infeksioni në orofarings dhe që është përkufizuar me DNM. DNM është një entitet klinik jo i zakonshë. M. Brunelli dhe bashkëpunëtorë raportuan 58 raste (5). Corsten dhe bashkëpunëtorë kane raportuar 69 raste nga viti 1960-1995 (6). Në periudhën e preantibiotike, Pearse (2) ka raportuar 110 pacient me mediastinit nga infeksioni cervikal, ku 21 prej tyre rezultuan nga infeksioni orofaringeal. Megjithëse sëmundje e rralle kjo formë e mediastinitit është një variant i sëmundjes me vdekshmëri të lartë në studimet e bëra nga Estrera dhe bashkëpunëtorë (1), të cilët raportojne rreth 40%. Në studimin tonë

të eksperiencës fillestare vdekeshmeria rezulton 25% e cila nuk tregon një shifër të lartë krahasuar me studimet në literaturë .

Infeksioni ka origjinën nga dyshemeja e gojës, planet fasciale cervikale të kokës dhe të qafës qe shpërndahen poshtë në mediastin nëpërmjet fascieve cervikale, thjeshtë me anë të gravitetit të frymëmarrjes dhe presionit negativ intratorakal. Lidhjet anatomike midis fascieve cervikale, fascies superficiale dhe tre shtresave të thella të fascies cervikale (superficiale viscerale dhe prevertebrale) janë themelore për të kuptuar anatominë e infeksionit të thellë të qafës dhe të mediastinit. Këto shtresa të qafës kanë disa hapsira potenciale si (hapsira pretrakeale, hapsira retrofaringeale, hapsira perivaskulare, dhe hapsira parafaringeale) që mund të shërbejnë të gjitha si portë hyrje e infeksionit në mediastin (Fig. 4). Rruga që pë rshkon më shpesh infeksioni është nga hapsira faringeale nëpërmjet hapsirës retroviscerale ne mediastinin inferior(7).





Fig. 4. Rruga e që rhapjes së infeksionit orofaringeal në mediastin

Diagnoza e DNM tregon një lidhje të qartë midis mediastinitit dhe infeksionit orofaringeal. Në seritë e klinikës sonë infeksioni primare orofaringeal është abscesi peritonsillare i pasuar nga abscesi dental. Sipas studimeve të Wheatley dhe bashkëpunëtorë (25 nga 43 rastet), është evidentuar se DNM është pasojë e infeksionit primare odontogjenik si absces mandibulare ose i molarit të tretë (6) dhe absces peritonsilare në serit tona (8 nga 12 rastet). Diagnoza e vonëshme është një arsye madhore për vdekeshmërinë e lartë që ka kjo së mundje. Diagnoza e infeksionit cervikal është klinikisht e dukeshme, por diagnoza e hershme e DNM është shpesh e vështirë, për shkak të simptomave vagale që përfshihen dhe implikojnë simptomat mediastinale. Ekzaminimi radiografik i qafës dhe kraharorit mund të zbuloje disa karakteristika: zgjerimi i hapsirës retroviscerale (me ose pa hydronivel); zhvendosjen anteriore të kolones aerike trakeale; emfizemës mediastinale dhe zgjerim i hapsirës mediastinale superiore. Megjithëse këto shënja duken shumë vonë në dekursin e sëmundjes. Për më tepër procedorat e mëpareshme (drenazhi, trakeostomia) dhe shërbimi teknik intensiv mund të bëjnë që interpretimi i radiografise torakale të jetë i vështirë. Diagnoza e mediastinitit me anë të radiografise torakale është vendosur vetëm në 2 pacient në studimin tonë (emfizemë mediastinale). Në gjithë rastet e tjera CT-skaner ka konfirmuar diagnozën e mediastinitit me një saktësi të lartë, duke treguar infiltracion të indeve të buta me humbje të planeve dhjamore normale ose me koleksion dens të likidit me ose pa prezencën e bulzave të gazit. Prerjet nga nje centimetr te skanerit cervikotorakal demonstron vazhdimin e procesit infeksioz midis qafës dhe toraksit duke vendosur lidhjen midis infeksionit cervikal dhe mediastinitit. Një sindromë e rendë

infeksioze, prania e infeksionit cervikal si dhe aspekti i mediastinitit në CT skaner, është një sygjerim i lartë për DNM. Terapia intravenoze me antibiotik të spektrit të gjërë veprimi vetëm nuk është efiçent pa drenazhin kirurgjikal cervikal adekuat dhe të koleksionit mediastinal, debridmimin e gjërë dhe ekscizionin e indeve nekrotike me lavazh të gjërë pleuromediastinal. CT skaner torakal preoperator mund të jap informacion të saktë për kompartmentet mediastinale të përfshira në proceset nekrotike dhe ndikon në përcaktimin e hyrjes optimale torakale për efiçencen e drenazhit kirurgjikal. Në shumicën e pacienteve tanë disa operacione cervikale të bëra në koperim dhe me kirurgët maksilofacial ishin të nevojëshme për shkak të persistences së përhapjes së infeksionit të lidhura me nekrozën reziduale me abscesin e pa drenuar ose përsëritës ose për shkak të bllokimit të drenave. Në mediastinin anterior mund të futemi transcervikal nëpërmjet hapsirës pretrakeale dhe disekojmë në mënyrë të verbër me gisht deri në nivelin e bifurkacionit trakeal; në mediastinin posterior hyjmë me anë të diseksionit të shtrirë në drejtim të hapsirës retrofaringeale në drejtim poshtë. Kjo formë e drenazhit mediastinal transcevikal është përdorur shumë në trajtimin e DNM para viteve 1990 [8]. Drenazhi i mediastinit mund të bëhet dhe nga një minitorakotomi (shtesë e drenazhit cervikal) në bazë të prodeminimit të infeksionit i cili determinohet me anë të CT skanerit torakal (në mediastinitin anterior mediastinotomi anteriore ose drenazh subksifoid, mediastinotomi posteriore në mediastinitin posterior). Torakotomia posterolaterale standarte realizon një ekspozim shumë të mirë të kavitetit pleural, perikardit dhe gjithë ndarjeve mediastinale dhe mund të hapen gjërë nga pjesa e sipërme torakale deri tek diafragma. Për shumicën e autorëve hyrja optimale kirurgjikale për drenazhin mediastinal në pacientët me DNM është në vartësi të nivelit të përhapjes së procesit nerotizues (1, 3, 4, 9, 10). Drenazhi mediastinal transcervikal standart mund të jetë adekuat nëse infeksioni mund të arrijë vetem lart në mediastinin superior. Përhapja dhe shtrirja e mëtejeshme e sëmundjes kërkon inçizion subksifoid ose torakal. Nëse mediastiniti është përhapur ose shtrirë poshtë bifurkacionit trakeal anteriorisht ose vertebrës së 4-t torakale posteriorisht, Estrera dhe kolegë (1) rekomandojnë drenazhin mediastinal nëpërmjet hyrjes torakotomike. Në eksperiencën tonë, drenazhi mediastinal adekuat në DNM kërkon një ndërhyrje kirurgjikale agresive me anë të torakotomisë standarte. Dy pacient janë trajtuar me anë të torakotomisë minima (inçizion parasternal dhe subksifoideus nje pacient dhe mediastinotomi posteriore një rast tjetër). Drenazhi mediastinal transcervikal dhe hyrjet e tjra të vogla torakale lejojnë hyrje të vogla në mediastin duke përjashtuar ekscizionin komplet të indit nekrotik. Torakotomia lejon hyrje më të mirë në të gjithë ndarjet e mediastinit duke lejuar debridmimin radikal kirurgjikal, ekscizionin komplet të indeve nekrotike, drenimin e kavitetit pleural dhe perikardial dhe vendosjen adekuate të tubave torakal me brima të shumta të mëdha për lavazh pleuro mediastinal. Rreziku i kontaminimit pleural rezultat i drenazhit transpleural (4, 8) është teorik pasi empiema pleurale është shpesh e lidhur me DNM ashtu siç paraqitet dhe në 10 pacientet e studimit tonë. Corsten dhe bashkeautor (6) raportojnë trajtimin me sukses të 7 prej 8 pacientëve me DNM ku 6-të prej tyre ju nënshrtruan drenazhit mediastinal nëpërmjet torakotomisë. Ky autor referojne se mediastini nuk mund te kontrollohet me anë të hyrjeve të limituara siç janë nëpërmjet mediastinotomive subksifoide ose anteriore dhe ai mbështet torakotominë e herëshme për kontroll më të mirë të sepsisit mediastinal. Subjekt i rishikimeve të, Corsten dhe bashkëpunëtorë [6] paportojnë një diferecë signifikante në mortalitetin e pacientëve të cilat janë trajtuar me drenazh cervikal dhe toracik (19%) krahasuar me ato pacient që janë trajtuar vetëm me drenazh cervikal (47%) ($p < 0.05$). Wheatley dhe kolegë (8) këshillojnë si jo adekuat drenazhin mediastinal transcervikal dhe në rishikimet e tyre në literaturë drenazhi mediastinal transcervikalrezulton jo adekuat ne 80% të rasteve; në këto raste pacientët kanë vdekur ose kërkuan drenazh pleural të mëtejshëm. Estrera (11) raporton 3 vdekje në 4 pacient me DNM me origjinë dentalr trajtuar pa kirurgji agresive. Ai rekomandon përdorimin e torakotomisë për drenazhin mediastinal komplet, pastrimin pleural dhe dekortikimin e herëshëm.

Drenazhi mediastinal transcervikal është i jusifikuar në abscesin mediastinal të kufizuar në mediastinin e sipërm por është jo efiçent në formën difuze dhe nekrotike të mediastinitit me koleksion jo kapsular i cili është prezantimi më i zakonshëm i mediastinitit në eksperiencën tonë (11, 12) dhe kërkon debridmim dhe ekscizion të gjërë të indeve nekrotike. Dështimi fillestarë I drenazhit kirurgjikal të limituar shoqëruar me sepsis mediastinal është indikacion për ndërhyrje kirurgjikale torakale madhore pa vonesë para se të ndodhë ngjaraja fatale të tilla si erozioni vazal dhe ekssanguinacioni ose komplikacionet kardiorespiratore. Ris dhe bashkepunëtorë (12), në publikimet e fundit raportuan trajtimin e suksesëshëmt të 2 prej 3 pacientëve me DNM të cilët kishin drenazh

mediastinal nëpërmjet inçizionit torakal anterolateral bilateral dhe sternotomisë transverese tip Clamshell. Nësë ekspozimi i mediastinit dhe i dy kaviteteve torakale është eksillent me avantazhet e interventit me një stad, kjo hyrje është kryesisht agresive në këta pacient të sëmure kritik dhe ekspozon aty me një rrisk të lartë për paralizë të nervit frenik dhe osteomilit sternal. Megjithëse autorët të cilët kanë përdorur këtë rrugë hyrje kirurgjikale nuk kanë observuar komplikacionet në seritë e tyre. Sternotomia mediane gjithashtu duket dhe konsiderohet si jo adekuate në trajtimin e DNM, sepse mund të ndodhë osteomieliti ose dehishienca sternale dhe është e vështirë hyrja në kompartmentin posterobazal të kavitetit torakal veçanarisht në anën e majtë (13). Diagrami i diagnozës dhe i trajtimit të DNM.



Roberts dhe bp. (14) raportojnë së fundi trajtimin torakoskopik të rasteve me DNM me absces mediastinal të kapsuluar dhe Gobien dhe bp. (15) propozuan drenazhin perkutan nën drejtimin e CT skanerit torakal si alternativë e vlefëshme e interventit kirurgjikal në pacientët e selektuar me absces mediastinal. Këta autor realizuan drenazhin perkutaneal me kateter në 6–të pacient, elektuan për kirurgji një pacient dhe siguruan kurimin në 5 pacient por të gjithë pacientët u prezantuan me absces mediastinal të izoluar duke pasuar kirurgjinë torakale ose abdominale. Abscesi izoluar mediastinal zakonisht rezulton nga perforacioni ezofageal, komplikacioni postoperativ ose infeksion i hematomës mediastinale postraumatike. Në kontrast DNM përfshinë infeksionin difuz të qafës dhe mediastinit duke bërë në shumicën e rasteve drenazhin torakoskopik dhe perkutan jo adekuat për shkak të koleksioni i likidit është jo i kapsuluar dhe me nekrozë celulare të përhapur i cili kërkon debridmim kirurgjikal radikal dhe jo vetem drenazh të thjeshtë të koleksionit. CT skaneri është mjet i përdorëshëm për ndjekjen postoperatore për vlerësimin e rezultatit të drenazhit kirurgjikal, përcakton zgjatjen e lavazhit dhe drenazhit kirurgjikal dhe përcaktimin e kohës së reinterventit nësë është e mundur në pacientët me sepsis të vazhdueshëm siç ishte në dy pacient të serisë tonë. Vonesa në diagnozë dhe drenazhi jo adekuat janë shkaqet kryesore në përqindjen e lartë të vdekëshmërisë në pacientët me DNM. Rekomandimi rutinë i përdorimit të CT skanerit ka vlerë të lartë në pacientët me infeksion të thellë cervikal për zbulimin e herëshëm dhe në kohë të mediastinitit kur rëntgenograma

torakale është akoma normal. CT skaneri torakal përcakton përhapjen dhe shtrirjen e procesit septik dhe është i aftë të drejtojë planin e drenazhit adekuat kirurgjikal. Një hap i ndërhyrjes me drenazh mediastinal transcervikal si fillim është i justifikuar në pacientët me sëmundje të kufizuar në mediastinin e sipërm por që e dërgojnë pacientin në sepsis mediastinal duke kërkuar pa vonesë një drenazh të ri adekuat nëpërmjet hyrjes së madhe torakotomike. Mediastiniti i gjërë nuk mund të trajtohet pa një drenazh mediastinal të gjërë adekuat duke perfshirë dhe torakotominë. Me Corsten dde bashkëpunëtorë (6) në mbështesim përdorimin e herëshëm të torakotomisë në trajtimin e DNM, një proces infeksioni i cili kërkon trajtim agresiv ashtu siç është agresive vetë sëmundja. Ky qëndrim agresiv kirurgjikal na ka lejuar neve të konfirmojmë rezultatatet tona fillestare (3) dhe të kemi një mortalitet të ulët 3 në 12 (25%) pacientët e trajtuar.

PËRFUNDIM

Trajtimi me drenazh mediastinal trans cervikal është i justifikuar në pacientët në të cilët sëmundja është shumë e kufizuar në mediastinin e sipërm anterior. Gjithashtu sepsisi mediastinal mund të kërkojë drenazh të ri nëpërmjet torakotomisë e cila duhet të bëhet menjëherë. Mediastiniti i gjërë nuk mund të trajtohet në mënyrë adekuate pa drenazhin mediastinal duke përfshirë dhe torakotomine. Trajtimi kirurgjikal agresive ka ulur vdekeshmërinë në (25%) në 12 pacientët tanë pasi kjo sëmundje ka vdekeshmëri të lartë.

REFERENCAT

1. Estrera AS, Lanay MJ, Grisham JM, et al. Descending necrotizing mediastinitis. Surg Gynecol Obstet 1983;157:545-552.
2. Kiernan PD, Hernandez A, Byrne VD, et al. Descending cervical mediastinitis. Ann Thorac Surg 1998;65:1483-1488.
3. Marty-Ané CH, Alric P, Alauzen M. Descending necrotizing mediastinitis. J Thorac Cardiovasc Surg 1994;107:55-61.
4. Levitt MGW. Cervical fascias and deep neck infections. Laryngoscope 1970;80:409-435.
5. Brunelli A, Sabbatini A, Catalini G, Fianchini A. Descending necrotizing mediastinitis. Arch Otolaryngol Head Neck Surg 1996;122:1326-1329.
6. Corsten MJ, Shamji FM, Odell PF. Optimal treatment of descending necrotizing mediastinitis. Thorax 1997;52:702-708.
7. Moncada R, Warphea R, Pickelman J. Mediastinitis from odontogenic infection and deep cervical infection. Chest 1978;73:497-500.
8. Wheatley MJ., Stirling MC, Kirsh MM. Descending necrotizing mediastinitis. Ann Thorac Surg 1990; 49: 780-784.
9. Howell HS, Prinz RA, Pickelman JR. Anaerobic mediastinitis. Surg Gynecol Obstet 1976; 43:353-359.
10. Rubin MM, Cozzi GM. Fatal necrotizing mediastinitis as a complication of an odontogenic infection. J Oral Maxillofac Surg 1987;45:529-533.
11. Esteva H. Descending necrotizing mediastinitis. Chest 1997; 111:529.
12. Ris HB, Banic A, Furrer M. Descending necrotizing mediastinitis. Ann Thorac Surg 1996; 62:1650-1654.
13. Casanova J, Bastos P, Barreiros F. Descending necrotizing mediastinitis. Successful treatment using a radical approach. Eur J Cardiothorac Surg 1997; 12:494-496.
14. Roberts JR, Smythe R, Weber RW. Thoracoscopic management of descending necrotizing mediastinitis. Chest 1997; 112: 850-854.
15. Gobien RP, Stanley JH, Gobien BS., Vujic I, Pass HI. Percutaneous catheter aspiration and drainage of suspected mediastinal abscesses. Radiology 1984;151: 69-71.

SUMMARY

MANAGEMENT OF DESCENDING NECROTIZING MEDIASTINITIS

Fadil Gradica[1], Agron Menzelxhiu[1], Zef Perduka[2], Ilir Skenduli[1], Alma Cami[1], Alban Hatibi[1], Epaminonda Fype[1]

University Hospital of Lung Disease, Thorax Surgery Service, Tirana, Albania.
[1]Anetstesiologi Reanimacion Service
[2]Pneumologie service, Rreshen, Albania

Piggott (1960) направил успешна класификација на Hallux valgus, која се однесува на состојбата на I метатарзофалангеален зглоб во три радиолошки групи (конгруентност, девијација, сублуксација).

Клиничката применливост на радиографските наоди и нивните хируршки импликации мора во целост да се проценат кога се планира корекција на деформитетот, за да се направи избор на соодветната хируршка процедура, одделно за секој тип на Hallux Valgus деформитетот. Радиографските наоди треба секогаш да бидат во корелација со клиничките наоди (1, 4, 8, 10).

Студијата ги обработува пациентите со Hallux Valgus деформитет, користејќи ја радиографската класификација по Piggot, за поставување на индикација за оперативно лекување по процедурите на Mitchell и Keller.

ЦЕЛ НА ТРУДОТ

Во оваа студија целта е да се прикаже влијанието на Piggott класификацијата при донесувањето на одлука за избор на оперативна техника во решавањето на Hallux Valgus деформитетот.


МАТЕРИЈАЛ И МЕТОДИ

Оваа студија се изработи на Клиниката за ортопедски болести при Медицинскиот факултет во Скопје. Во неа беа опфатени 70 испитаници со Hallux valgus деформитет. Испитаниците беа третирани со две различни опаративни техники, остеотомија на I метатарзална коска по Mitchell и ресекционата артропластика по методата на Keller.

Анализата на испитаниците вклучени во студијата беше извршена кај средно тежок и тежок степен на деформитет. Радиографската анализа беше извршена предоперативно и постоперативно кај двете оперативни техники.

Методот на Piggot подразбира проценка на состојбата на I метатарзофалангеален зглоб, кој може да биде : конгруентен, во девијација и со сублуксација. Проценката се изведува со поставување точки на медијалните и на латералните краеви на артикуларните површини на I метатарзална коска и првата фаланга. Ако двата пара точки се паралелно поставени еден на друг, тогаш зглобот е конгруентен. Секое отстапување води кон девијација или кон сублуксација на зглобот.

Слика 1. **A**- Конгруентен **B**- во девијација **C** – со субликсација



РЕЗУЛТАТИ

Кај испитаниците третирани по техниката на Mitchell, конгруентен I метатарзофалангеален зглоб се регистрира кај 2 (5.7%) испитаници, девијација на зглобот имаат 18 (51.4%) испитаници, а кај 15 (42.9%) зглобот е во состојба на сублуксација.

Во групата испитаници третирани со техниката по Keller, доминантни 27 (77.1%) испитаници имаат I метатарзофалангеален зглоб кој е сублуксиран, кај 6 (17.1%) постои негова девијација, додека 1 испитаник има конгруентен I метатарзофалангеален зглоб, и кај еден испитаник овој зглоб е во сублуксација.

Со Kolmogorov-Smirnov тестот ја тестиравме разликата во дистрибуцијата на модалитетите на состојбата на I метатарзофалангеален зглоб кај испитаниците оперирани со различни хируршки техники, при што за ниво на $p<0.025$ оваа разлика е статистички сигнификантна. Испитаниците оперирани по Mitchell техниката имаат како резултат на hallux valgus деформитетот значајно почесто девијација на I метатарзофалангеален зглоб, додека кај испитаниците третирани по Keller техниката значајно почесто се дијагностицира негова сублуксација (Табела 1).

Табела 1.

Проценка на I метатарзофалангеален зглоб – пред оперативно

Проценка на I метатарзофалангеален зглоб	**MITCHELL-група1**		**KELLER-група2**	
	N	%	N	**%**
конгруентност	2	5.71	1	**2.86**
девијација	18	51.43	6	**17.14**
сублуксација	15	42.86	27	**77.14**
луксација	0	0	1	**2.86**
вкупно	**35**	**100**	**35**	**100**

Kolmogorov-Smirnov Dmax=-0.38 $p<0.025$

Постоперативно, по методата на Mitchell, конгруентентен I метатарзо-фалангеален зглоб се регистрира кај мнознството испитаници од оваа група-30 (85.7%), додека кај останатите 5 (14.3%) испитаници се регистрира отстапување, односно девијација (Табела 2).

Табела 2.

Проценка на I метатарзофалангеален агол – пред оперативно / постоперативно

Проценка на I метатарзофалангеален агол	**Пред операција**		**По операција**	
	број	%	број	**%**
конгруентност	2	5.71	30	**85.71**
девијација	18	51.43	5	**14.29**
сублуксација	15	42.86	0	**0**
вкупно	**35**	**100**	**35**	**100**

ДИСКУСИЈА

Во светската стручна литература е дадено значајно место на овој деформитет како комплексен ортопедски проблем. Предмет е на бројни клинички студии во изминатите декади. Заради фактот дека овој деформитет во услови на нашето поднебје на живеење е недоволно обработена област, произлезе оваа студија која резултира во корист и ќе биде важна во теоријата и во ортопедската пракса.

Лекувањето на hallux valgus е хируршко. Оперативните процедури се состојат од едноставни аблации со капсулорафии, па сè до поопсежни операции како артродеза, трансфер на тетиви, ресекциона артропластика и разни остеотомии на I метатарзална коска (2, 6, 9).

Кај испитаниците третирани по техниката на Mitchell, преоперативно, доминантна беше девијацијата на зглобот кај 18 (51.4%) пациенти. Додека постоперативно со статистичката анализа на Wilcoxon-Matched Pairs тестот со кој ја тестиравме разликата во проценката на состојбата на зглобот, се потврди висока статистички сигнификантна разлика ($p<0.001$), која се должи на високо значајно почесто регистрирање на испитаници во постоперативниот период со конгруентна состојба на I метатарзафалангеален зглоб.

Предоперативно проценката на состојбата на I метарзо-фалангеалниот зглоб по методата на Piggot кај групата оперирани со ресекционата артропластика по Keller, доминираше сублуксацијата кај 27 (77.1%) од испитаниците. Додека постоперативно радиографската метода по Piggot кај оваа група на испитаници не е можно да се направи поради ресекцијата на проксималната половина од проксималната фаланга на палецот.

Според Piggot најважен фактор во одредувањето на хируршкиот пристап е конгруентноста на I метатарзофалангеален зглоб. Оперативната процедура мора да го заштити интегритетот на анатомската структура на зглобот. Друг голем решавачки фактор е присуството или отсуството на артроза во зглобот (3, 7).

За донесувањето на конечна одлука за типот на оперативната интервенција потребна е корелација на клиничките и на радиографските наоди (1, 4, 8, 10).

ЗАКЛУЧОК

Класификацијата по Piggot се покажа како важна радиографска метода во изборот на оперативната техника. Кај методата по Mitchell се покажа како корисна радиографска анализа и за постоперативното одредување на конгруентноста на I метатарзофалангеалниот зглоб.

ЛИТЕРАТУРА

1. Berquist TH. Radiology of the Foot and Ankle. *2nd ed.* 2000.
2. Coughlin MJ, Jones CP. Hallux valgus: demographics, etiology, and radiographic assessment. *Foot Ankle Int.* 2007;28(7):759-77.
3. Dhukaram V, Hullin MG, Senthil Kumar C. The Mitchell and Scarf osteotomies for hallux valgus correction: a retrospective, comparative analysis using plantar pressures. *J Foot Ankle Surg.* 2006;45(6):400-9.
4. Havlícek V, Kovanda M, Kunovský R. Surgical management of hallux valgus by techniques preserving the first metatarsophalangeal joint: long-term results. *Acta Chir Orthop Traumatol Cech.* 2007;74(2):105-10.
5. Hurst JM, Nunley JA 2nd. Distraction osteogenesis for the shortened metatarsal after hallux valgus surgery. *Foot Ankle Int.* 2007;28(2):194-8.

6. Madjarevic M, Kolundzic R, Matek D, Smigovec I, Crnkovic T, Trkulja V. Mitchell and Wilson metatarsal osteotomies for the treatment of hallux valgus: comparison of outcomes two decades after the surgery. *Foot Ankle Int.* 2006;27(11):877-82.
7. Mitchell CL, Fleming JL, Allen R, et al. Osteotomy-bunionectomy for Hallux Valgus. *J Bone Joint Surg.* 1958; 40A: 41-60.
8. Tanaka Y, Takakura Y, Kumai T, Samoto N, Tamai S. Radiographic analysis of Hallux Valgus. *J Bone Joint Surg.* 1995; 77-A: 205-213.
9. Valtin B. Changing concepts in the surgery of Hallux Valgus. *European Instructional course Lectures.* 1999; 4: 119-127.
10. Vanore JV. Diagnosis and treatment of first metatarsophalangeal joint disorders. Section 1: Hallux valgus. J FOOT ANKLE SURG. 2003; 42(3): 112-123.

SUMMARY

THE IMPORTANCE OF PIGGOTT CLASSIFICATION IN THE OPERATIVE TREATMENT OF HALLUX VALGUS DEFORMITY

Daniela Georgieva[1], Djordji Zafiroski[1], Ljupco Karevski[1]

[1]PHI University Clinic for Orthopedic Diseases, Skopje, R Macedonia

Aim: *The aim of this work is to show the importance of Piggott classification in the choice of operative procedure concerning Hallux Valgus deformity.* ***Material and methods:*** *The study included 70 patients having hallux valgus deformity of the foot. The patients were treated by two, completely different operative techniques: the osteotomy of the I-st metatarsal bone according to Mitchell, and the resectional arthroplasty according to Keller. Clinical and radiographic findings were used in order to evaluate the results of the patients.* ***Results:*** *The patients were 5 men and 65 women. The analysis of the clinical and radiographic results was done preoperatively and postoperatively. The evaluation of the condition of the I-st metatarsophalangeal joint was done by the Piggott method. According to this method the joint can be congruent, in deviation, with subluxation and ith luxation. The patients operated by Mitchell's technique, according to Piggott classification, have deviation significantly more often on the I-st metatarsophalangeal joint of 51.43% as a result of their Hallux valgus deformity. Significantly more often, there is a subluxation of 77.14% on the I-st metatarsophalangeal joint in the patients treated by Keller's technique.* ***Summary:*** *Clinical application of Piggott classification showed as very important one in the choice of corresponding surgical procedure in the treatment of Hallux Valgus deformity.*

Key words: *Hallux Valgus, Piggott, Mitchell, Keller, foot*

PUNIM PROFESIONAL / PROFESIONAL PAPER
OTORINOLARINGOLOGJI

PROBLEMET QË HASEN GJATË ANESTEZISË DHE BRONKOSKOPISË RIGIDE PËR HEQJEN E TRUPAVE TË HUAJ NË RRUGËT E POSHTMË TË FRYMËMARRJES NË MOSHAT PEDIATRIKE.

Igli Zhilla[1], Bledi Nini[2]
[1]Shërbimi Anestezi-Reanimacion, QSU "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri
[2]Shërbimi ORL, QSU, Tiranë, Shqipëri



Igli Zhilla, mjek anestezist-reanimator
Rr Hoxha Tahsin P 109/1/2Tiranë, Shqipëri
Tel: 00355682055820
e-mail:**igli.zhilla@gmail.com**

PËRMBLEDHJE: Hyrje: *Gëlltitja e trupave të huaj në rrugët e poshtme respiratore paraqet në vetëvete urgjencën më të madhe në fushën e otorinolaringologjisë, sepse mund të jetë lidhur teknikisht dhe të përcaktojë në mënyrë të drejtëpërdrejtë morbiditetin dhë mortalitetin e pacientit. Pjesa më e madhe e gëlltitjes së trupavë të huaj laringeo-trakeo-bronkialë, ndodh tek fëmijët, ndërmjet moshës 1-4 vjeç gjë që bën akoma më të vështirë proçedurën për heqjen e tyre.* ***Qëllimi:*** *Me ane te ketij studimi ne u perpoqem te vlerësojme dhe përcaktojmë sëmundshmërine dhe problemet që hasen gjatë heqjes së trupave të huaj në rrugët e poshtme të frymëmarrjes.* ***Materiali dhe metoda:*** *Në studimin tonë jemi mbështetur në të dhënat e nxjerra nga rastet e paraqitura në klinikën ORL të QSUT gjatë periudhës Qershor 2005-Qershor 2010 me diagnozën: Suspekt trup i huaj në rrugët e poshtme të frymëmarrjes. Këta pacientë iu nënshtruan bronkoskopisë rigide. Gjatë studimit tonë pacientët u ndanë në dy grupe në varësi të kohës së paraqitjes në shërbimin ORL: Grupi i parë kur rasti u paraqit brënda 24 orëvë të para pas gëlltitjës (akute) dhe grupi i dytë kur rasti u paraqit mbas 24 orëvetë gëlltitjes së trupit të huaj (subakute). U analizuan të dhënat e pacientëvë, lloji i anestezisë së përdorur, premedikimi, kohëzgjatja e interventit, ndërlikimet gjatë interventit dhe kohëzgjatja e qëndrimit në spital.* ***Rezultatet:*** *Në total 176 fëmijë të moshës 0 deri 14 vjeç u përfshinë në studim. Në 90% të rasteve u gjet dhe u hoq një trup i huaj në rrugët e poshtme respiratore. Në grupin e parë trupi i huaj u gjet në 89% te rasteve ndërsa në grupin e dytë 93% te rasteve. Nga ndërlikimet më të shpeshta që u hasën ishin dispnea 11%, hemorragjia 14%, stridori postoperator 11,5%. Në 2 raste u nevojit trakeotomia për heqjen e trupit të huaj ndërsa në një rast torakotomia si pasojëe formës dhe madhësisë së trupit të huaj.* ***Përfundimi:*** *Në përfundim të studimit tonë mendojmë se bronkoskopia rigide eksplorative dhë anestezia gjenerale e përdorur në rastet me një suspekt të trupit të huaj në rrugët e poshtme respiratore është një proçedurë që mbart një risk të vogël anestetik dhe operator.*

Fjalë kyç*. Trupa të huaj, rrugët e poshtme të frymëmarrjes, anestezia, bronkoskopia rigide*
Medicus 2011, Vol. XV (1):

HYRJE

Trupat e huaj në rrugët e poshtme të frymëmarrjes janë një ndodhi e shpeshtë tek fëmijët lidhur kjo me zakonin e fëmijëve për të futur në gojë sendet që ata mbajnë në dorë. Shpesh kjo ndodh pa praninë e të rriturve në momentin e gëlltitjes, gjë që bën të mundur vonimin në vendosjen e diagnozës, veçanërisht në rastet kur gëlltitja e tij nuk shoqërohet me dramën laringeale (1, 3).

Megjithë arritjet në vitet e fundit ne anestezi dhe otorinolaringologji gëlltitja e trupit të huaj është një problem me sëmundshmëri të lartë dhe mbart në vetvete rrezik si gjatë periudhës para interventit ashtu edhe gjatë interventit. Kjo si pasojë e pranisë së trupit të huaj (forma dhë natyra) dhe nga ana tjetër vetë interventit (2, 5).

Incidenca e trupave të huaj në vëndin tone është 2.93 raste për 100.000 banorë, dhe ata përbëjnë 45% të urgjencave madhore në shërbimin ORL të QSUT.

Në menaxhimin e rasteve të trupave të huaj kërkohet një bashkëpunim shumë i mirë kirurg-anestezist pasi ata ndajnë të njëjtën fushë operatore, me një potencial rreziku të lartë. Përpara futjes në anestezi kirurgu dhe anestezisti duhet të përgatisin një plan të detajuar mirë për kryerjen me sukses të proçedurës. Nëqoftëse pacienti paraqitet me distres respirator në spital duhet të kryhet një bronkoskopi urgjente. Nëqoftëse pacienti është në një gjendje të stabilizuar është më mirë që proçedura të kryhët ditën, me kushtë optimale, nga një ekip i specializuar (6, 7).

QËLLIMI

Qëllimet e kryerjes se këtij studimi janë:

1. Vlerësimi preoperator i të sëmurëvë për përcaktimin e një teknike sa më të përshtatshmë anestetike gjatë proçedurës së bronkoskopisë rigide;
2. Parandalimi dhe zgjidhja e komplikacioneve te mundshme gjatë bronkoskopisë rigide;
3. Kombinimi i teknikave të ndryshme për arritjen e një procedure sa më komode për pacientin dhe mjekun njëkohësisht.

MATERIALI DHE METODA

Në studimin tonë jemi mbështetur në të dhënat e nxjerra nga 176 raste të paraqitura në klinikën ORL gjatë periudhës Qershor 2005 - Qershor 2010.

Këto të dhëna u nxorrën nga shqyrtimi i kartelavë të shërbimit ORL mbasi u mor aprovimi nga Komiteti i etikës pranë QSUT.

Përzgjëdhja e rastevë u bë mbi bazën e disa kritereve:

- U përfshinë në studim fëmijë brënda kufijve të moshës pediatrike, 0-14vjeç dhe
- Çdo subjekt duhet të ketë diagnozë pranimi: Suspekt trup i huaj në rrugët e frymëmarrjës.

Për qëllime analize rastet u ndanë në dy grupë në varësi të kohës së paraqitjes në spital mbas gëlltitjes së trupit të huaj. Brënda 24 orëvë të para (akute) dhe mbas 24 orëvë të para (subakutë). Një trup i huaj u suspektua si rast akut kur fëmija u paraqit më distres akut respirator, shënjat radiologjike të pranisë së tij, anamnezën e një drame laringeale dhe ndryshime në auskultim me ose pa shuarje të respiracionit unilateral. Rastet subakute u përcaktuan kur fëmija u paraqit me shënjat e një patologjie bronkopulmonare, trajtuar gjatë më antibiotikë, shënjat radiologjike të trupit të huajtë pranishëm dhe një histori dramë laringeale mbi 24 orë deri në 2 javë .

U analizuan reperti rëntgenologjik preoperator, hypoxia (SpO2<90%), bradikardia (<60/min), hypotensioni (TA sistolik<70mmhg).

Gjithashtu u morrën të dhëna mbi lokalizimin e trupave të huaj, përbërjen e tyre komplikacionet gjatë proçedurës dhe gjëndjen ë fëmijëvë në unitin post anestezisë.

REZULTATET

Në studim u përfshinë 176 raste. Nga këta 95 ishin meshkuj (54%) dhe 81 femra (46%). Mosha mesatare ishte 1,85 vjeç, më predominim të moshës 0-3 vjeç 71% të rastëvë (n=123). Shënjat e gëlltitjes së trupit të huaj brënda 24 orëvë të para (grupi akut) u vunë re në 99 raste (57%), ndërsa mbas 24 orëve të para (grupi subakut) 77 raste (43%).

Anestezia e përdorur në moshat deri 7 vjeç në induksion u bë me sevofluran dhe oksigjen me ose pa protoksid azoti dhe në moshat mbi 7 vjeç endovenoze me propofol. Në këtë grup u përdorën dhe miorelaksantët por jo në të gjithë rastet. Gjatë interventit pacientët u ventiluan në mënyrë manuale nëpërmjet bronkoskopit rigid.

Në 160 nga 176 rastet ekzaminuar (90%) u vu re prania e trupit të huaj i cili u hoq me anë të bronkoskopisë rigide. Në grupin e parë (akut) përqindja e rasteve ku trupi i huaj nuk u gjet ishtë më e madhe 11 nga 99 rastet (11%) ndërsa në grupin e dytë subakut 5 nga 77 rastet (6,6%).

Në varësi të vendndodhjes së trupit të huaj, lokalizimi më i shpeshtë ishte bronku i djathtë 86 raste (54%), bronku i majtë 50 raste (31%), trake 13 raste (8%), në të dy bronket 7 raste (4%) dhe larings 4 raste (3%).

Nga llojet e trupave të huaj 133 rastë (80%) ishin më natyrë organike (arra, lajthi, fara të ndryshme, kikirik, fasule, misër dhe copëza të ndryshme frutash. Në rastet me trupa të huaj me përmbajtje yndyrore u vunë re edhe patologjitë e ndryshme shoqëruese si trakeobronkiti, bronkiti purulent, etj.

Kohëzgjatja e interventit ishte përafërsisht 20 minuta, më e gjatë në grupin subakut si pasojë edhe e komplikacioneve të rrugëve të poshtme të frymëmarrjes nga prania e gjatë e trupit të huaj.

Në 15 raste (15%) të grupit akut u has vështirësi në heqjën e trupit të huaj si pasojë e copëtimit të trupit të huaj dhe zhvendosjes së tij në bronket sekondarë, ndërsa në grupin subakut në 25 raste (33%) siç u përshkrua më lart nga ndryshimet e mukozës, edema e bronkut, sekrecionet e shtuara, indit të granulacionit të formuar përreth trupit të huaj.




Fig. 1, 2, 3: Trupi huaj në rrugët e poshtme të frymëmarrjes

Gjatë interventit në 23 raste (14%) pati hemorragji bronkiale si pasojë e dëmtimit të mukozës. Kjo hemorragji u trajtua lokalisht më sol adrenalinë 1:100.000.

Nga të dhënat preoperatore një ulje e saturimit të oksigjenit u vu re në 18 raste (O2sat< 90%). 1 rast i transportuar më urgjencëme trup të huaj bilateral u paraqit me O2sat<75%. Stridori postoperator si pasojëe bronkoskopisë u has në 19 raste (11,5%) si pasojë e bronkoskopisë së zgjatur dhe u trajtua më kortikosteroidë i.v si dhe inhalacion me adrënalinë. Pneumotoraks nga baro trauma apo çregullime kardiake nuk u vunë re.

Në 3 raste të grupit subakut u vu re një bronkospazëm si pasojëe trupit të huaj (kikirik).Në 10 raste u nevojit përsëritja e bronkoskopisë si pasojë e mosgjetjes së trupit të huaj herën e parë. Në 2 raste u nevojit trakeotomia si pasojëe formës dhe madhësisë së trupit të huaj

pasi nuk lejonte daljen nëpërmjet rimës glotike. Në një rast treguar në foton më lart (gjilpërë) fëmija u transferua në kirurgjinë torakale ku u bë heqja e trupit të huaj nëpërmjet torakotomisë.

Në 15 raste u nevojit transferimi në terapinë intensive të shërbimit pediatrik si pasojë ë insufiçiencës respiratore nga atelektaza e plotëe njërës mushkëri.

Qëndrimi në spital pas bronkoskopisë ishte 2-5 orë në 75 raste të grupit akut ndërsa në grupin subakut qëndrimi deri në 24 orë pas interventit në 50 raste kjo si pasojë e ardhjes nga zonat rurale të pacientëve.

DISKUTIM

Me anë të këtij studimi ne u përpoqëm të paraqesim eksperiencën tonë në rastet kur bronkoskopia rigide u përdor për heqjen e trupave të huaj trakeobronkialë.

Një fëmijë më dramë laringeale (mbytje dhe kollë persistente), vështirësi në frymëmarrje, mund të jetë një suspekt i një trupi të huaj të gëlltitur në rrugët e frymëmarrjes. Gjithashtu një kollë e zgjatur e shoqëruar me temperaturë, e cila nuk i përgjigjet terapisë konvencionale mund të bëjnë të mendosh për një trup të huaj. Shpëshherë në këto raste kur edhe ekzaminimi rutinë rëntgenologjik nuk jep të dhëna, një fibrobronkoskopi fleksibël do të jepte një vlerësim diagnostik dhe terapeutik (1, 2 , 4).

Nga autorë të tjerë referohet se anestezia e përgjithshme në rastet e fëmijëvë me një suspekt të trupit të huaj në rrugët e poshtme të frymëmarrjes mbart në vetvete një rrezik të konsideruëshëm si pasojë e komplikacioneve që mund të ndodhin si psh. aspirimi i përmbajtjes gastrikë, pneumotoraksi gjatë manipulimit apo nga kolla e fortë, laringospazma, bllokimi i plotë i rrugëve të frymëmarrjes nga zhvendosja e trupit të huaj, arresti kardiak dhe ndoshta dhe vdekja e papritur (6).

Gjithashtu vetë bronkoskopia rigide mund të çojë në desaturim,i shoqëruar apo jo më çregullime të ritmit, stridor postoperator nga edëma e laringsit dhe bronkospazëm 3-25% (4, 5).

Gjatë studimit tonë u vu re se komplikacionet e lartpërmëndura si stridori laringeal apo bronkospazma u vunë re në 1%-14% të rasteve. Nuk pati asnjë vdekje, arrest kardiak apo pneumotoraks.

Anestezia e përdorur u bë në bazë të një protokolli, inhalatore me sevofluran të shoqëruar më spray topikal lidokainë 2% për të ulur reflekset e kollës tek fëmijët e vegjël dhe intravenoze me propofol dhe spray lokal më lidokainë 2% tek fëmijët mbi 6 vjeç. Gjithashtu tek fëmijët e mëdhënj u përdorën dhe miorelaksantët për të lehtësuar proçedurën e bronkoskopisë. Megjithëse nga autorë të tjerë (7) ventilimi spontan gjatë bronkoskopisë ka disavantazhet e kollës apo hypoventilimit nga eksperienca jone kemi vënë re se me ventilim spontan ne kemi një kontroll të kënaqshëm të ventilimit dhe nga ana tjetër eleminojmë mundësinë e barotraumave si pasojëe ventilimit mekanik.

Komplikacionet më të mëdha gjatë bronkoskopisë u hasën në trupat e huaj të grupit subakut të padiagnostikuar, kur periudha e qëndrimit të tij në rrugët e frymëmarrjes ishte mbi 1 javë apo në rastet e trupave të huaj organikë me natyrë yndyrore. Kështu, sekrecionet e shtuara bronkiale, sekrecionet purulente, granulacionet përreth trupit të huaj apo pneumonitë u hasën shpesh në këto raste. Gjithashtu hemorragjitë gjatë heqjes së trupit të huaj u vunë re në rastet tona, në 5 prej tyre si pasojëe formës së tyre apo pozicionimit në muret e bronkeve apo trakesë (gjilpëra, instrumente dentarë, etj) dhe në rastet e tjera gjatë kryerjes së proçedurës, krahasuëshmërisht në % të përafërta më autorë të tjerë (3).

Duke u bazuar në të dhënat tona vërejmë së problemet më të mëdha në një pacient më trup të huaj hasen në periudhën preoperatore , dhe më pak gjatë interventit.

Komplikacionet më të mëdha janë vënë re tek fëmijët të cilët do ti nënshtrohen më shumë se një herë bronkoskopisë rigide. Në rastet me dyshime për praninë e trupit të huaj një konsultë më specialistin pediatër, ORL, anestezistin dhe një fibrobronkoskopi fleksibël nën anestezi

gjenerale me LMA do të ishte një zgjidhje optimale pasi është më pak invazivedhe mbart më pak rreziqe (9).

PËRFUNDIMI

Në përfundim të studimit tonë mendojmë se bronkoskopia rigide eksplorative në rastet me një suspekt të trupit të huaj në rrugët e poshtme respiratore është një proçedurë që mbart një risk të vogël anestetik dhë operator. Rreziqët më të mëdha hasen në rastet me prezencën e gjatë të një trupi të huaj si pasojëe komplikacioneve që e shoqërojnë atë.
Kjo proçedurë duhet të kryhet në qëndra të specializuara ku problemet me menaxhimin e rrugëve të frymëmarrjes mund të zgjidhen nga personeli ekspert dhe i trajnuar.

BIBLIOGRAFIA

1. Brown TC, Clark CM. Inhaled foreign bodies in children. M*ed J Aust* 1982;**2**:322-6.
2. Pasaoglu I, Dogan R, Demirçin M et al. Bronchosçopial removal of foreign bodies in çhildren: retrospeçtive analysis of 822 cases.*Thorac cardiovasç Surg* 1990;**39**:95-98.
3. Higuchi O, Adachi Y, Ichimaru T, Asai M, Kawasaki K. Foreign body aspiration in çhildren: a nationwide survey in Japan. *Int J PediatrOtorinolaringol* 2009;**73**:659-61.
4. Emir H,Tekant G, Besik Ç, et al. Bronchosçopic removal of trachceobronçhial foreign bodies: value of patient history and timing.;*Pediatr SurgInt*;2001;**17**:85-7.
5. Zaytoun GM, Ronadi PW,Baki DH. Endosçopic management of foreign bodies in the tracheobronchial tree: predictive factors for complications.*Otolaringol Head Neçk Surg* 2000;**123**:311-16.
6. Farrel PT. Rigid bronçhosçopy for foreign body removal:anesthesiaand ventilation. Pediatr Anesth 2004;**14**:84-89.
7. Perrin G, Colt HG, Marti C, Mak MA, Dumon JF, Gouin F. Safety of interventional rigid bronchoscopy using intravenous anesthesia and spontaneous assisted ventilation, a prospective study.*Chest*;1992;**102**:1526-3.
8. Barker N, Lim J, Amari E, Malherbe S, Ansermino JM. Relationship between age and spontanious ventilation during intravenous anesthesia in çhildren. *Pediatr Anesth* 2007;**17**:948-55.
9. Martinot A, Çlosset M, MarquetteCH et al. Indications for flexible versus rigid bronchosçopy in children with suspected foreign body aspiration. *Am JRespir Crit Care Med* 1997;**155**:1676-79.

SUMMARY

MORBIDITY AND COMPLICATIONS DURING ANAESTHESIA AND RIGID BRONCHOSCOPY FOR LOWER RESPIRATORY TRACT FOREIGN BODIES REMOVAL IN CHILDREN

Igli Zhilla[1], Bledi Nini[2]

[1]Department of Anaesthesia & Intensive Care, UHC, Tirana, Albania
[2]Department of ENT, UHC, Tirana, Albania

Introduction. *Foreign body aspiration in lower respiratory tract is the most emergent procedure in ENT because it may be associated and determine so direct morbidity and mortality of patients. Most of laringo-tracheo-bronchial foreign bodies aspiration happens inchildren, between 1-4 years old. It make smore difficult the procedure of rigid bronchoscopy for their removal.* ***Aim.*** *In our study weare based on data drawn from the cases admitted in ENT clinic of UHC during theperi od June 2005-June 2010 with diagnosis: Suspect of foreign body*

aspiration on lower respiratory tract. These patient sunderwent rigid bronchoscopy and we match problems and complication sencoun tered during anesthesia and rigid bronchoscopy it self. ***Materials and method:*** *During our study patients were divided into two groups depending on the time of submission at the ENT department: 1st group: thecase was submitted within 24 hours after ingestion (acute) and the 2nd group: thecase was presente dafter 24 hours of ingestion the foreign body (sub acute). We analyzed the data of patients, type of anesthesia used, length of intervention, complications during procedure length of stay in ward.* ***Results:*** *In total 176 children aged 0 to 14 years were included in the study. In 90% of cases was found and removed a foreign body on the lower respiratory tract. Foreign body was found in 89% of acute group while in the second 93%. Most frequent complications wereb leeding 14%, dyspnea 11%, post interventional stridor 11,5%. In two cases wene eded a tracheotomy for removal of foreign body while in one case thoracotomy because of shape and size of foreign body.* ***Conclusion:*** *As a summary of our study study wenotice that rigid bronchoscopy and general anesthesia used in cases with a suspect of foreign body in lower respiratory tract carries a no significant risk to the patients.*

Key words*: Foreign bodies, lower respiratory tract, anesthesia, rigid bronchoscopy*

PUNIM PROFESIONAL / PROFESIONAL PAPER
KIRURGJI ORO-MAKSILO-FACIALE

SHËRBIMI ORO-MAXILLO- FACIAL NË PËRBËRJE TË NJË POLITRAUME

Alma Teliti[1]
Qendra Kombëtare e Traumës
[1]Spitali Ushtarak, Tiranë, Shqipëri



Alma Teliti, mjeke kirurge maksillo-faciale
Rr. Sulejman Delvina, Pallati 1, Shk.1. Ap. 12, Tiranë, Shqipëri
Tel: 0684048155
e-mail: telitialma@yahoo.it

REZYME: *Eksperienca disa vjeçare e Qendrës Kombëtare e Traumës pranë SUQU ka evidentuar shërbimin Oro-Maxillo-Facial si një element të rëndësishëm dhe të ndjeshëm te një politraume, trajtimi i së cilës përfaqëson rreth 75% të patologjive te ndryshme të prezantuara në këtë qëndër. Rastet politraumatike, sot po hasen gjithnjë e më shpesh kudo në botë dhe pacientët e politraumatizuar prezantojnë lezione të shumta në organe ose aparate të ndryshme me kompremention ose potencial të funksioneve vitale. Këta pacientë kanë nevojë për një trajtim shëndëtësor multidisiplinar, pra dhe për një trajtim Oro-Maxillo- Facial. Sipas statistikave të Informacionit të SUQU rezulton se trajtimet ORO-Maxillo-Faciale lidhen me rreth 30% të politraumave të trajtuara në Qendrën Kombëtare të Traumës. Në këtë studim synohet të jepet një karakterizim i bazuar i bashkërendimit të shërbimit Oro-Maxillo-Facial me hallkat përbërëse të politraumave të trajtuara në Qendrën Kombëtare të Traumës në SUQU; një karakterizim specifik i disa trajtimeve kirurgjikale ndaj pacientëve me dëmtime në regionin OMF dhe një vlerësim adekuat i metodës së osteo-sintezës në trajtimet kirurgjikale të traumave në kete region.* ***Materiale dhe metoda****. Janë shqyrtuar raste politraumash të trajtuara në Qendrën Kombëtare të Traumës (SUQU) për dhjetor2007- dhjetor 2008 dhe janar 2010- tetor 2010, të cilat janë shoqëruar dhe me dëmtime në regjonin OMF.*

Fjalë kyç*: Politrauma, oro-maxillo-facial, etiologji, ostoeosintezë, mandibul, maksile*

Medicus 2011, Vol. XV (1):

QËLLIMI PARË

Përballimi me sukses i rasteve politraumatike në vënde të ndryshme në botë mbështëtet në protokolle operative, aplikimi i të cilave kushtëzohet nga kushtet gjeografike, demografike dhe social ekonomike të atij vendi. Në tërësinë e tyre këta protokolle kanë elementë të përbashkët, por kanë dhe specifikat e tyre (4), të cilat kushtëzohen nga cilësia e aparaturave apo e

teknikave që disponojnë, nga niveli profesional i stafeve mjekësore, nga tradita e krijuar etj. Një nga qëllimet e këtij studimi është që të jepet një karakterizim i bashkërendimit të shërbimit Oro-Maxillo-Facial me hallkat përbërëse të politraumave të trajtuara në Qëndrën Kombëtare të Traumës.


MATERIALI DHE METODA

Janë shqyrtuar të dhëna të Urgjencës së SUQU për periudhën dhjetor 2007- qershor 2008 dhe pacientët me dëmtime maxillo-faciale të trajtuar në shërbimin Oro- maxillo–facial gjatë periudhës janar 2010–tetor 2010.

REZULTATET


Rastet e shumta të pacientëve të paraqitur ndër vite në Qendrën Kombëtare të Traumës janë në shumicën e tyre me natyrë politraumatike. Përballimi me sukes i tyre nënkupton aplikimin e protokolleve operative që bazohen jo vetëm në eksperiencën fituar në këtë qendër por dhe në eksperiencat protokollare të aplikuara jashtë kufijve. Për periudhën dhjetor 2007- qershor 2008 në Qendrën Kombëtare të Traumës janë trajtuar 1685 pacientë të shtruar dhe ambulantë me shpërndarje:

sipas seksit 77.5% meshkuj , 22,5% femra dhe me shpërndarje sipas moshave :13.7% nga 0-14 vjec, 32.4% nga 15-30 vjeç dhe 51.4% mbi moshën 30 vjeç. Në kuadrin e trajtimit politraumatik të këtyre pacientëve, 44,6% të tyre janë trajtuar nga Shërbimi Neurokirurgjisë, 33% nga Shërbimi Ortopedik, 20.8% nga Shërbimi i Kirurgjisë dhe 1.4% nga shërbimi OMF.



Shpërndarja sipas seksit

Meshkuj	Femra
77.5 %	22.5 %




Shpërndarja sipas moshës

0-14 vjec	15-30 vjec	Mbi 30 vjec
13.7 %	32.4 %	51.4 %

Shpërndarja sipas specialiteteve

Neuro kirurji	Ortopedi	Kirurgji	OMF
44.6%	33%	20.8%	1.4%



DISKUTIMI

Në aplikimin e protokolleve të përditshme në SUQU, Shërbimi Oro-maxillo- facial përbën një element të rëndësishëm të realizimit protokollar pas kalimit të fazës së urgjencës (sigurimit të jetës,A.B.C.D.E.) nga pacienti dhe pas një sërë vlerësimesh e konsultash bashkërenduese me mjekët reanimatorë, radiologë, neurokirurgë, ki- rurgë, ortopedë, okulistë, etj.

Në këtë zinxhir vlerësimesh ekzaminimi radiologjik përbën një hallkë të vecantë orientimi për pacientët me dëmti me maxillo faciale, pasi nëpërmjet tij gjykohet mbi demonstrimin e lezioneve të mundshme të ATM, luksacioneve, linjave të frakturave, të kufijve të sinuseve paranazale, e mundësisë së grumbullimeve hemoragjike e inflamatore, të deformimeve seletike e fizionomike, e malokluzionit, e incidenteve të mundshme operatore, e komplikacioneve të mundshme skeptike, etj. Shërbimi OMF (SUQU) i referohet, në praktikën e tij, kryesisht projeksioneve antero-posteriore, latero–laterale dhe në rastin e traumave masive i referohet tomografisë kompjuterike (CT), e cila, nga autorë të ndryshëm, rekomandohet në shumë protokolle të aplikuara jashtë vendit (1, 10). Ndonëse kushtet ekonomike individuale të pacientëve kufizojnë përdorimin e CT statistikat e Qendrës së Radiografisë në SUQU flasin për një rritje nga viti në vit të numrit të te CT-ve. Në vitin 2009 ato përbënin rreth një të katërtën e tërë ekzaminimeve radiografike. Fillimi i përdorimit të CT këto tre vitet e fundit në Qendren Kombëtare të Traumës përmisuar në mënyrë të ndjeshme jo vetëm protokollin e trajtimit të një politraume, por dhe të shërbimit maxillo facial në përbërje të një politraume.

QËLLIMI DYTË


Një qëllim tjetër i këtij studimi është karakterizimi specifik i disa trajtimeve kirurgjikale ndaj pacientëve me dëmtime në regionin OMF.

MATERIALI DHE METODA

Janë shqyrtuar pacientët me dëmtime maxiollo faciale të trajtuar nga Shërbimi Kirurgjik OMF në Qendrën Kombëtare të Traumës në periudhën janar 2010-tetor 2010.

REZULTATET

Gjatë kësaj periudhe janë trajtuar 28 raste me dëmtime në regionin OMF Pacientët e trajtuar kanë patur fraktura madibulae, fraktura maxillae dhe fraktura të dy nofullave. Frakturat kanë prekur në rastin e mandibulës: vijat mediane, paramediane, angulus, artikulacionin, paramediane dhe angulus; ndërsa në rastin e maxillës kanë prekur: pjesën anteriore, sinusin maxilar, Lefort II, Lefort II dhe frakturë vertikale, Lefort III dhe frakturë vertikale. Rezultatet 10 mujore të studimit shprehen me tabelat dhe grafikët e mëposhtëm.



DISKUTIMI

Në periudhën janar 2010-tetor 2010 me fraktura maxilla-faciale janë prekur të dy sekset, por më i prekur është seksi mashkull. Nga një studim statistikor i rasteve të trajtuara në periudhën janar 2010 – tetor 2010 rezulton se kemi 85.6% raste nga aksidentet rrugore, 7% raste rënie nga lartësia, 3.2 % incidente në punë dhe 3.2 % raste violence. Aksidentet rrugore mbeten shkaku kryesor i traumave OMF.

Në periudhën dhjetor 2007-qershor 2008 aksidentet rrugore përbëjnë 34.6% të rasteve. Ndonëse kemi më pak raste në këtë periudhë, sepse nuk përfshihen muajt e stinës së verës, theksojmë se aksidentët rrugore përbëjnë shkakun kryesor të traumave OMF pothuaj gjatë tërë vitit. Një vlerësim i mëtejshëm në lidhje me moshë për periudhën janar 2010- tetor 2010 evidenton 7% të rasteve nga 0-14 vjeç, 65% e rasteve nga 15-30 vjeç dhe 28% të rasteve mbi 30 vjeç.Pra mosha më e prekur në këtë periudhë është mosha 15-30 vjeç.

Ashtu siç citohet në studime të ndryshme jashtë kufijve (2, 3, 5, 7, 8, 11) në rastin e pacientëve të trajtuar gjatë kësaj periudhe mandibula, si kockë e lëvizshme, është më e prekshme se maxilla. Ndër vijat më të prekura të mandibulës është këndi i nofullës (vija angulus) si dhe paramediane ndërsa vijat e frakturës së maxillës janë prekur pothuajse një lloj. Muajt janar, korrik dhe gusht janë periudhat me shifra më të larta të frakturave dhe kjo lidhet me fluksin e madh të lëvizjeve të popullatës dhe me praninë e një numri të konsiderueshëm emigrantësh gjatë këtyre periudhave.

QËLLIMI TRETË

Një qëllim tjetër i këtij studimi është karakterizimi i metodës së osteosintezës në trajtimet kirurgjikale të traumave në regionin OMF nga shërbimi OMF në SUQU.

MATERIALI DHE METODA

Janë studiuar metodikat e trajtimit në shërbimin OMF të pacientëve me dëmtime në regionin maxillo facial për periudhën janar 2010-tetor 2010.

REZULTATET

Janë trajtuar me ndërhyrje kirurgjikale 28 raste nga të cilat 25 raste me osteosintezë dhe 3 raste me mjekim ortopedik. Të dy metodikat janë përdorur në trajtimin e frakurave të mandibulës,

të maxillës dhe të dy nofullave. Frakturat e mandibulës janë me shpërndarje: vijave mediane 15%, vija paramediane 30%, vija angulus 45%, artikulacioni 8%, vija paramediane dhe angulus 23% të rasteve. Frakturat e maxillës janë me shpërndarje: pjesa anteriore 4%, sinus maxilar 4%, Lefort II 8%, Lefort II dhe frakturë vertikale 4% të rasteve.

DISKUTIMI

Ndonëse mjekimi kirurgjikal kushtëzohet nga gjëndja shëndetësore e pacientit, nga mosha, graviteti i lezionit dhe nga kushtet social ekonomike, ky mjekim mbetet më i përzgjedhuri gjatë kësaj periudhe. Ai, në krahasim me atë ortopedik, shënon disa avantazhe pasi siguron një reponim korrekt nëpërmjet një fushëpamje direkte, përmisim të cilësisë së jetës, duke e kthyer pacientin më shpejt në normalitet. Në këtë periudhë shërbimi OMF ka trajtuar raste në bashkëpunim me mjekë neurokirurgë dhe ortopedë. Figurat 1 dhe 2 paraqesin aplikimin e metodës së osteosintezës tek pacienti Xh.K., i cili është trajtuar nga shërbimi neurokirurgë, ndërsa figurat 3 dhe 4 paraqesin aplikimin e metodës së osteosizës tek pacienti Gj.S. me diagnozë fractura mandibulae, fractura comminutive apta cruris et manus dex.



Fig.1



Fig 2.



Fig.3



Fig.4

BIBLIOGRAFIA

1. Abstracts 11th European Cogress of Trauma and Emergy Surgery.Belgium 2010.
2. Behcet Erol. Maxillo facial fractures. Journal of Cranio Maxillofacial Surgery, Turkey, 2004.
3. Charles Gomersall. Maxillofacial injury. Asian Intensive Care Research Meeting, Hong Kong, 1999.
4. Chat V Dang, Charles Drew, Procedures. Emedicine clinical, 2009.
5. Dr. Chan Sai Kwing. Incidence of maxillo facial trauma in the Hong Kong Queen Mary Hospital, Hong Kong, 1993.

6. Ghysen D, Ozsarlak. Maxillo facial trauma. Departament of Radiology, Univ. of Antwerp, Antwerp, Belgium, 2000.
7. Jose Carlos Martins. Epidemiological characteristic of trauma pacients maxillo surgery Internacional archives of ortorhinolaryngology, Vol 14, Nr.2, 2010.
8. Rajendra PB, Mathw TP. Charecteristic of associated craniofacial trauma in patients with head injuries. Emerg Trauma shock, Mangolare, 2009.
9. Hussein S. Role of advanced CT scan and management of maxillo facial trauma.
10. Hussein S. Maxillo facial trauma. Pakistan Institut of Medical Sciences, Islamabad, 2002.
11. William CS. Mandibule, Fractures, Imaging. Regional Medical Centre of San Jose, 2010.

ORO-MAXILLO-FACIAL SERVICE INCLUTED IN A POLYTRAUMA

Alma Teliti[1]

[1]Department of ORL- Chirurgy Oro-Max-Fac- Ophthalmology
Central Military University Hospital, Tirana, Albania

The treatment of trauma and polytrauma represents about 75 % of different pathologies treated in the National Center of Trauma during the 12 years period of its existence. Maxillofacial trauma cases treated in this center are about 30 % of the total cases treated in this period. The large number of maxillofacial traumas treated in the last few years is an object of further discussions in several directions: the etiological estimations, the estimation of surgical and clinical treatment protocols, the characterizations of concrete methodologies of surgical interventions etc.The aim of this study is threefold to give a retrospective and comparative etiological estimation of polytrauma cases with maxilla-facial treatment of the National Trauma Center and of some other trauma centers abroad,to give a coordination protocol for the treatment of maxillofacial trauma within the framework of the treatment of polytraumas in general and to give a specific evaluation for the method of osteosintesis in the treatment of surgical traumas in the region OMF

***Key words**: Polytrauma, oro-maxillo-facial, etiology, ostoeosyntesis, mandibule, maxille*

PUNIM PROFESIONAL / PROFESIONAL PAPER
KIRURGJI ORO-MAKSILO-FACIALE

RIKONSTRUKSIONI KIRURGJIKAL NË DËMTIMET E MAKSILLËS E MANDIBULES SHKAKTUAR NGA ARMËT E ZJARRIT TIP PISTOLETË

Lozana Binjaku[1]

Spitali Ushtarak Qendror Universitar, Tiranë, Shqipëri
[1]Shërbimi ORL-Kirurgji Oro-Max-Fac-Okulistikë



Lozana Binjaku, mjeke kirurge oro-maksillo-faciale
Pallatet "Hawai Construction", Kulla 1, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 69 21 28 677 & +355 42 2415214
e-mail: **lozanaimeri@yahoo.com**

REZYME: Qëllimi i studimit*: Vlerësimi i trajtimit kirurgjikal në plagët me armë zjarri në regjionin e fytyrës, në mënyrë që ky trajtim të sigurojë rikthimin e anës funksionale, estetike e fiziologjike për një kohë të shkurtër në krahasim me trajtimet e tjera.* ***Pacientët dhe metoda****: Ne kemi trajtuar rreth 50 pacientë me dëmtime me armë zjarri në regjionin e maksillës e mandibules në periudhë 3-vjeçare. Studimi është bazuar në zgjedhjen e rastësishme të pacientëve të paraqitur në spitalin tonë. Ky është një studim prospektiv historik, pasi synimi i studimit është futja e metodës së re të trajtimit kirurgjikal në protokollin tonë, duke u nisur nga shkaqet e llojet e dëmtimeve të armëve të zjarrit që janë evidentuar më parë.* ***Rezultatet****: U paraqitën 40 meshkuj e 10 femra. Nga 50 pacientë që u paraqitën, 10 kishin dëmtime të indeve të buta, 8 kishin fraktura të izoluara alveolare, 5 kishin fraktura jokomplete e pa zhvendosje, 21 kishin dëmtime mandibul-maksillë (nga këta 12 kishin dëmtime maksillë + mandibuk e 9 dëmtime vetëm të mandibulës (Numri i vdekjeve 6. Në 15 pacientë u vendos shinë paraprakisht. Në 4 u aplikua fiksim ortopedik maksillë mandibulë e 17 u trajtuan me intervent kirurgjikal.* ***Konkluzion:*** *rajtimi i pacientëve fillon me sigurimin e rrugëve të frymëmarrjes, ndalimi i hemoragjive e trajtimi për rregullimin e indeve të buta e të forta të fytyrës. Komplikacionet varen nga shkalla e dëmtimit e nga zgjedhja e trajtimit.* ***Rëndësia:*** *Stabilizimi i fragmenteve me trajtimin korrekt është kërkesë efikase për sigurimin e vazhdimësisë kockore e rikthimin e funksionit në kohë të shkurtër.*

Fjalë kyç*: Dëmtime, armë zjarri, osteosintezë, komplikacion, fiksim ortopedik*

Medicus 2011. Vol XV (1):

HYRJE

Dëmtimet me armë zjarri janë një problem i madh e publik për shëndetin për arsye të sëmundshmërisë, mortalitetit, shpenzimeve shoqërore. Këto dëmtime janë efiçiente edhe tani në kohë paqeje, për arsye të zotërimit të armëve të zjarrit në duart e popullsisë civile, pas hapjes së depove të municionit në vitin 1997 në të gjithë Shqipërinë.

Traumat me armë zjarri zënë vendin e dytë pas traumave të shkaktuara nga aksidentet automobilistike. Këto përbëjnë një sfidë të vështirë për rikonstruksionin kirurgjikal, pasi dëmtimet e humbjet kockore, si dhe dëmtimet e indeve të buta, shoqërohen me shkatërrime të indeve të afërta nazale, orbitale, kraniale.

Shkalla e dëmtimeve varet:

- nga shpejtësia e plumbit
- kalibri i fishekut
- distanca e gjuajtjes
- lloji i fishekut

Kemi 3 lloje dëmtimesh të indeve të buta.

- Sipërfaqësore (kur plumbi kalon tangencialisht e dëmtimet janë minimale në formë gërvishtjeje)
- Penetruese (kur plumbi depërton në inde, formon rrugën e tij e fiksohet në inde)
- Shpuese (kur plumbi depërton në inde, formon rrugën e tij përshkuese dhe del jashtë indeve; pra ka vrimë hyrje e dalje të plumbit)

QELLIMI

Vlerësimi i trajtimit kirurgjikal në plagët me armë zjarri në regjionin e fytyrës, në mënyrë që ky trajtim të sigurojë rikthimin e anës funksionale, estetike e fiziologjike për një kohë të shkurtër në krahasim me trajtimet e tjera.

PACIENTËT DHE METODA

Studimi ynë përfshin një numër prej 49 personash civilë e 1 ushtarak, të cilët ishin dëmtuar me armë zjarri në kokë e fytyrë të trajtuar në spitalin tonë nga viti 2007-2010. Midis tyre, 10 kishin bërë tentativë vetvrasje, 30 ishin qëlluar nga distanca e 10 raste nuk e dinin nga ishin qëlluar.

Mosha e tyre ishte 16-70 vjeç.

Në qendrën tonë të traumës, e vetmja në Shqipëri, vepron një ekip mjekësor me specialistë nga të gjitha fushat, kështu që dhe trajtimi i këtyre të sëmurëve është i menjëhershëm.

Dëmtimet maksillo-faciale ne i kemi grupuar:

- dëmtime mandibulare
- dëmtime maksillare
- kombinime të këtyre dy dëmtimeve

Në spitalin tonë pikënisja e trajtimit të këtyre dëmtimeve filloi me trajtimin e rrugëve të frymëmarrjes që bllokohen nga hemoragjia, edema e fragmentet kockore. Fillimisht pastrohet goja nga trupat e huaj, koagulat e gjakut dhe nga fragmentet kockore apo dhëmbët e shkëputur. Ajo që vihet re në këto raste, në krahasim me traumën e thjeshtë, është që stabilizimi i rrugëve të frymëmarrjes në shumicën e rasteve u realizua nga trakeostomia (në studimin tonë, 10 pacientë).

Pas sigurimit të frymëmarrjes, etapat e ndjekjes kanë qenë:

- Ekzaminimi fizik, që përfshin: inspeksionin (kontuzion, abrazion, laçeracion, edemë, gjakderdhje) palpacion (vazhdimësinë kockore, emphizemën e lëvizjet e ATM)
- Ekzaminimi i kavitetit oral: përfshin ekzaminimin për trupa të huaj, laçeracione, hematoma, për dhëmbë që mungojnë ose të frakturuar, për okluzionin bimaksillar, ekzaminimin e gjendrave të pështymës (duktuse e orificume) e palatumin.

Nga të gjithë pacientët e rasteve tona kishim të bënim me plagë shpuese, pra evidentohej qartë vrima e hyrjes dhe e daljes.

Ekzaminimi i të sëmurëve është plotësuar me ekzaminimin rëntgenografik të kryer në urgjencën e S.U.Q.U:

a- grafi antero-posteriore të kokës
b- grafi mandibulae
c- panoramex
d- CT me prerje të ndryshme (të kokës, mandibulës, maksillës dhe vetëm 1 rast me skaner tredimensional (i realizuar privatisht).

Protokolli ynë i përmirësuar për rikonstruksionin e dëmtimeve maksillo-faciale nga armët e zjarrit synon: vendosjen e fragmenteve në pozicion sa më normal dhe fiksimi i tyre me pllaka titaniumi. Këto sigurojnë edhe adaptimin më lehtë të indeve të buta. Pllakat janë hequr vetëm kur pacientët e kanë kërkuar, se këto pllaka prej titaniumi janë më të favorshme për shkak të biokompatibilitetit. Ne kemi preferuar heqjen e pllakës pas 8 muaj-1 vit pas një ekzaminimi paraprak panoramik që evidenton përfundimin e ngjitjes së fragmenteve.


Në maksillë, protokolli ynë i përmirësuar ka synuar vendosjen e pllakave të titaniumit në nivele të ndryshme të maksillës, e, në dëmtimet e mëdha të shoqëruar me humbje kockore të mëdha, janë vendosur proteza me obturatorë pas 1 viti, që synoi me zëvendësimin e defekteve kockore e dhëmbëve të humbur.

Trajtimi kirurgjikal me transplante nga kocka iliake apo brinjë nuk është aplikuar në asnjë rast në këtë studim.

REZULTATET

- Gjatë periudhës së këtij studimi (tre vjeçar), numri i pacientëve me armë zjarri të ndjekur e trajtuar nga ana jonë është 50 pacientë.
- Gjatë vitit 2008, numri i përgjithshëm i pacientëve të paraqitur në spitalin tonë me dëmtim nga armë zjarri ishte 79 pacientë, sipas seksit ato janë:
  seksi femër 4 persona
  seksi mashkull 75 persona

Grafiku 1.




Viti 2009

Numri i përgjithshëm i pacientëve të dëmtuar me armë zjarri ishte 96 pacientë. Sipas seksit ishte:

- Seksi mashkull 86 persona
- Seksi femër 11 persona

Grafiku 2.




Viti 2010

Numri i përgjithshem i pacientëve të dëmtuar me armë zjarri ishte 93 pacientë. Sipas seksit ishte:

- Seksi mashkull 80 persona
- Seksi femër 13 persona

Grafiku 3.



Prej 50 pacientëve me dëmtime me armë zjarri në pjesën e kokës, fytyrës apo kombinimit të fytyrë +kokë+organe të ndryshme, 10 prej tyre kishin dëmtime vetëm prej indeve të buta pa dëmtime kockore, 8 kishin fraktura të izoluara alveolare që u trajtuan me procedura dentare, 5 prej tyre kishin fraktura jo komplete dhe pa zhvendosje, të cilat nuk kishin nevojë për trajtim kirurgjikal, por u trajtuan me fiksim mandibul-maksill dhe 21 kishin dëmtime të maxillës dhe mandibulës komunitive me zhvendosje dhe me humbje substancë. (Nga këta, 12 pacientë kishin dëmtime në maksillë + mandibul dhe 9 dëmtime vetëm në mandibul).

Gjatë tre viteve ka pasur 6 të vdekur nga armët e zjarrit gjatë trajtimit të parë në urgjencë, përveç njërit që vdiq pas një jave.

Në 15 pacientë, në momentin e parë iu vendos shinë unimaksillare (mandibul e maksill ose në njërën prej tyre).

Për mbajtjen e fragmenteve dhe 3–4 ditë pas uljes së edemës iu nënshtruan trajtimit kirurgjikal (Osteosinteza me pllaka), kurse vetëm 6 pacientëve nuk iu bë mjekimi paraprak ortopedik

por vetëm trajtim kirurgjikal pas tre katër ditëve, për arsye se fragmentet kockore mbaheshin në pozicion nga indet e butë.

Nga 21 pacientët, vetëm në katër prej tyre u aplikua fiksimi mandibul-maksill, për arësye të pamundësisë ekonomike për të blerë pllakat pasi spitali nuk i disponon ato dhe blihen privatisht.

Nga 17 pacientët që u trajtuan me intervent kirurgjikal, vetëm në 15 pacientë u përdorën pllaka titanium dhe në 2 u përdorën pllaka çeliku për arsye të kostos së lirë. Nuk kemi asnjë rast të trajtuar me kockë të marrë nga kreshta iliake apo me fiksim të jashtëm. Frakturat e mandibulës sipas vendosjes ishin: 9 fraktura te trupit, 5 fraktura të këndit, 2 të simfizës, 1 frakturë të ramus mandibule dhe 4 fraktura të izoluara alveolare.

KOMPLIKACIONET

Komplikacioni më i shpeshtë është edema postoperatore, e cila u reduktua në trajtimin postoperator (antibiotiko-terapi).

Komplikacioni që na ka ndodhur pas 2 muajsh ishte osteomyelitis corpus mandibulae në 2 pacientë, të cilët u trajtuan me sekuestrotomi + rifiksim i fragmenteve me pllaka titaniumi.

Komplikacioni më i largët ndodhi pas 5 muajsh në 5 pacientë dhe ishte ekspozimi i pllakave në mukozë.

Në trajtimin me fiksim bimaksillar tip traksioni elastik, 4 pacientë nuk rifituan okluzion të mirë.

Fig. 1



Fig. 2.



Fig. 3.




Fig. 4.



Fig. 5.



Fig. 6.



DISKUTIMI

Duke u bazuar në praktikën tonë rekonstruksioni kirurgjikal i dëmtimeve të maksillës e mandibulës nga armët e zjarrit është trajtim më efikas se trajtimi ortopedik, pasi rikthimi i funksioneve, pamjes estetike dhe fiziologjike arrihet për një kohë të shkurtër, e këta pacientë adaptohen më lehtë e më shpejtë në jetën sociale. Në rastet me tentativë vetvrasje, dëmtimet kockore e të indeve të buta janë më të mëdha, prandaj rikonstruksioni i tyre është i vështirë e komplikacionet e mëdha.

Zgjedhja e mënyrës së trajtimit varet nga eksperienca e kirurgut dhe ka rëndësi në suksesin e trajtimit.

PERFUNDIMI

Gash	778	333	815	301	500	611	514	603	911	186
Thaç	163	91	186	69	116	137	116	136	216	38
Berish	564	242	581	226	395	411	379	427	671	137
Shaljan	149	64	155	60	90	124	98	115	178	34
Morin	801	343	858	286	504	641	503	641	955	182
Kelmend	158	89	183	64	108	133	105	144	205	36
Kryezi	29	27	30	24	26	29	27	29	31	23
Gjithsej	4116	1959	4408	1674	2690	3380	2866	3207	4984	1054

Vërejtje: krahu i djathtë mbi të majtin =D/M; krahu i majtë mbi të djathtin M/D; gishti i djathtë mbi të majtin =D/M; gishti i majtë mbi të djathtin M/D.

REZULTATE DHE DISKUTIME

Analiza e cilësive morfologjike në këtë mostër të popullatës të Komunës së Preshevës gjatë këtij studimi ka ndihmuar në raportimin e 9 fiseve të cilët i përkasin një etniteti. Duke përdorur formulimin matematik të Hardi-Vajnbergut ($p^2+2pq+q^2$), për të gjitha cilësitë e përfshira në këtë studim kemi llogaritur frekuencën e aleleve dominante dhe recesive (Pasqyra 2).

Pasqyra 2.

Frekuenca e alelit dominantë (D) dhe recesivë (R) në tiparet e studiuara

Fiset	Tipari	Tipari	Tipari	Tipari	Tipari

	gjuhë		vesh		krahu		gishti		mjekër	
	D	R	D	R	D	R	D	R	D	R
Krasniq	0.44	0.56	0.43	0.57	0.35	0.65	0.34	0.66	0.53	0.47
Sop	0.4	0.6	0.48	0.52	0.35	0.65	0.32	0.68	0.59	0.41
Gash	0.45	0.55	0.48	0.52	0.33	0.67	0.32	0.68	0.59	0.41
Thaç	0.4	0.6	0.48	0.52	0.32	0.68	0.32	0.68	0.61	0.39
Berishë	0.45	0.55	0.47	0.53	0.3	0.7	0.32	0.68	0.59	0.41
Shaljan	0.45	0.55	0.47	0.53	0.35	0.65	0.32	0.68	0.6	0.4
Morinë	0.45	0.55	0.5	0.5	0.34	0.66	0.34	0.66	0.6	0.4
Kelmend	0.4	0.6	0.49	0.51	0.33	0.67	0.35	0.65	0.61	0.39
Kryezi	0.31	0.69	0.34	0.66	0.27	0.73	0.28	0.72	0.34	0.66


Pasi kemi fituar rezultatet e frekuencës së aleleve dominante dhe recesive për tiparet, në çdo fis kemi bërë shumën e tyre dhe kemi përpjestuar me numrin 5 i cili paraqet numrin e tipareve. Në këtë mënyrë fitojmë vlerën mesatare të gjnotipit dominant dhe recesiv për çdo fis. Pasi kemi fituar vlerat e mesatares të gjenotipit te secili fis, kemi bërë ndryshimin e këtyre vlerave ndërmjet fiseve. Aty ku vlera e mesatares është e ngjashme ose kanë më pak ndryshime ndërmjet fiseve kuptojmë për një afërsi më të lartë. Ndërsa aty ku ndryshimet janë më të mëdha kuptojmë për një largësi gjenetike të tyre.

Mesatarja e gjnotipit të fituara e çdo fisi duket në Pasqyrën 3.

Pasqyra 3.

Vlerat mesatare të gjenotipeve dominante (D) dhe recesive (R) e tipareve të studiuara te fiset

Fiset	**Vlerat mesatare të gjenotipit dominant(D) dhe recesiv (R) te fiset**	
	D	**R**
Krasniq- A	0.418	0.582
Sop- B	0.428	0.572
Gash- C	0.434	0.566
Thaç- D	0.426	0.574
Berishë- E	0.426	0.574
Shaljan- F	0.438	0.562
Morinë- G	0.446	0.554
Kelmend-H	0.436	0.564
Kryezi- I	0.308	0.692



Grafikoni 1. Paraqitja e distancës gjenetike te fiset duke filluar nga vlera më e vogël e mesatarës së gjenotipit dominant deri te vlera më e madhe e mesatarës së gjenotipit dominant

Pasqyra 4.

Paraqitja e distancava(ndryshimeve) gjenetike te fiset e përfshira në këtë studim

	A	B	C	D	E	F	G	H	I
A	//	0.01	0.016	0.008	0.008	0.02	0.028	0.018	0.11
B	//	//	0.006	0.02	0.002	0.01	0.018	0.008	0.12
C	//	//	//	0.008	0.008	0.004	0.012	0.002	0.126
D	//	//	//	//	0.00	0.012	0.02	0.01	0.118
E	//	//	//	//	//	0.012	0.02	0.01	0.118
F	//	//	//	//	//	//	0.008	0.002	0.13
G	//	//	//	//	//	//	//	0.01	0.138
H	//	//	//	//	//	//	//	//	0.128
I	//	//	//	//	//	//	//	//	//

Vërejtje: me shkronja kemi paraqitur fiset: A=Krasniq; B=Sop; C= Gash; D=Thaç; E= Berish; F= Shal; G= Morin; H= Kelmend dhe I= Kryezi.

Kjo pasqyrë quhet matricë e distancave (ndryshimeve) midis popullatave. Në këtë punim kemi distancën gjenetike midis fiseve dhe me shkronja të mëdha kemi paraqitur fiset dhe vlerat e tyre. Duke bërë krahasimin në këtë matricë tregohet se me 0% ndryshime janë fisi Thaç dhe Berishë. Kjo ngjashmëri gjenetike bazuar në këto 5 tipare trashëguese na paraqet jo vetëm përbërjen gjenetike të tyre por edhe prejardhjen e përbashkët dhe ndrajen e vonshme të këtyre fiseve nga njëri tjetri. Si fis më i afërt me këto dy fise është fisi Sop me distancë gjenetike 0.002. Një afërsi të ngjashme me fisin Thaç dhe Berishë kanë fisi Kelmend dhe Gash me distancë gjenetike prej 0.002. Fiset Krasniq dhe Gash kanë të njejtën distanc gjenetike me fisin Berishë dhe Thaç. Fisi Krasniq pas këtyre fiseve ngjashmërin më të afërt gjenetike e ka me fisin Sop prej 0.001, fisin Gash prej 0.016 dhe me fisin Kelmend me 0.018. Fisi Gash është i afërt me fisin Shalë me diferenc prej 0.004. Në anën tjetër nga analiza dhe krahasimi i rezultateve tjera mund të themi se në distancë më të madhe është fisi Morinë me fisin Kryezi. Po ashtu me distancë dhe ndryshim gjenetik më të madh ka fisi Shalë dhe fisi Kelmend me fisin Kryezi. Vlenë të theksohet se edhe fiset tjera me fisin Kryezi janë në një distancë më të madhe, kurse distnacën më të vogël prej 0.11 e ka me fisin Krasniq e cila mbështet në faktin se fisi Kryezi është ndarë më vonë nga fisi Krasniq dhe përmban nji periodë të shkurtër evolutive (kohore). Në bazë të dhënave rreth distancave gjenetike të fiseve paraqesim dendogramin (Figura 2).




Figura 2. Dendograma e fiseve në Komunën e Preshevës në bazë të distancës gjenetike të tyre.

Së pari, dendogrami tregon se fiset janë ndarë në një kohë të caktuar dhe kanë nji distancë gjenetike relative. Prandaj duke vërejtur ndryshimet apo distancën gjenetike ndërmjet fiseve kuptojmë për nji ndarje të një etnie në krahaina të ndryshme etnografike. Duke jetuar në zona të ndryshme gjeografike të cilat karakterizohen me faktorë të ndryshëm ekologjik ka ardhur deri te ndryshimet gjenetike të fiseve. Sa më të theksuara të jenë ndryshimet ndërmjet fiseve aq më gjatë duhet të ketë qenë periudha kohore e ndarjes së fiseve nga njëri tjetri. Sa më të mëdha të janë ngjashmërit ndërmjet fiseve nënkuptohet se aq më vonë kanë divergjuar njëri prej tjetrit. Në dendogram shihet degëzimi i fiseve sipas afërsisë gjenetike.

PËRFUNDIME

1. Mbështetur në strukturën fisnore popullata e Komunës së Preshevës është e përzier.
2. Kjo prezencë e fiseve në një sipërfaqe prej 264km^2 nënkupton për një imigrim nga viset tjera të Serbisë Qendrore.
3. Ndryshimet dhe afërsia e këtyre tipareve nëpër fise na pasqyron një afërsi dhe distancë gjenetike ndërmjet fiseve.
4. Ngjashmëria gjenetike na kujtonë një ndarje apo divergjencë më të vonshme ndërsa distanca apo ndryshimi gjenetik më i madhë nënkuptonë nji ndarje më të hershme të fiseve dhe duke jetuar nëpër regjione të ndryshme gjeografike, faktori i mjedisit duke ndikuar në faktorin gjenetik ka sjellur këto ndryshime apo distanca gjenetike.
5. Fisi Thaç dhe fisi Berishë nuk kanë ndryshime gjenetike prandaj vendosen në bazën ose fillimin e dendogramit sepse ngjashmëria këtyre dy fiseve është e njëjtë me të gjitha fiset tjera.
6. Pas fisit Thaç dhe Berishë si fise më të afërta në mes veti janë: Fisi Gash dhe Shalë me fisin Kelmend me 0.002%ndryshime, Fisi Gash me fisini Shalë me 0.004%, Fisi Sop me fisin Gash me 0.006% dhe fisin Kelmend 0.008%. Pastaj me nga 0.008% ndryshime gjenetike janë: Fisi Krasniq dhe fisi Gash me fiset: Thaç, Berishë dhe në fund fisi Shalë me 0.008% ndryshim me fisin Morinë.

LITERATURA

1. Bajrami Z.1997. Për një hapësirë holistike në studimet antropologjike. Konferenca e parë e Antropologjisë shqiptare, Tiranë: 4-7.
2. Bajrami Z, Koni M. 2000.Teoria e evolucionit.SH.B.L.U.Tiranë, 51-64.
3. Bajrami Z, Mikerezi I.1988.Gjenetika (pjesa e dytë).Tiranë, 563.
4. Beadini Sh, Bajrami Ani. 2010. Antropologjia.Tetovë, 107-110.
5. Emery EHA, Muller FR,1987.Elemente të gjenetikës mjekësore.Tiranë, 66
6. Memushi L. 2000. Antropologjia. Tiranë, 267-269
7. Memushi L. 2003. Biologjia Humane. SHBLU.Tiranë, 72-84
8. Miladinović N. 2006. Metodologija Utvrđivanja Polne Pripadnosti Skeleta sa Arheoloških Nalazišta. Beograd, 23-27.
9. Kamberi N. 2009. Studim Gjenetik -Demografik i P opullatës së Preshevës (Punim i doktoraturës). Tiranë.
10. Ruka E, Bajrami Zyri. 1999. *Fjalori* i biologjisë.Tiranë.
11. Salillari A,Hoxha S. 2002.Gjenetika.Tiranë, 68-69.
12. Stanimirović Z, Đelić N. 2004. Principi genetike. Beograd, 21-25.

SUMMARY

THE RESEARCH OF GENETIC CLOSENESS AT ALBANIAN'S TRIBES IN PRESHEVO

Naser Kamberi[1], Shenasi Jusufi[2]

[1]Gymnasium "Skenderbeu", Preshevo, R. Serbia
[2] Hospital for Gynecology - Akushery
Unit Neonatology, "Mother Theresa", Cair, Skopje, Macedonia

By the notice of changes or the genetic distance among tribes we come to know the separation of one ethnicity in different ethnographical provinces. Living in different geographical zones the tribes have been under the influence of different ecological factors which inflamed the genetic changes. The more are the changes among the tribes the longer had been the period of the separation of the tribes from one another. The more were the similarities among the tribes the later happened the differences from one another. Dendogram shows that the tribes were split up in a definite time and had a relative genetic distance. By making a comparison in this matrix it is shown that 0% changes are at the tribe Thaç and Berishë. This genetic similarity basing on these 5 inherited features represents to us not only genetic form but as well as the common origin and the later separation of these tribes from one to another.The tribe which has more similarities with these tribes is the tribe Sop with the genetic distance of 0.002. The same similarity exists between the tribe Gash and Kelmend. The tribes Krasniq and Gash have more similarities with the tribe Shalë with the genetic difference of 0.004. On the other hand from the analyze and comparison of the results we can say that the bigger distance is with the tribe Morinë and the tribe Kryezi. Also the genetic distance is bigger between the tribe Shalë and tribe Kelmend with the tribe Kryezi and the smallest distance is 0.11 at the tribe Krasniq which is based on the fact that this tribe had been separated later and it consists a relative short period of evolution

Key words: *Albanian's tribes, dendogram*

PUNIM PROFESIONAL / PROFESIONAL PAPER

MJEKËSI SOCIALE

TË DHËNAT SOCIO-DEMOGRAFIKE TË GRAVE QË VUAJNË DËNIM NË BURGJET SHQIPTARE

Tatjana Milo[1]**,** Vangjel Tavo[1], Ervin Toci[1], Enver Roshi[1]

[1]Shërbimi Obstetrike Gjinekologji "Nëna Mbretëreshë", Tiranë, Shqipëri



Tatjana Milo, mjeke gjinekologe obsteter
Rr. "Pjeter Budi" Godina Nr 7 kati 3
Tel: 0035542262782 & 0035542227600
e-mail: **tanamilo@yahoo.com & tatjanamilo@yahoo.com**

REZYME: Sfondi: *Rreth grave te burgosura ne Shqiperi dihet shume pak dhe fare pak informacion mund te gjesh ne median elektronike gjithashtu. Kryesisht per to shkruhet ne raste te faljes se pjeses se mbetur te denimit nga Presidenti i Republikes, ne raste krimesh te bujshme me autore grate, ne ndonje kronike televizive lidhur me kushtet e tyre te jeteses apo kur politikanet perfshijne edhe grate e burgosura ne axhenden e aktiviteteve te tyre gjate diteve te shenuara apo ne kuader to fushatave te ndryshme me karakter social. Grate mund te jene denuar per arsye te ndryshme por pasojat e ketij veprimi jane shume dimensionale dhe bien jo vetem mbi vete te burgosurat por ne nje pjese te madhe dhe mbi femijet e tyre, te cilet duhet te vuajne faturen perkatese duke u munguar prania e nenes ne jeten e tyre. Duke lene menjane motivet qe i kane shtyre grate te kryejne krime te ndryshme, faktin se si ndjehen tani qe e gjykojne me gjakftohtesi te kaluaren, pasojat per jeten e tyre dhe te femijeve te tyre, ne ju drejtuam Drejtorise se Burgjeve per te marre ndonje informacion lidhur me grate e burgosura ne Shqiperi. Drejtoria e Burgjeve u tregua e gatshme dhe na ofroi te dhena lidhur me faktoret socio-demografike te grave te burgosura ne Shqiperi, perfshire moshen dhe arsimin si dhe kohezgjatjen e denimit te seciles prej tyre dhe arsyet e denimit per periudhen 2007-2010.*

Fjalë kyç: *Gratë e dënuara, burgjet shqiptare*

Medicus 2011, Vol. XV (1):

QËLLIMI I STUDIMIT

Studimi synon te vleresoje arsyet e burgosjes dhe lidhjen e tyre me faktoret socio-demografike te grave te denuara ne Shqiperi ne menyre qe te evidentohen implikimet e mundshme per sistemin arsimor dhe social per te mundesuar reduktimin e fenomenit ne te ardhmen.

Objektivi i pergjithshem

Te percaktoje arsyet e burgosjes dhe lidhjen e tyre me faktoret socio-demografike te grave te burgosura ne Shqiperi per periudhen 2007-2010.

Objektivat specifike

4. Te pershkruaje shperndarjen e llojeve te denimeve dhe kohezgjatjen e denimeve midis grave te burgosura ne Shqiperi per periudhen 2007-2010
5. Te vleresoje lidhjen e llojit te denimit me faktoret socio-demografike (mosha, arsim, rajoni i origjines) midis grave te burgosura ne Shqiperi per periudhen 2007-2010

METODOLOGJIA

Tipi i studimit: cross-seksional, vezhgues

- Pershkrues: shperndarja e subjekteve sipas vitit, faktoreve socio-demografike dhe llojit dhe kohezgjatjes se denimit
- Analitik: lidhja midis llojit te denimit dhe faktoreve socio-demografike

Popullata ne studim: grate e burgosura ne Shqiperi, sipas te dhenave te marra nga Drejtoria e Burgjeve, Sektori i Statistikave

Analiza e te dhenave: Analiza eshte kryer ne SPSS versioni 15, Incl dhe jane raportuar frekuencat ne numer absolut dhe perqindje. Duke qene se te gjithe variablet jane kategorike, atehere eshte perdorur testi chi square per te gjykuar nese ndryshimet mes kategorive te dy variableve jane statistikisht domethenes apo jo. Rezultatet u konsideruan domethenese nese nese p<=0.05.

REZULTATET

Te dhenat nga Drejtoria e Burgjeve i referoheshin 504 grave te burgosura ne te gjithe Shqiperine per vitet 2007-2010. Tabela 1 ne vijim paraqet nje permbledhje te te dhenave socio-demografike per keto subjekte kurse, Tabela 2 paraqet informacione lidhur me kohezgjatjen e denimit dhe llojin e krimit te kryer.

Tabela 1. Te dhenat socio-demografike te subjekteve ne studim

Variabli	Numer (%)	Variabli	Numer (%)
1. Viti		**2. Mosha**	
2007	111 (22.0)	21-30	156 (31.0)
2008	146 (29.0)	31-40	177 (35.1)
2009	150 (29.8)	41-50	126 (25.0)
2010	97 (19.2)	51+	45 (8.9)
3. Arsimi		**4. Origjina**	
Analfabet	54 (10.7)	Veri	171 (33.9)
Fillor	41 (8.1)	Jug	129 (25.6)
8-vjecar	315 (62.5)	Shqiperia e Mesme	204 (40.5)
I mesem	90 (17.9)		
I larte	4 (0.8)		

Tabela 2. Te dhenat lidhur me kohezgjatjen e denimit dhe llojit te tij

Variabli	Numer (%)	Variabli	Numer (%)
1. Kohezgjatja e denimit		**2. Lloji i krimit***	
Nen 1 vit	70 (13.9)	Krim ndaj personit (kryesisht brenda familjes)	207 (46.5)
1-5 vjet	142 (28.2)	Vjedhje	41 (9.2)
5-10 vjet	107 (21.2)	Shfrytezim prositucioni	47 (10.6)
10-15 vjet	68 (13.5)	Prostitucion	24 (5.4)
15-25 vjet	117 (23.2)	Trafik lendesh narkotike	98 (22.0)
		Mashtrim	28 (6.3)

*Mungon informacioni
per 59 gra

Tabela 3 dhe Tabela 4 ne vijim paraqesin shperndarjen e kohezgjatjes se denimit te caktuar per to dhe llojit te krimit te kryer sipas grup-moshes se subjekteve, perkatesisht.

Tabela 3. Shperndarja e subjekteve sipas grup-moshes dhe kohezgjatjes se denimit							
Grup-mosha	**Kohezgjatja e denimit**						
	Nen 1 vit	**1-5 vjet**	**5-10 vjet**	**10-15 vjet**	**15-25 vjet**	**TOTAL**	**P****
21-30	70 (44.9)*	85 (54.5)	0 (0.0)	1 (0.6)	0 (0.0)	156	
31-40	0 (0.0)	57 (32.2)	106 (59.9)	14 (7.9)	0 (0.0)	177	< 0.000
41-50	0 (0.0)	0 (0.0)	1 (0.8)	53 (42.1)	72 (57.1)	126	
51+	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	45 (100.0)	45	

* Numri dhe perqindja sipas rrjeshtit ne kllapa
**Vlera e P sipas testit chi square

Tabela 4. Shperndarja e subjekteve sipas grup-moshes dhe llojit te krimit te kryer								
Grup-mosha	**Lloji i krimit te kryer**							
	Krim ndaj personit	**Vjedhje**	**Shfrytezim prostitucioni**	**Prostitucion**	**Trafik lendesh narkotike**	**Mashtrim**	**Total**	**P****
21-30	155 (99.4)*	0 (0.0)	1 (0.6)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	156	
31-40	52 (29.4)	41 (23.2)	46 (26.0)	20 (11.3)	18 (10.2)	0 (0.0)	177	< 0.000
41-50	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	4 (3.8)	80 (76.2)	21 (20.0)	105[x]	
51+	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	7 (100.0)	7[xx]	

* Numri dhe perqindja sipas rrjeshtit ne kllapa
**Vlera e P sipas testit chi square
[x] Mungon informacioni per 21 persona
[xx]Mungon informacioni per 38 persona

Tabela 5 dhe Tabela 6 paraqesin shperndarjen e kohezgjatjes se denimit dhe llojit te krimit te kryer sipas nivelit te arsimit te subjekteve

Tabela 5. Shperndarja e subjekteve sipas nivelit te arsimit dhe kohezgjatjes se denimit							
Niveli i arsimit	**Kohezgjatja e denimit**						
	Nen 1 vit	**1-5 vjet**	**5-10 vjet**	**10-15 vjet**	**15-25 vjet**	**Total**	**P****
Analfabet	51 (94.4)	2 (3.7)	0 (0.0)	1 (1.9)	0 (0.0)	54	
Fillor	14 (34.1)	27 (65.9)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	41	
8-vjecar	5 (1.6)	113 (35.9)	107 (34.0)	64 (20.3)	26 (8.3)	315	< 0.000
I mesem	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	3 (3.3)	87 (96.7)	90	
I larte	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	4 (100.0)	4	

* Numri dhe perqindja sipas rrjeshtit ne kllapa
**Vlera e P sipas testit chi square

Tabela 6. Shperndarja e subjekteve sipas nivelit te arsimit dhe llojit te krimit			
Niveli i	**Lloji i krimit te kryer**		

arsimit								
	Krim ndaj personit	Vjedhje	Shfrytezim prostitucioni	Prostitucion	Trafik lendesh narkotike	Mashtrim	Total	P**
Analfabet	53 (98.1)	0 (0.0)	1 (1.9)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	54	
Fillor	41 (100)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	41	
8-vjecar	113 (35.9)	41 (13.0)	46 (14.6)	24 (7.6)	80 (25.4)	11 (3.5)	315	< 0.000
I mesem	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	4 (3.8)	18 (51.4)	17 (48.6)	35[x]	
I larte	-	-	-	-	-	-	-[xx]	

* Numri dhe perqindja sipas rrjeshtit ne kllapa
**Vlera e P sipas testit chi square
[x] Mungon informacioni per 55 persona
[xx]Mungon informacioni per 4 persona

Lidhur me shperndarjen e kohezgjatjes se denimit sipas origjines se subjekteve, Tabelat 7 dhe 8 japin nje informacion te detajuar

Tabela 7. Shperndarja e subjekteve sipas origjines dhe kohezgjatjes se denimit

Origjina	Kohezgjatja e denimit						
	Nen 1 vit	1-5 vjet	5-10 vjet	10-15 vjet	15-25 vjet	Total	P**
Veri	68 (39.8)	96 (56.1)	5 (2.9)	1 (0.6)	1 (0.6)	171	
Jug	2 (1.6)	45 (34.9)	77 (59.7)	4 (3.1)	1 (0.8)	129	< 0.000
Shqiperi e Mesme	0 (0.0)	142 (28.2)	107 (21.2)	68 (13.5)	117 (23.2)	204	

* Numri dhe perqindja sipas rrjeshtit ne kllapa
**Vlera e P sipas testit chi square

Tabela 8. Shperndarja e subjekteve sipas origjines dhe llojit te krimit

Origjina	Lloji i krimit te kryer							
	Krim ndaj personit	Vjedhje	Shfrytezim prostitucioni	Prostitucion	Trafik lendesh narkotike	Mashtrim	Total	P**
Veri	169 (98.8)	0 (0.0)	1 (0.6)	0 (0.0)	1 (0.6)	0 (0.0)	171 (100.0)	
Jug	36 (28.1)	41 (32.0)	39 (30.5)	12 (9.4)	0 (0.0)	0 (0.0)	128[x] (100.0)	< 0.000
Shqiperi e Mesme	2 (1.4)	0 (0.0)	7 (4.8)	12 (8.2)	97 (66.4)	28 (19.2)	146[xx] (100.0)	

* Numri dhe perqindja sipas rrjeshtit ne kllapa
**Vlera e P sipas testit chi square
[x] Mungon informacioni per 1 person
[xx]Mungon informacioni per 58 persona

Tabela 9 ne vijim paraqet nje informacion te detajuar lidhur me shperndarjen e subjekteve sipas origjines dhe llojit te krimit te kryer, pergjate viteve 2007-2010

Tabela 9. Shperndarja e subjekteve sipas origjines dhe llojit te krimit te kryer, sipas viteve

		Lloji i krimit te kryer							
Viti	Origjina	Krim ndaj	Vjedhje	Shfrytezim	Ushtrim prostituci	Trafik lende	Mashtrim	Total	P**

		personit		prostitucioni	oni	narkotike			
2007	Veri	**45 (100.0)**	0 (0.0)	**0 (0.0)**	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	45 (100.0)	<0.000
	Jug	**8 (30.8)**	7 (26.9)	**8 (30.8)**	**3 (11.5)**	0 (0.0)	0 (0.0)	26 (100.0)	
	Shq mesme	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	2 (8.0)	**16 (64.0)**	7 (28.0)	25 (100.0)	
2008	Veri	**51 (98.1)**	0 (0.0)	**0 (0.0)**	0 (0.0)	1 (1.9)	0 (0.0)	52 (100.0)	<0.000
	Jug	**5 (15.2)**	10 (30.3)	**12 (36.4)**	**6 (18.2)**	0 (0.0)	0 (0.0)	33 (100.0)	
	Shq mesme	1 (2.4)	0 (0.0)	0 (0.0)	2 (4.8)	**33 (78.6)**	6 (14.3)	42 (100.0)	
2009	Veri	**43 (100.0)**	0 (0.0)	**0 (0.0)**	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	43 (100.0)	<0.000
	Jug	**10 (23.3)**	17 (39.5)	**13 (30.2)**	3 (7.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	43 (100.0)	
	Shq mesme	0 (0.0)	0 (0.0)	1 (2.6)	6 (15.4)	**25 (64.1)**	7 (17.9)	39 (100.0)	
2010	Veri	**30 (96.8)**	0 (0.0)	**1 (3.2)**	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	31 (100.0)	<0.000
	Jug	**13 (50.0)**	7 (26.9)	**6 (23.1)**	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	26 (100.0)	
	Shq mesme	1 (2.5)	0 (0.0)	6 (15.0)	2 (5.0)	**23 (57.5)**	8 (20.0)	40 (100.0)	

* Numri dhe perqindja sipas rrjeshtit ne kllapa
**Vlera e P sipas testit chi square

Tabela 10 tregon shperndarjen e subjekteve sipas nivelit te arsimit dhe llojit te krimit te kryer, pergjate viteve 2007-201

Tabela 10. Shperndarja e subjekteve sipas nivelit te arsimit dhe llojit te krimit te kryer, sipas viteve

		Lloji i krimit te kryer							
Viti	**Niveli i arsimit**	**Krimndaj personit**	**Vjedhje**	**Shfrytezim prostitucioni**	**Ushtrim prostitucioni**	**Trafik lende narkotike**	**Mashtrim**	**Total**	**P****
2007	**Analfabet**	14 (100.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	14 (100.0)	<0.000
	Fillor	11 (100.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	11 (100.0)	
	8-vjecar	28 (40.6)	7 (10.1)	8 (11.6)	5 (7.2)	16 (23.2)	5 (7.2)	69 (100.0)	
	Mesem	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	2 (100.0)	2 (100.0)	
2008	**Analfabet**	17 (100.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	17 (100.0)	<0.000
	Fillor	12 (100.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	12 (100.0)	
	8-vjecar	28 (30.4)	10 (10.9)	12 (13.0)	8 (8.7)	34 (37.0)	0 (0.0)	92 (100.0)	
	Mesem	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	6 (100.0)	6 (100.0)	

2009	**Analfabet**	14 (100.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	14 (100.0)	<0.000
	Fillor	12 (100.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	12 (100.0)	
	8-vjecar	27 (28.4)	17 (17.9)	14 (14.7)	9 (9.5)	25 (26.3)	3 (3.2)	95 (100.0)	
	Mesem	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	4 (100.0)	4 (100.0)	
2010	**Analfabet**	8 (88.9)	0 (0.0)	1 (11.1)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	9 (100.0)	<0.000
	Fillor	6 (100.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	6 (100.0)	
	8-vjecar	30 (50.8)	17 (11.9)	12 (20.3)	2 (3.4)	5 (8.5)	3 (5.1)	59 (100.0)	
	Mesem	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	0 (0.0)	18 (78.3)	5 (21.7)	23 (100.0)	

* Numri dhe perqindja sipas rrjeshtit ne kllapa
**Vlera e P sipas testit chi square

DISKUTIMI

Nga viti 2007 deri ne 2009 kemi nje rritje te numrit te grave te denuara me burgim (22% kundrejt 29.8% respektivisht) ndersa viti 2010 eshte shoqeruar me uljen e perqindjes se tyre kundrejt totalit per keto kater vite (19.2%). Gati nje e treta e grave te denuara i perkasin grupmoshave 21-30, 31-40 dhe 41-50 vjeç ndersa grup-mosha me pak e perfaqesuar eshte ajo mbi 51 vjec me 8.9% te te gjitha grave te burgosura. Grate me arsim 8-vjeçar perbejne grupin dominues midis grave te burgosura te ndjekura nga ato me arsim te mesem dhe ato pa shkolle (62.5%, 17.9% dhe 10.7% respektivisht). Vetem 0.8% e grave te denuara jane me arsim te larte. Nje shperndarje e tille sipas niveli arsimor ndoshta tregon nevojen qe arsimi i detyrueshem duhet te shtrihet dhe ne shkollen e mesme duke qene se pas arsimit 8-vjecar verehet nje renie drastike e perqindjes se grave me arsim te mesem qe shkelin ligjin per arsye nga me te ndryshmet.

Persa i perket origjines se grave, afersisht nje e treta e tyre vijne nga jugu, veriu dhe Shqiperia e mesme (25.6%, 33.9% dhe 40.5% respektivisht). Kjo do te thote qe asnje zone e Shqiperise nuk eshte "imune" nga grate qe kryejne krime te ndryshme, edhe pse zona jugore perfaqesohet lehtesisht me pak krahasuar me zonat e tjera te vendit.

Perqindja me e madhe e grave jane denuar me 1-5 vjet (28.2%), te ndjekur nga 23.2% e tyre te denuara me 15-25 vjet burgim dhe 21.2% te denuara me 5-10 vjet. Sigurisht, kohezgjatja e denimit eshte e lidhur me llojin dhe rendesine e krimit te kryer.

Lidhur me llojin e krimit te kryer, rreth gjysma e grave (46.5%) jane denuar per krime ndaj personit, ndjekur nga 22.0% e tyre te denuara per trafik lendesh narkotike dhe 10.6% per shfrytezim prostitucioni. Nderkohe vetem 5.4% e grave jane denuar per ushtrim prostitucioni. Nese krahasohen te dhenat lidhur me kohezgjatjen e denimit dhe llojin e krimit te kryer, mund te verehet nje korrespondim i mire i shifrave. Per shembull, dihet qe denimet me te ashpra jepen ne rastin e krimit kunder personit dhe nga te dhenat mund te vihet re qe 46.5% e grave jane denuar per krime ndaj personit dhe 36.7 % e grave jane denuar me mbi 10 vjet burgim, cka verteton konstatimin e bere ne paragrafin mesiper lidhur me varesine e kohezgjatjes se denimit nga lloji i krimit te kryer.

Shqyrtimi i lidhjes midis moshes se subjekteve dhe kohezgjatjes se denimit tregon nje ndryshim te forte statistikisht domethenes ($p<0.000$) midis grupmoshave te ndryshme dhe kategorive te kohezgjatjes se denimit. Gati te gjitha grate e grupmoshes 21-30 vjec (99.4%) jane denuar 5 vjet ose me pak nderkohe gati te gjitha grate mbi 41 vjec jane denuar mbi 10 vjet (99.2% dhe 100.0% respektivisht). Nga ana tjeter, 99.4% e grave 21-30 vjec jane denuar per krim ndaj personit dhe me rritjen e moshes vihet re nje ulje e perqindjes se grave qe kryejne kete krim (29.4% midis grupmoshave 31-40 dhe 0% midis atyre mbi 41 vjec). Me rritjen e moshes, nje perqindje gjithnje e me e madhe e grave merren me trafik lendesh narkotike (76.2% midis grave 41-50 vjec) dhe mashtrim

(20.0% dhe 100.0% midis grave 41-50 vjec dhe mbi 51 vjec respektivisht). Ndryshimet jane domethenese ($p<0.000$).

Nje perqindje shume me e madhe e grave analfabete dhe me arsim te mesem kane kryer krime kunder personit krahasuar me grate me arsim me te larte (98.1% dhe 100.0% e grave analfabete dhe atyre me arsim fillor krahasuar me 35.9% te atyre me arsim 8 vjecar). Shfrytezimi i prostitucionit ushtrohet kryesisht nga grate me arsim 8-vjecar (14.6% e tyre) ndersa midis grave me arsim te mesem me shume se gjysma merren me trafik lendesh narkotike dhe gjysma me mashtrime te ndryshme (51.4% vs. 48.6% perkatesisht). Tabloja e mesiperme eshte e kuptueshme duke patur parasysh qe mungesa e shkollimit eshte nje faktor risku per krime te ndryshme te cilat kerkojne dhe fuqi fizike dhe ne konstatuam me lart qe pjesa me e madhe e krimeve kunder personit kryhet nga moshat e reja.

Kur shqyrtohen origjina e subjekteve sipas llojit te krimit vihet re qe gati te gjitha grate (98.8%) me origjine nga veriu i Shqiperise jane denuar per krime kunder personit krahasuar me 28.1% dhe 1.4% te grave me origjine nga jugu dhe Shqiperia e mesme perkatesisht te cilat jane denuar per te njejtat vepra penale. Keto ndryshime jane domethenese ($p<0.000$). Shkaku per keto diferenca te thella mund te jete mentaliteti i ndryshme ne keto zona te ndryshme te Shqiperise. Nese llogaritet raporti i gjasave (OR) i krimit ndaj personit midis grave me origjine nga veriu krahasuar me ato me origjine nga jugu dhe Shqiperia e mesme atehere rezulton qe grate me origjine nga veriu kane rreth 216 dhe 6000 here me shume te ngjare (OR=216 dhe OR=6084) te kryejne krime ndaj personit krahasuar me grate me origjine nga jugu apo pjesa e mesme e Shqiperise, respektivisht.

Nese behet nje analize e detajuar e llojit te krimit te kryer dhe origjines se grave sipas viteve ne studim, atehere vihet re po e njejta tendence gjate viteve: grate me origjine nga veriu i vendit i zgjidhin problemet e tyre nepermjet krimit ndaj personit dhe kjo eshte ne kontrast te thelle me grate me origjine nga zona te tjera te vendit. Psh, ne 2007, 100% e grave nga veriu jane burgosur per krim ndaj personit, ne 2008 98.1% e tyre jane denuar per kete krim dhe ne vitet 2009-2010 perqindja e grave veriore te denuara per krime ndaj personit varion 96.8%-100%. Nese shohim grate nga jugu i vendit mund te vihet re qe ne 2007, 30.8% e tyre jane denuar per krim ndaj personit, dhe nga vitet 2008-2010 perqindja e tyre varion 15.%-50.0% ne 2010. Ne 2010 shihet se ka nje rritje te theksuar te grave me origjine nga jugu te denuara per krime ndaj personit. Gjithsesi tabloja dominohet nga grate veriore te cilat ne shumice derrmuese denohen per krime ndaj personit. Kjo eshte nje situate qe meriton vemendje te vecante nga te gjithe aktoret, sepse kjo nuk eshte nje gjendje e rastesishme por eshte e lidhur ngushte me nje sere faktoresh te cilet mund te parandalohen.

Nderkohe qe lidhur me trafikimin e lendeve narkotike, perqindja me e madhe e grave te denuara per cdo vit eshte me origjine nga Shqiperia e mesme (64.0%, 78.6%, 64.1% dhe 57.5% gjate viteve 2007-2010, respektivisht). Mesa duket harta e krimeve ne Shqiperi te kryera nga grate ka nje ndarje pak a shume te qarte, ku zonat veriore dominohen nga krimet kunder personit, ato jugore nga shfrytezimi i prostitucionit dhe zonat e Shqiperise se mesme nga trafiku i lendeve narkotike.

Pergjate viteve, jane grate analfabete dhe ato me shkolle fillore ato te cilat ne shumice derrmuese qe varion nga 88.9%-100.0% jane denuar per krime kunder personit. Kjo duhet te sherbeje si nje alarm per mbare shoqerine shqiptare, dhe vecanerisht per politikanet, ne menyre qe sherbimi arsimor te mbuloje me mire te gjithe shoqerine tone dhe ne menyre te vecante te ndjeke nga afer zbatimin e ligjit lidhur me ndjekjen e shkolles se detyruar nga legjislacioni. Mesa duket nje ane negative e arsimit duhet te jete rritja e aftesise per te mashtruar duke qene se ne te gjitha rastet gati te gjitha grate me arsim te mesem ose me lart jane denuar per mashtrim, me perjashtim te vitit 2010. Gjithsesi shifrat e grave mashtruese jane shume me te vogla se ato te grave qe kryejne krime ndaj personit dhe ne 2010 vihet re nje renie e theksuar e grave mashtruese. Keshtu qe edukimi mbetet nje prioritet per parandalimin e krimeve te renda. Nderkohe qe trafiku i lendeve narkotike ne te gjitha rastet kryhet nga gra me arsim 8-vjecar ose me te larte.

KONKLUZIONE

Shqyrtimi i te dhenave rreth grave te denuara me burgim ne Shqiperi shpalosi te dhena mjaft interesante.

Krimi me i rende qe parashikohet nga legjislacioni penal shqiptar eshte krimi kunder personit per vete pasojat e pakthyeshme qe ai sjell per vete viktimen dhe, ne nje kuader me te gjere, per familjaret e tij. Shqyrtimi i kujdesshem i joni zbuloi se pjesa me e madhe e krimeve kunder personit

kryhet nga grate e reja te moshes 21-30, te cilat kryesisht jane gra analfabete dhe me shkolle fillore, dhe me origjine nga pjesa veriore e Shqiperise. Kjo tendence eshte e qendrueshme per gjate gjithe viteve ne shqyrtim 2007-2010.

Lidhur me trafikimin e lendeve narkotike pjesa me e madhe e grave te denuara si pasoje e kesaj shkeljeje jane me origjine nga Shqiperia e mesme, relativisht te shkolluara (shkolle 8-vjecare ose me lart) dhe ne meso-moshe (31-50 vjec).

Nje tjeter krim i perhapur ne Shqiperi, dhe ku grate luajne rol te konsiderueshem, eshte dhe shfrytezimi i prostitucionit. Grate e denuar per kete shkelje jane kryesisht nga pjesa jugore e Shqiperise, mesatarisht te arsimuara (arsim 8-vjecar) dhe te grup-moshes 31-40 vjecare.

Konkluzioni madhor i ketij studim eshte qe, mesa duket, harta e krimeve ne Shqiperi te kryera nga grate ka nje ndarje pak a shume te qarte, ku zonat veriore dominohen nga krimet kunder personit, ato jugore nga shfrytezimi i prostitucionit dhe zonat e Shqiperise se mesme nga trafiku i lendeve narkotike. Ne te gjitha rastet nje faktor percaktues mbetet niveli i shkollimit te grave, i cili u shfaq si nje faktor percaktues ne ndodhjen e krimeve te ndryshme, kryesisht te krimit kunder personit nga ana e grave. Fakti qe gati te gjitha krimet kunder personit jane kryer nga gra me origjine nga pjesa veriore e Shqiperise deshmon per nje prapambetje te thelle te grave ne keto zona, per nje mentalitet shume te ndryshem i cili duhet te analizohet me kujdes dhe te adresohet nga aktoret e interesuar.

REKOMANDIME

Ne perfundim, sugjerojme se eshte mese e domosdoshme te behet nje studim i thelluar rreth grave te denuara me burgim ne Shqiperi si dhe e situates se grave ne Veri te Shqiperise dhe ne gjithe vendin pergjithesi, ne menyre qe te parandalohen krimet e ardhshme dhe te ndihmohen grate qe te mos e gjejne zgjidhjen e problemeve te tyre nepermjet krimeve te cfaredo natyre qofshin, dhe kjo eshte nje detyre madhore qe duhet te permbushet nga shoqeria Shqiptare.

LITERATURA

1. http://www.forumishqiptar.com/showthread.php?t=60070
2. http://lajme.shqiperia.com/lajme/artikull/iden/372496/titulli/Grate-e-burgosura-ekspozite-ne-Tirane
3. http://www.gazetadielli.com/index.php?option=com_content&view=article&id=819:presidenti-priti-grate-e-persekutura-&catid=49:november-2010&Itemid=55
4. http://lajme.shqiperia.com/lajme/artikull/iden/206054/titulli/Grate-e-burgosura-festojne-8-Marsin

SUMMARY

SOCIO-DEMOGRAPHIC DATA AMONG WOMEN PRISONERS

Tatjan Milo[1], Vangjel Tavo[1], Drita Jaka[1], Enver Roshi[1], Ervin Toci[1]

[1]Obstetric-Gynecology Hospital "Mother Qeen", Tirana, Albania

Background: Most of information available on jailed women in Albania comes from electronic media which dedicates some attention to them in case of Presidential forgiveness of the remaining detention period, grave crimes signed by women or when politicians spend some attention on jailed women in the frame of international activities. Clearly, this is a neglected group and little is known about them. **Aim of the study:** To assess jail reasons and their associations with socio-demographic factors among jailed women in Albania in order to spot potential implications for the educational, social and political system for enabling the reduction of the phenomenon in the future. **Methods:** The data used in this cross-sectional survey were made available from the statistics office of the Jail Directory of Albania. The data cover the period 2007-2010. **Results:** From 2007-2009 there has been an increase in the number of newly jailed women but in 2010 this number decreased (22% vs. 19.2%, respectively). 8.9% of jailed women were 51+ years old whereas the remaining were equally divided among three younger age groups. 62.5% of jailed women were illiterate and only

0.8% of them had university education. About one third of women originated from north, south and middle parts of Albania. Just about half (46.5%) of women have been jailed for crimes against person. 22% for drugs trafficking and 10.6% for exploitation of prostitution. The association between age, level of education and origin with crime type was highly significant ($p<0.001$) with younger (21-30), illiterate (no school) and from northern parts women much more likely to commit crimes against person as compared to older ones, higher educated ones and from regions other than north of Albania. Women from middle parts of Albania are more likely to be jailed for illicit drug trafficking compared to women from other regions ($p<0.001$) whereas women from southern parts are more likely to be convicted for exploitation of prostitution compared to women from other parts of Albania ($p<0.001$).
Conclusions: The overwhelming majority of crimes against persons are computed by young women aged 21-30, which are mainly illiterate and originate from northern Albania and this trend, is constant during 2007-2010. It seems that the crimes' map committed by women in Albania is clearly contoured, with northern parts being dominated by crimes against person, southern ones by prostitution exploitation and middle part by illicit drugs trafficking. The major determinants of these trends seem to be education level (together with region of origin). The facts indicate a deeply concerning situation regarding the state of women in northern Albania and a still very different mentality of people in these parts which has to be carefully studied and addressed by relevant stakeholders. **Recommendations:** We suggest for the indispensability of further deepened research relating jailed women in Albania and the situation of women living in northern parts and across the country in general, in order to prevent and reduce future crimes and felonies and to help the women to not choose to solve problems through crimes of any nature. This is a major duty which Albanian society owes to its women.

Key words: Punitive women, Albanian jails

PREZANTIM RASTI / CASE REPORT KARDIOLOGJI

APLIKIMI I TERAPISË FIBRINOLITIKE ME PROTOKOL TË ZGJATUR NË LIZËN E TROMBIT MOBIL TË ATRIUMIT TË DJATHTË
Prezantim rasti

Fatmir Ferati[1], Nexhbedin Karemani[2], Sulejman Ameti[3]

Spitali Klinik, Tetovë, Maqedoni
[1]Reparti për Sëmundjet e Brendshme, Tetovë, Maqedoni
Universiteti Shtetëror Tetovë[2], Tetovë, Maqedoni
Reparti Neurologjik[3], Tetovë, Maqedoni



Fatmir Ferati, mjek internist kardiolog
Rr. Gj.Petrov 34.Tetovë
Tel: 070 224 138
e-mail: fatmir_ferati@yahoo.com

REZYME: *Në këte punim prezantojme aplikimin e fibrinolizës me streptokinazë, tek pacientja me kardimiopati iskemike dhe implant të pejsmejkerit permanent. Masa trombotike mobile e madhe, me siperfaqe prej 4 cm^2, ishte e vendosur në nivel të anulusit të valvulës trikuspidale, kurse masa e vogël trombotike në nivel të vena cava superior. Për shkak të trombit mobil në atriumin e djathtë ekzistonte rrezik i lartë për tromboemboli pulmonale me pasoja të rënda për pacienten. Si mundësi terapeutike urgjente, u parashtruan dy varianta: (1) menjanimi i masës trombotike me anë të ndërhyrjes operative dhe (2) aplikimi i fibrinolizës me protokol të zgjatur. Për shkak të kompleksitetit të gjendjes së pacientes, u zgjodh varianti i aplikimit të streptokinazës me protokol të zgjatur. Pas aplikimit të fibrinolizës, u bë kontrolli ultrasonografik i dytë, e cila vërtetoi lizën komplete të trombeve, me çka u vërtetua efekasiteti i fibrinolizës.*

Fjalë kyç: *2D ehokardiografia, tromb mobil në atriumin e djathtë, fibrinoliza, streptokinaza, implant i pejsmejkerit permanent, kardiomiopatia iskemike*

Medicus 2011, Vol. XV (1):

HYRJE

Fibrinoliza si një mjet terapeutik në mjekimin e infarktit akut miokardial, bëri një revolucion të vërtetë në mjekimin e kësaj gjendjeje akute dhe shumë të rëndë. Efektet e fibrinolizës, streptokinazës në mjekimin e infaktit akut u shprehën në mënyrë të shpejtë. Si rezultat i saj, u ul në menyrë dramatike vdekshmëria nga infarkti akut miokardial, dhe në epokën para ekzistimit të angioplastikës perkutane të arteriesë koronare, paraqiste metodën e vetme shpëtimtare për shumë pacientë me infakt të miokardit.

Sot, angioplastika ka një perparsi në mjekimin e sindromit akut koronar në mjedise ku ajo është e mundur, por ajo nuk mund të menjanojë aplikimin e fibrinolizës, metodë komplementare për mjekim adekuat të infarktit miokaradial.

Aplikimi i fibrinolizës, streptokinazës konsiderohet si metodë superiore në mjekim e pacientëve me trombemboli pulmonale dhe të trombeve intrakardiake.Tek pacientët të cilët kanë një kardiopati të avancuar, prani të trombit mobil në kaviteve ndërhyrja kirurgjike është e rezikshme, kurse aplikimi i fibrinolizës është standard i artë (1). Nëse streptokinaza nuk e bën lizën e trombit vjen në konsiderim ndërhyrja kirurgjike.

Te infarkti miokardial akut, jepet doza e plotë e streptokinazës në afat kohor të shkurtë prej 5 - 30 minuta, kurse te tromboembolia pulmonale si dhe te trombet në zemër, aplikimi bëhet me infusion 24 orësh ose më gjatë, varësisht prej protokolit të zgjedhur (1, 2, 3).


RASTI JONË

Raportojmë rastin e pacientes M.XH, 58 vjeç, e cila është hospitalizuar për shkak të dispnesë dhe lodhjes së pashpjeguar në muajin e fundit.

Para 6 vitesh pacientja ka përjtua infarkti akut miokardial, që është mjekuar në menyrë konvencionale. Më vonë tek pacientja është zhvilluar kardiopatia iskemike me shenja të një remodelimi të miokardit të ventrikulit të majtë. Për shkak të bradikardisë ekstreme tek e sëmura implantohet pejsmejker permanent.


Gjatë hospitalizimit në repartin tone në ekokardiografi EF isht 52%, hipo-akinezi të segmentit të mesëm dhe apikal të murit anterior të ventrikulit të majtë, i cili ishte i zgjeruar në mënyrë aneurizmatike. U vërejtë elektroda e pejsmejkerit në nivel të atriumit të djathtë dhe ventrikulit të djathtë me insercion normal.

Në nivel të valvulës trikuspidale, në pjesën e anulusit, u regjistrua një masë hiperehogjene, mjaft mobile, me dimenzione prej 2x2 cm. Në pjesën e hyrjes së elektrodës së pejsmejkerit në vena kava superior, vërehet gjithashtu masë hiperehogjene, e dyshuar për masë të vogël trombotike (fig. 1, 2 dhe 3).



Si opcione terapeutike më i pershatshme u zgjodh aplikimi i streptokinezës me një protokol të zgjatur. Paraprakisht u morrën analizat të hemostazes dhe aPTT, te cilat rezultuan në kufi të normales. D-dimeri si pasojë e masës trombotike ishte i lartë, në vlerë prej 8500 Ui/dl.

Në infuzion të Dekstrozës 5% prej 500 ml, u tret 1,500.000 IE të streptokinazës. Në infuzomat u caktua titri i i infuzionit prej 21 ml/ ore. Gjatë aplikimit të streptokinazes nuk u regjistruan efekte anësore majore, me përjashtim të hematurisë tranzitore që zgjati 10 orë. Për këtë arsye, heparina u aplikua 8 orë pas infuzionit në doze prej 20.000 Nj për 24 orë. Në ehokardiografi u regjistruan kavitete dhe parametrat e funksionit të zemrës me vlera të njëjta. Në nivel të atriumit të djathtë nuk vërehet masa trombotike e as partikula në hyrje të vena cava superior (fig. 4 dhe 5).



DISKUTIMI

Rasti jonë e tregon qartë rëndësinë e aplikimit të fibrinolizës te trombi në kavitetet e zemrës. Sot kjo terapi nuk aplikohet shpesh, ndonëse bën efekt të shkëlqyeshëm, sidomos në trombet mobile.

Këte rast ne e paraqesim me qëllim që të vërtetojmë efektin e aplikimit të fibrinolizës sidomos në masat trombotike mobile (1, 2, 3), të cilat kanë potencial të lartë të japin trombemboli pulmonale me pasoja të rënda. Aplikimi i streptokinazës si dhe fibrinolitikëve tjerë, kur përjashtohen kundërindikacionet, është mënyrë e përshtatshme dhe me pak efekte anësore (1, 2).

LITERATURA

1. Kenneth J. May, Jr, MD; John T. Cardone, MD; Paul P. Stroebel, MD; Arthur L. Riba, MD: Streptokinase Dissolution of a Right Atrial Thrombus Associated With a Temporary Pacemaker; ARCH INTERN MED. 1988;148(4):903-904
2. Margaret M. Olsen, Jeffrey L. Blumer, Michael W.L. Gauderer and Robert J. Izant, Jr. Streptokinase dissolution of a right atrial thrombus Journal of Pediatric Surgery Volume 20, Issue 1, February 1985, Pages 19-21
3. Dufour C, Molinari AC, Tasso L, De Caro E, Rimini A, Mori P. Lysis of a right atrial thrombus of more than a week's duration by high dose urokinase in a one-year-old child. Citation: Haematologica. 1997 May-Jun; 82(3): 357-9

SUMMARY

APPLYING FIBRINOLITICAL THERAPY WITH PROLONGED PROTOCO, INTO DIGESTION OF THE MOBILE TROMB OF THE RIGHT ATRIUM
Case report

Fatmir Ferati[1], Nexhbedin Karemani[2], Sulejman Ameti[3]

[1]Clinical Hospital for Internal Medicine, Tetova, Macedonia
[2]State University of Tetova, Tetova, Macedonia
[3]Departament of Neurology, Tetova, Macedonia

In this case we will resent the appliance of fibrinolisys (streptokinase) on the patient with ischemic cardimiopathy, implant of the permanent pacemaker, where the presence of the mobile thrombotic masses with volume 4cm2, positioned on the annulus of the tricuspid valve. Due to a mobile thrombi of the right atrium, where the high possibility of pulmonary thromboembolism exists and which because of the high volume of the thrombi could have left very tough consequences for the patient and for urgent therapy were given two options: (1) elimination of the thrombotic volume with surgery or (2) applying fibrinolysis with prolonged protocol for lisys of the thrombotic masses. Because of the complexity of the patients state, the streptokinase option was chosen with prolonged protocol. After applying streptokinase, the second ultrasound exam was made, which proved the complete lisys of the thrombotic masses.

Key words: *2D echocardiography, mobile thrombi in the right atrium, fibrinolysis, streptokinase, implant of the permanent pacemaker, cardiomyopathy*

PREZANTIM RASTI / CASE REPORT
PEDIATRI-NEONATOLOGJI

MENINGOMYELOCELA
-Prezantim rasti-

Sani Bajrami[1], Florin Besimi [2], Zllata Trimçevska[2], Antigona Trenevska[2], Drita Tefiku[2], Meral Rexhepi[2], Afërdita Ismaili[2], Nagip Rufati[2], Arian Alili[2], Destan Haliti [2], Arben Taravari[2]

[1]Spitali Klinik, Tetovë, Maqedoni
[1]Reparti Gjinekologji-Akusheri-Neonatologji, Tetovë, Maqedoni
[2]Reparti Kirurgji Tetovë, Maqedoni
[2]Klinika e Neurologjisë, Shkup, Maqedoni



Sani Bajrami, mjek pediatër
Spitali Klinik, Tetovë, Maqedoni
Tel: 070/321 643
e-mail: **dr.sanibajrami@hotmail.com**

REZYME. *Meningomyelocela është anomali e rallë e boshtit kurrizor. Kjo anomali kërkon trajtim të veçantë kirurgjik, si dhe përcjellje të mëtutjeshme neurologjike. Qëllimi i prezantimit tonë, është paraqitja e një rasti me meningomyelocele në repartin tonë, diagnostikimi i herëshëm i saj dhe nevoja dhe arsyjet për intervenim të shpejtë kirurgjik, të cilat janë shumë të rëndësishme në trajtimin e mëtutjeshëm.*

Fjalë kyç*: Meningomyelocele, diagnostikimi, paraparesa*

Medicus 2011, Vol. XV (1):

HYRJE

Meningomyelocela paraqet prominence pedunkulare e cila përveç meningjeve përmban edhe pjesë të boshtit të kurizit si dhe rënjëve të nervave që mund ose jo të jetë e mbuluar me lëlkurë. Etiologjia e saj mbetet e pa qartë. Faktorët negativ veprojnë mes muajve 4 dhe 12 të jetës intrauterine. Paraqitet me incidencë nga 0,2 deri 4,0 në 1000 lindje. Faktorët hereditarë luajnë rol shumë të rëndësishem.

Shpesh herë kjo anomali shkon bashkë me anomali të tjera të sistemit nervor qëndror (SNQ), si p.sh. sindrmi i Arnold-Chiari, sipas saj edhe hydrocephalusi do të jetë shenjë shoqëruese (1).

Kjo anomali krijohet nga dita e 26-30 e shtatzanisë, nga mungesa e mbylljes së kanalit neural në nivelin lumbal të boshtit kurizor.

Me së shpesh paraqitet ne regjionin lumbosakral 80-90%. Prek palcen kurrizore, meningjet, rënjët e nervave dhe lëkurën. Në rastet më të shpeshta paraqitet lesion dorsal i strukturave të prekura në formën e qeses me mungesë të pjesërishme ose të plotë të lëkurës mbi malformacionin.

Deficitet neurologjike paraqiten varësisht nga lokalizimi dhe madhësia e lokalizimit dhe reziku nga meningjiti ashendent. Manifestimet kryesore jane parapareza flakcide ose parapareza spastike, çrregullimi i sensibilitetit, infeksione urinare të shpeshta, fëshikëza urinare neurogjene (2).

Vdekshmëria arrin deri në 50%, edhe atë shkaqet kryesore për këtë më së shpeshti janë: meningjiti, hidrocefalusi, insuficienca renale kronike (3).

Terapia konsiston në intervenimin e hershëm kirurgjik për të ruajtur motilitetin dhe senzibilitetin, por jo për të zgjatur jetën e pacientëve. Në shume raste eshte e diskutueshme intervenimi nëse janë prezente anomali të tjera (4).

Prognoza nuk është shumë e mirë. Diagnoza prenatale është e mundur nëse caktohet alfa fetoproteina në lëngun amniotik si dhe diagnostimi me ultrazë (5).

Karakteristikat klinike të Meningomyelocele

Manifestimet klinike varen nga prekja e strukturave të boshtit kurrizor. Kështu në lokalizime të epërta (cervikale) kemi prekje të lehtë të katër ekstremiteteve (quadriparesis), kurse në lokalizim më të ulët të meingomyelocelës (p.sh. në segmentet lumbale apo sakrale) do të regjistrojmë manifestim klinik, në formë të paraparezës flakcide, shumë rrallë paraparezë spastike, çrregullimi i sensibilitetit për kualitete të ndryshme, varësisht prej fijeve nervore që janë të kyçura, infeksione urinare te shpeshta, fëshikza urinare neurogjene, çregullim të sfinkterëve, etj.

RASTI JONË

Pacienti është vajzë, fëmia e parë, nga shtatzania e dytë. Shtatzania e pare ka mbaruar me abort spontan. Në periudhën e shtatzanisë është trajtuar me vitamina dhe magnezium. Nuk janë realizuar analizat virusologjike, si dhe ultrazë vetem një herë gjatë periudhës së shtatzanisë.

Lindja është realizuar para kohe, në javën e gestacionit (JG)= 30. Fëmia ka qenë me peshë 1200 gram, gjatesia trupore=45 cm, dimenzioni i kokës=27 cm, kurse i toraksit=26 cm). E lindur spontanisht, A/S=1/1, i reanimur në sallë të lindjes me dhënie të oksigjenit me presion, aspiracion, masazhë; e njejta me përgjigje të dobët në reanimim, menjëherë i vendosur ne inkubator me oksigjen të koncentruar, monitorim të saturacionit, frymëmarjes dhe pulsit të zemres. Në dy orët e para, saturacioni ka qene në vlera 96-98%, mandej me reduktim te saturacionit, nuk ka paraqitur konvulzione, si dhe shenja të tjera meningeale. Eshtë ordinuar vitamina K dhe atë 2 mg për të parandaluar hemoragji të mundëshme cerebrale. Mbas 7 orë jetë për shkak te insuficiencës respiratore dhe prematuritetit mbaroi me exitus letalis.



Fig. 1 dhe 2: Meningomyelocele

DISKUTIM DHE PERFUNDIM

Kujdesi ndaj defektit kur ekziston "qesja me nerva" në kurrizin e foshnjes së posalindur, mundësitë që ajo tëjetojë janë më të mëdha nëse operohet brenda javëve të para të jetës. Operacioni

mundëson të mbulohet defekti me muskuj dhe lëkurë. Pa këtë operacion rreziku është i madh meqë mund të shkaktohet dëmtimi dhe infektimi i trurit apo meningjiti; fëmija me siguri nuk jeton shumë gjatë (6). Pranimi dhe kujdesi i femijëve me anomali të lindura në Njësinë Gjysëmintenzive behet problem sa më aktual nga shumë aspekte, para së gjithash lufta për t'i mbajtur në jetë këta fëmijë është e rëndë, e gjate, e pa parashikueshme për shkak të manifestimeve multisistemike. Nga ana tjeter tek fëmijte që kane nje anomali majore duhet te kërkohet në të gjithë sistemet anomali të tjera të cilat mund të ndikojne në trajtimin dhe jetën e mëtutjeshme. Për definimin e këtyre anomalive nevojitet ekip i gjërë multidiciplinor të disa profileve si pediatër, neurolog, neurokirurg, gjeneticist.

Tek fëmijët të cilët nuk mund të operohen është e domosdoshme të mbrohet qesja enervave, pra të mos dëmtohet ose prishet mbështjellësi i hollë që mbulon atë. Nëse ky mbështjellës dëmtohet, atëherë shkaktohet shfaqja e meningjitit. Një mënyrë e mbrojtjes së qeses është bërja e një unaze apo rrethi prej materiali të butë.

Duhet të mos lejohet që unaza apo veshja ta prekë qesen. Referojmë një rast tjetër në vitin 2010 me meningomyelocele, i cili ë operuar brenda 24 orë pas lindjes dhe tani nuk shfaqën ndonjë simpomë neurologjike, por të cilin do ta vëzhgojmë dhe më tutje (7).

LITERATURA

1. Skarpa D. Poremecaji zatvaranja neuralne cijevi. Ne Mardesic G.Pedijatrija.Zagreb::Skolska Knjiga"d.d 2000: 1004-1009
2. Rao SB, Dinakar I. Lumbosacral meningocele in an adult – a case report. J Postgrad Med 1971; 17 (2) : 91-2.
3. WHO. International federation for hydrocephalus and spina bifida, Worldfederation of Occupational Therapist, World confederation for physical therapy .
4. Akay KM, Gonul E, Ocal E, Timurkaynak E. The initial treatment of meningocele and myelomeningocele lesions in adulthood: experiences with seven patients. Neurosurg Rev 2003; 26 (3) : 162-7.
5. Midrio, Paola Prenatal Diagnosis of Terminal Myelocystocele in the Fetal Surgery EraMay 2002).
6. Sofijanov N.Razvojni anomali na rebetniot mozok i rbetnikot..Në:Zaboluvanja na nervniot sistem vo detska vozrast.Skopje:"Makedonska kniga",1985: 80-96.
7. Prenatal Diagnosis of Terminal Myelocystocele in the Fetal Surgery Era: Case Report. Midrio, Paola M.D.; Silberstein, Howard J. M.D.; Bilaniuk, Larissa T. M.D.; Adzick, N. Scott M.D.; Sutton, Leslie N. M.D,May 2002 - Volume 50 - Issue 5 - pp 1152-1155.

SUMMARY

MENINGOMYELOCELE
-Case report-

Sani Bajrami[1], Florin Besimi [2], Zllata Trimçevska[2], Antigona Trenevska[2], Drita Tefiku[2], Meral Rexhepi[2], Afërdita Ismaili[2], Nagip Rufati[2], Arian Alili[2], Destan Haliti [2], Arben Taravari[2]

General Hospital, Tetovo, Macedonia

[1]Department of Gynecology–Obstetric-Neonatology, Tetovo, Macedonia

[2]Surgery Department, Tetova, Macedonia

[3]PHO University Clinic of Neurology, Skopje, Macedonia

Meningomyelocele is rare anomally of vertebral axis wich is appears in our Department, wich as such requires special surgical treatmet and further neurological examination after treatment. The purpose of our paper, is the presentation of a case with meningomyelocele in our department, with early diagnosis and the needs and reasons for rapid surgical intervention, which are very important in further treatment.

Key words: *Meningomyelocele, diagnosis, paraparesis*

PUNIM PROFESIONAL /PROFESIONAL PAPER
NEONATOLOGJI

TRAJTIMI I PAREZAVE TË PLEKSUSIT TË SIPËRM BRAKIAL (Erb-Duchenne) TË LINDJES

Sani Bajrami[1], Florin Besimi [1], Zllata Trimçevska[2], Antigona Trenevska[2], Afërdita Ismaili[2], Drita Tefiku[2], Meral Rexhepi[2], Nagip Rufati[2], Arian Alili[2], Bashkim Ismaili[2], Destan Haliti[2], Arben Taravari[2], Ylber Besimi[2]

[1]Spitali Klinik, Tetovë, Maqedoni
[1]Reparti Gjinekologji-Akusheri-Neonatologji, Tetovë, Maqedoni
[2]Reparti Kirurgjik, Tetovë, Maqedoni
[2]Klinika e Neurologjisë, Shkup, Maqedoni



Sani Bajrami, mjek pediatër
Spitali Klinik, Tetovë, Maqedoni
Tel: 070/321 643
e-mail: **dr.sanibajrami@hotmail.com**

REZYME. *Pareza e pleksusit brakial paraqet traumën më të shpeshte të lindjes. Në fëmijë të mëdhenj është pasojë e traumës, tërheqjes dhe rallë si pasojë e neuritit brakial. Sipas lokalizimit kemi tre lloje të parezave të pleksusit brakial: (1) pareza të pleksusit të siperm (Erb-Duchenne), (2) Pareza të pleksusit të poshtëm (Klumpke) dhe (3) Paraliza totale e pleksusit brakial. Në parezën e pleksusit të sipërm brakial lezioni prek C_5-C_6. Lesioni më i shpeshtë është i njëanshëm. Shenja kryesore klinike është qëndrimi karakteristik i ekstremitetit të sipërm, si rezultat i paralizes së m. deltoideus, m. supraspinatus, m.infraspinatus, m. biceps, m. brachioradialis. Dora e varur, e aduktuar dhe e rotulluar për nga brenda, refleksi i Morros është asimetrik (dora e paralizuar nuk merr pjesë), refleksi i bicepsit është negativ ne atë anë. Në studimin janë analizuar 4 te porsalindur, të zgjedhur me radhë sipas lindjes, që janë lindur dhe mjekuar në Repartin Gjinekologji-Akusheri –Neonatologji-Tetove, në periudhën Janar 2010 - Shurt 2011. Të porsalindurit i kemi ndarë në dy grupe sipas mënyres së trajtimit. Grupin I-rë e përbëjnë 3 fëmijë të lindur spontanisht. Rasti parë: I porsalindur maskull me nr.lindje=546,spontanisht,peshë lindje=4150 gr.Dg.Paresis pl.brachialis lat.dex. (foto 1). Rasti dytë: E porsalindur femër nr.i lindjes1875, spontanisht, peshë lindje 4020gr, Dg. Paresis pl. brachialis. lat. dex. (foto 2). Rasti tretë: I porsalindur maskull nr.lindjes 2178,spontanisht,p eshë lindje=4100gr. Dg. Paresis pl. brachialis. dex. (foto.3). Të trajtuar me terapi medikamentoze Vitamin B6 dhe Vitamina B1(8). Grupin II-të e përbën një i porsalindur spontanisht, maskull nr. linjes=228, peshë lindje=4010gr, Dg.Paresis pl.brachialis.lat.dex. (foto 4). fëmi i lindur spontanisht dhe me peshë lindje=4150gr, të trajtuar me tretman medikamentoz: Vitamin B6 ,Vitamin B1 si dhe trajtim me terapi fizikale. Pareza është diagnostikuar klinikisht si dhe në dy femijë është realizuar dhe radiografi e artikulacionit skapulohumeral. Nuk është konstatuar tek asnjëri frakturë e skapules. Tetë*

gjithë fëmijtë është realizuar fiksimi i krahut me manzhete në pozicion te flektuar 30 grade. Kemi konstatuar se pareza tek tre fëmijë është korigjuar pas tre muajsh me trajtim medikamentoz, kontrakturat janë parandaluar me masazhe të lehta të shpatullës, krahut dhe parakrahut. Ndërsa tek njëri është nevojit edhe trajtim me terapi fizikale, e cila ka rezultuar poashtu me reinervim ku ka qenë e indikuar dhe realizimi i EMG.

***Fjalë kyç**: Pareza, pesha trupore, pleksus brahialis*

Medicus 2011, Vol. XV (1):

HYRJE

Pesha e të porsalindurit si dhe lindja e parë jane faktor shume të rëndëesishëm në krijimin e parezave të pleksuseve brakiale, vecanërisht të atyre të pleksusit të sipërm. Në periudhën e dytë të lindjes ose faza e ekspulsionit të lindjes në rast të distocionit të shpatullave për shkak të tërheqjes më të fuqishme dhe shtypjes së pleksusit brakial bëhen lëndime të cilat shkaktojnë pareza të pleksusit brakial (2, 6). Shenja kryesore klinike është dora e varur, e adduktuar dhe e rotulluar për nga brenda. Refleksi i Morros është asimetrik (dora e paralizuar nuk merr pjesë)**,** ndërsa refleksi i bicepsit është negativ ne atë anë (1, 4, 5).

QËLLIMI:

Ky punim ka për qëllim të percaktojë ndikimin e peshes trupore ne paraqitjen e tipeve te pareses brakiale si dhe trajtimi adekuat i tyre.

RASTET TONA

Në Rrepartin Gjinekologji-Akusheri-Neonatologji, kemi analizuar 4 te porsalindur, të zgjedhur sipas radhes se lindjes në periudhën Janar 2010 – Shkurt 2011. Të sëmurët sipas trajtimit i kemi ndare ne dy grupe:

- Grupi I-rë përfshinë 3 të porsalindur të trajtuar në mënyre medikamentoze deri në moshe 3 mujore;
- Grupi II-të 1 i trajtuar në mënyre medikamentoze dhe me terapi fizikale i trajtuar deri në moshë 12 muajshe (9). Te të gjithë të sëmurët është bërë ekzaminimi fizik dhe tek dy të posalindur është realizuar radiografi e artikulacionit humeroskapularen. Pareza është konstatuar klinikisht dhe në bazë të radiografisë.



foto 1



foto 4





foto 2 **foto 5**



foto 3

REZULTATET:

Në grupin e parë kemi tre fëmijë ose 75% të trajtuar me terapi medikamentoze, ndërsa në grupin e dytë, kemi vetëm 1 fëmijë ose 25 % të trajtuar me terapi medikamentoze dhe tretman fizikal i cili ka dhëne rezultat të plote deri në fund të vitit të parë.

Mënyra e trajtimit	0-6 muaj	0-12 muaj	
Vit.B6+B1	3 (75%)		
Vit.B6+B1 dhe trajtim fizikal		1 (25%)	
Gjithsejt	3 (75%)	1 (25%)	4

DISKUTIMI

Parezat e pleksusit brakiale të sipërme janë një nga traumat më të shpeshta të lindjes e cila varet shumë nga mënyra e lindjes si dhe më e rëndësishmja është pesha e lindjes si dhe nga ajo se a është lindje e pare (3. 6). Parezat e pleksusit brakial të poshtem ndeshen më ralle. përqindja eshte e ulet. Prandaj duhet përkrahur qëndrimet e literatures botërore dhe trendeve të saj në trajtimin e menjëhershëm të parezave të pleksuseve brakiale qoftë të sipërme ose të poshtme (4, 8), si dhe e rendësie të vecantë është mënyra e lindjes së fëmiut vecanërisht e lindjeve të sforcuara.

PËRFUNDIMI

Diagnostikimit adekuat të parezave duhet dhëne rëndësi e veçante sepse mundet të bëhet ndonjë lëshim eventual vecanërisht tek dëmtimet totale të nervave cervikale, si dhe tek frakturat e skapules në anen e pareses (1). Trajtimi i parezave të pleksusit brakial kërkon trajtim adekuat dhe të menjëhershëm sidomos ai medikamentoz si dhe në fillim me masazh në kushte shtëpiake, qe do te thotë lëvizje passive të dorës. Nëse është e nevojshme duhet dhënë edhe ndihma nëpermjet terapise fizikale (1, 8). Rezultate që i kemi aritur në repartin tone sa u perket trajtimeve të parezave janë shumë të mira dhe korespondojne me ato të spitaleve më të zhvilluara.

LITERATURA

1. Sofijanov N. Perinatalna trauma na periferni i kapitalni nervi. Në:Zaboluvanja na nervniot sistem vo detska vozrast.Skopje:"Makedonska kniga",1985: 296-297.
2. Jean Henri Baudet. Distotia nga pesha e madhe fetale. Ne:Obstetrika Praktike.Maloine,Paris 1990:333-335.
3. Jean Henri Baudet.Vuajtja fetale gjate lindjes. Ne:Obstetrika Praktike.Maloine,Paris 1990.336-345.
4. Sydney S. Gellis MD. (Perkthyer dhe pershtatur Gjata G..Traumat e pleksusit brakial. Ne Mjekimi bashkekohor ne Pediatri.Tirane. 1987: 41-43.
5. Mardesic D. Novorodeno Ne: Mardesic D. Pedijatria Zagreb: "Shkolska knjiga"d.d., 2000:336-339.
6. Gliozheni O. Bimbashi A. Fenomenet Ametaro-fetalo te lindjes. Ne Bazat e Obstetrikes.Tirane 2006.125-129.
7. Magljaljic S. Porodjajne povrede Ne: Stepanovic R. Pedijatrija Beograd: Savremena administacija 2001.59-62.
8. Gjuric G. Vitamini Ne: Mardesic D. Pedijatria Zagreb: "Shkolska knjiga"d.d., 2000:235-236.

9. Cans C, McManus V, Crowley M, Guillem P, Platt M, Johnson A, Arnaud C. Surveillance of Cerebral Palsy in Europe Collaborative Group (2004) Cerebral palsy of post-neonatal origin: Characteristics and risk factors. *Paediatr Perinat Epidemiol*, 18(3): 214-20.

SUMMARY

TREATMENT OF PARESIS PLEXUS BRAKIALIS(Erb-Duchenne) THE BIRTHS

Sani Bajrami[1], Florin Besimi[1], Zllata Trimçevska[2], Antigona Trenevska[2], Afërdita Ismaili[2], Drita Tefiku[2], Meral Rexhepi[2], Nagip Rufati[2], Arian Alili[2], Bashkim Ismaili[2], Destan Haliti[2], Arben Taravari[2], Ylber Besimi[2]

General Hospital, Tetovo, Macedonia
[1]Department of Gynecology–Obstetric-Neonatology, Tetovo, Macedonia
[2]Surgery Department, Tetova, Macedonia
[3]PHO University Clinic of Neurology, Skopje, Macedonia

Paresis of plexus brachialis represents the most frequent birth trauma. Although the desired birth is that spontaneous paresis of plexus brachialis appears almost only in spontaneous deliveries. In children is a result of major trauma, withdrawal and rarely as a result of brachial neuritis. According to localization there are three types of paresis of the brachial plexus: 1. Paresis of upper plexus (Erb-Duchenne); 2. Paresis of lower plexus (Klumpke) and 3. Total paresis of plexus brachialis. In upper paresis of plexus brachialis are affected regions C5-C6. The most frequent lesions are just one side. The main clinical signs characteristic is the position of the upper extremity as a result of paralysis: musculus deltoideus, m.supraspinatus, m.infraspinatus, m.biceps brachi and m.brachioradialis. Pendant hand, adducted and rotated internally, reflex of Morro is asymmetric (crippled hand is not participate), the reflex of m. biceps brachi is negative in that area (1-picture 5). In the study were analized 4 newborns, chosen by the time of birth, who are born and treated in the Department of Gynecology & neonatology, Tetovo, in the period from January 2010 to February 2011. The newborns we have divided into two groups according to mode of treatment. I)- first group consists 3 children born spontaneously: 1-male newborn with nr. born 546, spontaneously borne, birth weight = 4150 gram, with Dg.Paresis plexus brachialis lat.dex. (photo 1) female newborn with nr. born 1875, spontaneously borne, birth weight=4020 g., with Dg.: Paresis plexus brachialis lat. dex. (picture 2) male newborn with nr. born 2178, spontaneously born, birth weight=4100 g, with Dg: Paresis plexus brachialis lat. dex. (picture 3); Treated with drug therapy Vitamin B6 and Vitamin B1. II) second group constitutes: 1) a male newborn spontaneously born, with nr born = 228, birth weight = 4010gr, with Dg.Paresis plexus.brachialis.lat.dex. (picture 4); 2) A child born spontaneously and with birth weight=4150g, treated with drug treatment: Vitamin B6, Vitamin B1 and physical therapy treatment. Paresis is diagnosed clinically and in two children is realized and radiography of humero-scapular artikulacionitrticulation; is not found scapulas fractures. In all children was conducted fixing of the wing cufflinks in flexion position 30 degrees. We found that the queen in three children is revised after three months of drug treatment, the contracturs are prevent with light massage of the scapular and hand region. While on one arm and is also need treatment with physical therapy, which has also resulted in reinervation where has been indicated to realizated EMG.

Key words: *Paresis, Body weight, Pleksus brahialis.*

PREZANTIM RASTI / CASE REPORT
NEUROLOGJI

NJË RAST FAMILJAR I CHARCOT-MARIE-TOOTH ME SIMPTOMATOLOGJI TË NDRYSHUESHME NË TRE MOTRA DHE NËNËN E TYRE
-Prezantim rasti-

Altin Kuqo[1], Gentian Vyshka[2], Jera Kruja[1]

[1]Shërbimi i Neurologjisë, QSU "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri
[2]Departamenti Biomjekësor e Eksperimental, Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri



Altin Kuqo, mjek
Rr. Dibrës 371, Tiranë
Tel. +355692084992
E-mail: **altini71neuro@gmail.com**

REZYME: *Neuropatitë hereditare, të njohura më parë nën akronimin HSMN (hereditary sensory-motor neuropathies) janë përshkruar mbi 120 vite më parë nga tre autorë, Charcot, Marie dhe Tooth. Ashtu si edhe shumë klasifikime të tjera mjekësore, emërtesat dhe definicionet përkatëse pësuan ndryshime të vazhdueshme, dhe aktualisht akronimi i përdorur CMT (në nder të tre autorëve) përmbledh të gjithë kuadrin sindromik. CMT1A është forma më e shpeshtë; e studiuar edhe në punimin aktual. Autorët përshkruajnë rastin e një familje me CMT1A; karakteristike për këtë rast është fakti që u diagnostikuan si klinikisht dhe elektrikisht të prekura vetëm femra (tre motra dhe nëna e tyre, e cila simptomatologjikisht nuk paraqiste kurrfarë ankese). Paraqiten foto me kuadrin tipik të atrofisë distale, deformimeve skeletike (pes cavus) dhe plagëve trofike të cilat shoqërojnë CMT; si edhe shqyrtohet literatura ndërkombëtare lidhur me neuropatitë hereditare në përgjithësi.*

Fjalë kyç: *neuropati hereditare, CMT, atrofi e lozhës peroneale, pes cavus, plagë trofike, elektroneurografi.*

Medicus 2011, Vol. XV (1):

HYRJE

Kanë kaluar pothuaj 120 vite që kur është bërë përshkrimi i parë i një sindrome neurologjike familjare, të ashtuquajturës "atrofia muskulare peroneale", prej Charcot dhe Marie në Paris, dhe Tooth në Angli (1, 2). Në raportimin që ata i bënë kësaj sindrome, e cila më pas morri edhe emrin e tyre, u përshkruan fare mirë pothuaj të gjitha karakteristikat klinike të saj: *karakterin e trashëgueshëm (familjar), deformitetet skeletike, humbjen progresive të masës muskulare distale dhe uljen e forcës;* ata po ashtu e lidhnin këtë sëmundje me çrregullimet e nervit periferik. Disa vjet më pas, Dejerine dhe Sottas përshkruan në dy fëmijë të të njëjtës familje një neuropati akoma më të rëndë, me fillim të hershëm dhe hipertrofi të nervit (3).

Dyck dhe Lambert (4, 5) si dhe Thomas e Harding (6, 7) kontribuan në mënyrë thelbësore në drejtim të klasifikimit shkencor të kompleksit klinik të atrofive "peroneale", sipas modelit të trashëgimisë përkatëse, bashkë me tiparet klinike, elektrofiziologjike dhe patologjike. Këta autorë konceptuan termat *neuropati hereditare motore* dhe *ndjesore* (**HSMN**) dhe e emërtuan HSMN tip I si formën autozomale-dominante "hipertrofike" me shpejtësi përçimi nervor tejet të ulura, në të cilën demielinizimi segmentar dhe remielinizimi ishin karakteristikat kryesore. Po këta autorë emërtuan si HSMN tip II formën autozomale-dominante me shpejtësi të përçimit nervor relativisht të ruajtura ose pak të ulura, por ku ndryshimet anatomopatologjike të nervit flisnin në favor të degjenerimit dhe rigjenerimit aksonal. HSMN tip III është sëmundja e përshkruar nga Dejerine dhe Sottas, si një neuropati demielinizuese "hipertrofike" e rëndë dhe me fillim të hershëm. HSMN tip IV është një neuropati autozomale-recezive hipertrofike e hasur në kuadrin e sëmundjes Refsum. HSMN tip V karakterizohet nga atrofia muskulare peroneale dhe paraplegjia spastike. Tipet VI dhe VII të HSMN janë sindroma e atrofisë muskulare peroneale të komplikuar përkatësisht me atrofi optike dhe me retinopati pigmentare.

Harding dhe Thomas (7) vunë re se shpejtësitë e përçimit nervor në HSMN kanë një shpërndarje bimodale, dhe si kufi arbitrar për të dalluar formën demielinizuese (HSMN tip I) nga forma aksonale (HSMN tip II) pranuan një rënie të shpejtësisë <38 m/s mbi nervin median që forma të konsiderohet demielinizuese, dhe një shpejtësi >38 m/s që ajo të quhet aksonale.

Me ardhjen e epokës së biologjisë molekulare, termi-akronim HSMN filloi gradualisht të zëvendësohej në të gjithë literaturën moderne nga akronimi CMT. Kështu, **CMT1** e formës demielinizuese korrespondon me HSMN tip I; forma aksonale e **CMT2** korrespondon me HSMN tip II; HSMN tip III u zëvendësua nga termi **DSN** (neuropatia Dejerine-Sottas) dhe jo nga termi CMT3, i cili praktikisht nuk hyri kurrë në qarkullim.

Karakteristikat klinike dhe biologjia molekulare

CMT vlerësohet të jetë çrregullimi i trashëgueshëm neurologjik më i shpeshtë, dhe prevalenca e tij vlerësohet 17–40:100.000 (8). Pavarësisht se gjenetikisht përfaqëson një çrregullim mjaft heterogjen, fenotipi klinik i CMT nga ana tjetër është pothuaj uniform. Kështu, CMT karakterizohet nga humbja e masës muskulore dhe dobësia e territoreve distale, sidomos në lozhën peroneale (**Figura 1**).



***Figura 1**: Pacientja JS, 45 vjeç. Pamundësi për të kryer fleksion dorsal të të dyja shputave të këmbëve (**foot-drop**) si pasojë e dëmtimit të nn. peronealë në të dy anësitë e poshtme.*

Kjo humbje e fuqisë dhe masës muskulore e cila spikat në lozhat peroneale shoqërohet me dëmtim të ndjeshmërisë në pothuaj të gjitha modalitetet e saj, deformitete skeletike dhe mungesë të reflekseve osteotendinoze (9).

Fenotipi klinik është i ngjashëm për sëmundjen CMT të shkaktuar nga mutacione në gjene të ndryshme që influencojnë disa funksione neuronale si p.sh., kodimin e proteinave mielinike strukturore, elementët e citoskeletit neuronal, enzimat, faktorët e transkripsionit e kështu me radhë. Disfunksioni i proteinave të lartpërmendura dhe të tjerave akoma mund të shkaktojë përpos dëmtimit parësor të mielinës, edhe degjenerim aksonal në vartësi nga gjatësia e nervit (d.m.th. me predominim distal dhe në anësitë e poshtme) (10).

CMT është gjenetikisht një sindromë heterogjene. Një prej gjeneve që pësojnë mutacion në CMT1 lokalizohet në kromozomin 17 (17p11.2; CMT1A); një tjetër gjen lokalizohet në kromozomin

1 (1q22-q23; CMT1B). Forma dominante e lidhur me kromozomin X e sindromës Charcot-Marie-Tooth (CMTX) lidhet me mutacionet në gjenin e koneksinës 32 (Cx32), i lokalizuar në Xq13, dhe që kodon një proteinë neuronale të junksioneve të tipit gap (11). Klinikisht CMTX karakterizohet ashtu si edhe format e tjera me deficit sensorimotor distal dhe me atrofi muskulare; meshkujt që shfaqin CMTX si rregull janë të dëmtuar më rëndë se femrat. Pavarësisht nga kjo konsideratë e fundit klinike, ka autorë që kanë referuar forma të CMTX që kanë prekur vetëm femrat (12).

Subtipi më i shpeshtë CMT është CMT1A, i cili shoqërohet me duplikim 17p12. Ky tip përfshin 60 deri 90% të pacientëve me CMT1 dhe rreth 40 deri 50% të pacientëve me CMT (13). CMT1A është edhe prototipi klinik i fenotipit të sindromës Charcot-Marie-Tooth. Ai karakterizohet nga një fillim i hershëm, por përgjithësisht ka një ecuri më pak agresive se CMT-ja në përgjithësi. Pavarësisht nga kjo konsideratë, ashpërsia e sëmundjes ndryshon shumë nga njëri rast në tjetrin. Hipertrofia e nervave periferike mund të evidentohet klinikisht në disa raste, sidomos në nervin e madh aurikular (pas veshit) si edhe në nervat e anësive të sipërme.

Shpejtësitë e përçimit nervor si në fibrat motore ashtu edhe ato sensore janë tipikisht mjaft të ulura; pjesa më e madhe e pacientëve kanë vlera 15-30 m/s (kufiri i poshtëm normal përkatës është rreth 40 m/s për anësitë e poshtme dhe 45 m/s për anësitë e sipërme). Ulja e shpejtësisë së përçimit nervor prek të gjitha nervat e trupit, madje edhe ato të cilët nuk shfaqin shenja disfunksioni klinik, përfshi këtu edhe nervat facialë apo statoakustikë; çka sugjeron një dëmtim të përgjithësuar të qelizave Schwann (14). Megjithatë, ulja e shpejtësive të përçimit nuk duket të korrelojë me ashpërsinë apo vjetërsinë e sëmundjes; përkundrazi ashpërsia e sëmundjes korrelon në mënyrë drejtpërpjestimore me rënien e amplitudës së potencialit të evokuar motor, si edhe me zhdukjen e plotë të potencialit të evokuar ndjesor. Ulja e shpejtësisë së përçimit nervor është e pranishme që në fazat e hershme të mielinizimit, duke u instaluar në mënyrë përfundimtare brenda vitit të tretë deri të pestë të jetës. Ky ngadalësim i shpejtësisë së përçimit nervor nuk ndryshon në mënyrë thelbësore me kalimin e kohës, pavarësisht nga ashpërsia klinike e sindromës; kësisoj ulja e shpejtësisë së përçimit nervor është tregues i sëmundjes edhe në pacientë asimptomatikë ose oligosimptomatikë. Përparimi i sëmundjes nga ana tjetër, duket se ka të bëjë me humbjen aksonale, më shumë se sa me demielinizimin në vetvete (15).

RASTI FAMILJAR I TRE MOTRAVE DHE NËNËS SË TYRE

Probandi 56 vjeçar u paraqit për vizitë në Shërbimin e Neurologjisë QSUT gjatë vitit 2008, me ankesa kryesisht ndjesore (parestezi, mpirje, rëndim dhe dhimbje shpuese në këmbët, sidomos në orët e natës) ndaj të cilave konkomitonin edhe vështirësia në ecje. Ekzaminimi klinik evidentoi një atrofi të shprehur të muskulaturës distale të anësive të poshtme (**Figura 2**).



Figura 2*: Probandi JL, 56 vjeç. Distrofi e muskulaturës distale; në aspektin posterior të kërcirit mungon konturimi i muskujve gastrocnemius në të dy anësitë e poshtme.*

Ekzaminimi klinik u pasua nga ai elektrik (elektroneurografia) si edhe marrja e anamnezës familjare; elektroneurografia sugjeroi shpejtësi përçimi tejet të ulura të cilat pajtoheshin me diagnozën klinike të neuropatisë hereditare sensitivo-motore (CMT).

Nr	Parametrat e pacienteve ne shqyrtim								
	Mosha vj	Seksi	Mosha e fillimit te semundjes	Kohezgjatja e semundjes	Elektrofiziologjia				
					MCMAP	MSNAP	MNCV	UCMAP	USNAP
1	78	F	e pa percaktuar	e papercaktuar	3.7mv	7.4μv	21.3m/s	5.2mv	3.5μv
2	56	F	40	16	2.8mv	nr	18.6m/s	3.4mv	nr
3	54	F	40	14	2.4mv	5.3μv	20.2m/s	3.6mv	2.1μv
4	45	F	38	7	3.9mv	16.4μv	29.8m/s	4.8mv	8.0μv

Tabela 1: Të dhënat anamnestike *(mosha, kohëzgjatja e sëmundjes) dhe ato* ***elektroneurografike*** *(amplitudat dhe shpejtësitë e përçimit nervor në territoret e ekzaminuara).* V.O.: nr = nuk regjistrohet; **amplitudë** minimale në normë konsiderohet 5 mV për territoret motore dhe 10 μV; **shpejtësia** e përçimit ≥ 40 m/s).

U ekzaminuan klinikisht dhe elektrikisht të gjithë familjarët e tjerë; rezultuan të prekur dy motrat e tjera dhe nëna e tyre (78 vjeç); nga ana tjetër asnjëri prej dy vëllezërve nuk pati ankesa ose kuadër elektroneurografik që të pajtohej me diagnozën e CMT.

Të dhënat anamnestike (mosha; koha e fillimit të sëmundjes; shpejtësitë e përçimit motor [mbi medianin dhe ulnarin]; amplitudat e potencialit të evokuar përkatësisht motor dhe ndjesor) paraqiten në tabelën përmbledhëse nr. 1 (shih më lart).

Pedigree e familjes në fjalë paraqitet në **Figurën 3**.




Figura 3*: Pedigree e familjes; nëna e tre motrave të sëmura i përket brezit të dytë; në brezin e tretë janë evidentuar tre motrat e sëmura me CMT. Me shigjetë tregohet probandi.*



Figura 4*: Pes cavus dhe plagë trofike pak mbi malleolus medialis të anësisë së poshtme të djathtë (JV, 54 vjeç).*

Nëna e familjes (78 vjeç) rezultoi e prekur elektrikisht, por nga ana subjektive nuk paraqiste asnjë ankesë. Përkundrazi, kuadri simptomatologjik në tre motrat e prekura elektrikisht dhe objektivisht (arefleksi osteotendinoze; atrofi e muskulaturës distale sidomos në anësitë e poshtme; pes cavus – shih **Figurën 4**).

KONKLUZION

Si vihet re nga përshkrimi i familjes J; kuadri sindromik i Charcot-Marie-Tooth është mjaft i larmishëm për sa i takon ankesave subjektive, por nga ana tjetër objektivisht aty spikatin në mënyrë konstante atrofia e muskulaturës distale dhe deformimet skeletike (pes cavus etj.). Elektroneurografikisht shpejtësitë e përçimit mjaft të ulëta (deri 20 m/s; norma ≥ 40 m/s) dhe mosregjistrimi mjaft shpesh i potencialit të evokuar ndjesor mbi suralin bilateralisht, janë disa prej të dhënave që sugjerojnë praninë e një neuropatie hereditare.

Në terren të dyshimit klinik (atrofia distale, anamneza e gjatë që kontraston me gjendjen fizike deri diku të mirë të të sëmurit) duhet bërë një hulumtim i hollësishëm dhe i kujdesshëm i të gjithë trungut familjar; pedigree mjaft shpesh zbulon raste asimptomatike në brezat paraardhës, të cilët përndryshe elektroneurografikisht do të rezultojnë me prekje pothuaj uniforme. Në këto rrethana, kombinimi i studimit klinik (ekzaminimi objektiv neurologjik); anamneza e hollësishme dhe elektroneurografia, mundësojnë detajimin e të gjitha rasteve të prekura, duke stadifikuar njëkohësisht edhe gravitetin sindromik rast-pas-rasti.

REFERENCAT

1. Charcot JM, Marie P. (1886) Sur une forme particuliére d'atrophie musculaire progressive souvent familial debutant par les pieds et les jambs et atteignant plus tard les mains. *Rev. Med. (Paris)* 6, 97–138.
2. Tooth HH. (1886) The peroneal type of progressive muscular atrophy. London H.K. Lewis & Co, Ltd.
3. Dejerine J, Sottas J. (1893) Sur la nevrite: interstitielle, hypertrophique et progressive de l'enfance. C. R. Soc. Biol. (Paris) 45, 63–96.
4. Dyck PJ, Lambert EH. (1968) Lower motor and primary sensory neuron diseases with peroneal muscular atrophy. I. Neurologic, genetic and electrophysiologic findings in hereditary polyneuropathies. *Arch. Neurol*. 18, 603–618.
5. Dyck PJ, Lambert EH. (1968) Lower motor and primary sensory neuron diseases with peroneal muscular atrophy. II. Neurologic, genetic and electrophysiologic findings in various neuronal degenerations. *Arch. Neurol*. 18, 619–625.
6. Thomas PK, Calne DB, Stewart G. (1974) Hereditary motor and sensory polyneuropathy (peroneal muscular atrophy). *Ann. Hum. Genet.* 38, 111–153.
7. Harding AE, Thomas PK. (1980) The clinical features of hereditary motor and sensory neuropathy (types I and II). *Brain* 103, 259–280.
8. Martyn CN. and Hughes RAC. (1997) Epidemiology of peripheral neuropathy. *J. Neurol. Neurosurg. Psychiatry* 62, 310–318.
9. Shy ME, Lupski JR, Chance PF, Klein CJ, Dyck PJ. (2005) Hereditary Motor and Sensory Neuropathies: an overview of clinical, genetic, electrophysiologic, and pathologic features, tek: Dyck PJ. dhe Thomas PK., eds., *Peripheral Neuropathy*, 4th ed., Elsevier Saunders, Philadelphia, pp. 1623–1658.
10. Scherer S. (1999) Axonal pathology in demyelinating diseases. *Ann. Neurol.* 45, 6, 7.
11. Gal A, Mücke J, Theile H, Wieacker PF, Ropers HH, Wienker TF. (1985) X-linked dominant Charcot-Marie-Tooth disease: suggestion of linkage with a cloned DNA sequence from the proximal Xq. *Hum Genet*; 70:38–42.
12. Wicklein EM, Orth U, Gal A. (1997) Missense mutation (R15W) of the connexin 32 gene in a family with X chromosomal Charcot-Marie-Tooth neuropathy with only female family members affected. *J Neurol Neurosurg Psychiatry* 63: 379-381.
13. Boerkoel CF, Takashima H, Garcia CA. (2002) Charcot-Marie-Tooth disease and related neuropathies: mutation distribution and genotype phenotype correlation. *Ann. Neurol.* 51, 190–201.
14. Kumagai-Eto R, Kaseda Y, Tobimatsu S, Uozumi T, Tsuji S, Nakamura S. (2004) Subclinical cranial nerve involvement in hereditary motor and sensory neuropathy: a combined conduction study with electrical and magnetic stimulation. *Clin. Neurophysiol.* 115, 1689–1696.

15. Krajewski KM, Lewis RA, Fuerst DR, et al. (2000) Neurological dysfunction and axonal degeneration in Charcot-Marie-Tooth disease type 1A. *Brain* 123, 1516–1527.

SUMMARY

A FAMILIAR CASE OF CHARCOT-MARIE-TOOTH WITH VARIABLE SYMPTOMATOLOGY AFFECTING THREE SISTERS AND THEIR MOTHER
-Case report-

Altin Kuqo[1], Gentian Vyshka[2], Jera Kruja[1]

[1]Service of Neurology, UHC "Mother Theresa", Tirana
[2]Biomedical and Experimental Department, Faculty of Medicine, Tirana

In the present paper the authors describe the family J, whose siblings and their respective mother presented the syndromic traits of a Charcot-Marie-Tooth disease. The subjective complaints were extremely variable, but distal muscular atrophy and skeletal deformities (pes cavus) were constant. At the electroneurography we detected very low velocities of nerve conduction (up to 20 m/s, normal values being greater than 40 m/s); sensory evoked potentials were predominantly absent. The electric picture suggested therefore a hereditary sensory-motor neuropathy. In such a case of clinical suspicion (a time-lengthy anamnesis contrasting the otherwise acceptable general condition of the patient) the medical staff has to carefully examine the entire familial pedigree. Through such a study asymptomatic cases in predecessors are registered as a rule; the electroneurography will confirm the clinical and anamnestic suspicion. Therefore, the combination of electrical and clinical studies are an indispensable condition to stadify the disease and to quantify its severity.
Key words: *Hereditary neuropathies; CMT; peroneal muscular atrophy; pes cavus; trophic ulcers; electroneurography*

PREZANTIM RASTI / CASE REPORT
NEONATOLOGJI

HIPERPLAZIONI I ZEMRËS SË MAJTË ME ATREZION TË AORTËS
- Prezantim rasti –

Nagip Rufati[1], Florin Besimi[1], Arian Alili[1], Zllata Trimçevska[1], Sani Bajrami[1]

Spitali Klinik, Tetovë, Maqedoni
[1]Departamenti i Gjinekologjisë dhe Obstetrikës, Tetovë, Maqedoni



Nagip Rufati, mjek gjinekolog obstetër, pedagog
Rr. J. Sandanski nr. 47, 1200 Tetovë, Maqedoni
Tel: +389 44 331 963 & +389 78 452 046
e-mail: **nagiprufati@yahoo.com**

REZYME: *Sindroma e hipolazisë të zemrës së majtë është anomali e rrallë trashëguese, tek e cila ana e majtë e zemra është e pazhvilluar. Ventrikuli i djathtë pompon gjak në arterin pulmonal, ndërsa gjaku në aortë vjen nëpërmjet duktusit arterioz. Foshnja në lindje duket normale, mirëpo problemet paraqiten kur mbyllët duktusi arterioz. Foshnja atëherë fiton cianozë, takidispne dhe ka vështërsi gjatë të ushqyerit.* ***Prezantim rasti:*** *Prezantojmë një foshnje mashkull, të posalindur spontanisht dhe në kohë, nga shtatëzania e parë, me PTL 2800 gr dhe gjatësi 50 cm si dhe AS 6/8. Për shkak të cianozës akriale të lehtë foshnja vendoset në në inkubator në përkrahje të O2. Pas 24 orë qëndrimi në inkubator foshnja fiton takidispe, aritmi dhe cianozë. Pas reanimacionit sipas protokolit prej 30 minuta, foshnja ekziton. Raporti i obdukcionit nga Instituti i Anatomisë Patologjike në Shkup ishte: hipoplazion i zemrës së majtë me atrezion të aortës.* ***Konklузion.*** *Te foshnjat e posalindur me takidispne, aritmi dhe cianozë duhet të mendojmë edhe për sindromië e hipoplazisë së zemrës së majtë tek të posalindurit, malformacion kongjenital i rrallë.*

Fjalë kyç: *Hipolazion i zemrës së majtë, atrezion i aortës, i posalindur*

Medicus 2011, Vol. XV (1):

HYRJE

Sindroma e hipolazisë të zemrës së majtë është anomali e rrallë trashëguese, tek e cila ana e majtë e zemra është e pazhvilluar.

Etiologjia. Shkaktarët janë të panjohur. Hulumtimet e fundit tregojnë se shfaqja e malformacionit varet nga faktori gjenetik. Sëmundja hyn në grupin e anomalive të zemrës që emërohen si - defekti i njërit ventrikul (single ventricle defects).

1. Aorta dhe harku aortal ashendent hipoplastik
2. Hipoplazi e ventrikuli të majtë
3. Hapja enorme e ductus arteriozus dhe
4. ASD – atrium septal defect.

Tek fëmijët me hipoplazi të zemrës së majtë, të gjitha strukturat e zemrës së majtë janë të pazhvilluara. Valvulat aortale dhe mitrale janë atretike. Ventrikuli i majtë është shumë e vogël. Pjesa fillestare e aortës gjithashtu është e vogël. Gjaku i cili kthehet prej mushkërive në atriumin e majtë kalon nëpërmjet defktit të septumit atrial në anën e djathtë të zemrës. Atriumi i djathtë bën funksion të dyfishtë: pompon gjak në mushkëri nëpërmjet arerit pulmonal, kurse nëpërmjet ductus arteriozus të hapur e shpërndanë gjakun në tërë organizmin. Kur fillon mbyllja e duktusit arterioz, që zakonisht ndodh ditët e para të jetës, zvoglohet qarkullimi i gjakut në organet vitale dhe shfaqet hipotension dhe gjendje shoku. Pasi nuk ekziston mjekim konzervativ ky sindrom është fatal në orët apo ditët e para të jetës.

Simptomatologjia.Të posalindurit me hipoplazion të zemrës së majtë mund të zhvillojnë shok të rrezikshëm për jetën kur fillon të mbyllet ductus arteriozus. Këto fëmijë si zakonisht kanë saturacion më të ulët se normal, për arsye të përzierjes së gjakut që këthehet nga mushkritë. Cianoza është shenja e parë që e alrmon gjendjen e zemrës. Shfaqet distress respiratorë sindroma, plogështia, humbje e vetëdijes, pulsi i dobët, letargjia, pamundësia e të ushqyerit dhe më në fund paraqitet gjendje shoku me insufiencë renale, hepatike dhe pason *exitus letalis.*

Diagnoza. Ekokardiograma fetale dhe skrining me ultratingull janë metodat kryesore diagnostikuese.

Mjekimi. Ky defekt trajtohet me ndërhyrje operative, në disa etapa apo me transplatim të zemrës. Derisa të realizohet intervenimi operativ ductusi arterioz mbahet i hapur me medikamente intravenoze.

Prognoza e sëmundjes është infauste.

RASTI JONË

Në Reaprtin e Obstertikës, Spitali Klinik në Tetovë, M.Z., Nr 270/2009, lind djal me PTL 2800 gr, gjatësi 50 cm, A/S 6-8, në javën e 40 gestagene. Foshnja ekziton pas 24 orëve nga shkaqe të panjohura. Nëna nuk ka anamnezë të ngarkuar familjare dhe personale. Prindërit nuk janë në lidhje gjaku. Shtatzania ka qenë e kontrolluar, janë bërë kontrolla ekokardiografike. Shtatzëna nuk ka pranuar barëra, me përjashtim të vitaminave dhe preparative te Fe. Lindja ishte spontane, pa stimulacion. Lëngu amnial "ngjyrë qumshti", placenta dhe kordoni pa veçori.

Statusi i foshnjës në lindje tregoj gjakosje petekiale në lëkruën e fytyrës dhe cianozë të lehtë akrale. Në auskultacion akcioni i zemrës ishte ritmik, tonet ishin të qartë, pa zhurma. Foshnja vendoste në inkubator i pëmbajtur me O2 nga 2 litra në minute. Foshnjës i aplikohet vitamina K. Ditën e pare të jetës të gjitha funksionet vitale ishin në normë. Ditën e dytë, në orët e hershme të mëngjesit, i posalinduri vjell pas të ushqyerit dhe kishte një cianozë periferike të lehtë, stauracioni ishte i kënaqur. Pas pak kohe frymëmarrja keqësohet, foshnja vjell pa ndërprerë, kurse cianoza gjeneralizohet. Foshnja reanimohet me aspiracion dhe me oksigjenim - me O2 me balon dhe më pas me shtypje. Gjendja edhe më tej vështirësohet dhe foshnja vendoset në reanimacion me ventilim me O2, me ambu. Foshnja 24 orë pas lindjes përfundon me exitus letalis.

Si rast i paqartë dhe i pa diagnostikuar trupi i foshnjës dërgohet për obdukcion në Institutin për Anatomi Patologjike në Shkup. Raporti i obduksionit rezultoj me: ***hipoplasio atrialis et ventriculi lateris sinistri. Atresio aortae.***

KOMENTIM DHE PËRFUNDIM

Hipoplazia e zemrës së majtë është anomali kongjenitale e rrallë. Supozohet se ky malforamcion është trashëgues. Kontrollimet ekokardiografike, analizat gjenetike dhe përcjellja e vazhdueshme e shtatzanisë, mund ta zbulojnë këtë anomali kongjenitale të zemrës. Diagnoza e

hershme intrauterine e anomalis na mundëson ndërhyrje kirurgjike të foshnjës menjëherë pas lindjes. Mbijetesa dhe prognoza, edhe pas ndërhyrjes, është e keqe dhe e pa parashikueshme.

LITERATURA

1. Antonios P. et al. From the Departments of Cardiology, Childrens's Hospital and Peditrik's, Harvard Medical School, Boston, Receividet October 8, 2003; Revision Receividet February 6, 2004, accepdet February 10, 2004.
2. Robert B. Hinton, et al. Division of Cardiology, Clinical Children"s Hospital Medical Centre, Cinncinati, Ohio. Manusscript receividet April 4, 2007.
3. Deborah L. et al. From the international center for Health Outcomes and Inovation Research, Departmen of Surgary, Neë York, NY 10032.
4. Rucy-Kang, et al. Division of Cardiology, department of Pediatrics, harbor-UCLA Medical Center, Torrance: California. Departmen of Pediatriks, UCLA Schoolof Medicine, los Angeles, California, 1987-1997.

SUMMARY

HYPERPLASIA OF LEFT HEART AND AORTIC ATRESIA

- Case report -

Nagip Rufati[1], Florin Besimi[1], Arian Alili[1], Zllata Trimcevska[1], Sani Bajrami[1]

General Hospital, Tetovo, Macedonia
[1]Department of Gynecology and Obstetric, Tetovo, Macedonia

The hypoplastic left heart syndrome, including aorta, aortic valve, left chamber and mitral valve, are underdeveloped, the blood from the lungs must pass through defected atrial septum. The right chamber pumps the blood in the pulmonary artery and the blood comes into aorta through the opening of arterial duct. The baby appeared normal at birth, but the problem appeared when the duct started to close, the baby then got cyanosis, tachydispnea and difficulties during feeding. That is fatal for the heart in the early days or months of life. ***Case story:*** *In our unit we had a newborn baby boy from the first pregnancy, regularly examined, born spontaneously and on his due date, with PTL 2800 gram and height 50 cm and AS 6/8, the status of the organs and systems was normal after the birth. The baby took only vitamin K ampoule. It was deployed in the incubator due to light acrocyanosis and because the mother was in the primary sterility for 5 years. After 23 hours the general condition worsened: tachydispnea with cardiac dysrhythmia, cyanosis. The autopsy report of the Institute of pathological anatomy in Skopje: left chamber hypoplasia with aortic atresia.* ***Conclusion:*** *When we will have another case of the baby born with similar symptoms we should always take into consideration rare cases like these, the congenital malformations among the newborn babies.*

Key words*: Hypoplasia, heart and newborn*

VËSHTRIM/REVIEW SHËNDTËSI PUBLIKE

PËRDORIMI I KRIPËS SË JODIZUAR MBRON GJENERATAT NGA PAAFTËSITË MENDORE DHE FIZIKE TË SHKAKTUARA NGA PAMJAFTUESHMËRIA JODIKE

Jolanda Hyska[1], Arben Luzati[1], Entela Bushi[1]

[1]Instituti i Shëndetit Publik "Hulo Hajdëri"
Departamenti Mjedisi dhe Shëndeti,Tiranë, Shqipëri



Jolanda Hyska, mjeke nutricioniste,
Rr. Mihal Grameno, Pallati 7/1 Ap 14, Tiranë, Shqipëri
Tel: +35542370058 & +355672052972
e-mail: **lhyska2002@yahoo.it**

PËRMBLEDHJE: Qëllimi *i këtij studimi ishte për të hetuar nëse jodi i shtuar në kripë si jodur ose jodat kalium ndikon në përpunimin dhe/ose në cilësinë (ngjyrë, shije dhe strukturë) e ushqimeve, per t'i ofruar për herë të parë në shqip, industrisë vendase prodhuese dhe përpunuese të ushqimit një material që do të mund të shërbejë sadopak në largimin e paqartësive të tyre lidhur me efektet e përdorimit të kripes së jodizuar në industrinë përpunuese ushqimore me qëllim përdorimin pa hezitim të kesaj kripe në proceset përpunuese të ushqimeve ku ata operojnë. Informacioni për këtë çështje është grumbulluar nëpërmjet rishikimit të literaturës shkencore ndërkombetare të ushqimit që prej vitit 1940.* ***Mund të arrihet në përfundimin*** *se as joduri i kaliumit, as jodati i kaliumit i shtuar në kripë nuk prodhojnë efekte negative mbi cilësinë e ushqimeve. I vetmi shqetësim i mundshëm është i lidhur me kripën e përdorur për perimet turshi për të cilat nuk ka të dhëna të mjaftueshme. Prandaj është e rekomandueshme të kryhen studime për të përcaktuar nëse ekziston një problem me përdorimin e kripës së jodizuar për perimet turshi.*

Fjalë bosht*: pamjaftueshmëria jodike, kripa e jodizuar, industria ushqimore, shëndeti publik*

Medicus 2011, Vol. XV (1):

HYRJE

UNICEF-i, OBSH-ja dhe ICCIDD-ja janë duke mbështetur në mënyrë aktive atë që është bërë i njohur si "Jodizimi Universal i Kripës" për të eliminuar mangësinë e jodit në të gjitha vendet ku çrregullimet e jodit nga pamjaftueshmëria e tij janë një problem i shëndetit publik (1).

Këto Agjensi avokojnë se "e gjithë kripa për konsum njerëzor, duke përfshirë kripën që përdoret në përgatitjen e ushqimit të përpunuar, duhet të jodizohet me jodat/jodur kalium në përputhje me standardet e pranuara dhe përcaktuara".

Megjithatë, akoma ka një numër të konsiderueshëm vendesh, kryesisht vende me të ardhura mesatare në Lindjen e Mesme dhe në Evropën Lindore që nuk përdorin kripë të jodizuar, apo ku

industria e ushqimit nuk është e gatshme që të përdorë kripë të jodizuar (1). Kjo vjen për shkak të frikës se jodi do të ndikojë në cilësinë e ushqimeve të prodhuara, veçanërisht në lidhje me ngjyrën, shijen dhe aromën.

Në veçanti, ekziston një shqetësim i madh lidhur me efektet e përdorimit të kripës së jodizuar në disa ushqime (sidomos në turshi, dhe në produkte me përmbajtje amidoni) si ngjyrosja në blu pas procesit të ruajtjen, dhe/apo ndërhyrja në shijen e këtyre ushqimeve.

Qëllimi i këtij studimit është për të hetuar nëse jodi i shtuar në kripë si jodur kalium ose jodat kalium ndikon në përpunimin dhe/ose cilësinë (ngjyrë, shije dhe strukturë) e ushqimeve, për t'i ofruar për herë të parë në shqip, industrisë vendase prodhuese dhe përpunuese të ushqimit një material që do të mund të shërbejë sadopak në largimin e paqartësive të tyre lidhur me efektet e përdorimit të kripës së jodizuar në industrinë përpunuese ushqimore me qëllim përdorimin pa hezitim të kësaj kripe në proceset përpunuese të ushqimeve ku ata operojnë.

Informacioni për këtë çështje është grumbulluar nëpërmjet rishikimit të literaturës ndërkombetare shkencore të ushqimit që prej vitit 1940, dhe me marrjen e informatave nga institute që kanë punuar në këtë fushë.

Përveç kësaj, janë marrë në konsideratë edhe eksperimente të kryer për të hetuar ndikimet e mundshme të kripës jodizuar në cilësinë e ushqimeve. Janë bërë propozime për studime të mëtejshme.

Kimia e jodit në ushqime

Reagimi i jodurit dhe jodatit në ushqime nuk është studiuar gjerësisht. Studime mbi stabilitetin e jodurit dhe jodatit të shtuar në kripë tregojnë se jodati është forma më e qëndrueshme (1). Në një mjedis të lagësht dhe acid, dhe në prani të agjentëve oksidues, joduri oksidohet në jod te lirë i cili është volatil. Në prani të agjentëve reduktues, jodati reduktohet. Kjo është arsyeja e përdorimit të jodatit të kaliumit si një përmirësues i bukës, pasi ai oksidon grupet sulphydryl të mbetjeve cysteinike të proteinave në ura disulphide.

Prania e çrregullimeve nga mungesa e jodit në botë dhe Shqipëri

Rreth 1.9 bilion njerëz është shifra e fundit e popullatës në risk për çrregullimet nga mungesa e jodit (rreth 30% e popullatës së botës) ku zonat më të prekura vlerësohen vendet e Azisë juglindore dhe Europë (4).

655 milion njerëz janë me gushë, 26 milion kanë dëmtime të trurit nga mungesa e jodit dhe 5,7 milion prej tyre janë kretin (prapambetje mendore).

Pamjaftueshmëria jodike ka qenë e ndeshur pothuajse në të gjithë Shqipërine dhe forma të ashpra të saj janë konstatuar sidomos në disa zona malore.

Kështu, në bazë të studimit të fundit mbi "Prevalencen e Pamjaftueshmërise jodike (ID) në Shqipëri", të kryer nga ISHP në bashkëpunim me UNICEF-in tek femijët e moshës 6-13 vjec, sot popullata shqiptare rezulton me një prevalencë të pamjaftueshëmëris jodike **55.6%** (6.8% ID e rëndë, 19.9% ID e mesme, 28.9% ID e lehtë). Bazuar në këto të dhëna rezulton të kemi një **prevalencë të lehtë** të pamjaftueshmërise jodike nga nje **prevalencë e rëndë** jodike në 1993 ((97%**).** Ky ndryshim lidhet kryesisht me përdorimin e kripës së jodizuar për gatim në periudhen mes dy studimeve (5).

Jodizimi universal i kripës, ndërhyrja më efektive për shëndetin publik

Nisur nga rëndësia e madhe e këtij problemi për shëndetit publik në Shqipëri në vitin 2008 u miratua Ligji "Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut" (nr. 9942, datë 26.06.2008), i cili përcakton qartë nivelet e jodit për kripën e importit apo të prodhuar në vend për konsum human, shtazor dhe përdorim në industrinë ushqimore (6).

Ky ligj ka për qëllim parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut, nëpërmjet jodizimit të përgjithshëm të kripës, të destinuar për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore.

Jodizimi i përgjithshëm i kripës për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore është i detyrueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Teknologjia për përdorimin në industrinë ushqimore të kripës së jodizuar me qëllim korrigjimin e mungesës së jodit është tërësisht e disponueshme dhe lehtësisht e realizueshme.

Përvoja e përdorimit të kripës së jodizuar në industrinë ushqimore në Europë

Kripa e jodizuar është perdorur me sukses në industrinë e përpunimit të ushqimeve prej dekadash në disa vende përfshirë këtu dhe vende të industrializuara. Studime të kryera për të përcaktuar nëse kripa e jodizuar në krahasim me kripën e pajodizuar, ndikon në përpunimin dhe cilësinë (shijen, ngjyrën, aromën) e ushqimeve (prodhime mishi, djath, konserva perimesh, bukë, patatina), kanë treguar që si kripa e fortifikuar me jodat ashtu dhe ajo e fortifikuar me jodur nuk ndikojnë në cilësinë e këtyre produkteve (2, 3). Në industrinë ushqimore kripa është e jodizuar, pothuajse të gjitha furrat e bukës dhe restorantet përdorin këtë kripë. Zvicra është një model shumë i mirë edhe në prodhimin e djathit me kripë të jodizuar (Gruyere cheese) (7, 8).

Në Bullgari: Përdorimi i kripës se jodizuar ka filluar që në 1958, së pari për zonat endemike. Në 1994 ka filluar përdorimi universal i kripës se jodizuar, për njerëzit, kafshët dhe gjithë industrinë ushqimore. Përdorimi i kripës së jodizuar shtrihet sot në të gjitha furrat e bukës, në fabrikat e përpunimit të qumështit, si dhe në ato të konservave (11).

Në Hollandë: Kripa jodizohet që prej 1969. Fillimisht jodi shtohej në kripen e tavolinës dhe të gatimit ndërsa më vone edhe në përgatitjen e bukës. Është interesant fakti i përdorimit vullnetar të kripës së jodizuar prej të gjithë prodhuesve të bukës, në këtë vend.

Në Gjermani: Edhe pse përdorimi i kripës së jodizuar në nivel familjeje është vullnetar, industria ushqimore e ka futur përdorimin e kripës së jodizuar në proceset prodhuese që në vitin 1989. Rreth 60-80% e nënprodukteve të mishit prodhohet me kripë të jodizuar.

Në Danimarkë: Kripa e jodizuar është bërë e detyrueshme në vitin 2000 për kripën e tavolinës dhe për kripën që përdoret për prodhimin e bukës. Rreth 98% e bukës është e jodizuar (10).

Në Bjellorusi: Vendimi i qeverisë për perdorimin e detyruar të kripës së jodizuar në të gjithë industrinë ushqimore, ka çuar në eleminimin e pamjaftueshmërisë jodike në të gjithë popullatën duke përfshirë edhe gratë shtatzëna.

Në Bosnjë Hercegovinë, Kroaci, Serbi, Maqedoni: Përdorimi i kripës së jodizuar është i detyruar në të gjithë zinxhirin e industrisë ushqimore.

Një pyetje që besoj se e preokupon çdo shkencëtar se si memorohen ndryshimet gjenetike që i kërkon evulucioni në qelizat trashëguese (spermatozoidet dhe qeliza ve). Duke u nisur nga fakti se të gjitha qelizat somatike e kanë të njejtin ADN dhe se e kanë aktive vetëm atë pjesë për të cilën janë të diferencuara kurse tjetrën pasive, të njejtin princip gjendetet edhe tek qelizat trashëguese e njejta ADN por 23 gjysma e kromozomeve. Mehanizmi i ndikimit të nevojave të përditshme nga bërthama në citoplazmë i cila merr sinjalet për sintezën e enzimeve, hormoneve, neurotransmiterëve dhe përmes ARN sintetizon proteina specifike intervente, me madhësi 0.2-0.5µm, të cilat i pari i zbulon dhe i përshkruan Mahowald, në vitin 1962 me mikroskop elektronik, dalohen si grimca me ngjyrë të errtë që pastaj ndikojnë direkt në bërthamë dhe AND (acidi dezoksiribonukleik), në ndryshim shifrimi tek bazat purine dhe pirinimidine. Ndryshimet e bëra rezultojnë me prodhimin e proteinave për të cilat qeliza ka nevojë për përshtatjen e funksioneve të reja që i kërkon evulucioni. Gjatë spermatogjenezës dhe ogjenezës, praqelizat trashëguese poashtu i marrin këto sinjale për ndryshime sepse ushqehen me të njejtin gjak por këto qeliza kanë funksionin vetëm memorues e jo sintetik, pra si një filter informatash dhe një kompjuter memorues. Me bashkimin e qelizave trashëguese (fekondimi) aktivizohen aftësitë dominante dhe recesive të secilit gjenom dhe fillon faza shumë e komplikuar e

diferencimit, këtë aftësi nxitjeje të bërthamës për diferencim tash e bashkuar në 46 kromosome e ka vetëm citoplazma e qelizës ve. Ndryshimet nga kërkesat e evulucionit gjenden të memoruara edhe tek qelizat somatike, që dëshmohet në procesin e klonimit ku bërthama somatike e një qelize me 46 kromozome futet në citoplazmë të qelizës ve ku i ka kushtet për nxitjen e procesin të diferencimit dhe krijimit të zigotit por tash si klon, shifra vetëm prej një individi. Aftësitë memoruese për bartjen e shifrave krijuese tek individua e re, kurse ai tek brezi tjetër nuk mund ta spjegojmë ndryshe përveç si një luftë mbrojtëse nga plakja, vdekja dhe zhdukja.

Apoptoza

Apoptoza si kuptim rrjedh nga fjala greke (apoptosis- humbje ose zhdukje me qëllim). Defininimi nënkuptohet si vdekje e programuar, në fakt vetëvrasje qelizore. Gjenetiku i njohur Australian David Lein, shpjegon shumë mirë apoptozën dhe gjenin P53 i cili e ka për detyrë të kodojë prodhimin e një protein me emër protein p53, i cili si ndërprerës e blokon proteinin izoform, me çka nis sinxhiri i blokimeve të reaksioneve vitale drejt vdekjes.

Po si aktivizohet gjeni P53 dhe si mbahet ndër kontrollë që mos aktivizohet pa nevojë?

Gjenetiku Australian jep disa shpjegime:

- Fryerja e bërthamëse rrit presionin e bërthamës me çka e aktivizon kodimin e gjenit.
- Fragmentimi i ADN-së qoftë nga rrezatimet, virusët apo përmes ndonje mekanizmi tjetër.
- Tranformimi i qelizës në malinje, këtu pos prodhimit të proteinit vetëvrasës, krijohen edhe fije të kolagjenit në membranë që shërbejnë si antigjene për t'i njohtuar fagocitët dhe TN-limfocitet, pra një thirje për vrasësit që të kryhet vetëvrasja.
- Atrofimi natyral, qelizat e riprodhimit të pa fekonduara, endometriumi i uterusit.

Gati se e sigurtë është se secili prej nesh në veti ka qeliza të posa transformuara në malinje të cilat pastaj aparati i lartë përmendur vrasës nuk i lejon që të zhvillohen më tepër dhe në afat shumë të shpejtë i zhduk, duke mos i lejuar këto qeliza me kapacitet të shprehur të reprodukimit, qe të zmadhojnë numrin e tyre, i cili mandej rritet me progresion gjeometrik.
Ironike është të konstatojmë se vetëvrasja (apoptoza) është ndonjëherë e dobishme dhe një mjet kundër devijimeve patologjike qofshin ato biologjike apo psikologjike.

Vdekja (lat. mors)

Definohet si ndarje nga jeta me çka ndërpritet ekzistimi i individues si një element në sistemin e gjërë të jetës. Në këtë temë patjetër të ndalemi dhe ta definojmë jetën e pastaj e kemi të lehtë se vdekja është ndarje nga jeta.

Disa filozof materialist vdekjen e quajnë si një moment i jetës, kurse të jetosh do të thotë proces vdekshmërie. Patjetër të konstatojm se jeta e një organizmi është një kompleks i madhë i një koalicioni dhe bashkëveprimi perfekt ndërmjet disa biliona qelizave që njihen si elementi (njësia) themelor i një organizmi që jeton.

Ekzistojnë një numër i madhë organizmash njëqelizorë, për të cilat gjithashtu themi se edhe ata jetojnë.

Organizmat shumëqelizorë në mes veti bashkpunojnë dhe krijojnë një organizëm mega kompleks me mega funksione, i cili evoluon me milijarda vite. Bashkpunimi i tyre fillon prej funksioneve më të thjeshta, siç eshtë osmoza dhe deri te krijimi i ngjenjave që krijon vetëdijen dhe intelegjencën.

Në teologji këto mega funksione të një mega kompleksi definohet si shpirt. Frojdi në psikoanalizë i quajti si: id, ego dhe superego. Në psikologjin moderne, emërohet si psikikë.
Në 1885 Koning i pari bën masazhën ekstrakorpuskulare të zemrës dhe e kthen në jetë njeriun pas një aresti kardiak. Para kësaj kohe ka qenë i panjohur kthimi pas arestit dhe se procesi i ndarjes nga jeta është një proces i caktuar kohor dhe në atë moment del shpirti i cili nuk mund të kthehet.

Logjikisht duhet të konstatojmë se sikur të mos ishte vdekja nuk do të ekzistonte lindja dhe kështu edhe procesit të evulucionit i jepet shansë që me shifrat e momoruara prej species së vjetër të lind një specie e re me përvoj të cilat i ka të memoruara në genomin e qelizave trashëguese në një specie më të përsosur. Pra një garë për përsosshmëri e cila të garanton mbijetesën e llojit të vet, me program dhe me koalicion, sigurisht që po, ndryshe zhdukje e pamëshirshme.

DISKUTIMI

Nga tre kapitujt a lartë përmendur do të diskutojmë konkretisht duke i krahasuar me disa punime botërore.

Në punimin e para disa kohësh në një artikull me titull "Stresi kronik e përshpejton plakjen qelizore" të Proceedings of the National Academy of Sciences Kaliforni, shkencëtarët bien në konstatim se te disa nëna në stres, për shkak të fimijëve të tyre të sëmurë tregojnë shkallë më të naltë të plakjes qelizore se nënat e fëmijëve të shëndoshë me më pakë stres. Leukocitet e nënave me stres janë 9-17 vjet më të vjetra se sa tek ato nëna pa stres. Pse? Bëhet krahasimi i nivelit të stresit dhe telomerave në 39 nëna me fëmijët e sëmurë kronik dhe me ato nëna me fëmijë të shëndoshë me të njejtat parametra. Telomeret janë komplekse proteinash dhe AND –së në skajet e kromosomeve, të cilat shkurtohen me çdo ndarje qelizore dhe në këtë mënyrë janë si tregues së moshës biologjike të qelizës. Secilës nënë i është dhënë një formular dhe me anamnezë i është matur niveli i stresit në një muaj të kaluar, u është marrë gjak për analizë që të caktohet gjatësia e telomereve dhe është analizuar edhe aktiviteti i telomerazës, enzim i cili e regullon strukturën e telomerave. Gjithashtu u është marrë edhe urina për të matur përbërsat lidhur me stresin oksidativ (proces i shkaktuar nga radikalet e lira jostabile që destruktive për qelizën).

Nënat me stres më të lartë u konstatua se kanë telomerë më të shkurtër, sa më i gjatë që ishte kohëzgjatja e brengës për fëmijën e sëmurë, niveli i telemerazës ishte më i ulët. Nëna me nivel më të lartë stresi kishte humbur 550 baza çifte të telomerave. Rezultati ishte i panvarur nga mosha dhe indexi i masës trupore. Mekanizmi i lidhjes së trurit me qelizat periferike spjegohet se organizmi është një sistem i lidhur dhe unik çdo qelizë është në kontakt me fije neurotike simpatiku, parasimpatiku, me hormone dhe transmitues, pra indirekt shkaktohet stresi qelizor ose i njohtur edhe si "nervoza qelizore". Ekziston fakti se aktivizimi kronik i hormoneve të stresit shkakton kushtin për stresin oksidativ që mund edhe in vitro të vërtetohet shkurtimi i telomereve.

Konkretisht, një lloj ushqimi si mund të ndikojë direkt në plakje qelizore.

Omega-3 acidet yndyrore gjithashtu mund të ndikojnë në shkurtimin e telomerave, por kësaj radhe si "kapuç mbrojtës". Pra në ngadalsimin e shkurtimit të telomerave me çka indirekt ngadalsohet procesi i harxhimit dhe plakjes qelizore. Ramin Faryaneh-Far, autori kryesor i studimeve nga universiteti i Kalifornisë e marë nga E.Huff/Natural News, analizon 608 pacijent me probleme të zemrës dhe atheroskleros të arterieve koronare. Analiza zgjatë 5 vjet dhe konstaton se pacijentët që kanë konsumuar më tëpër omega-3 acide yndyrore kanë shumë më pak nivelin e shkurtimit të telomereve po ashtu edhe më pakë aterosklerozë. Omega 3-acidet yndyrore përveç ngadalsimit të proçesit së plakjen ndikojnë edhe në rritjen e kolesterolit të dobishëm HDL, kurse e zvoglon LDL kolesterolin e dëmshëm dhe trigliceridet, që do të thotë se edhe qelizat ruhen nga plakja edhe ateroskleroza ngadalësohet, për shkak të uljes së nivelit të LDL dhe triglicerideve.

Nga një punim tjetër interesant lidhur me apoptozën dhe luftën kundër vdekjes i bazuar në "mashtrim" i marrur nga Biology News.net dhe Agroatlas.ru, gjenetiku Justin Faris, SHBA, studjon këpurdhën Pyrenophora tritici – repentis dhe Stagonospora nodorum, si një çift bashkëpunojnë dhe shkatojnë infektim të qelizës nikoqire të grurit. Ata direkt nuk janë të afta të shkaktojn nekrozën e saj. Por bashkë tajojnë toksinin–ToxA, i cili toksin është i aftë të aktivizojë gjenit nikoqir Tsn1, i cili është një ndër gjenet për kontrollimin e vdekjes së programuar qelizore (apoptozën). Dhe çka ndodh, me mashtrim qeliza normale hyn në programin e vetëvrasjes qelizore, pastaj pas autonekrozës këpurdhat ushqehen me indin e vdekur. Pra, edhe mashtrimi ndonjëher është i lejuar për mbijetesë.

PËRFUNDIM

Në fund mund të konstatojm një përfundim

- Plakja, apoptoza dhe vdekja ekzistojnë si pjesa jonë e jetës dhe si të tilla pranohen.
- Organizmi është bukur i organizuar t'i mbajë nën kontrollë sepse ai evulon me miliarda vite, din si të mbrohet dhe të mbijetojë. A i duhet ndihma e vetëdijes tonë, po sigurisht.
- Ne në mjekësi jemi bukur mirë duke hulumtuar metoda të reja kundër devijimeve jovitale duke e sofistikuar shkencën e mjekësisë me punë të palodhshme në tërë botën, por kemi

edhe ne afekte anësore si "tabletomanija", satisfaksioni në opijate dhe duhan, dukuri negative, e cila duhet të jetë sa më e vogël, sidomos tek fëmijët.

LITERATURA

1. Lein D. Discovery of P53.gene, Agency for science technology and research, Singapore 2008 Sep; 3-5.
2. Robbins SL. Osnove Patologije. Apoptoza M.F Harvard. 1994; 14-17.
3. Marusič M. Patofiziologija Starenja Medicinska naklada,M.Fakultet Zagreb. 1990; 604-612.
4. Mahowald AP, Hennen S. Ultrastone of the germ in eggs. 1971;Dev.37-53.
5. Supek Z. Starenje medicinska naklada.Medicinski Fakultet Zagreb:1990; 176-177.
6. Padovan I. Staračka psihijatrija medicinska naklada. Medicinski Fakultet Zagreb:1992; 845-846.

SUMMARY

GENESIS OF THE OLDEN, APOPTOSIS AND DEATH

Sadri Olomani[1]
HO "Shëndeti" Çegran, Macedonia

Three thema which are closely bound up with, they are old about milliard of years and they intercommunicate. In the project I hope in the level of cell and genetics to be connected and explanation. Coding their in the genetics, reason why it happening and natural how medicine can influence and change. Apoptosis like process of the cleaning and prevendive from pathological functions and the death like a fact and reality, oftentimes we choose not to talking and think about.

***Key words**: Olden, apoptosis and death*

VËSHTRIM/REVIEW SPORT

REKREACIONI SPORTIV

Enver Tahiraj[1], Fikret Shatri[1], Fadil Rexhepi[2]
[1]Departamenti i Sportit, Prishtinë, Kosovë
Kolegji Universitar "Eurosporti", Prishtinë, Kosovë
[2]Fakulteti i Kultures Fizike, Tetovë, Maqedoni



Enver Tahiraj, magjistër, menaxher për sportin rekreativ
Rr. Sarajevës 123/B, Prishtinë, Kosovë
Tel: +377 (0)44 112 013
e-mail: **envertahiraj@live.com**

REZYME: *Rekreacioni sportiv ka një rëndësi të madhe tek njeriu, i cili sot aktivitetet e tija i shtrin në lagje, qytet dhe në tërë vendin. Nga kjo del se marrja me rekreacion sportiv do ketë ndikim në shoqëri dhe në largimin e tyre nga vetit negative duke bërë kështu edhe më freskues njeriun dhe shëndetin e tij për punët e përditshme të tij. Tashme kuptohet që rekreacioni sportiv, vetëm ka hyrë në fakultete dhe duhet më tutje të hyjë dhe të shtohen edhe orët e edukimit fizik për të rinjët (në shkolla) ku nuk do kishte devijime të ndryshme që paraqiten tani apo më vonë dhe do shërbej në evitimin e tyre. Shumë mjekë dhe shkencëtarë ja rritin vlerën edhe më të madhe rekreacionit dhe kyçjes në të për një trup më të shëndoshë.*

Fjalët kyçe: *Rekreacioni sportiv, rekreacioni amator, rekreacioni aktiv-amator, këshillat bazë për aktivitetet rekreative si dhe autorët për rekreacionin sportivë*

Medicus 2011, Vol. XV (1):

HYRJE

Rekreacioni sportiv si lëndë mësimore ka nisur fillet e saja diku në vitet e gjashtëdhjeta tani sot në fakultete zhvillohet edhe si lëndë e veçantë, si e nevojshme për aplikimin e mjeteve te edukimit fizik që këto aktivitete rekreative-sportive të bëhen pjesë e njeriut pa marrë parasysh se cilin profesion e posedon. Tani me zhvillimin e hovshëm të teknologjisë sportive vjen deri te minimizimi i funksioneve të themi prodhuese të njeriut, e nga i cili zhvillim ka ngarkesa më të vogla fizike për t'ju dhënë progres funksioneve dhe udhëheqjes në procesin e punës.

Andaj, ky zhvillim i hovshëm i kushteve të punës nënkupton në zvogëlimin e ngarkesave psiko-fizike, e cila vet njeriun e sjell deri te ky zvogëlim i ngarkesave psiko-fizike në procesin e punës së bashku me aktivitetet jetësore në përgjithësi. Mënyra e jetesës dhe punës së njeriut me përparimet tjera, njerëzimit të sotëm i ka ndikuar edhe gjendja e tij bio-psiko-fizike që është edhe duke ju rrezikuar.

QËLLIMI I STUDIMIT

Qëllimi i këtij punimi është që si profesionistë të kësaj fushe, do të mundohemi që sado pak të kontribuojmë në organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve rekreative-sportive me grupmoshat e ndryshme të vendit tonë. Qëllimi primar, qëndron kryesisht në përmbledhjen e informatave programore, lidhur me strukturën dhe analizën e njohjes së punës gjatë aktiviteteve rekreative dhe mundësisht funksionimin e përhershëm të aktiviteteve të tilla.

DEFINICIONI I REKREACIONIT SPORTIV

Fjala rekreacion vjen nga fjala **rec-reo-are**, që do të thotë; përsëri të krijuarit, formimi, përsëritje, argëtim, etj.

Sot për rekreacion përdoren disa terma si: rekreacioni i sportit, rekreacioni fizik, rekreacioni trupor, rekreacioni ushtrimorë-fizik, lëvizjet rekreative, rekreacioni turistik, rekreacioni shëndetësorë, rekreacioni kineziologjik ose vetëm rekreacion.

Rekreacioni sportiv, përfshin dhe angazhon te gjithë ata që ndjenjë nevojë për lëvizjen, aktivitetin dhe ushtrimin e trupit, pa marrë parasysh trupin, moshën, gjininë, aftësitë psiko-fizike, etj.

Ky aktivitet i rekreacionit sportiv është organizim që merret te fëmijët e moshës parashkollore, shkollore, të rinjtë, mosha e mesatare, e vjetër e deri edhe ata punëtorë në organizatat punuese që merren me aktivitete sportive-rekreative, pra me rekreacion merren të gjithë ata pa dallim moshe dhe gjinie.

Në rekreacionin sportiv nuk ka seleksionim si të sportet jo-rekreative dhe as rezultatet nuk janë primare si në sportin aktiv e garues. Rekreacioni zhvillon aftësitë psiko-fizike dhe shëndetin shpirtëror në krahasim me sportin aktiv, i cili jo vetëm që zhvillon dhe perfeksionon këto, por edhe aftësitë tjera specifiko-fizike me qëllim të arritjes së rezultateve sa më të mëdha në sport. Pra, në aktivitete rekreative rezultati është sekondar dhe më e rëndësishme është mbajtja e aftësive të njëjta si dhe shndërrimi në aktivitete qetësuese-relaksuese-freskuese duke eliminuar edhe stresin.

Në mes sportit rekreativ dhe sportit aktiv ka dallime, e këto dallime mund të jenë:

- Sporti rekreativ nuk ka organizim dhe rregullta strikte, por sporti rekreativ është më shumë si aktivitet argëtues, qetësues, relaksues, freskues të organizmit dhe çka është më me rëndësi edhe si mirëmbajtës i organizmit të njeriut në tërësi, etj. dhe
- Sporti aktiv-amator ka përbërje hierarkike-organizative, prej të ulëtës deri te ajo më e larta e shkollës së garave, me rregulla të respektuara dhe të kuptuara (pranuara) nga ana e garuesve.

Gjithashtu në grupin e rekreacionit sportiv hyn edhe njëra nder aktivitete e shumta siç është "peace run" vrapimi i paqes qe tubon rreth miliona njerëz dhe me qindra qytete e kryeqytet me disa dhjetëra shtete ne gjithë boten vrapimi për paqe. Kjo do te thotë edhe rëndësia e rekreacionit (aktiviteteve) ne ndihme për humanizëm dhe njëkohësisht dhe rekreacion. Këta njerëz e dine tashme se me çka është aktiviteti trupor, dine çka janë edhe ushtrimet, dhe po ashtu dine për çka duhet merren me sport rekreativ.

AUTORËT RRETH REKREACIONIT

Pra shikuar më lartë dhe shtuar më poshtë se termin adekuat të rekreacionit fiziko-sportiv-aktiv nuk ka.

Sipas autorit të njohur të lamisë së rekreacioni, Relac M, thotë "rekreacion do të thotë aktivitetet e përgjithshme të njeriut jashtë profesionit të tij, të mbrojtura prej dëshirës, të prura për zhvillim dhe ruajtjen shpirtërore-fizike të njeriut dhe mbajtjen e vitalitetit, pushimit e freskimit".

Historia tregon se rekreacioni si nocion shoqëror ka filluar të zhvillohet në kapitalizëm, në kohën e procesit të punës kur edhe produktiviteti i punës është rritur nga punëtorët.

Rekreacioni apo rekreacioni sportiv ose sporti për te gjithë (sports for all), mbledh dhe angazhon te gjithë ata qe kane dhe ndien nevoje te merren me ushtrime, lojëra apo lëvizje trupore, pa dallim moshe dhe gjinie.

Me rekreacion janë poashtu te organizuar dhe merren punëtorët ne organizatat punuese, qytetaret ne vendet e ndryshme sportive rekreative.

Rekreacioni nuk është i organizuar si federata tjera, respektojnë rregullat e lojës, dhe këto rregulla nuk janë te forta. Për planifikimin e këtij aktiviteti sportiv duhet shikuar edhe disa faktor si: terrenet sportive qe nevojiten për lojtar dhe gara, pastaj kuadrot profesionale-sportive-rekreative ne mënyrë qe udhëheqin dhe ndihmojnë njerëzit qe dëshirojnë te merren me ketë sport dhe interesi qe njerëzit te mblidhen dhe merren më shume me sport.

Nuk duhet harruar se dallimi ne mes sportit garues dhe atij rekreativ është se nuk ka seleksionim dhe rezultatet nuk janë aq te rëndësishme si te sporti garues por me shume dëfryes. Rezultati në sportin rekreativ është sekondar dhe rezultati primar eshte ne arritjen sa me te mire te efektit te shëndetit si nga ana fizike po ashtu edhe nga ajo e kënaqjes shpirterore. Qëllimi i marrjes me rekreacioni sportiv (ushtrimet rekreative trupore) para se gjithash janë ne lëvizjen, kënaqjen, argëtimin, funksionimin sa me te mire te organizmit dhe shoqërizimin e njerëzve qe merren me ketë sport.

PËRFUNDIMI

Rekreacioni sportiv duhet të arrijë deri te ajo njohuri e gjerë e popullatës dhe ndikimi tij në marrjen me të. Le të shpresojmë se me marrjen me aktivitete rekreative-sportive, do të mundohemi që të arrijmë deri tek një afirmim, zhvillim dhe përparim të mirëfilltë në fushën e aktiviteteve rekreative-sportive.

Pra, jeta bashkëkohore sot e popullatës jo vetëm që ka shumë të mira por edhe me ato të mira materiale kanë ardhur edhe ndryshimet jetësore të tij, e ky ndryshim është mungesa e aktiviteteve rekreative-sportive. Andaj, duhet këtë ndryshim ta korrigjojmë dhe ta bëjmë më të mirën për neve dhe të tjerët që na rrethojnë.

LITERATURA

1. Andrijasevic M. Slobodno vrijeme i igre. Zagreb. 2000.
2. Clark M. Optimum sports recreation. Hum.Kinetics. New York. U.S.A. 1994.
3. Colgan N. Nansy colgan's sports nutirtion guidebook. New York. U.S.A1993.
4. Tahiraj E. Rekreacioni Sportiv. Prishtinë. 2007:5-6.
5. Salihu H. Rëndësia e ushqimit për realizimin e suksesshëm të programit gjatë aktiviteteve sportive rekreative. St.Sp.nr.5. Tiranë – Albania 2004.
6. Danjek K, Tepli Z. Vestina rekreacije. Beogad. 1978.
7. Hadzikadunic M, Demir M. Sportska rekreacija. Sarajevo. 2002.

SUMMARY

SPORTS RECREATION

Enver Tahiraj[1], Fikret Shatri[1], Fadil Rexhepi[2]

[1]Department of Sports, Prishtina, Kosovo
College Graduate "Eurosporti", Prishtina, Kosovo
[2]Staty University of Tetovo

Today, sports recreation is of the great importance to man, if activated, which will expand in the neighborhood, city and throughout the country. From this it appears that dealing with recreational sports will keep influence in society and remove them from the negative features making it even more refreshing man and his health to his chores to expect and will not be complaining to the routine. Now of course sports recreation, just entered university and must go further and increase the hours of physical education for young people in schools where there were various deviations that occur now or later and will serve to avoid them. Many doctors and scientists increase the value has even greater recreation and inclusion in a more healthy body.

Key words: *Recreation sports, recreation enthusiast, active recreation, amateur, basic tips for recreational activities for recreation and sporting authors*

VËSHTRIM/REVIEW DIETETIKË

NEVOJAT ENERGJETIKE TË ORGANIZMIT

Agron M. Rexhepi[1], Behlul Brestovci[2]

[1]Kolegji Universitar për Edukim Sportiv "Eurosporti", Fakulteti "Iliria", Prishtinë, Kosovë

[2]Fakulteti për Edukim dhe Rehabilitim Special, Universiteti i Zagrebit, Kroaci



Agron M. Rexhepi, mjek i sportit, dr sci.
Str. Sali Butka Nr. 31/D
Prishtina, Kosovo, 10020.
Tel: +377 44 110 855,
e-mail: **agronmrexhepi@gmail.com**

REZYME: *Të ushqyerit është furnizimi i qelizave të organizmit me materie ushqyese, të domosdoshme për vazhdimin e jetës. Pesha trupore e njeriut është e determinuar nga ekuilibri ndërmjet energjisë hyrëse (energjia e fituar nga materiet ushqyese) dhe energjisë dalëse (energjia e shpenzuar gjatë aktiviteteve fizike ditore dhe metabolizmit bazal). Trashësia është sëmundje kronike me përmasa epidemiologjike që kërkon tretman mjekësor dhe humbje të peshës. Ndikimi i të ushqyerit të shëndosh në rezultatet sportive është tejet i madh. Edhe pse, në përgjithësi, nevojat nutritive nga aspekti kualitativ janë të ngjashme për të gjithë sportistët, dallimet kuantitative mund të hasen te sportistët e sporteve të ndryshme. Janë dy lloje të energjisë nga ekuilibri i të cilave varet gjendja e peshës trupore: (1) Energjia hyrëse (nga oksidimi i materieve ushqyese), (2) Energjia dalëse (reaksionet hidrolitike të ATP). Kjo energji përbëhet nga: (a) Metabolizmi bazal nënkupton sasinë minimale të energjisë së nevojshme për mbajtjen e funksioneve vitale të organizmit, kur organizmi është në gjendje të pushimit të plotë; (b) Sasia e energjisë që shpenzohet gjatë aktiviteteve fizike ditore ndryshon varësisht nga intensiteti, kohëzgjatja dhe lloji i aktivitetit fizik që bëhet. Në përgjithësi kjo formë e shpenzimit të energjisë përfshinë 20-30% të energjisë së përgjithshme ditore që e shpenzon organizmi dhe (c) Efekti termik i materieve ushqyese përfshinë sasinë e energjisë që organizmi e shpenzon gjatë konsumimit, tretjes, transportit, metabolizmit dhe deponimit të materieve ushqyese, ndërkaq e arrin vlerën afërsisht 10% të energjisë ditore të shpenzuar. Nëse Eh=Ed – pesha trupore e njëjtë; Eh<Ed – humbje e peshës; Eh>Ed – shtim i peshës*

Fjalë kyç: *Të ushqyerit, energjia hyrëse, energjia dalëse, metabolizmi bazal, trashësi.*

Medicus 2011, Vol. XV (1):

"Ushqimi i përgatitur për dy, është i mjaftueshëm edhe për tre, kurse ushqimi i përgatitur për tre, mjafton për katër"

HYRJE

Nga shumë faktorë ekzogjen që veprojnë fuqishëm në organizmin e njeriut, që nga lindja e deri në vdekje, pa dyshim është ushqimi. Nutricioni apo të ushqyerit është furnizimi i qelizave të organizmit me materie (në formë të ushqimit), të domosdoshme për vazhdimin e jetës. Ndërkaq, nutricionistika është shkencë relativisht e re dhe mjaftë dinamike, e cila studion mënyrën e të ushqyerit të shëndoshë, si dhe hulumton reagimet metabolike dhe fiziologjike të organizmit në dieta të ndryshme.

Në përbërjen kimike të organizmit të njeriut hyn një numër shumë i madh i elementeve kimike të kombinuara në proporcione të ndryshme. Afërsisht 65% të organizmit (apo ¾ e peshës trupore) e përbëjnë dy elemente kimike: oksigjeni dhe hidrogjeni që, të kombinuara, japin ujin. Ndërkaq, pjesa tjetër e organizmit (afërsisht 35%) është materia e thatë e organizmit që përbëhet 30% nga materiet organike (proteinat, karbohidratet dhe yndyrnat) dhe 5% nga materiet minerale (kripërat inorganike).

Në "fabrikat energjetike" të organizmit të njeriut, përmes proceseve **oksiduese,** afro 40% e energjisë që ndodhet në ushqim transferohet në bashkëdyzimin kimik energjetik–ATP *(adenozinë trefosfati)*. Kjo molekulë, më pastaj, i nënshtrohet reaksionit **hidrolitik**, me ç'rast lirohet sasia e energjisë së lirë *(e cila përdoret për punë mekanike, si psh. rrëshqitja e fijeve muskulore aktinë në fijet miozinë)* dhe energjia në formë të nxehtësisë (1, 3, 4).

Sot zgjedhjes së problemeve nutritive, të cilat dita më ditë po rriten, nutricionistika ju kushton rëndësi të posaçme. Përderisa në disa vende të botës ka mungesë të ushqimit, në vendet tjera ka tepricë. Në të dy rastet si pasojë e disbalancës së dietës lajmërohet gjendja e malnutricionit, gjendje kjo mjaftë kërcënuese për shëndetin e popullatës së përfshirë (7). Si formë mjaftë të shpeshtë të malnutricionit vlen të përmendim gjendjen e trashësisë trupore apo të mbipeshës (obeziteti), e cila gjendje karakterizohet me akumulim të tepërt të indit dhjamor, dhe veçse është duke i marrë përmasat epidemiologjike. Që t'i shmangemi kësaj gjendjeje të padëshiruar duhet ruajtur ekuilibrin ndërmjet energjisë hyrëse – oksiduese dhe energjisë dalëse – hidrolitike (Eh=Ed). Deri te trashësia trupore vije kur ekuilibri ndërmjet këtyre dy energjive prishet në favor të energjisë hyrëse (Eh>Ed). Kjo lloj e prishjes së ekuilibrit ndërmjet energjive mund të vije si pasojë e disa faktorëve, si psh. marrja e tepërt e ushqimit, mungesa e aktiviteteve fizike, apo të ndonjë faktori patologjik. Sigurisht se nuk duhet harruar edhe faktorin gjenetik i cili vepron deri në 50%. Në rastet kur veçse kemi të bëjmë me trashësi trupore, atëherë sa më shpejtë që është e mundur duhet të rivendoset ekuilibri i prishur ndërmjet energjive. Rivendosja e këtij ekuilibri kërkon përpilimin e programeve gjegjëse nutritive, si dhe programeve stërvitore. Krejt kjo duhet bërë me qëllim të zvogëlimit të kalorive të marrura dhe rritjes së kalorive të shpenzuara (2, 4).

E një rëndësie primare është që, ende pa filluar përpilimi i planit nutritiv për një person, të caktohet nevoja ditore energjetike për atë person, respektivisht sasia e energjisë hidrolitike - e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve ditore. Në organizmin e njeriut energjia e liruar, pas reaksioneve hidrolitike, shfrytëzohet për:

I. Metabolizmin bazal, që nënkupton sasinë e energjisë së nevojshme për mbajtjen e funksioneve vitale të organizmit. Kjo vlerë është më reale në orët e mëngjesit (pas zgjimit nga gjumi), respektivisht pas një agjërimi 12 orësh (abstenim nga çdo lloj ushqimi);
II. Zhvillimin e aktiviteteve fizike, të përditshme;
III. Tretjen e ushqimit (efekti termik).
IV.

I. Metabolizmi bazal

Metabolizmi bazal nënkupton sasinë minimale të energjisë së nevojshme për mbajtjen e funksioneve vitale të organizmit, kur organizmi është në gjendje të pushimit të plotë. Kjo vlerë më së miri do të matej kur organizmi është në një gjendje të pushimit të plotë (pas zgjimit, apo pas një agjërimi 12 orësh), në ambient të rehatshëm, të qetë dhe të ngrohtë. Metabolizmi bazal mund të jetë "përgjegjës" për shpenzimin e më shumë se 70% të energjisë së përgjithshme që e shpenzon organizmi i njeriut. E tërë kjo energji shpenzohet për mbajtjen në jetë të funksioneve vitale të organizmit, siç janë: proceset respiratore, kardiovaskulare, termorregullacioni, tretja e ushqimit, eritropoeza, etj.

Metabolizmi bazal ndryshon nga individi në individ, dhe është pikënisje për kalkulimin e sasisë së përgjithshme të energjisë që organizmi ka nevojë (qoftë për mbajtjen e peshës trupore që ka, për shtimin apo për humbjen e saj). Metabolizmi bazal është i determinuar nga faktorë gjenetikë dhe nga faktorë të jashtëm:

- Faktorët gjenetikë – disa njerëz janë të lindur ta kenë metabolizmin bazal të shpejtë, e disa më të ngadalshëm;
- Gjinia – Pasi që meshkujt kanë masë muskulore më të madhe krahasuar me femrat, edhe metabolizmin bazal e kanë më të madh;
- Mosha – Pas moshës 20 vjeçare vlera e metabolizmit bazal zvogëlohet, afërsisht 2% për çdo dhjetë vjet;
- Pesha trupore – Sa më e madhe të jetë pesha trupore aq më të mëdha do të jenë kërkesat energjetike për metabolizmin bazal;
- Lartësia trupore – Personat me trup të gjatë dhe të dobët e kanë metabolizmin bazal më të rritur krahasuar me personat me peshë trupore të njëjtë, por me trup më të shkurtër;
- Përqindja e indit dhjamor – Sa më e vogël të jetë masa dhjamore e trupit aq më i madh do të jetë metabolizmi bazal dhe anasjelltas;
- Dieta – Uria e madhe e zvogëlon shumë metabolizmin bazal;
- Temperatura trupore – Çdo rritje e temperaturës së brendshme trupore për 0.5^0C e rrit metabolizmin bazal afërsisht për 7%;
- Temperaturat e ambientit të jashtëm – Si temperatura e ulët ashtu edhe temperatura e lartë e ambientit të jashtëm e rrisin metabolizmin bazal;
- Gjëndrat – Gjëndra e tiroidesë, përmes hormonit tiroksin, kontrollon nivelin e metabolizmit bazal. Sekretimi i shtuar i këtij hormoni (thyrotoxicosis) rrit metabolizmin bazal mbi vlera normale, ndërsa zvogëlimi i sekretimit të tiroksinës (myxoedema) ul metabolizmin bazal ndër vlera normale;
- Stërvitjet (aktivitetet fizike) – ndikojnë në rritjen e metabolizmit bazal gjatë dhe pas aktivitetit fizik;
- Sëmundjet e ndryshme (psh. ethet, shtimi i stres-hormoneve) rrisin metabolizmin bazal, ndërkaq uria, agjërimi apo malnutricioni ulin metabolizmin bazal.

Siç e kemi cekur më lart, konform faktorëve të lartpërmendur, në rastet kur dëshirohet humbja e peshës trupore duhet që dieta në ushqim të shoqërohet me shtimin e aktiviteteve fizike (për shkak se rritet shpenzimi i kalorive të tepërta).

Për llogaritjen e metabolizmit bazal të një personi, deri më tani, janë propozuar shumë formula, të cilat marrin parasysh faktorë të ndryshëm, si: gjinia, mosha, lartësia trupore, pesha trupore, masa muskulore pa dhjamë, si dhe niveli i aktivitetit fizik që bëhet. Meqenëse masa muskulore është faktor që, në një masë të madhe, e determinon nivelin e metabolizmit bazal, pjesëmarrja e saj në formulat llogaritëse të metabolizmit bazal do të ishte mjaft e rëndësishme. Por, për shkak të lehtësimit të punës, edhe formulat tjera që përcaktohen nga fakorë të tjerë, të përmendur më lartë (psh. pesha trupore), në praktikë, janë mjaft të përdorshme.

Nutricionistët australianë kalkulimin e metabolizmit bazal e bazojnë në peshën e përgjithshme trupore. Sipas tyre, kalkulimi i metabolizmit bazal mund të bëhet si vijon:

Për meshkuj të rritur: MB = (Pt x 10) + (2 x Pt)

Për femra të rritura: MB = (Pt x 10) + Pt

MB = metabolizmi bazal (kcal/ditë); Pt = pesha trupore në Paund (LB);

1 LB (Paund) = 0.454 kg, respektivisht 1 kg = 2.2 LB.

Shembulli 1:

Të llogaritet metabolizmi bazal për mashkullin me peshë trupore 80 kg dhe për femrën me peshë 55 kg:

MB për mashkullin:

Pt = 80kg x 2.2 = 176 LB; MB = (176 x 10) + (2 x 176) = 1760 + 352 = **2112 kcal**

MB për femrën:

Pt =55kg x 2.2 = 121 LB; MB = (121 x 10) + 121 = 1210 + 121 = **1331 kcal**

Autorët Katch dhe McArdle metabolizmin bazal e kalkulojnë duke u bazuar në masën trupore pa dhjamë. Kjo formulë është shumë më e besueshme se sa formula e bazuar në peshën e

përgjithshme trupore. Këta autorë, si për femra ashtu edhe për meshkuj, propozojnë të njëjtën formulë:

MB = 370 + (21.6 x masa trupore pa dhjamë në kg)

Shembulli 2:

Të kalkulohet MB për një person me peshë trupore 70 kg dhe me përqindje të indit dhjamor 20%. Përqindja e indit dhjamor kalkulohet nga matjet e mëparshme të indit dhjamor në pjesë të caktuara të trupit, dhe më pastaj në bazë të vlerave tabelore, apo përmes formulave të caktuara për llogaritjen e kompozicionit trupor.

Së pari, duhet të kalkulohet masa dhjamore e trupit, e më pastaj masa trupore pa dhjamë:

70 kg x 20% = 14 kg masë dhjamore;

70 kg – 14 kg = 56 kg masë trupore pa dhjamë;

Pasi që kemi kalkuluar masën trupore pa dhjamë, përmes formulës së propozuar të autorëve Katch dhe McArdle, kalkulojmë metabolizmin bazal:

MB = 370 + (21.6 x 56) = 370 + 1209.6 = **1579.6 kcal**

Siç u tha më lartë, në metabolizmin bazal ndikojnë faktorë të shumtë (mosha, gjinia, lartësia trupore, pesha trupore, masa trupore pa dhjamë), andaj nutricionistët britanikë propozojnë formula tjera për kalkulimin e metabolizmit bazal, ku marrin parasysh gjininë, moshën, lartësinë trupore dhe peshën trupore:

Për meshkuj: MB = 66 + (13.7 x Pt) + (5 x Lt) – (6.8 x Mosha);

Për femra: MB = 655 + (9.6 x Pt) + (1.8 x Lt) – (4.7 x Mosha);

- MB = metabolizmi bazal (kcal/ditë);
- Pt = pesha trupore në kg;
- Lt = lartësia trupore në cm;
- Mosha në vite.

E metë e kësaj formule është mosmarrja parasysh e faktorit që përcakton masën trupore pa dhjamë.

Shembulli 3:

Të kalkulohet metabolizmi bazal për një person mashkull të moshës 46 vjeçare, me peshë trupore Pt = 85 kg, dhe me lartësi trupore Lt = 183 cm:

MB = 66 + (13.7 x 85) + (5 x 183) – (6.8 x 46) = 2145.5 – 312.8 = **1832.7 kcal**

Shembulli 4:

Të kalkulohet metabolizmi bazal për personin femër të moshës 30 vjeçare, me peshë trupore Pt = 60 kg, dhe lartësi trupore Lt = 163 cm:

MB = 655 + (9.6 x 60) + (1.8 x 163) – (4.7 x 30) = 1524.4 – 141 = **1383.4 kcal**

Vlerat e fituara të MB-së, të kalkuluara me formula të ndryshme kalkuluese për personin e njëjtë, edhe pse të përafërta, janë të ndryshme. Një dallim i tillë mund të arsyetohet me mospërfshirjen e faktorëve të njëjtë në kalkulim (mosha, pesha trupore, lartësia trupore, gjinia dhe masa trupore pa dhjamë, respektivisht kompozicioni i trupit). Andaj, për të minimizuar gabimin në vlerësimin e MB-së preferohet që në kalkulim të merren parasysh sa më shumë faktorë që është e mundur.

II. Energjia e shpenzuar gjatë aktiviteteve fizike

Rruga e dytë e shpenzimit të energjisë hyrëse, e që ka rëndësi në caktimin e raportit ndërmjet energjisë hyrëse dhe energjisë dalëse (me rastin e përpilimit të programit nutritiv), është aktiviteti ynë fizik brenda ditës. Aktivitetet fizike ndikojnë 20–30% në shpenzimin e energjisë së përgjithshme trupore.

Çdo punë apo aktivitet fizik rrit shpenzimin e energjisë në organizëm (1, 2, 4). Ndërkaq, sasia e energjisë, që do të shpenzohet gjatë aktivitetit fizik, varet nga intensiteti dhe kohëzgjatja e aktivitetit, respektivisht e punës fizike (1, 3, 4, 5).

Tabela 2. Shpenzimi i energjisë (kcal) gjatë 30 minutave te aktivitetet e caktuara fizike

Lloji i sportit	Shpenzimi i Energjisë
Skijimi	600 kcal
Basketbolli	600 kcal
Vrapimi (8.5 km/h)	570 kcal

Kërcimi	550 kcal
Noti	500 kcal
Alpinizmi	500 kcal
Gjimnastika	450 kcal
Çiklizmi	410 kcal
Ecje e shpejtë (6 km/h)	300 kcal
Ecje e lehtë (4.2 km/h)	200 kcal

Tabela 3. Paraqitja tabelore e shpenzimit të energjisë gjatë disa aktiviteteve fizike

Lloji i punës fizike	**Shpenzimi i energjisë kilokalori/minutë**
Larja e enëve	1.4 kcal/min
Larja e rrobave	1.8 kcal/min
Pastrimi i dyshemesë	3.5 kcal/min
Punët administrative	1.2-1.9 kcal/min
Gjumi-pushimi në shtrat	0.7-1.2 kcal/min
Ulur-dëgjim muzike	1.2 kcal/min
Vallëzimi	5.2-7.5 kcal/min
Noti	9.7 kcal/min
Skijimi	14.5-17.9 kcal/min

Sa më shumë që një person të jetë fizikisht aktiv aq më të mëdha do të jenë nevojat e tij energjetike, si dhe sa më e madhe të jetë masa muskulore aq më e madhe do të jetë energjia dalëse.

III. Tretja e ushqimit (efekti termik)

Forma e tretë e energjisë dalëse, respektivisht e shpenzimit të energjisë, është sasia e energjisë, e nevojshme për tretjen e ushqimit (efekti termik i ushqimit). Sasia e kësaj energjie mendohet se është e barabartë me 10% të energjisë hyrëse, respektivisht 10% të sasisë së energjisë që merret përmes ushqimit (4, 6). P.sh., nëse një person konsumon ushqim në sasi 2500 kcal, energjia e nevojshme për tretjen e kësaj sasie të ushqimit do të jetë 250 kcal (efekti termik = 250 kcal).

Nevojat Ditore Energjetike (NDE)

Metodë e kalkulimit të nevojave ditore energjetike të një entiteti është kur së pari kalkulohet metabolizmi bazal i tij duke pasur parasysh shumë faktorë që kanë ndikim në te (lartësia trupore, pesha trupore, mosha dhe gjinia). Më pastaj, kjo vlerë e metabolizmit bazal shumëzohet me koeficientin e nivelit të aktivitetit fizik që bën entiteti dhe fitohet vlera e Nevojave Ditore Energjetike. Kjo mënyrë e vlerësimit të NDE-së bëhet duke u shërbyer me Ekuacionin e Harris-Benedictit.

Pra, llogaritja e NDE-së, sipas ekuacionit të Harris-Benedictit, bazohet në prodhimin ndërmjet metabolizmit bazal (MB) dhe koeficientit të aktivitetit fizk që bën një entitet (kAF). Faktori i vetëm që është lënë anash këtij ekuacioni është masa pa dhjamë e trupit, e cila masë kërkon më tepër kalori krahasuar me masën dhjamore. Për këtë shkak, ky ekuacion mund të përdoret te të gjitha entitetet përjashtuar ato me masë të madhe muskulore (do të ndërvlerësohen kaloritë e nevojshme), dhe te entitetet me masë të tepërt dhjamore (do të mbivlerësohet sasia e kalorive të nevojshme) (6).

NDE = MB x kAF

MB për meshkuj = 66 + (13.7 x Pt) + (5 x Lt) – (6.8 x Mosha);

MB për femra = 655 + (9.6 x Pt) + (1.8 x Lt) – (4.7 x Mosha);

Sipas Harris-Benedictit, vlera e koeficientit të aktivitetit fizik (kAF) ndryshon varësisht nga niveli i aktivitetit fizik që bën entiteti:

- **Të ndenjurit ulur (aktivitete fizike shumë të pakta, apo mungojnë fare–puna në tavolinë) = 1.2;**
- **Aktivitete fizike të lehta (stërvitje apo sport i lehtë 1 - 3 ditë në javë) = 1.375;**
- **Aktivitete fizike mesatare (stërvitje apo sport mesatar 3 – 5 ditë në javë) = 1.55;**
- **Aktivitete fizike intensive (stërvitje apo sport i rëndë 6 – 7 herë në javë) = 1.725;**

- **Aktivitete fizike tejet intensive (punë fizike, stërvitje apo sport tejet i rëndë që bëhet 2 herë në ditë, apo maratona) = 1.9.**

Shembulli 5:

Të llogaritet NDE-ja për mashkullin N.N. të moshës 20 vjeçare, me lartësi trupore 170 cm, peshë trupore 65 kg, dhe që bën aktivitet fizik mesatar.

Së pari, duhet të kalkulojmë vlerën e metabolizmit bazal (MB):

MB për meshkuj = 66 + (13.7 x Pt) + (5 x Lt) – (6.8 x Mosha)

MB = 66 + (13.7 x 65) + (5 x 170) – (6.8 x 20) = 66+ 890.5 + 850 – 136 = **1670.5 kcal**

Në bazë të ekuacionit të Harris-Benedictit, koeficienti për aktivitete fizike (kAF) të nivelit mesatar është **1.55**.

Tani, pasi që e kemi kalkuluar vlerën e MB-së dhe e dimë vlerën e kAF, do ta kalkulojmë nevojën ditore energjetike të entitetit në fjalë:

NDE = MB x kAF = 1670.5 x 1.55 = 2589.3 kcal

Si përfundim mund të nxjerrim se për entitetin e gjinisë mashkullore, të moshës 20 vjeçare, me lartësi trupore 170 cm, peshë trupore 65 kg, dhe që bën aktivitet fizik të nivelit mesatar, nevojat ditore energjetike janë 2589.3 kcal. Me fjalë të tjera, energjia hyrëse ditore, që merret përmes gjërave ushqimore për të ruajtur kompozicionin momental trupor të entitetit, duhet të jetë 2589.3 kcal.

Humbja e peshës. Në rast se dëshirohet të arrihet humbje e peshës trupore atëherë duhet që NDE-të të zvogëlohen për 500 – 1000 kcal (varësisht nga pesha momentale që ka). Ky deficit i kalorive ditore do të favorizonte djegien e yndyrnave të deponuara, ndërsa arrihet përmes dietës në ushqim, aktiviteteve fizike, apo kombinimit të të dyjave. Preferohet që për fillim të fillohet me zbritje të NDE-së për 15-20%. Nëse brenda një jave sasia e përgjithshme energjetike zvogëlohet për 3500 kcal do të kemi humbje të peshës trupore për 450-500 gramë për një javë. Nëse deficiti i sasisë së përgjithshme energjetike, për një javë, arrin në 7000 kcal atëherë do të humbet afërsisht 1 kg peshë trupore. Sipas ACSM-së (American College of Sports Medicine) kurrë nuk duhet që NDE-të për femra të zvogëlohen ndër 1200 kcal, respektivisht për meshkuj ndër 1800 kcal (5).

Shembulli 6 – humbja e peshës:

Personi N.N. me peshë trupore 65 kg dhe me Nevoja Ditore Energjetike NDE=2589.3 kcal;
Deficiti kalorik = 20% të NDE = 2589.3kcal x 20% = 517.86 kcal;

Për të zvogëluar peshën trupore, personi N.N. me NDE=2589.3 kcal duhet të zvogëlojë NDE në 2071.44kcal (NDE – 20% = 2589.3kcal – 517.86kcal = 2071.44 kcal).

Pra, sasia maksimale e kalorive ditore, që duhet të merren, është 2071.44 kcal/ditë.

Shtimi i peshës. Për të rritur peshën trupore duhet të veprohet ngjashëm si në rastin e zvogëlimit të peshës trupore, por në drejtim të kundërt - me fjalë të tjera duhet të prishet ekuilibri i energjisë hyrëse dhe i energjisë dalëse në kuptimin pozitiv. Sasisë së përgjithshme të NDE-ve duhet t'u shtohen afërsisht 300 – 500 kcal, apo NDE-të të rriten për 15 – 20%.

Shembulli 7 – shtim i peshës trupore:

Personi N.N. me peshë trupore 65 kg dhe me NDE = 2589.3 kcal;
Suficiti kalorik = 20% të NDE = 2589.3 x 20% = 517.86 kcal;

Për të shtuar peshën, personi N.N. me NDE = 2589.3 kcal duhet të shtojë NDE në 3107.16 kcal (2589.3 kcal + 517.86 kcal = 3107.16 kcal).

Në përgjithësi, nuk këshillohet që të bëhen ndryshime drastike, të përnjëhershme, në dietë. Psh. nëse për një kohë të gjatë një person ka pasur NDE të vogla, nuk duhet të praktikohet marrja e përnjëhershme dhe e lartë e kalorive ditore. Kjo ka rëndësi pasi që një person me NDE të ulta e ka nivelin e ulët të metabolizmit, dhe nëse përnjëherë zbatohet rritja e kalorive hyrëse atëherë e tërë pesha e shtuar do të shkojë në favor të rritjes së indit dhjamor. Në këto raste, preferohet që për disa javë rritja e kalorive ditore, të marra, të bëhet në mënyrë graduale – krejt kjo me qëllim të adaptimit të metabolizmit. Mënyra më e mirë për të shtuar peshën trupore është që kaloritë e tepërta të merren përmes karbohidrateve komplekse, perimeve të gjelbra dhe pemëve, si dhe të bëhen aktivitete të rregullta fizike dhe stërvitje të forcës (me qëllim të mos- lejimit që pesha e shtuar trupore të shkojë në favor të shtimit të masës dhjamore). Më së miri është që shtimi i peshës trupore të bëhet gradualisht, duke shtuar masën muskulore, e jo masën dhjamore, madje jo më shumë se 250-300 gramë në javë. Preferohet që ushqimi, brenda ditës, të merret në sasi të vogla dhe në racione të shpeshta, të mos pihen kafeja dhe alkooli, të mos hahen ushqimi i përpunuar, sheqeri i bardhë, mishi i kuq dhe yndyrat shtazore, si dhe të mos pihet duhani dhe të shmangen vendet e mbyllura ku pihet duhani.

REFERENCA

1. Burke L. Deakin V. Clinical sports nutrition, 2000.
2. Clark N. Sportska Prehrana. Zagreb, 2000.
3. Rexhepi A. Mjekësia Sportive. Prishtinë, 2009.
4. Rexhepi A. Nutricioni dhe Sportistët, Prishtinë, 2010
5. http://sportsmedicine.about.com/od/fitnessevalandassessment/a/Body_Fat_Comp.htm
6. http://www.onlinestudy.oxfordcollege.ac/coursehome.aspx?cid=67
7. http://en.wikipedia.org/wiki/Malnutrition
8. http://www.who.int/topics/obesity/en/

SUMMARY

THE BODY'S ENERGY NEEDS

Agron M. Rexhepi[1], Behlul Brestovci[2]

[1]University College for Sport Education "Eurosporti" Faculty "Iliria", Prishtina, Kosova

[2]Faculty of Special Education and Rehabilitation, University of Zagreb, Croatia

Nutrition is an essential process for living organisms that provides cells with materials in the form of food that are necessary to support life. Our weight is determined by a balance between our energy intake (amount of energy that we take in as food) and expended energy (the amount of energy we expend during daily activities and BMR). Obesity is a chronic disease that affects many people and often requires medical treatment to promote and sustain weight loss. Nutrition and physical training are connected; so long term athletic success depends on meeting day-to-day nutritional needs. Although sport nutrition basics are similar for all athletes, important differences exist for individual athletes in various sports. There are two types of energy and their balance is responsible for someone to lose, gain or stay the same weight: (1) Energy Intake or energy from oxidation of food ***(Eo)****; (2) Expended energy or energy from hydrolytic reaction of ATP* ***(Eh)****. This kind of energy consists of: (a) Basal metabolic rate (BMR) is the amount of energy that we expend to maintain our bodily functions while resting in neutrally temperate environment and after about twelve hours fasting. BMR is determinates by the endogen and external factors; (b) The amount of energy expended during daily physical activities will vary depending on intensity, duration and type of exercise that we do. In general, because more physically active people have higher energy needs, the daily physical activities contribute with 20-30% in body's total energy expenditure and (c) The thermic effect of food (TEF) is the expression that we use to describe the energy that our body expends in order to consume, digest, transport, metabolise and store nutrients. TEF accounts for approximately 10% of daily consumed Calories.*

If: ***Eo=Eh*** *– same weight;* ***Eo>Eh*** *– gain weight;* ***Eo<Eh*** *– lose weight.*

Key words*: Nutrition, energy intake, expended energy, basal metabolic rate, obesity*

VËSHTRIM/REVIEW REUMATOLOGJI

ANTI-INFLAMATORËT JOSTEROIDË

Remzi Izairi[1]
[1]USHT, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Tetovë, Maqedoni



Remzi Izairi, mjek internist reumatolog
1237 Çegran, Maqedoni
Tel. +389 (0)42 321 600 & 070 379 007
e-mail: **shmshm@live.com**

REZYME: *Antiinflamatorët josteroidë janë barna të cilët përdoren për qetësimin e dhimbjes dhe të inflamacionit, në radh të parë te sëmundjet reumatike. Antireumatikët josteroidë e qetësojnë dhimbjen dhe inflamacionin duke e inhibuar sintezën e enzimës ciklooksigjenaza 1 (COX-1) dhe ciklooksigjenaza 2 (COX-2). Efektet anësore më të rrezikshme të anti-inflamatorëve josteroidë shfaqen në sistemin digjestiv, zemër dhe tru. Antireumatikët i shkruan mjeku në recetë, por blehen në barnatore edhe pa reçetë.*
Fjalë kyç: *Antiinflamatorët josteroidë, parimet themeolre, komplikimet*

Medicus 2011, Vol. XV (1):

TË PËRGJITHSHME

Antiinflamatorët josteroidë (AIJS), ose siç quhen në popull antireumatikët ose antireumatizmalët, janë barna të cilët përdoren për qetësimin e dhimbjes dhe të inflamacionit te sëmundje të ndryshme.

AIJS, antireumatikët, më shpesh përdoren kundër dhimbjeve dhe inflamacionit te sëmundjet e nyjave dhe të shtyllës kurrizore, të tetivave dhe muskujve; pastaj te dhimbjet pas lëndimeve, si dhe te dhimbjet me etiologji tjetër, siç janë: dhimbje koke, dhimbje dhëmbi, inflamacioni i nervave, te dismenorea, kolikat abdominale, kolikat renale dhe shumë algji të tjera.

AIJS përdoren vetëm nëse i këshillon mjeku, në dozë më të vogël dhe në kohë sa më të shkurtë, respektivisht duke respektuar udhëzimet e përdorimit të tyre.

Antireumatizmalët josteroidë që përdoren më shpesh janë: Diklofenaku, Ibuprofeni, Ketoprofeni, Piroksikami, Nimesulidi, Meloksikami, Celekoksib, etj.

Antireumatikët josteroidë e qetësojnë dhimbjen dhe inflamacionin duke e suprimuar aktivitetin e enzimës ciklooksigjenaza 1 (COX-1) dhe ciklooksigjenaza 2 (COX-2). Me ndihmën e këtyre enzimave prodhohen prostaglandinët, të cilët e nisin dhe e mbajnë inflamacionin dhe dhimbjen. Me ndihmën e COX-1 dhe COX-2 sitetizohen edhe prostaglandinët për funksionimin fiziologjik të lukthit, qarkullimit të gjakut në veshka dhe funksionimin e trombociteve. Pra, AIJS me suprimimin e sintezës së prostaglandinave, jo vetëm që e qetësojnë dhimbjen, por mund t'i çrregullojnë edhe disa funksione fiziologjike të organizmit.

Efektet anësore të AIJS mund të klasifikohen si: efekte anësore të rënda dhe efekte anësore të lehta. Në efekte të pa dëshiruara të rënda hyn: gjakderdhja gastrointestinale dhe ulcerat në lukth dhe zorrë, infarkti i miokardit, apopleksia cerebrale, hipertensioni arterial, pamjaftueshmëria e zemrës, insuficienca renale, anemia, alergjia, reaksionet lëkurore, insuficienca hepatite dhe krizat astmatike.

Në efekte anësore të lehta hyn: dhembje barku, obstipacioni, diarrea, meteorizmi, hiperaciditeti, neveria, vjellja dhe marramendja.

Prej efekteve të pa dëshiruara më shpesh shfaqen ato në sistemin gastrointestinal. AIJS mund ta dëmtojnë lukthin dhe zorrët, mund të provokojnë ulcerë në gastroduodenum dhe në zorrë, si dhe gjakderdhje nga trakti digjestiv qoftë në fillim të përdorimit ose më vonë. Ulceracionet dhe gjakderdhja mund të vdekjen e të sëmurit.

Faktorët e rrezikut për shfaqjen e ulcerës dhe gjakderdhjes nga tubi digjestiv janë: marrja e AIJS bashk me kortikosteroidet ose antikoagulantët; marrja e dy ose më tepër antireumatikëve; marrja në kohë të gjatë e AIJS; te konsumimi i alkoolit; te duhanpirësit; në pleqëri dhe te personat e sëmurë. AIJS të gjeneratës së re, të ashtuquajtur antireumatikët COX-2 selektiv (celekoksib, meloksikam, nimesulid) janë më pak të rrezikshëm për lukthin dhe zorrët se sa antireumatikët josteroid joselektiv.

Rreziku për infarktin e miokardit dhe apopleksinë cerebrale është më i madh te përdorimi i gjatë i antireumatikëve, te personat me sëmundje të zemrës, me pamjaftueshmëri të zemrës të shkallës NYHA II-IV. Ekzistojnë fakte se AIJS, të ashtuquajtur inhibitorët selektiv të lartë të COX-2 ose koksibët, në veçanti rofekoksibët, janë më të rrezikshëm për zemrën dhe enët e gjakut se sa inhibitorët COX-2 selektiv dhe antireumatikët joselektiv.

AIJS me kujdes të veçantë duhet të përdoren gjatë shtatzënisë, posaçërisht në fund të graviditetit dhe gjatë gjidhënies, kurse janë të kundërindikuar te astma bronkiale, urtikaria ose alergjia ndaj tyre, te dhimbjet para dhe pas by-pass-it aortokoronar dhe të kombinuar me antikoagulantë dhe kortikosteroide.

Manifestimet klinike që mund të paraqiten gjatë marrjes së AIJS janë: gjak në feçe ose feçe të zeza si kafea ose katrani, hematemeza, dispnea, stenokardia, hemipareza, pengesa në të folurit dhe ënjte e fytyrës ose qafës.

AIJS duhet të ndërpriten nëse pacienti ka neveri, plogështi, kruarje, subikterus, dhimbje barku, alergji dhe edema të duarve dhe këmbëve.

AIJS si rregull i shkruan mjeku në recetë. Disa AIJS mund të blehen në barnatore pa recetë. Mjerisht, disa antireumatikë edhe jashtë institucioneve shëndetësore, herë herë, edhe në treg të lirë. Disa AIJS mund të merren me recetë me një participim të vogël, kurse disa janë të shtrejtë. Rekomandimi i antireumatikëve josteroid nuk duhet të bazohet në çmimin e tyre, por në indikacionin aktual.

LITERATURA

1. Furst DE, Kolba KS, Fleischmann R. et al. Dose response and safety of meloxicam up to 22.5 mg daily in rheumatoid arthritis: a 12 week multicenter, double blind, doses response study versus placebo and diclofenac. J Rheumatol. 2002;29:436-46.
2. Damjanov N, Krstic M. Vrline i mane NSAIL. Prv Makedonski revmatoloski kongres. Ohrid 2009:42-43.
3. Pilipovic N. Reumatologia. Zavod za udzbenike i nastavna sredstva. Beograd 2000:219-227.
4. Tafaj A. Reumatologjia. "Alepaper" Tiranë 2004: 41-7
5. Popovic M, Stefanovic D, Mitrovic D. dhe bp. Reumaticne i srodne bolesti. Beograd 2000: 50-61.
6. Simon L, Blotman F, Claustre J, Herisson Ch. Reumatologjia. SHBLU, Tiranë 2000: 256-329.
7. Izairi R. dhe bp. Doracak për diagnozën dhe mjekimin e sëmundjeve reumatike. Prishtinë, 1986: 168-171.
8. Izairi R. Antiinflamatorët josteroidë, Movalis® në mjekimin e artritit reumatoid. Medicus 2010, Vol. XIII (1): 12-5

SUMMARY

NON-STEROID ANTIINFLAMATORY DRUGS

Remzi Izairi[1]

[1]SUT, Faculty of Medical Sciences, Tetovo

RESUME: *Non-steroid antiinflamatory drugs are medicines used to ménage the pain, first of all in rheumatic diseases. Non-steroid antirheumatics manage the pain and inflammation causing an inhibition of synthesis of ciclooxygenase 1 (COX-1) and ciclooxigenase 2 (COX-2) enzyme. The most dangeroust side effects of non-steroid antiinflamatory drugs appear in digestive system, heart and brain. The doctor prescribes the antirheumatics, but they can be bought at pharmacy without recipe, too.*

Key words: *Non-steroid antiinflamatory drugs, basic princips, complication*

VËSHTRIM/REVIEW GJINEKOLOGJI

DIMENSIONET E SEKSUALITETIT
-Medicina e bazuar në fakte-

Hasmije Izairi–Aliu[1]
[1]Spitali Gjinekologjik–Akusherik, Çair, Shkup, Maqedoni



Hasmije Izairi–Aliu, mjek gjinekolog–akusher
Spitali Gjinekologjik–Akusherik, Çair, Shkup
Tel.+389(0)22 627-657 & +389(0)70 829 666
e-mail: **preventiva21@yahoo.com**

***REZYME**: Seksualtiteti përfshinë të gjitha aspektet e të qenët mashkull ose femër. Fillon nga moment i lindjes, zhvillohet gjatë gjithë jetës dhe ka të bëj vetëm me riprodhimin. Seksualiteti i individit ndikohet prej pikëpamjeve, vlerave, besimeve dhe kulturës. Seksualiteti ka dimension fizik, psikosocial, etik dhe kulturor.*

***Fjalë kyç:** seksualiteti, dimensionet*

Medicus 2011, Vol. XV (1):

HYRJE

Seksualiteti është pjesë përbërëse e të qenët njeri. Ai fillon nga lindja dhe zhvillohet gjatë gjithë jetës së individit. Seksualiteti në vetvete përmban edhe potencialin e mirëfilltë të krijimit të jetës së re. Ai mund të krijoj intimitet dhe mund t'u sjellë kënaqësi partnerëve. Seksualiteti përfshin atë që njerëzit e besojnë se pritet nga ata, si burrë ose si grua, si dhe mënyrën e kujdesit për shëndetin e tyre seksual.

Seksualiteti mund të ketë edhe aspekte negative, siç janë shtatzënia e padëshiruar dhe sëmundjet ngjitëse seksuale, ku bën pjesë edhe AIDS. Për disa, seksualiteti shoqërohet me ndrotje, faj dhe parehati. Seksualiteti njerëzor, shpesh rrethohet me një sere mitesh, ankthesh, shtrembërimesh, paragjykimesh dhe porosish të paqarta.

Për të qenë seksualisht të përgjegjshëm, njerëzit duhet:

- ta kuptojnë seksualitetin dhe të jenë të vetëdijshëm për zhvillimin e tyre seksual;
- ta respektojnë vetveten dhe partnerin e tyre;
- t'i evitojnë dëmtimet fizike dhe emocionale të vetvetes dhe të partnerit;
- të sigurohen se shtatzënia do të ndodhë vetëm atëherë kur të jetë e dëshiruar dhe

- ta kuptojnë dhe tolerojnë shumëllojshmërinë e vlerave seksuale të çdo bashkësie.

Dimensionet e seksualitetit

Çdo studim i seksualitetit bazohet në të kuptuarit e tij biologjik. Mirëpo, seksualiteti përfshin të gjitha aspektet e të qenët mashkull ose femër. Pra, është e pamundur të studiohet riprodhimi i njeriut, pa e diskutuar atë edhe nga aspekti kulturor, psikosocial dhe etik. Këto aspekte të sekusalitetit ndërlidhen dhe plotësohen mes veti.

Seksualiteti ka së paku 4 dimensione: ***biologjik, psikosocial, etik*** dhe ***kulturor***

Dimensioni ***biologjik*** përfshin: pamjen fizike, dëshirën seksuale dhe reagimin ndaj ngacmimit seksual, aftësinë e riprodhimit ose të kontrollit të fekondimit (fertilitetit), si dhe rritjen dhe zhvillimin e përgjithshëm.

Dimensioni ***psikosocial*** u referohet ndjenjave të njerëzve dhe pikëpamjeve të tyre për vetveten dhe të tjerët. Nga përvoja personale njerëzit mësojnë, se si t'i shprehin emocionet dhe në ç'mënyrë të sillen si krijesa seksuale. Ky mësim nuk përfshin vetëm atë se çka bëjnë njerëzit, por si dhe përse e bëjnë atë.

Dimensioni ***etik*** përcakton vlerat, të cilat ndikojnë edhe në seksualitet. Vlerat krijohen nga ajo, se si njerëzit e vlerësojnë sjelljen dhe, se si i marrin vendimet lidhur me atë, se ç'ka është e drejtë e çka jo, bazuar në besimin e tyre fetar, vlerat familjare ose në ndonjë sistem tjetër vlerash.

Dimensioni ***kulturor*** është shuma e gjithë ndikimeve të jashtme, si atyre historike, ashtu edhe atyre të së tashmes, që ndikojnë në mendimet dhe veprimet e individëve. Shumë mendime rreth seksualitetit janë relative për kohën, vendin dhe rrethanat. Traditat sekusale, përgjegjësitë gjinore dhe ligjet përcaktuese të praktikave seksuale janë funksione të kulturës. Sot, ndikimin kryesor kulturor në seksualitet e kanë mediat, institucionet sociale, raportet ndërpersonale dhe praktikat e standardeve familjare.

PËRFUNDIM

- Seksualiteti fillon nga moment i lindjes dhe zhvillohet gjatë gjithë jetës;
- Shëndeti seksual ka kuptim më të gjërë, sesa mosprania e sëmundjes; ai përfshin edhe përgjegjësinë seksuale dhe zgjedhjen e qëlluar, për ta shprehur seksualitetin personal dhe
- Seksualiteti ka dimension fizik, psikosocial, etik dhe kulturor.

LITERATURA

1. Strang L, Gonzales-Caro N, Kane WM. Healt Facts. Reproductive Health and Pregnancy Prevention. ETR Associates. Santa Cruz, California – USA 2004: 15-18.

SUMMARY

DIMENSION OF SEXUALITY
- Medicine based in facts -

Hasmije Izairi–Aliu[1]
[1]Hospital of Gynecology and Obstretics, Cair, Skopje, Macedonia

Sexuality includes all the aspects of being mail or female. It begins from the moment of birth, grows the hole life and it is just about the reproduction. The individual sexuality is infuented by the viewpoint, values, religion and the culture. Sexuality has a physic, psychosocial, ethic and cultural dimension.

Key words: *Sexuality, dimension*

HISTORI / HISTORY

A E DINI SE?

Cushing sindromin (hiperadrenokorticizmi) e përshkruajti dhe e sqaroj **H. W. Cushing** në vitin 1932, kurse **sëmundjen Cushing** e përshkruajti në vitin 1932.
Daltonizmin i pari e përmendi **Huddart** në vitin 1777; e zbuloj **John Dalton** në vitin 1798, kurse e sqaroj **A.F. Holmgren** në vitin 1878.
Dezinfeksionin e duarve me alkool dhe sublimat e inauguroj **Paul Fürbringer** në vitin 1888.
Diabetin e broncit i pari e përshkruajti **Pierre Marie** në vitin 1895.
Diabetes insipidus e definoi **Thomas Willis** në shekullin e XVII dhe **William Cullen** në shekullin e XVIII. E ndau na diabeti i sheqerit **Johann Peter Frank** në vitin 1794.
Diabetes mellitus i pari e përshkruajti **Aretej** në shekullin e II të e.s.; shijen e ëmbël të urines e konstatoj **Thomas Willis** në vitin 1673; praninë e sheqerit në urine e vërtetoj **Matthew Dobson** në vitin 1775; hiperkliceminë te diabetikët e zbuloj **John Rollo** në vitin 1797; diabetin pas ekstirpacionit të pankreasit e vërtetuan **Joseph von Mering** dhe **Minkowski** në vitin 1889.
Ductus thoracicus i pari e përshkruajti **Jean Pecquet** në vitin 1647 dhe pavarsisht nga ky **Thomas Bartholin** në vitin 1652.
Duodenal, sonda e promovojë **Max Einhorn** në vitin 1908.
Dystrophia adiposogenitalis i pari e përshkëruajti **Alfred Fröhlich** në vitin 1901.
Ekinokokun e ka njohur **Hipokrati.** E studio **J. A. Goeze** në vitin 1781. E përshkruajti dhe e emëroj **K.A Rudolphi** në vitin 1801.
Eklampsia, mjekimin konzervativ e promovojë **V.V. Stroganov** në vitin 11897.
Ekstirpimin e veshkës I pari e realizojë **Enrico Bottini** në vitin 1890.
Ekstirpimin e uterusit e realizoj i pari **W.A. Freund** në vitin 1878; ekstirpimin total abdominal e realizojë **Alwin Mackenrodt** në vitin 1894; e përpunojë **Ernst Wertheim** në vitin 1897.
Ekstrasistolat i pari i përshkruajti **J.B. Bouillaud** në vitin 1835; I pari i studiojë **James Meckenzie** në vitin 1902.
Eksudative, **diateza** e zbulojë **Adalbert Czerny** në vitin 1905.
Elektroencefalografinë e promovojë **Hans Berger** në vitin 1931.
Elektroforezën e promovojë **Arne Tiselius** në vitin 1937.
Elektrokardiografinë e themeloi **Willem Einthoven** në vitin 1902.
Elektrolitik disociacionin, teorinë e themeloj **Svante Arrhenius** në vitin 1884.
Elektromagnetin në okulistikë e promovojë **Julius Hirschberg** në vitin 1885.
Elektronike, teorinë e themeloj **Hendrik Snton Lorentz** në vitin 1883.
Elektronik, mikroskopin e konstruojë **Hans Busch** në vitin 1926; e përsosën **Max Knoll** dhe **Ernst Ruska** në vitin 1931.
Elektro-shok terapinë e promovuan **Lucio Bini** dhe **Cerletti** në vitin 1938.
Embolinë, e definoj **Rudolf Virchow** në vitin 1846; **operacionin** e embolisë e realizojë i pari **Martin Kirschner** në vitin 1924.
Emfizema pulmonum i pari e përshkruajti **René Théophile Hyacinthe Laennec** në vitin 1924.
Encefalografinë e promovojë **W.E. Dandy** në vitin 1918.

(Vazhdon në numrin e ardhshëm)

Përgatiti: Prof. dr sci. Remzi Izairi

RELAKSIM / RELAX

"Në hulumtimet mjekësore me njerëzit, kujdesi për gjendjen e mirë shëndetësore të njeriut duhet të ketë përparësi ndaj interesave të shkencës dhe shoqërisë".

ZBULUES I QARKULLIMIT TË GJAKUT



William Harvey, 1578-1657

William Harvey, u lind në vitin 1578 në Folkeston, Angli. Studioj në Cambridgeu, ku në vitin 1597 bëhet "Baccalaureus artium". Në vitin 1598 shkon në Padovë, ku e themelon "thetarum anatomicum". Në vitin 1602 Harvey mbron doktoranturën dhe këthehet në Londër ku punon si mjek prakticist. Në vitin 1607 bëhet anëtarë i Royal College of Physicians dhe mjek në spitalin londinez. Në vitin 1615 merr titullin profesor i anatomisë dhe fiziologjisë. Në vitin 1616 e zbulon qarkullimin e gjakut, kurse në vitin 1628 e boton veprën e vet "Exercitatio anatomica de motu cordis et sanguinis in animalibus". Hasi në kundërshime te kolegët e vet. "Excercitationes de generatione animalium" është vepra e dytë e madhe e Harveyit. Vdes në vitin 1657 në Rochampton.

Në veprën e vet "Exercitatio anatomica de motu cordis et sanguinis in animalibus", i hedh poshtë mësimet e gabushme dhe vërteton se:

a) gjaku qarkullon;
b) pulsi arterial është pasojë e kontraksionit të zemrës;
c) të dy anët e zemrës kanë ndërtimin e njëjtë si dhe enët e mëdha të gjakut;
d) zemra është qendra e qarkullimit të gjakut dhe se ajo tkurret dhe relaksohet;
e) "kur tkurret, zemra e hedh gjakun në arterie në të gjitha drejtimet, kur relaksohet, gjaku prej periferisë, nëpërmjet venave, këthehet në zemër".
f) zbulues i valvulave venoze.

Të gjitha konstatimet e W. Harvey-it janë aq të sakta dhe aktuale sa që asnjë nuk është hedhë poshtë si e gabueshme.

W. Harvey nuk dha sqarim për qarkullimin kapilar. Ai mendonte se në inde ka pore nëpër të cilat gjaku drejtpërdrejt prej arteriolave kalon në vena.

Përgatiti: Prof. dr sci. Remzi Izairi

Provoni dijen tuaj?
Cilët alkaloide i përmban tinktura e opiumit?

LAJME PERSONALE / PERSONAL NEWS

DOKTOR I SHKENCAVE MJEKËSORE



Nasir Behxheti, mjek, magjistër, asistent

Mr. sci. dr Nasir Behxheti me datë 01.02 2011 në Fakultetin e Mjekësisë, të Universitetit të Tiranës, me sukses e mbrojti temën e doktoraturës me titull**: "Farmakokinetika dhe farmakodinamika e antibiotikëve makrolid, me theks të vaçant azitromicina në mjekimin e infeksioneve të traktit respirator"**, para komisionit shkencorë në përbërje: **Prof. dr sci.Ylli Sarolli, Kryetar, Prof. dr sci. Genc Burazeri, Prof.dr sci.Tatjana Nurka, oponent, Prof. dr sci. Xheladin Çeka dhe Prof.dr sci. Gëzim Boçari, anëtar.**

Autori në tezën e doktoraturës me titull: **"Farmakokinetika dhe farmakodinamika e antibiotikëve makrolid, me theks të vaçant azitromicina në mjekimin e infeksioneve të traktit respirator"**, ka paraqitur përparsitë e azitromicinës ndaj antibiotikëve tjerë makrolid duke u bazuar në farmakokinetikën dhe farmakodinamikën e tyre në mjekimin e infeksioneve të traktit respirator. Këto përparësi bazohen në: mënyrën e dozimit shumë të shkurtë (një herë në ditë, vetëm 3 ditë), kurse organizmi është i mbuluar me bar edhe 10 ditë pas mbarimit të terapisë d.m.th. koncentrim maksimal të substancës aktive në vatrën e infeksionit edhe pas 10 ditëve të mbarimit të terapisë, spektrin antimikrobial, tolerancën, formën dhe mënyrën e përdorimit të barit. Spektri i gjërë i veprimit, farmakokinetika dhe farmakodinamika specifike, terapia e shkurt e bëjnë azitromicinën bar të qëlluar në mjekimin e infeksioneve respiratore te fëmijët dhe të rriturit.

Autori përfundon se të gjitha këta karakteristika të mesipërme janë tregues të qartë, që azitromicina mund të përdoret gjërësishtë në punën e përditëshme të mjekëve të profileve të ndryshme në ambientet ambulantore dhe ato spitalore.

Redaksia, për prezantimin e rezultateve origjinale, autorut i dëshiron suksese në punën e mëtutjeshme profesionale, shkencore dhe edukative.

Përgatiti: Prof. dr sci. Remzi Izairi

LETEËR REDAKSISË / LETTER TO THE EDITORY

I nderuar Prof. dr Remzi Izairi,
Uroj të jeni mirë me shëndet, Ju dhe familja Juaj.
Jam mjeke obstetre gjinekologe në Departamentin e Obstetrikë Gjinekologjisë në Spitalin Rajonal Durrës.
Morra informacion për Simpoziumin qe do të zhvillohet në Kërçovë (ku dëshiroj të marr pjesë) nga i nderuari z. S. Sulejmani dhe në ate faqe interneti mësova për revistën Tuaj prestigjoze MEDICUS. Pashë në ate reviste punime serioze të kolegëve dhe do të dëshiroja të botoj dhe une një punim timin.
U mundova të plotesoj siç duhet rregullat për shkrimin e materialit që po dërgoj duke shpresuar që të pranohet nga ana Juaj për botim dhe duke Ju falënderuar njëkohësisht për mundësitë pozitive që na ofroni për bashkëpunim nëpërmjet revistës Tuaj.
Jam në pritje të përgjigjes Suaj. Ju falënderit.
Me respekt.
Diana Shahini, Durrës, Shqipëri

……..
Përshëndetje Profesor Remzi,
Uroj gjithë të mirat për Ju dhe familjen Tuaj,
Vërtet që u mrekullova kur lexova on-line pjesë nga Revistat Tuaja.
Do ishte fat nëse edhe unë do të jem e vlerësuar për të qenë pjesë e kësaj reviste.
Gjithsesi unë po e dërgoj njëherë publikimin tim.
Është në Anglisht, sepse kuptova që edhe në anglisht mund të botoni.
Nëse keni ndonjë kërkesë, apo vërejtje, Ju lutem shumë më vini në dijeni.
Jam në pritje për vlerësimin Tuaj
Me shumë respekt
Dr Manika Kreka, Tiranë, Shqipëri
……..

Profesor i nderuar,
Dua të ju falënderoj për mikpritjen dhe kujdesin që treguat gjatë tërë kohës sa qendruam në Simpozium. Shpresoj për një bashkpunim shkencor edhe në të ardhmen. Besoj se do të jeni i gatshem ta bëni ndonjë recenzion të botimeve që jamë duke i përgatit ose eventualisht të më ofroni mbajtjen e ndonjë cikli të shkurtër ligjëratash nga Emergjenca me studentët e Universitetit të Tetoves.
Pres edhe ndoj koment për librin: Emergjencat medikale në fatkeqësi dhe katastrofa.
Shumë suksese dhe shëndet ju dëshiroj.
Me nderime
Mr sci. dr Isuf Bajrami, Prishtinë, Kosovë
……..
Profesor i dashur,
Ju uroj gjithë të mirat.
Pranoni falënderimet dhe urimet e mija për takimin e Kërçovës. Ishte vërtet nje organizim i mirë dhe një mundësi për t'u takuar me kolegët.
Shumë të fala.
Dr Gentian Vyshka, Tiranë, Shqipëri
……..

I nderuari Prof. Remzi,
Takimet profesionale shkencore të cilët i organizon çdo vitë me radhë Shoqata e Mjekëve Shqipëtarë në Maqedoni kanë një vend të posaçëm për lidhjet tona në disa fusha:

- profersionale,
- kombëtare dhe
- miqësore

Me nderime
Prim. dr Gani Karamanaga
Ulqin, Mali i Zi

……

Porfesor i nderuar,
Desha të Ju lajmeroj se punimi i "Fibromialgjisë" sot na është botuar në një revistë të Sarajevës, ku ne e patem dërguar më herët me shume pak shpresë që do te publikohej! Duke e ditur se nuk lejohet publikimi i një punimi dy herë, në emër timin, të dr Afrimit, Ju falënderoj shumë për sygjerimet, korigjimet që treguat gatishmëri të na i jipni vazhdimisht! Unë personalisht, mburrem që në trojet shqiptare kemi një njeri të madh si ju, me të cilin edhe ne specializantët gjejmë shumë lehtë gjuhën e komunikimit, virtyt ky të cilin shumë rrallë e ndeshim në mesin e mësimdhënësve dhe profesorëve tanë!
Me shumë respekt!
Dr Jehona Ismaili, Prishtinë, Kosovë
.....

Pocituvani Profesore Remzi,

Ve pozdravuvame i Vi poželuvame uspešna rabota so Vašiot časopis i se nadevame na profesionalna sorabotka.
Vo ime na taa ideja bi sakale da ni kazete koga može da aplicirame za trud vo Vašiot cenet časopis, deadline za trud - propozicii.
Pozdrav
As Biljana Zafirova, MD, PhD
As Biljana Trpkovska, MD, MsC
Institut za anatomija
Medicinski Fakultet, Skopje, Makedonija
……
Te nderuar Kolege dhe Stafi botues,0
Është hera e parë që bie në kontakt me botimin tuaj MEDICUS. Është mjaft interesant dhe komplimenta dhe nga ana ime. Do te doja më shumë informacion dhe të dhëna në lidhje me kriteret e një botimi. Mesa lexova del dy here në vit dhe besoj se për këtë vit e keni mbyllur?
Me respekt
Shpëtim Qyra
Mjek mikrobiolog
Instituti i Shendetit Publik. Tiranë, Shqipëri
…….
I dashur Prof Remzi,

Së pari Ju prezantohem, quhem Igli Zhilla, anestezist pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në Tiranë. Jam interesuar dhe jam lexues i rregullt i revistes Medicus. Do të dëshiroja të merrja pjesë edhe unë me një punim timin në numrin e ardhshëm të revistës. Punimi titullohet "Anestezia gjenerale në heqjen e trpave të huaj në rrugët e poshtme respiratore". Do të dëshiroja të dija nëse është e mundur dhe nëse po kur është afati i fundit i pranimit të punimit.

Me shume respekt,
Dr Igli Zhilla, Tiranë, Shqipëri
……

I nderuari Profesor,
Në shenjë respekti ndaj punes suaj shkencore të palodhshme, dhe revistes suaj, (ashtu siç Ju kam premtuar) po ju dërgojmë një punim tonin origjinal. Që në fillim Ju kërkoj falje për numrin më të madh se sa që duhet të fjalëve në Rezyme, por nuk munda ta zvogloj numrin e tyre pa e cungu përmbajtjen. Arsye për këtë është përpunimi i gjerë statistikor i punimit dhe sasia e madhe e informatave që e përmban ky punim.
Jam i bindur se edhe vitin e ardhshem, ashtu sikurse vitet e kaluara, me ndihmën e Zotit, Ju do të organizoni Takim Profesional Mjekesor. Andaj, ne do të çmojmë nëse Ju (bordi i juaj) e shihni se e vlen që ky punim modest i yni të gjindet në mesin e punimeve tjera (qoftë për takim apo për revistë).
Duke Ju dëshiruar gjithë të mirat Ju përshëndesim,
Dr Agron Rexhepi, Prishtinë, Kosovë

……

I nderuari prof Remzi,

Ju përshëndes nga Prishtina dhe Ju përgëzoj për punën që jeni duke e bërë në revistën MEDICUS.
Dëshiroj dhe kam nderin që edhe unë të kontriboj në revisten Tuaj me një punim shkencor, eksperimental, të punuar në Institutin e Fiziologjisë të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë, e që është njëkohësisht edhe pjesë e temës së doktoraturës që shpresoj ta mbrojë së shpejti në Universitetin "Kiril Metodij", në Shkup.
Por, para se ta dergoj punimin, më duhet të dijë se a ka mundësi që punimi të publikohet në numrin e parë të revistes MEDICUS 2011, natyrisht nëse i plotëson kriteret për publikim në revistën Tuaj.
Shpresoj në mirëkuptimin dhe bashkpunimin Tuaj!
Me respekt,
Dr Antigona Hasani MSC
Spec. e Anesteziologjise dhe Reanimacionit, Prishtinë, Kosovë

…….

I nderuar Prof.Remziu,

Para së gjitha uroj shumë mirëshëndetin Tuaj. Jame një mjek Fadil Gradica i datëlindjes 1968. kirurg torakal në Spitalin Universitare të Sëmundjeve të Mushkrive, Tiranë, Albania. Nga kolegët kam dëgjuar fjalë shumë të mira për revisten Tuaj medicinale për të cilën shpreh dhe unë gatishmërinë time për të dërguar materiale shkencore të aktivitetit profesional të departamentit tonë të kirurgjisë.
Ju uroj gjithë të mirat.
Urimet më të mira për festat e fundvitit dhe vitin e Ri 2011.

Sinqerisht
Dr.Fadil Gradica
University Hospital of Lung Disease "Shefqet Ndroqi"
Thorax Surgery Department, Tirane Albania.
e mail:fadilgradica@yahoo.com
tel.cel.++355(0)682130841

…….

I nderuar Prof. Izairi,
Unë jam dr Agron Dogjani, kirurg i përgjithshëm në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar në Tiranë. Jam anëtar prej vitesh i ESTES, IATES , ISS/SIC i këtyre shoqatave presigjoze Europiane dhe botërore ku botoj dhe mbajtur referime të shumta në revista dhe kongrese kirurgjikale ndërkombetare. Aktualisht medical director i telemjekësisë në Shqipëri.
Por sot rastësishte lexova revisten ―MEDICUS organ i SHMSHM, e cila më ngacmoj me seriozitetin e organizimit dhe publikimeve të realizuara në këtë numër Vol. XI (1) Qershor, 2009.
Duke Ju uruar punë të mbarë në rrugën e gjatë dhe të

lodhshme por shumë fisnike, më lejoni dhe mua të kontriboj sado pak me disa
botime origjinale të pa botuara ose referuara më parë në asnjë revistë apo kongres kombëtar dhe ndërkombetar.
Pershendetje të ngrohta
Dr Agron Dogjani
Kirurg i përgjithshëm
Spitalin Ushtarak Qendror Universitar,
Qendra Kombetare e Traumes , Tiranë, Shqipëri

.....

Prof. Remzi pershendetje!

Ky është kontakti parë me Ju dhe unë Ju uroj së pari Gëzuar dhe një vit i mbarë.
Ju falënderoj për bashkepunimin me Ju në botimin e materialeve tona paranë MRDICUS.
Në botimin e fundit të 2010 që Ju dërguat me Dr. Bajarakarin unë vura re me vëmendje që kishte një seksion të veçantë për promovimin e librave të botuar. Së fundmi unë dhe një kolegu im kemi botuar "Dietologjinë" libër për sudentët e infermieristikës dhe studentët e Shendetit Publik.

Nuk e di nëse këkrkesa që kam për një promovim të këtij libri pranë revistës Tuaj është i vlefshëm. Ju lutem nëse e konsideroni me vend kërkesën time. Jam në pritje të mendimit Tuaj.

Me respekt dhe gjithe te mirat
Dr. Lindita Molla

……
Pocituvan Profesore Dr. Remzi Izairi,

So blagodarnost za dosegasnata sorabotka, i so nadez za uspesna ponatamosba sorabotka Vi prakam tema so naslov :
Forensic Evaluation in Examiners with Criminal Behavior-prevention of criminal recidiv i bi Ve zamolila da bide objavena vo naredniot broj – Junskiot broj 2011, koj sega ke bide Medjunarodno naucno spisanije.
Odnapred Vi blagodaram i voedno Vi cestitam za uspehot na spisanieto koe i ponatamu napreduva i veke dostigna razmer na Medjunarodno naucno spisanije, koe e od golema vaznost za razvitok na naukata od oblasta na medicinata vo Makedonija.
So pocit,
Dr Valentina Talevska, Demir Hisar, Makedonija

……..

I dashur Profesor Remziu
Në radhë të parë dua t`ju pyes për shëndetin si jeni Ju dhe familja e Juaj, besoj
se jeni mirë .
Në këto momente të vështira për kombin shqiptarë me gjithë fushatën e shfrenuar
antishqiptare të të gjitha qarqeve antishqiptare, ne intelektualëve na del për
detyrë që t'u dalim për zot fateve tona me anë të punës sonë sistematike në çdo
lami të jetës ku punojmë dhe jetojmë .Në kuadër të asaj që sapo citova me lartë
unë Ju falënderoj nga zemra juve profesor për punën Tuaj sa fisnike edhe të
dobishme për të mbledhur gjithë ajkën mjekësore të kombit tonë pa dallim me Ju në
krye, për të bërë një revistë e cila tashmë është tashmë nje tribune mbarë shqipetare e shkencës mjekësore.
Unë jam përpjekur që në bazë të udhezimeve Tuaja të vlefshme të bëj rregullimet
e duhura për punimin mjeksor.
Shpresoj që të shihemi së shpejti

Me respekt të thellë
Dr Agron Dogjani, Tiranë, Shqipëri
.....
Pocituvani profesore Remzi,
Isto vremeno bi sakala, ako dozvoluvate da dadam nekoi sugestii kon vas, najdobro namerni. Ako e mozno da go izmenite ureduvackiot odbor t.e. da dodadete stranci (odnost spored Zakonot za obrazovanie treba da bide 60:40 vo korist na strancite), za da trudot pecaten vo MEDICUS bide vrednuvan so 6 boda. Toa e dobro za pomladite kolegi, koi i kako sto znaete i dosega bea ucesnici vo MEDICUS, a imaat potreba za izborite vo povisoki zvanja.

Mnogu pozdravi

Prof. dr Rozalinda Isjanovska, MD. PhD, epidemiologist
Institute of Epidemiology with biostatistcs and medical informatics
Medical faculty, University "St.Ciril & Metodij"
Vodnjanska No 31,1000 Skopje, Republic of Macedonia
Tel. office + 389 2 3114825
Tel. home +389 2 3061811
Tel.mob 070361311
……
I nderuar **Prof. dr Remzi**

Shprehur vlerësimin tim më të lartë për revistën Tuaj, e cila me të vërtetë po bëhet një urë lidhëse midis kolegëve. Do të kisha kënaqsinë, nese artikulli im do të merrej parasysh për tu botuar në revistën Tuaj. Duke shprehur edhe një herë vlerësimin tim maksimal për këtë revistë dhe duke Ju përshëndetur me këtë ndërmarrje Tuajen.

Me respekt
Neritan Myderrizi
shef i Klinikes Ortopedike
Spitali Rajonal Durres
L8 Rr:Aleksander Goga Durres Albania
cel:00355692082301
e-mail:nmyderrizi@yahoo.com
……
I nderuar Prof. dr Remzi Izairi!

Unë që po ju shkruaj jam Sajmir Kullolli, Drejtor i Qendrës së Osteoporozez "Harrison" me qendër në Tiranë.
Kam parë në internet revisten Tuaj Medikus. Jam i interesuar për botimin e një artikulli lidhur me osteoporozën në Shqipëri, një studim i kryer nga qendra jonë gjatë vitit 2010 sponsorizuar nga kompania farmaceutike Novartis.
Ndëkohë jam i interesuar për bashkepunim të vazhdueshëm.
Ju lutem ,nëse keni hapësirë botimi dhe bashkepunimi më ktheni një përgjigje.
Drejtoreshë të projektit kemi patur Prof.Teuta Backa (Cico) Rheumatologe.
Mendoj që është një artikull me vlerë pasi një poster na është miratuar për botim në Kongresin Europian të osteoporozëz që mbahet këtë vit në Valencia.

Falënderit,
Me respekt,
Sajmir Kullolli
Drejtor i Qendrës "Harrison"
……

I nderuari profesor Remzi,
Së pari shpresoj të jeni mirë me shëndet Ju dhe familja Jauj.
Pas konferencës në Kerçovë fare nuk u dëgjuam. Ju falënderojmë për organizimin dhe mirëpritjen e shkelqyshëm nga ana Juaj. Spresoj të kemi prap takime të tilla me ide të reja dhe përshtypje të mira.
I nderuari professor, jam në fund të mbrojtjes së doktoraturës pranë Fakultetit të Mjekësisë në Shkup andaj më nevojitet edhe një punim për publikim. Kam arritur të perfundoj këtë punim që po Ju dërgoj.
Shpresoj se do të gjeni hapsirë për ta botuar në revistën Tuaj.
Me respect
Dr. Ferat Sallai, Prishtinë, Kosovë

……

I nderuar Profesor Remzi

Dëshiroj të jeni mirë me shëndet dhe punë. Më dukeni i palodhshem kur kujtoj punën tuaj në organizimin e Simpoziumeve dhe të revistës.
Pasi kemi kaluar shumë mirë në Simpoziumin në Kerçovë, dëshiroj të vazhdojë bashkëpunimin me Ju. Dua të di deri kur është afati për dorëzimin e punimeve për botim në revisten Tuaj.
Ju dëshiroj shëndet të plotë dhe suksese të reja. Mos harroni se nga angazhimi Juaj varen shumë aktivitete të rëndësishme mjekësore jo vetëm në Maqedoni.

Çdo të mirë nga
Dr Bajram Shaqiri, MD,MSc, otorinolaringolog
Sekretar i Shoqatës ORL-KKQ të Kosovës
Spitali Rajonal Gjilan, Kosovë

……

I nderuar Profesor Remzi!

Ju lutem më lejoni të prezantohem: Quhem Rezarta Shkreli, farmaciste në proçes doktorature pranë Universitetit të Tiranes, Fakultetit të Mjekësisë.
Ju përgëzoj për revistën Tuaj prestigjioze dhe me shumë vlera në zhvillimin e shkencës mbarëshqiptare si edhe një falenderim i veçantë është per Ju për mundesinë që na jepnin për botimin e artikujve tonë shkencore.
Une dhe koleget e mi kemi përgatitur një punim i cili ka të bëjë me kontrollin cilësor dhe sasior farmakopeal të tre tabletave xhenerike të barit Ibuprofen.
Ky bar është gjërësisht i përdorur në ditët e sotme kështu që mendoj se do ishte me shumë interes njohja dhe prezantimi i këtij punimi në revisten tuaj.
Në mungesë të një informacioni të saktë rreth dates së fundit të pranimit të punimeve më lejoni Ju lutem t`ju dërgoj një abstrak të këtij punimi dhe brenda javës t`Jua dërgoj punimin tonë të plotë.
Do ju ishim shumë mirënjohës nëse do na jepnit mundësinë e pranimit të tij.
Duke Ju falenderuar paraprakisht për mirëkuptimin Ju uroj gjithë të mirat dhe suksese të mëtejshme.

Me respekt Msc. Rezarta Shkreli

I nderuari Prof. Remzi Izairi,

Unë ndjehem i nderuar që punimi im i ka plotësuar kriteret për tu botuar në revisten tuaj. Uroj që ky bashkëpunim të jetë sa më i frytshëm dhe revista shkencore që ju udhëheqni të jetë një urë lidhëse midis kolegëve nga të gjitha trevat tona.
Ju përgëzoj për punën e madhe që jeni duke bërë në ngritjen e vlerave të shkencës mjekësore.
Ju falenderoj për kohën që i keni kushtuar punimit tim dhe shpreh mirënjohjen time për Ju.

Me respekt dhe konsideratë,
Dr.sci. Rexhep Kasumaj
QKUK.Klinika e Urologjisë,Prishtinë, Kosovë

RECENZENTË

Prof. dr sci. Snezhana Stoilova, Manastir, Maqedoni
Prof. dr sci. Lençe Mirçevska, Manastir, Maqedoni
Prof. dr sci. Dragan Danilovski, Shkup, Maqedoni
Prof. dr sci. Rozalinda Isjanovska, Shkup, Maqedoni
Prof. dr sci. Remzi Izairi, Çegran, Maqedoni
Prof. dr sci. Afërdita Manaj, Tiranë, Shqipëri
Prof. dr sci. Orion Gliozheni, Tiranë, Shqipëri
Ass. Mr sci. dr Arben Taravari, Gostivar, Maqedoni
Prof. dr sci. Rajmonda Niko, Tiranë, Shqipëri
Prof. dr sci. Durim Bebeci, Tiranë, Shqipëri
Prof. dr sci. Paskal Cullufi, Tiranë, Shqipëri
Prof. Asc dr sci. Nevyana Feschieva, Varna, Bullgari
Prof. Asc. dr sci. Stojanka Popova, Varna, Bullgari
Prof. dr sci. Antonio Gligorievski, Shkup, Maqedoni
Prof. dr sci Lupço Karevski, Shkup, Maqedoni
Prof. dr sci. Beti Zafirovska Ivanovska, Shkup, Maqedoni
Prof. dr sci. Anastasika Poposka, Shkup, Maqedoni
Prof. dr sci. Dhimitër Kraja,Tiranë, Shqipëri
Prof. dr sci. Betim Byku, Tiranë, Shqipëri
Prof. dr sci. Goran Kondov, Shkup, Maqedoni
Prof. dr sci. Tatjana Andreevska, Shkup, Maqedoni
Prof. dr sci. Eduard Gjika, Tiranë, Shqipëri
Prof. dr sci. Ilia Mazniku, Tiranë, Shqipëri
Prof. dr sci. Anila Godo, Tiranë, Shqipëri
Prof. dr sci. Adyla Bulo, Tiranë, Shqipëri
Prof. dr sci. Ali Kuqo, Tiranë, Shqipëri
Prof.dr sci. Anila Godo, Tiranë, Shqipëri
Prof. Dr sci. Sashenka Dega, Tiranë, Shqipëri
Alban Ylli, MD, MPH, PhD, Tiranë, Shqipëri
Mr sci. dr Kadri Haxhihamza, Shkup, Maqedoni
Ass. Mr sci. dr Arben Taravari, Gostivar, Maqedoni
Prof. dr sci. Nikollaq Leka, Tiranë, Shqipëri
Prof. dr sci. Ylli Sarolli, Tiranë, Shqipëri
Prof. Asc. dr sci. Dalip Limani, Prishtinë, Kosovë
Prof. dr sci. Behar Shehi, Tiranë, Shqipëri
Prof. dr sci. Eduart Hashorva, Tiranë, Shqipëri
Prof. dr sci. Zihni Sulaj, Tiranë, Shqipëri
Prof. Asc.dr sci. Ilia Mazniku, Tiranë, Shqipëri
Prof. Asis. dr sci. Avdyl Krasniqi, Prishtinë, Kosovë
Prof. Asc. dr sci. Gani Bajraktari, Prishtinë, Kosovë
Prof. dr sci. Lubica Pavlova, Shkup, Maqedoni
Prof. dr sci. Elez Selimi, Tiranë, Shqipëri
Prof. dr sci. Jul Bushati, Tiranë, Shqipëri
Prim. dr Ali Dalipi, Kumanovë, Maqedoni
Prof. dr sci. Milica Ivanoska, Shkup, Maqedoni
Prof. dr sci. Kujtim Karafili, Tiranë, Shqipëri
Prof. Asc. dr sci. Zihni Sulaj, Tiranë, Shqipëri
Prof. dr sci. Pjerin Radovani, Tiranë, Shqipëri
Prof. dr sci. Sulejman Zhugli, Tiranë, Shqipëri
Mr sci. Agron Gashi, Prishtinë, Kosovë
Mr sci. Fatlum Grajçevci, Prishtinë, Kosovë
Prof. dr sci. Vesna Pejovska Gerazova, Shkup, Maqedoni
Doc. dr sci. Branislav Stefanovski, Shkup, Maqedoni
Prof. dr sci. Çedomir Dimitrovski, Shkup, Maqedoni
Prof. dr sci.Slavica Shubeska Stratrova, Shkup, Maqedoni
Prof. dr sci. Sneyana Stoilova, Shkup, Maqedoni
Prim. dr Tome Hristovski, Demir Hisar, Maqedoni
Prof. dr sci. Kristin Vasilevska, Shkup, Maqedoni
Prof. dr sci. Liljana Siljanovska, Shkup, Maqedoni
Ass. dr sci. Agim Ramadani, Tetovë, Maqedoni
Prof. dr sci. Afrim Tabaku, Tiranë, Shqipëri
Prof. dr sci. Kristin Vasilevska, Shkup, Maqedoni
Ass. Mr sci. dr Arben Taravari, Shkup, Maqedoni
Prof. dr sci. Hasan Ahmeti, Prishtinë, Kosovë
Dr sci Irina Pavlovska, bp. profesional, Shkup, Maqedoni
Prof. dr sci. Hamdi Ramadani, Prishtinë, Kosovë
Mr sci. dr Salih Ahmeti, Prishtinë, Kosovë

Përgjigje në pyetjen e parashtruar:

Lulet dhe gjethet e thara të kërpit (marihuanës) ose rëshira e saj hashashi si dhe lëngu i tharë qumështor i lulekuqes, pas zhytjes në alkool (ethanol) e krijojnë tinkturën e opiumit, e cila përmban: Morphin, Codein, Noscapin, Papaverin, Narcotin, Narcein dhe shumë lëndë tjera.

Përgatiti: Prof. dr sci. Remzi Izairi

NJOFTIM
Vëllimi XVI (2) i Revistës "Medicus" do të del nga shtypi në Dhjetor, 2011.
Afati i dorëzimit të punimeve është deri më: **1 Shtator, 2011.**

UDHËZIME PËR AUTORË / GUIDELINES FOR AUTHORS

Medicus është revistë e mjekëve. Boton punime profesionale dhe shkencore të mjekësisë, prezantim rastesh, artikuj revyal, vështrime, risi nga mjekësia, recensione librash, raporte nga tubime shkencore dhe letra dërguar redaksisë. Pranohen vetëm punime origjinale dhe të pabotuara më parë diku tjetër. Punimet dhe shtesat tjera dërgohen në adresën e

Kryeredaktorit:
Prof. dr Remzi Izairi
1237 Çegran, Gostivar
e-mail: **shmshm@live.com**

Teksti i punimit dhe shtesave tjera

Punimet botohen në gjuhën shqipe ose në gjuhën angleze. **Autori, punimin e lekturuar bashkë me tabelat dhe fotografitë, si dhe një fotografi personale të formatit 3x4, është i obliguar ta dërgojë me postë elektronike në e-mail të Shoqatës.** Një autor mund të jetë bartës vetëm i një punimi, ndërsa bashkautor në më shumë tri punime. Punimi të shtypet në kompjuter, programi "Word for Windovs" (Times New Roman, madhësia e shkronjave 12, me 1 lines, me margjinë përreth 4cm, jo më tepër se 30 rreshta dhe 60 shenja në rend). Punimet origjinale shkencore, profesionale dhe revyale me të gjitha shtesat mund të kenë deri në 12 faqe të letrës së formatit A4; përshkrimi dhe prezantimi i rasteve 6 faqe, kurse raporti nga tubimet shkencore-profesionale, recensione librash, risi nga mjekësia dhe letër redaksisë 1 deri 2 faqe. Punimi duhet të jetë i saktë, i qartë dhe pa përsëritje.

Përgatitja e punimit, manuskriptit

Fleta e parë përmban **titullin** sa më të saktë dhe informativ të punimit, emrin dhe mbiemrin e plotë të çdo autori, emrin e institucionit ku është kryer punimi **dhe rezymenë** në gjuhën shqipe. **Rezymeja** duhet të jetë e shkurtër, jo më shumë se 150 fjalë ose 15 rreshta. **Rezymeja** përmban vështrimin e përgjithshëm të temës, qëllimin e punimit, materialin dhe metodat e punës, rezultatet dhe përfundimet kryesore, pa citate nga literatura. **Rezymeja** duhet të jetë faktografike, jo përshkruese dhe të shkruhet në **vetën e tretë njëjës.** Shkurtesat, përveç këtyre standardeve të matjes, të mos përdoren. Nën rezyme shënohen **2-5 fjalë ose fraza të shkurtra kyç ose bosht**, që janë thelbësore për identifikimin dhe klasifikimin e përmbajtjes së punimit.

Fleta e dytë përmban titullin e punimit, emrin e institucionit ku është kryer punimi dhe **rezymenë** e punimit me **fjalët kyç** në gjuhën angleze.

Fleta e tretë fillon me **tekstin e punimit** i cili përmban: **hyrjen, materialin dhe metodat, rezultatet, diskutimin dhe përfundimin.**

Hyrja shkruhet në **kohën e tashme**. Duhet të jetë e shkurtër dhe të prezantojë në mënyrë të qartë e të saktë thelbin e problemit të studimit dhe qëllimin e punimit. Referencat që merren me këtë problem të përmenden në mënyrë telegrafike. Të dhënat nga literatura (autorët, citatet), kudo që përmenden në tekst të punimit, duhet të shënohen në kllapa ( ), me shifra arabe dhe duhet t'u përgjigjen atyre në regjistrin e **literaturës**.

Materiali dhe **metodat** e punës shkruhen në **kohën e kaluar**. Duhet të përmbajnë të dhënat se **çka dhe si, ku** dhe **kur** është bërë punimi. Metoda e punës duhet të përshkruhet qartë, kurse metodat e njohura nuk përshkruhen por përmenden nga cila literaturë. Barënat shkruhen me emrin e tyre gjenerik.

Rezultatet e punimit shkruhen në **kohën e kaluar**. Duhet të paraqiten në mënyrë të saktë dhe të qartë, të shënohen me njësi të SI ose në kllapa edhe me njësi matëse tradicionale. Rëndësi të veçantë ka përpunimi statistikor i rezultateve.

Diskutimi shkruhet në **kohën e tashme** dhe është interpretim i rezultateve të fituara dhe krahasimi i tyre me njohuritë e deritanishme e me të dhënat nga literatura.

Përfundimi del nga qëllimi i punimit dhe diskutimi. Duhet të jetë i thuktë. Në përfundim autori jep mendimet, sugjerimet dhe propozimet e veta.

Mirënjohje e shkurtër kushtuar atyre që e kanë ndihmuar autorin mund të shkruhet në fund të tekstit.

Tabelat, fotografitë dhe skicat

Çdo **tabelë, fotografi dhe skicë duhet të shtypet në tekst në vendin e paraparë**. Tabela, përveç numrit, duhet të përmbajë titullin dhe pjesën tekstuale në gjuhën shqipe. **Titulli** i shkurtër dhe i kuptueshëm shënohet në krye të tabelës, kurse shënimet shpjeguese nën tabelë. Shkurtesat e përdorura duhet të shpjegohen nën tabelë, sipas renditjes alfabetike. Të mos përdoren titujt vertikal. Shtyllat të shënohen me shifra romake ose me shkronja të mëdha siç sqarohen në legjendë.

Përshkrimi i fotografisë ose legjenda duhet të bëhet nën fotografi dhe të ketë numrin rendor. Preferohet që vendet e rëndësishme të fotografisë të shënohen me shigjeta. Të sëmurëve gjatë fotografimit u mbyllen sytë me një shirit të zi për të mos u identifikuar. Marrja dhe riprodhimi i tabelave, fotografive dhe e skicave nga autorë të tjerë,duhet të bëhet me lejen e botuesit dhe të autorit.

Të gjitha shkrimet në ilustrim duhet të jenë në gjuhën shqipe.

Regjistri i literaturës. Autorët (referencat), të cilat përmenden me shifra arabe në kllapa ( ) në tekstin e punimit, në regjistër të literaturës radhiten sikurse janë përmendur në tekst. Shënohet numri rendor arab, pastaj të gjithë autorët e referencës, përveç kur janë më shumë se 6 autorë, kur do të shkruhen 3 autorët e parë me shkurtesën bp. Pika nuk përdoret pas inicialeve të emrave të autorëve. Shkurtesat për revista shënohen sipas regjistrit në **Index medicus.**

Shembuj për regjistrim të literaturës nga:

Revista

Izairi R, Izairi-Aliu H, Izairi A. Përvojat tona në diagnozën dhe mjekimin e angjinës-faringitit streptokoksik. Medicus 2004; vol. 1 (1):5-9.

Libri dhe Monografia

Rexhepi J. Ekzaminimi klinik i sëmundjeve të brendshme. Prishtinë, 1982:22-6..

Kapitulli i librit

Petani H. Hipertensioni esencial. Në: Adhami JE. Traktati i sëmundjeve të brendshme. Tiranë: "Mihal Duri", 1974: 207-230.

Përmbledhje e punimeve

Izairi-Aliu H, Aliu B, Izairi H, Izairi R.Graviditeti dhe artriti reumatoid. Përmbledhje e punimeve. Takim Profesional Mjekësor 2003. Tetovë, 2003:173-8.

Disertacioni dhe Magjistratura

Rexhepi S. Veçoritë e artritit reumatoid në pleqëri. Tezë e disertacionit. Universiteti i Prishtinës. 1997,34.

Fleta e fundit. Për çdo autor, në fletë të veçantë, shkruhet shkalla e titullit akademik, fusha e specializimit, institucioni, adresa e punës dhe e banimit, si dhe numrat e telefonit dhe e-mail.

Udhëzimet për autorin janë adaptuar sipas rekomandimeve të **Uniform Requirements for Manuscripts Submitted To Biomedical Jurnals. N Engl J Med l991: 324:424-8**

NJOFTIM. Të gjitha punimet shqyrtohen nga botuesi. Punimet që nuk i plotësojnë kriteret e udhëzimeve, si dhe ato që i refuzon redaksia, i kthehen autorit. Punimet i nënshtrohen recensionit dhe redaktuarës gjuhësore. Redaksia e Revistës e cakton renditjen e botimit të punimit, rezervon të drejtën, si për pakësimin e vëllimit dhe numrit të ilustrimeve, ashtu edhe për përshtatjen e tekstit të punimit në bashkëpunim me autorin. Punimet nuk paguhen. Autorit i jepen 2 ekzemplarë të revistës "Medicus".

Verba volant, scripta manent" - "Fjalët fluturojnë, shkrimi mbetet"

DREJTUAR MJEKËVE DHE SHOQATAVE!

Nëse keni hasur në ndonjë risi mjekësore në literaturën botërore ose në sajtet e internetit që është interesante për lexuesit, ju lutemi që ta prezantoni në revistën "Medicus". Tekstin e shkruar në kompjuter, në Times New Roman, në formatin "Word for Windovs", deri në 50 rreshta, bashkë me një fotografi Tuajën të formatit 3x4cm, mund ta dërgoni në e-mail adresën e Shoqatës: shmshm@live.com

Po ashtu, mund të dërgoni informacione për ndonjë aktivitet të shoqatës Tuaj. Ju lutemi na informoni për: ditën, muajin dhe vitin e mbajtjes, vendin dhe objektin, emrin oficial të takimit dhe temat, organizatorin dhe kontakt adresën.

e-mail: **shmshm@live.com**
Web faqja: **www.medalb.com**

LEXUES TË NDERUAR

Nëse jeni të interesuar që t'i keni numrat vijues të Revistës "Medicus", atëherë drejtohuni në adresën e Kryetarit të Degës Tuaj dhe kërkoni numrin e revistës Tuaj.
Revista shpërndahet falas, kurse distribuimin e bën Kryesia e Degës Tuaj.
Nëse keni vërejtje në punën Tonë, Ju lutemi të gjitha vërejtjet dhe sygjerimet t'i drejtoni në adresën e Redaksisë.
Ju falënderit për bashkëpunimin dhe që jeni lexues të Revistës sonë.
Me respekt
Redaksia e Revistës "Medicus".